

‘Abdu’l-Bahá

PËRGJIGJE PËR DISA PYETJE

Original Title:

‘Abdu’l-Bahá, Some Answered Questions

Published by Bahá’í Publishing Trust USA, 1984, reprinted
edition 1990

Text: Albanian

Përkthyer e botuar nën kujdesen e Komitetit të Botimeve Bahá’í

© Asambleja Shpirtërore Kombëtare
e Bahá’í-ve të Shqipërisë
Rruga e Dibrës 59 - Tiranë
Botimi i parë 2000 - 157 E.B.

PËRMBAJTJA

Parathënie e Botuesit për botimin e vitit 1981	8
Parathënie e Botuesit për botimin e vitit 1964	12
Parathënie e Autorit për botimin e parë	13

Pjesa I

PËR NDIKIMIN E PROFETËVE NË EVOLUCIONIN E NJERËZIMIT

1. Natyra qeveriset nga një ligj i vetëm universal	15
2. Provat dhe dëshmitë e ekzistencës së Perëndisë	16
3. Nevoja për një Edukator	18
4. Abrahami	22
5. Moisiu	24
6. Krishti	25
7. Muhameti	27
8. Báb-i	32
9. Bahá'u'lláh-u	33
10. Prova tradicionale me shembuj nga Libri i Danielit	41
11. Koment për kreun e njëmbëdhjetë të Revelacionit të Shën Gjorit	48
12. Koment për kreun e njëmbëdhjetë të Isaisë	61
13. Koment për kreun e dymbëdhjetë të Revelacionit të Shën Gjorit	64
14. Prova shpirtërore	68
15. Pasuria e vërtetë	72

Pjesa II

DISA TEMA TË KRISHTËRIMIT

16. Format e jashtme dhe simbolet duhen përdorur për të shprehur koncepte intelektuale	75
17. Lindja e Krishtit	78
18. Madhështia e Krishtit u detyrohet përsosurive të Tij	79
19. Pagëzimi i Krishtit	81
20. Nevoja e pagëzimit	82
21. Simbolizmi i bukës dhe i verës	86
22. Mrekullitë	88
23. Ringjallja e Krishtit	90
24. Zbritja e Shpirtit të Shenjtë mbi Apostujt	92
25. Shpirti i Shenjtë	93
26. Ardha e dytë e Krishtit dhe Dita e Gjyqit	94
27. Trinia	96
28. Shpjegim i vargut pesë, kreu shtatëmbëdhjetë, të Ungjillit të Shën Gjonit	98
29. Shpjegim i vargut njëzet e dy, kreu pesëmbëdhjetë, të letrës së parë të Shën Pavlit drejtuar korintasve	100
30. Adami dhe Eva	103
31. Shpjegim i blasfemisë kundër Shpirtit të Shenjtë	107
32. Shpjegim i vargut “Sepse të shumtë janë ata që thirren, por të paktë ata që zgjidhen”	108
33. “Kthimi” për të cilin flasin Profetët	110
34. Deklarimi i Besimit nga Pjetri	112
35. Paracaktimi	115

Pjesa III

PËR FUQINË DHE KUSHTET E MANIFESTIMEVE TË PERËNDISË

36. Pesë aspektet e shpirtit	116
37. Hyjnia mund të kuptohet vetëm përmes Manifestimeve Hyjnore	118
38. Tri pozitat e Manifestimeve Hyjnore	122
39. Pozita njerëzore dhe pozita shpirtërore e Manifestimeve Hyjnore	124
40. Dija e Manifestimeve Hyjnore	126
41. Ciklet Universale	128
42. Fuqia dhe ndikimi i Manifestimeve Hyjnore	129
43. Dy kategoritë e Profetëve	131
44. Shpjegim i qortimeve që Perëndia u ka bërë Profetëve	133
45. Shpjegim i vargut të Qitapi Akdas-it “Nuk ka shok për Atë që është Agimi i Revelacionit në Pagabueshmërinë e Tij Supreme”	136

Pjesa IV

PËR PREJARDHJEN, AFTËSITË DHE KUSHTET E NJERIUT

46. Ndryshimi i llojeve	140
47. Gjithësia nuk ka fillim	142
48. Dallimi midis njeriut dhe kafshës	146
49. Rritja dhe zhvillimi i gjinisë Njerëzore	151
50. Prova shpirtërore të prejardhjes së njeriut	154

51. Shpirti dhe mendja e njeriut kanë ekzistuar që nga fillimi	156
52. Shfaqja e shpirtit në trupin	157
53. Raporti midis Perëndisë dhe krijesës	159
54. Shpirti njerëzor vjen nga Perëndia	161
55. Fryma, shpirti dhe mendja	163
56. Aftësitë fizike dhe aftësitë mendore	164
57. Shkaqet e dallimeve në karakteret e njerëzve	165
58. Shkalla e Dijes që zotërojnë njeriu dhe Manifestimet Hyjnore	169
59. Dija e njeriut për Perëndinë	170
60. Pavdekësia e shpirtit (1)	173
61. Pavdekësia e shpirtit (2)	175
62. Përsosuritë nuk kanë kufi	178
63. Përparimi i njeriut në botën tjetër	180
64. Gjendja e njeriut dhe përparimi i tij pas vdekjes	181
65. Shpjegimi i një Vargu nga Qitapi Akdas-i	183
66. Ekzistenca e shpirtit racional pas vdekjes së trupit	183
67. Jeta e pasosur dhe hyrja në Mbretërinë e Perëndisë	185
68. Fati	187
69. Ndikimi i yjeve	188
70. Vullneti i lirë	190
71. Vizionet dhe komunikimi me shpirtrat	192
72. Shërimi me mjete shpirtërore	194
73. Shërimi me mjete materiale	196

Pjesa V

ÇËSHTJE TË NDRYSHME

74. Mosekzistenca e së keqes	198
75. Dy lloje vuajtjeje	199
76. Drejtësia dhe mëshira e Perëndisë	200
77. Metoda e drejtë për trajtimin e kriminelëve	201
78. Grevat	205
79. Realiteti i botës së jashtme	208
80. Paraqenia reale	209
81. Ritrupëzimi	211
82. Panteizmi	217
83. Katër metodat për të fituar dije	222
84. Nevoja e ndjekjes së mësimëve të Manifestimeve Hyjnore	224

Treguesi Tematik

Treguesi Tematik	229
------------------	-----

PARATHËNIE E BOTUESIT PËR BOTIMIN E VITIT 1981

A mund ta njohim Perëndinë? A ka Perëndi? A mund të pajtohen mësimet fetare me dijet shkencore? Ç’do të thotë të jesh qenie njerëzore? Këto janë pyetje që dikur konsideroheshin fushë vetëm e filozofëve dhe e teologëve. Por nuk është më kështu. Në kohën tonë ato janë pronë e publikut. Qytetërimi ynë i tronditur e i hutuar, i çliruar nga besimet e vlerat që e kanë mbështetur atë për shekuj, po lëkundet në buzë të vetëshkatërrimit. Ne, individët e tij, po përjetojmë humbjen e kuptimit e të qëllimit në jetë, të cilin parardhësit tanë e pranonin si të mirëqenë. Sot këto pyetje kërkojnë përgjigje.

Përgjigje për disa pyetje trajton, në mënyrë tërheqëse, të përmbledhur e logjike, jo vetëm pyetje rreth Perëndisë dhe raportit midis shkencës e fesë, por edhe një varg të gjerë pyetjesh, që me siguri paraqesin interes për shpirtin që kërkon të vërtetën e fesë, si dhe për mendjen kureshtare, shkencore. Përgjigjet jepen nga ‘Abdu’l-Bahá-i, djali i Profetit-Themelues të Besimit Bahá’í, një fe e re dhe e pavarur botërore, që ka pasues praktikisht në çdo vend. Përgjigjet janë përmbledhur nga një seri bisedash që Ai ka bërë rreth tryezës gjatë viteve 1904, 1905 dhe 1906. Në secilën prej pesë pjesëve të librit ‘Abdu’l-Bahá-i shtjellon çështje që shtrihen nga metafizika deri te realiteti i gjallë. Nga njëra anë, Ai hyn në fushën e filozofisë për të diskutuar çështje të tilla si pavdekësia, predestinimi, vullneti i lirë dhe doktrinën e gabuara të ritrupëzimit—gjithnjë duke shkelur shtegun mistik me hapa praktikë. Nga ana tjetër, flet për çështje që kanë të bëjnë me organizimin e shoqërisë njerëzore—si problemi i grevave, trajtimi i kriminelëve dhe marrëdhëniet e drejta midis kapitalit e punës—duke futur në këto çështje të zakonshme shekullare domethënie shpirtërore.

Në pjesën e parë të Përgjigje për disa pyetje, ‘Abdu’l-Bahá-i përdor si provat logjike dhe ato tradicionale për të vërtetuar ekzistencën e Perëndisë dhe nevojën e Edukatorëve Hyjnorë apo të Manifestimeve të Perëndisë. Ai ua kushton disa biseda jetës dhe bëmave të disa prej këtyre Manifestimeve Hyjnore, duke përfshirë Abrahamin, Moisiun, Krishtin, Muhametin, Báb-in e Bahá’u’lláh-un dhe duke e parë secilin si një hallkë të mëtejshme në shpalosjen e planit të Perëndisë për

edukimin e njerëzimit. Ai hedh kështu dritë të re mbi historinë fetare dhe për vetë natyrën e fesë. ‘Abdu’l-Bahá-i i kthehet temës së Manifestimeve të Perëndisë në pjesën e tretë të librit, ku Ai ndriçon me hollësi më të madhe karakterin, pozitën dhe fuqitë e Qenieve të vetme të zgjedhura për të vepruar si zëdhënës të Perëndisë.

Në pjesën e dytë të Përgjigje për disa pyetje, ‘Abdu’l-Bahá-i parashtron pikëpamjen Bahá’í për një numër subjektesh të koklavitura kristiane. Ai i kushton vëmendje të veçantë çështjes së “kthimit” apo të Ardhjes së Dytë të Krishtit. Ai shqyrton gjithashtu lindjen e Krishtit, Ringjalljen, pagëzimin, domethënien e kungimit, mrekullitë e Krishtit dhe Trininë në një mënyrë që lexuesit e mësuar në doktrinën tradicionale Kristiane me siguri do ta gjejnë çuditërisht të freskët e sqaruese.

Në pjesën e katërt të librit, ‘Abdu’l-Bahá-i merret me prejardhjen, aftësitë dhe kushtet e njeriut. Pohimi Bahá’í për një harmoni e përputhje në themel midis shkencës e fesë del në pah në shpjegimin e Tij për prejardhjen dhe zhvillimin e species njerëzore. Pjesa e pestë dhe e fundit e librit u kushtohet subjekteve të ndryshme, duke përfshirë diskutime për bazat e dijes njerëzore dhe për panteizmin.

Përgjigje për disa pyetje, në stil e strukturë, ndryshon nga veprat e tjera të ‘Abdu’l-Bahá-it. Libri i Tij Vullneti dhe Testamenti, i shkruar në tri pjesë, vesh me autoritet Rendin Administrativ të Besimit Bahá’í dhe siguron integritetin e unitetin e tij. Sekretet e Qytetërimit Hyjnor është një traktat për gjendjen e përgjithshme të qytetërimit të sotëm. Tregimi i një Udhëtari përshkruan historitë e hershme të Besimeve Bábí e Bahá’í. Kujtimet e Besnikut përmban kujtimet e ‘Abdu’l-Bahá-it për shtatëdhjetë e nëntë Bahá’í-të e hershëm, të bashkuar të gjithë nga dashuria e tyre për Bahá’u’lláh-un. Vetëm Përgjigje për disa pyetje, që është ndërtuar mbi bazën e pyetjeve drejtuar Atij gjatë të ngrënit, i ofron lexuesit shtjellime për një larmi temash—çdonjëra prej të cilave mund të lexohet ose si e veçantë, si një çështje e veçuar për studim e reflektim, ose si pjesë e së tërës, që del nga një përmbledhje bisedash. Shumica e bisedave janë të shkurtra. Të gjitha bartin shenjat e të biseduarit. Të gjitha përdorin ilustrime të qarta e konkrete për të sqaruar tema të vështira. Humori zbut karakterin serioz. Në çdo rast, “një

thjeshtësi e shkëlqyer”, “bindje” dhe “forcë” ndriçon parimet themelore dhe çështjet e holla të besimit Bahá’í.

Besimi Bahá’í është themeluar nga Mirza Hysen Ali [Mírzá Husayn ‘Alí] (1817-1892), i njohur si Bahá’u’lláh-u, “Lavdia e Perëndisë”. Prejardhja e Besimit Bahá’í është e lidhur ngushtë me Besimin Bábí, të themeluar në Persi (Iran) më 1844 nga Mirza Ali Muhamet [Mírzá ‘Alí-Muhammad] (1819-1850), i njohur si Báb-i, ose “Porta”. Báb-i shpalli se Ai ishte jo vetëm themeluesi i një feje të pavarur, por edhe lajmëtari i një profeti e të dërguari të ri e shumë më të madh të Perëndisë, i Cili do të shpallte një epokë paqesje për gjithë njerëzimin. Më 1863, Bahá’u’lláh-u deklaroi se ishte Ai që qe profetizuar prej Báb-it.

Mësimet e Bahá’u’lláh-ut shpejt e sollën Atë në konflikt me qeverinë Persiane e me klerin mysliman dhe Ai u syrgjynos nga Irani në vende të ndryshme brenda Perandorisë Otomane. Më 1868 Ai u çua i burgosur në fortesën e qytetit të Akrës [‘Akká], në Tokën e Shenjtë, në rrethinat e së cilës Ai ndërroi jetë më 1892. Në testamentin e Tij Ai caktoi ‘Abdu’l-Bahá-in (1844-1921), djalin e Tij të madh, që ta zëvendësonte në udhëheqje të komunitetit Bahá’í dhe për të interpretuar shkrimet Bahá’í. ‘Abdu’l-Bahá-i, nga ana e tij, caktoi nipin e Tij të madh, Shoghi Effendi-un (1897-1957), si pasardhës të Tij, Ruajtës të Kauzës dhe intepretues të autorizuar të mësimëve Bahá’í. Sot, punët e komunitetit botëror Bahá’í administrohen nga Shtëpia Universale e Drejtësisë, këshilli i zgjedhur suprem i Besimit Bahá’í.

Mësimet bazë të Besimit Bahá’í janë njëshmëria e Perëndisë, njëshmëria e fesë dhe njëshmëria e njerëzimit. Parimet themelore të shpallura nga Bahá’u’lláh-u janë se e vërteta fetare nuk është absolute, por relative; se Revelacioni Hyjnor është një proces i vazhdueshëm e i shkallëzuar; se të gjitha fetë e mëdha të botës janë me prejardhje hyjnore; dhe se misionet e tyre përfaqësojnë fazat të shkallëzuara në zhvillimin shpirtëror të shoqërisë njerëzore. Meqenëse Bahá’u’lláh-u mëson se qëllimi i fesë është të mbjellë harmoninë e unitetin dhe se feja është faktori kryesor për arritjen e paqes e të progresit të rregullt në shoqëri, shkrimet Bahá’í japin skemën e institucioneve të nevojshme për vendosjen e paqes dhe të rendit botëror. Këto përfshijnë një federatë ose konfederatë botërore me organet e saj ekzekutive, legjislative e gjyqësore; një gjuhë ndihmëse ndërkombëtare; një ekonomi botërore;

një mekanizëm për ndërlidhje botërore; dhe një sistem universal monedhe, peshash e matjeje.

Shkrimet Bahá'í japin, gjithashtu, udhëheqje specifike që i ndihmojnë Bahá'í-të (pasuesit e Bahá'u'lláh-ut) të përmbushin qëllimin bazë të jetës njerëzore—të njohin e të adhurojnë Perëndinë dhe “të çojnë përpara një qytetërim në përparim të pareshtur”,—ndërkohë që përpiqen të realizojnë unitetin e njerëzimit, paqen botërore dhe rendin botëror. Për shembull, shkrimet Bahá'í bëjnë thirrje për formimin e një karakteri të mirë dhe për zhvillimin e të tilla vetive shpirtërore si ndershmeria, besueshmëria, dhembshuria e drejtësia. Këto arrihen me anë të lutjes, të përsiatjes dhe të punës që bëhet në frymën e shërbimit ndaj njerëzimit—që për Bahá'í-të janë të gjitha shprehje të adhurimit të Perëndisë. Në zbatim të parimit Bahá'í të njëshmërisë organike të njerëzimit, shkrimet Bahá'í bëjnë thirrje për çrrënjosjen e paragjyqimeve të racës, të bindjeve, të klasës, të kombit e të seksit. Ato bëjnë thirrje për eliminimin sistematik të të gjitha formave të bestytnisë që pengojnë përparimin njerëzor dhe për arritjen e një drejtpeshimi midis aspekteve materiale e shpirtërore të jetës, të cilat mbështeten të gjitha në kuptimin e parimeve të kërkimit të lirshëm të së vërtetës dhe të harmonisë midis shkencës e fesë si dy anë të së vërtetës. Ato inkurajojnë zhvillimin e talenteve e të aftësive unikalë të çdo individi, nëpërmjet studimit të dijeve dhe fitimit të aftësive, sepse marrja me tregti ose ushtrimi i një profesioni kërkohet jo vetëm për motive personale, por edhe për pasurimin e shoqërisë në tërësi. Ato bëjnë thirrje për pjesëmarrje të plotë të burrave e të grave në të gjitha aspektet e jetës së komunitetit, duke përfshirë proceset e zgjedhjeve e ato administrative si dhe marrjen e vendimeve, në zbatim të parimit Bahá'í të mundësive, të të drejtave e të privilegjeve të barabarta për të dy sekset. Ato bëjnë thirrje për mbështetjen e parimit të shkollimit të detyrueshëm për të gjithë.

Përgjigje për disa pyetje ka dalë në një numër botimesh, pasi u botua për herë të parë në Londër më 1908. Ky libër vazhdon të jetë një prej veprave më popullore e më të kërkuara në literaturën në rritje të Besimit Bahá'í. Dhe ç'është më e rëndësishmja, libri ka zenë një vend me peshë në literaturën e shenjtë të Besimit, duke qenë një prej përmbledhjeve të pakta të thënieve të 'Abdu'l-Bahá-it të konfirmuara

nga Vetë ‘Abdu’l-Bahá-i. Ky botim i ri bën edhe një herë që të gjendet me lehtësi një burim i paçmuar për studiuesin e mësimeve Bahá’í dhe për shpirtrat kërkues.

PARATHËNIE E BOTUESIT PËR BOTIMIN E VITIT 1964

Duke pasur parasysh pyetjet që kanë dalë kohë pas kohe lidhur me Përgjigje për disa pyetje dhe si është shkruar ai, Laura Clifford Barney, bashkëbiseduesja që mori përgjigjet nga ‘Abdu’l-Bahá-i, u ka bërë të njohur botuesve faktet që vijojnë:

Bisedat ndërmjet ‘Abdu’l-Bahá-it dhe Laura Clifford Barney u zhvilluan gjatë viteve të vështira 1904-1906, kur Ai ishte i internuar në qytetin e Akrës nga qeveria Turke dhe lejohej të priste vetëm pak vizitorë. Në atë kohë Ai ndodhej nën kërcënimin e vazhdueshëm që të internohej në një vend të largët të izoluar.

Si bashkëbiseduese, Zonjusha Barney e rregulloi që njëri prej dhëndurëve të ‘Abdu’l-Bahá-it ose njëri prej tre persëve të shquar të sekretariatit të Tij të asaj periudhe, të ishte i pranishëm gjatë bisedave për të siguruar saktësi në mbajtjen shënim të përgjigjeve të Tij lidhur me pyetjet që i bëheshin. Më pas, ‘Abdu’l-Bahá-i i lexonte shënimet, duke ndryshuar ndonjëherë ndonjë fjalë apo rresht me penën e Tij prej kallami. Më pas ato u përkthyen në Anglisht nga zonjusha Barney. Tekstet origjinale persisht janë sot pjesë e arkivave Bahá’í të Haifasë. Për sqarime të tjera lidhur me këtë vepër, referojuni deklaratave të Shoghi Effendiut në Perëndia Kalon Pranë, f. 107, 260, 268, 305 dhe 383.

‘Abdu’l-Bahá-i u lirua më në fund më 1908, pas revolucionit në Perandorinë Turke dhe përmbysjes së Sulltanit. Disa vite më vonë, Ai udhëtoi në Egjipt, në Evropë dhe në Amerikën e Veriut, duke mirëpritur njerëz të të gjitha besimeve fetare e klasave, duke takuar personalitete të shquara dhe duke folur para grupe njerëzish në tempuj, në universitete, në qendra e misione fetare, si dhe në takime miqësore nëpër shtëpi.

PARATHËNIE PËR BOTIMIN E PARË

“Ju kam dhënë momentet e mia të lodhjes”, ishin fjalët e ‘Abdu’l-Bahá-it, kur u ngrit nga tavolina pasi i ishte përgjigjur njërës prej pyetjeve të mia.

Ashtu siç ndodhi atë ditë, kështu vazhdoi; ndërmjet orëve të punës, lodhja e Tij gjente lehtësim në një veprimtari tjetër; nganjëherë Ai ishte në gjendje të fliste gjerë e gjatë; por shpesh, edhe pse subjekti mund të kërkonte më tepër kohë, Atë e thërrisnin pas pak çastesh; pastaj kalonin ditë, madje javë, gjatë të cilave Ai nuk kishte mundësi të më mësonte. Por unë mund të isha e duruar, sepse kisha gjithmonë para meje mësimin më të madh—mësimin e jetës së Tij vetjake.

Gjatë mjaft vizitave të mia në Akra, këto përgjigje mbaheshin shënim në persisht, ndërsa fliste ‘Abdu’l-Bahá-i, jo me idenë për t’i botuar, por thjesht që unë t’i kisha për t’i studiuar më pas. Në fillim ato duhej t’i përshtateshin përkthimit gojor të përkthyesit; ndërsa më vonë, kur unë kisha fituar njëfarë njohurie të persishtes, duhej t’i përshtateshin fjalorit tim të kufizuar. Kjo shpjegon përsëritjen e figurave e të frazave, sepse askush nuk mund të matet me ‘Abdu’l-Bahá-in në përdorimin fatlum të shprehjeve të goditura. Në këto mësimet, Ai është mësuesi që ia përshtat Vetën nxënësit të Tij, dhe jo një orator ose poet.

Ky libër paraqet vetëm disa aspekte të Besimit Bahá’í, i cili sjell një mesazh universal dhe i ofron çdo kërkuesi përgjigjen që i përshtatet zhvillimit dhe nevojave të tij të veçanta.

Në rastin tim, mësimet jepeshin në mënyrë të thjeshtësuar që t’u përshtateshin njohurive të mia fillestare, prandaj ato nuk janë aspak të plota e të përfunduara, siç mund të mendohet duke u nisur nga Pasqyra e Lëndës—Pasqyra e Lëndës është shtuar thjesht për të treguar çështjet e trajtuara. Por unë besoj se ajo që ishte aq e vlefshme për mua mund të jetë e dobishme për të tjerë, derisa të gjithë njerëzit, pavarësisht nga dallimet e tyre, janë të bashkuar në kërkim të realitetit; prandaj i kërkova ‘Abdu’l-Bahá-it lejën për t’i botuar këto biseda.

Fillimisht ato nuk u dhanë në ndonjë renditje të veçantë, por tani janë klasifikuar në njëfarë mënyre për të lehtësuar lexuesin. Është

ndjekur besnikërisht teksti persisht, ndonjëherë madje në dëm të anglishtes, janë bërë disa ndryshime në përkthimin atje ku dhënia fjalë për fjalë dukej tepër e ngatërruar dhe e errët; por fjalët e shtuara, që nevojiteshin për ta bërë më të qartë kuptimin, nuk janë evidentuar, me qëllim që të shmangej ndërprerja e tepruar e mendimit me shenja teknike ose shpjeguese. Gjithashtu shumë emra persianë e arabë janë shkruar në formën e tyre më të thjeshtë, pa iu përmbajtur me rreptësi një sistemi shkencor, i cili do të shkaktonte vështirësi për lexuesin mesatar.

Laura Clifford Barney

Pjesa e Parë

PËR NDIKIMIN E PROFETËVE NË EVOLUCIONIN E NJERËZIMIT

1

NATYRA QEVERISET NGA NJË LIGJ I VETËM UNIVERSAL

Natyrë është ai kusht, ai realitet, i cili në dukje qëndron në jetën dhe vdekjen, ose, me fjalë të tjera, në përbërjen dhe shpërbërjen e të gjitha gjërave.

Kjo Natyrë i nënshtrohet një organizimi absolut, ligjeve të caktuara, një rendi të plotë e një skeme të përcaktuar, nga të cilat nuk ka për t'u shmangur kurrë—deri në atë shkallë, me të vërtetë, që, po të vështroni me kujdes e me sy të vëmendshëm, që nga atomi më i vogël i padukshëm deri te trupa të tillë të mëdhenj ekzistues si rruzulli i diellit ose yje të tjera të mëdha e sfera të shndritshme, po të shikoni strukturën e tyre, përbërjen e tyre, formën ose lëvizjen e tyre, do të shihni se të gjitha kanë shkallën më të lartë të organizimit dhe i nënshtrohen një ligji të vetëm, nga i cili nuk do të shmangen kurrë.

Por po të shikoni Natyrën në vetvete, do të vini re se ajo nuk ka as inteligjencë as vullnet. Për shembull, natyra e zjarrit është të digjet, ai digjet pa vullnet ose inteligjencë. Natyra e ujit është rrjedhshmëria, ai rrjedh pa vullnet ose inteligjencë. Natyra e diellit është shkëlqimi, ai shkëlqen pa vullnet ose inteligjencë. Natyra e avullit është të ngjitet lart, ai ngjitet pa vullnet ose inteligjencë. Është pra e qartë se lëvizjet natyrore të të gjitha gjërave janë të detyruara; nuk ka lëvizje të vullnetshme, veç atyre të kafshëve e, mbi të gjitha, atyre të njerëzve. Njeriu është i aftë t'i qëndrojë e t'i kundërvihet Natyrës, sepse ai zbulon përbërjen e gjërave dhe përmes kësaj mund të komandojë forcat e vetë Natyrës; të gjitha shpikjet që ai ka bërë i detyrohen zbulimit të përbërjes së gjërave. Për shembull, ai shpiku telegrafin, që është mjeti i

komunikimit midis Lindjes e Perëndimit. Është e qartë, pra, se njeriu sundon mbi Natyrën.

Tani, duke parë se ekzistojnë organizime, rregullime e ligje të tilla, a mund të thoni se të gjitha këto janë efekt i Natyrës, megjithëse Natyra nuk ka as inteligjencë as perceptim? Nëse jo, bëhet e qartë se kjo Natyrë, e cila nuk ka as perceptim as inteligjencë, i nënshtrohet Perëndisë së Gjithëfuqishëm, i Cili është Sunduesi i botës së Natyrës; Ai bën që Natyra të shfaqë gjithçka që Ai dëshiron.

Njëra prej gjërave që u shfaq në botën e qenies dhe që përbën një prej kërkesave të Natyrës, është jeta njerëzore. E parë nga ky kënd vështrimi, njeriu është dega dhe natyra është rrënja. Atëherë, a mundet që vullneti dhe inteligjenca e përsosuritë që ekzistojnë në degë, të mungojnë në rrënjë?

Është, pra, e qartë se Natyra, në vetë thelbin e saj, është nën pushtetin e Perëndisë, i Cili është i Përrjetshëm e i Gjithëfuqishëm: Ai e mban Natyrën brenda rregullash e ligjesh të sakta dhe sundon mbi të.¹

2

PROVAT DHE DËSHMITË E EKZISTENCËS SË PERËNDISË

Një prej provave dhe demonstrimeve të ekzistencës së Perëndisë është fakti që njeriu nuk ka krijuar vetveten: jo, krijuesi dhe projektuesi i tij është dikush tjetër e jo ai vetë.

Është e qartë dhe e pakundërshtueshme që krijuesi i njeriut nuk është si njeriu, sepse një krijesë e pafuqishme nuk mund të krijojë një

¹ Për idenë e Perëndisë shih: “Hyjnia mund të kuptohet vetëm nëpërmjet Manifestimeve Hyjnore”, f. 146, dhe “Dija e njeriut për Perëndinë”, f. 220.

Lexuesi do të shohë atje që Besimi Bahá’í nuk ka një koncept antropomorf të Perëndisë dhe që, nëse ai përdor një terminologji të zakonshme, tregon kujdes që të shpjegojë kuptimin simbolik të saj.

qenie tjetër. Artuesi, krijuesi duhet të zotërojë të gjitha përsosuritë, që të mund të krijojë.

A mund të jetë krijimi i përsosur dhe krijuesi i papërsosur? A mund të jetë një pikturë një kryevepër dhe piktori të jetë i papërsosur në artin e tij? Sepse ajo është arti dhe krijimi i tij. Për më tepër, piktura nuk mund të jetë si piktori, përndryshe piktura do të krijonte vetveten. Sado e përsosur të jetë piktura, në krahasim me piktorin ajo është në shkallën më të lartë të papërsosurisë.

Bota e rastësishme është burimi i papërsosurive: Perëndia është origjina e përsosurive. Papërsosuritë e botës së rastësishme janë në vetvete një provë e përsosurive të Perëndisë.

Për shembull, kur vështroni njeriun, shihni se ai është i dobët. Pikërisht kjo dobësi e krijesës është një provë e fuqisë së Fuqiptotit të Përjetshëm, sepse po të mos kishte fuqi nuk do të mund të përfytyrohej dobësia. Pra, dobësia e krijesës është një provë e fuqisë së Perëndisë; sepse po të mos kishte fuqi, nuk do të kishte dobësi; kështu, nga kjo dobësi bëhet e qartë se në botë ka fuqi. Më tej, në botën e mundshme ka varfëri; atëhere medoemos ekziston pasuria, derisa varfëria është e dukshme në botë. Në botën e mundshme ka injorancë; medoemos ekziston dija, derisa gjendet injorancë; sepse po të mos kishte dije, nuk do të kishte as injorancë. Injoranca është mosqenia e dijes dhe, po të mos kishte qenie, nuk do të mund të kishte mosqenie.

Është e qartë se gjithë bota e rastësishme i nënshtrohet një ligji e një rregulli të cilave ajo kurrë nuk mund të mos i bindet; edhe njeriu është i detyruar t'i nënshtrohet vdekjes, gjumit dhe kushteve të tjera— domethënë njeriu në disa drejtime është i qeverisur, dhe kjo gjendje e të qenit i qeverisur nënkupton medoemos ekzistencën e një qeverisësi. Sepse një karakteristikë e qenieve të rastësishme është varësia dhe kjo varësi është një nevojë thelbësore, pra duhet të ekzistojë një qenie e pavarur, pavarësia e së cilës është thelbësore.

Po kështu, nga njeriu që është i sëmurë kuptohet se duhet të ketë një tjetër që është i shëndetshëm; sepse po të mos kishte shëndet, nuk do të mund të provohej sëmundja e tij.

Prandaj bëhet e qartë se ekziston Fuqiploti i Përjetshëm, i Cili zotëron të gjitha përsosuritë, sepse po të mos zotëronte të gjitha përsosuritë, Ai do të ishte si krijesa e Tij.

Anëmbanë botës së qenies është po kështu; edhe gjëja më e vogël e krijuar provon se ka një krijues. Për shembull, kjo copë buke provon se është dikush që e ka bërë.

Lëvduar qoftë Perëndia! Ndryshimi më i vogël që bëhet në formën e gjësë më të vogël provon ekzistencën e një krijuesi: atëherë, a mundet që kjo gjithësi e madhe, që është e pafundme, të jetë vetëkrijuar e të ketë lindur nga veprimi i materies e i elementeve? Shihet qartë sesa i gabuar është një supozim i tillë!

Këto argumente që duken sheshit sillen për shpirtira të dobët; por po të jetë i hapur perceptimi i brendshëm, njëqind mijë prova të qarta dalin në pah. Kështu, kur njeriu e ndjen shpirtin që ndodhet brenda tij, ai nuk ka nevojë për argumente që të vërtetojnë ekzistencën e tij; por për ata që nuk e kanë dhuntinë e shpirtit është e nevojshme të sillen argumente të jashtme.

3

NEVOJA PËR NJË EDUKATOR

Kur vërejmë ekzistencën, shohim se botët, ajo minerale², bimore, shtazore e njerëzore të gjitha kanë nevojë për një edukator.

Në qoftë se toka nuk kultivohet, ajo bëhet një xhungël ku rriten barëra të padobishme; por në qoftë se një kultivues vjen dhe e punon tokën, ajo jep prodhime që ushqejnë krijesa të gjalla. Është, pra, e qartë se toka ka nevojë që bujku ta kultivojë. Shikoni drurët: po të mos kultivohen, ato nuk japin fryte, dhe pa fryte ato janë të padobishme; por në qoftë se për to kujdeset kopshtari, po këto pemë shterpa bëhen frytdhënëse, dhe me anë të kultivimit, të plehërimit e të shartimit të

² Me termin “bota minerale” nënkuptohet bota inorganike, ndërsa termi “mineral” ka kuptimin lëndë inorganike.—Shën. i red.

drurëve që kishin fryte të hidhura, prodhohen fryte të ëmbla. Këto janë prova racionale; në epokën e sotme popujt e botës kanë nevojë për argumente të arsyes.

Po kjo gjë është e vërtetë edhe për kafshët: vëreni se kur kafsha stërvitet, ajo zbutet dhe se njeriu, gjithashtu, po të lihet pa edukim bëhet shtazarak e, për më tepër, po të lihet nën sundimin e natyrës bëhet edhe më i ulët se kafsha, ndërsa, po të edukohet bëhet engjëll. Sepse pjesa më e madhe e kafshëve nuk e hanë atë që i përket llojit të vet, ndërsa disa njerëz, në Sudan, në krahinat qendrore të Afrikës, vrasin e hanë njëri-tjetrin.

Pa mendoni tani, se është edukimi që e vë Lindjen dhe Perëndimin nën pushtetin e njeriut; është edukimi që krijon industri të mahnitshme: është edukimi që përhap shkencat dhe artet e mëdha; është edukimi që bën të shfaqen zbulime e institucione të reja. Po të mos kishte edukator, nuk do të kishte gjëra të tilla si mirëqenia, qytetërimi ose njerëzia. Po të lihej një njeri i vetmuar në një vend të shkretë, ku të mos shikonte askënd të llojit të vet, ai padyshim do të bëhej një egërsirë e vërtetë; shihet, pra, qartë se ka nevojë për një edukator.

Por edukimi është tre llojesh: material, njerëzor dhe shpirtëror. Edukimi material ka të bëjë me progresin dhe zhvillimin e trupit, duke siguruar mjetet për mbajtjen e tij, sendet e komoditetin e tij material. Ky edukim është i përbashkët për kafshët dhe për njeriun.

Edukimi njerëzor nënkupton qytetërim dhe progres—që do të thotë qeverisje, administrim, vepra bamirësie, tregti, arte e zeje, shkenca, shpikje e zbulime të mëdha dhe institucione të ndërtuara me kujdes, që përbëjnë veprimtaritë thelbësore të njeriut, të cilat e shquajnë atë prej kafshës.

Edukimi hyjnor është ai i Mbretërisë së Perëndisë: ai qëndron në zotërimin e përsosurive hyjnore, dhe ky është edukimi i vërtetë; sepse në këto kushte njeriu bëhet vatra e bekimeve hyjnore, manifestimi i fjalëve “Le ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës Sonë dhe sipas ngjasimit Tonë”.³ Ky është qëllimi suprem i botës së njerëzimit.

³ Shih Zanafilla 1:26.

Pra, ne kemi nevojë për një edukator që të jetë, në të njëjtën kohë, një edukator material, njerëzor dhe shpirtëror, dhe autoriteti i të cilit të jetë efektiv në të gjitha kushtet. Kështu, po të thoshte dikush “Unë kam logjikë e inteligjencë të përsosur dhe nuk kam nevojë për një edukator të tillë”, ai do të mohonte atë që është e qartë e duket vetiu. Kjo është një lloj sikur një fëmijë të thoshte “Unë nuk kam nevojë për edukim; unë do të veproj sipas arsyes e inteligjencës sime dhe kështu do të arrij përsosuritë e ekzistencës”, ose sikur një i verbër të thoshte “Unë nuk kam nevojë për sy, sepse shumë njerëz të tjerë të verbër jetojnë pa vështirësi.”

Atëhere është e qartë e duket vetiu se njeriu ka nevojë për një edukator dhe ky edukator pa diskutim e padyshim duhet të jetë i përsosur në të gjitha drejtimet dhe i shquar mbi të gjithë njerëzit. Përndryshe, po të ishte si gjithë njerëzia, ai nuk do të mund të ishte edukatori i tyre, e në mënyrë të veçantë sepse ai duhet të jetë në të njëjtën kohë edukatori i tyre material e njerëzor, por edhe shpirtëror— domethënë ai duhet t’i mësojë njerëzit të organizojnë e të kryejnë punë fizike dhe të formojnë një rend shoqëror, me qëllim që të vendosin kooperim e ndihmë të ndërsjelltë në të jetuar, në mënyrë që punët materiale të mund të organizohen e të rregullohen në çdo rrethanë që mund të krijohet. Po kështu, ai duhet të bëjë edukimin njerëzor— domethënë duhet të edukojë inteligjencën e mendimin në mënyrë të tillë që ato të mund të arrijnë zhvillim të plotë, që dija e shkenca të mund të përparojnë dhe realiteti i gjërave, misteret e qenieve dhe vetitë e ekzistencës të mund të zbulohen; që, nga dita në ditë, orientimet, shpikjet e ligjet të mund të përmirësohen; dhe nga perceptimet shqisore të mund të nxirren përfundime në fushën mendore.

Ai duhet të japë gjithashtu edukim shpirtëror, në mënyrë që inteligjenca e të kuptuarit të mund të depërtojnë në botën metafizike, të përfitojnë nga filladi spastrues i shpirtit të Shenjtë dhe të hyjnë në marrëdhënie me Tubimin Suprem. Ai duhet ta edukojë në mënyrë të tillë realitetin njerëzor që ai të bëhet qendra e shfaqjes hyjnore, deri në atë shkallë sa atributet e emrat e Perëndisë të shkëlqejnë në pasqyrën e

realitetit të njeriut dhe vargu i shenjtë “Ne do ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës Sonë dhe ngjasimit Tonë” të përmbushet.⁴

Është e qartë se aftësia njerëzore nuk është në gjendje të kryejë një detyrë kaq të madhe dhe se vetëm arsyeja nuk do të mund të merrte mbi vete përgjegjësinë e një misioni kaq të madh. Si mundet një person i vetmuar, pa ndihmë e pa mbështetje, të hedhë themelet e një ndërtimi kaq fisnik? Për të qenë në gjendje të ndërmarrë këtë mision, ai duhet të mbështetet në ndihmën e fuqisë shpirtërore e hyjnore. Një Shpirt i Vetëm i Shenjtë i jep jetë botës së njerëzimit, i ndryshon pamjen rruzullit tokësor, bën që inteligjenca të përparojë, gjallëron shpirtrat, vendos bazat e një jete të re, hedh themelet e reja, organizon botën, i sjell kombet e fetë nën hijen e një flamuri të vetëm, e shpëton njeriun nga bota e papërsosurive dhe e veseve dhe e frymëzon atë me dëshirën e nevojën për përsosuri natyrore e të fituara. Sigurisht, asgjë tjetër veç një fuqie hyjnore nuk mund ta kryejë një vepër kaq të madhe. Ne duhet ta shohim këtë me drejtësi, sepse kjo është detyra e drejtësisë.

Një Kauzë, të cilën të gjitha qeveritë dhe popujt e botës, me të gjitha pushtetet e ushtritë, nuk mund ta shpallin e përhapin, një Shpirt i vetëm i Shenjtë mund ta çojë përpara pa ndihmë e mbështetje! A mund të bëhet kjo nga një fuqi njerëzore? Jo, për Perëndi! Për shembull, Krishti, vetëm e i vetmuar, ngriti flamurin e paqes shpirtërore e të drejtësisë, një vepër të cilën të gjitha qeveritë fitimtare me të gjitha ushtritë e tyre nuk janë në gjendje ta kryejnë. Kujtoni se cili ka qenë fati i kaq perandorive e popujve të ndryshëm: Perandoria Romake, Franca, Gjermania, Rusia, Anglia, etj. Të gjitha u mblodhën së bashku nën të njëjtën tendë— domethënë shfaqja e Krishtit solli bashkim midis këtyre kombeve të ndryshme, disa nga të cilat, nën ndikimin e Krishtërit, u bënë aq të bashkuara sa që flijonin jetën dhe pasurinë për njëri-tjetrin. Pas kohës së Kostandinit, i cili qe kampioni i Krishtërit, midis tyre shpërthyen përçarje. Pra, Krishti i bashkoi këto kombe, por pas një kohe qeveritë u bënë shkak përçarjeje. Ajo që dua të them është se Krishti mbështeti një Kauzë, të cilën nuk mundën ta çonin përpara gjithë mbretërit e tokës! Ai bashkoi fetë e ndryshme dhe ndryshoi zakonet e lashta. Mendoni ç’dallime të mëdha ekzistonin ndërmjet romakëve, grekëve, sirianëve,

⁴ Shih Zanafilla 1:26.

egjiptianëve, fenikasve, izrealitëve dhe popujve të tjerë të Evropës. Krishti i zhdukuri këto dallime dhe solli dashurinë midis këtyre komuniteteve. Edhe pse pas njëfarë kohe qeveritë e shkatërruan këtë bashkim, vepra e Krishtit u krye.

Ja përse Edukatori Universal duhet të jetë në të njëjtën kohë një edukator material, por edhe njerëzor e shpirtëror; dhe që të mund të mbajë pozitën e një mësuesi hyjnor, Ai duhet të zotërojë një fuqi të mbinatyrshme. Po të mos shfaqë një fuqi të tillë të shenjtë, Ai nuk do të jetë në gjendje të edukojë, sepse po qe i papërsosur si mundet Ai të japë një edukim të përsosur? Po nuk qe i ditur, si mundet Ai t'i bëjë të tjerët të mençur? Po qe i padrejtë, si mundet Ai t'i bëjë të tjerët të drejtë? Po qe tokësor, si mundet Ai t'i bëjë të tjerët qiellorë?

Le të gjykojmë, pra, me drejtësi: a i zotëronin këto Manifestime Hyjnore që janë shfaqur të gjitha këto cilësi apo jo?⁵ Po qe se Ata nuk do t'i kishin pasur këto cilësi e këto përsosuri, ata nuk do të ishin Edukatorë të vërtetë.

Pra, duhet të jetë detyra jonë t'ia provojmë me argumente të arsyeshme njeriut që mendon profetërinë e Mosisiut, të Krishtit dhe të Manifestimeve të tjera Hyjnore. Dhe provat e dëshmitë që ne japim nuk bazohen në argumente tradicionale por në argumente racionale.

Tani është provuar me argumente racionale se bota e qenies ka nevojë shumë të madhe për një edukator dhe se ky edukim arrihet me anë të një fuqie hyjnore. Nuk ka dyshim se kjo fuqi hyjnore është një revelacion dhe se bota duhet të edukohet me anë të fuqisë së tij, që qëndron mbi fuqinë njerëzore.

4

ABRAHAMI

⁵ Manifestime Hyjnore janë themeluesit e feve. Shih “Dy kategori Profetësh”, f. 164.

Njëri prej atyre që e kanë zotëruar këtë fuqi dhe që janë ndihmuar prej saj ishte Abrahami. Provë për këtë ishte se Ai pat lindur në Mesopotami⁶ dhe prej një familjeje që nuk dinte asgjë për Njëshmërinë e Perëndisë. Ai iu kundërvu kombit e popullit të Vet, madje edhe familjes së Vet, duke hedhur poshtë të gjithë perënditë e tyre. I vetmuar e pa ndihmë, Ai i bëri ballë një fisi të fuqishëm, gjë që nuk është as e thjeshtë as e lehtë. Është njëlloj sikur në kohën e sotme dikush të shkonte te një popull i krishterë, që është i lidhur me Biblën, dhe të mohonte Krishtin; ose sikur në Oborrin Papal—mos e dhëntë Zoti!—një person i tillë të shante në mënyrën më të rëndë Krishtin e t'i kundërvihej popullit.

Këta njerëz nuk besonin në një Perëndi të vetëm, por në shumë perëndi, të cilëve ata u vishnin mrekulli; prandaj ata u ngritën të gjithë kundër Tij dhe askush nuk e mbështeti Atë përveç Lotit, djalit të vëllait të Tij, dhe një ose dy vetëve të tjerë të parëndësishëm. Më në fund, duke rënë në hall të madh nga kundërvënia e armiqve të Tij, Ai u detyrua të lërë vendlindjen. Në të vërtetë ata e dëbuan, në mënyrë që Ai të dërmohej e të shkatërrohej dhe të mos mbetej asnjë gjurmë e Tij.

Abrahami erdhi atëherë në rajonin e Tokës së Shenjtë. Armiqtë e Tij mendonin se mërgimi do ta çonte Atë në shkatërrim e rrënim, pasi dukej e pamundur që një njeri i dëbuar nga vendlindja e Tij, i privuar nga të drejtat e Veta dhe i marrë nëpër këmbë nga të gjitha anët—edhe sikur të ishte mbret—të mund t'i shpëtonte shfarosjes. Por Abrahami qëndroi i patundur dhe tregoi një vendosmëri të jashtëzakonshme; dhe Perëndia bëri që ky mërgim të ishte nderimi i Tij i përjetshëm, sepse Ai vendosi Unitetin e Perëndisë në gjirin e një gjenerate politeiste. Ky mërgim solli përparimin e pasardhësve të Abrahamit dhe atyre iu dha Toka e Shenjtë. Si rezultat, mësimet e Abrahamit u përhapën jashtë vendit, midis pasardhësve të Tij dolën një Jakov dhe një Josif, që u bë njeri i madh në Egjipt. Si rrjedhojë e mërgimit të Tij, një Moisi dhe një qenie si Krishti u manifestuan nga gjiri i pasardhësve të Tij, dhe u gjend Hagari nga e cila lindi Ishmaeli, një prej pasardhësve të të cilit ishte Muhameti. Si pasojë e mërgimit të Tij, nga pasardhësit e Tij u shfaq

⁶ Mesopotamia, që do të thotë vendi midis dy lumenjve, ndodhet midis Tigris dhe Eufratit.

Báb-i,⁷ dhe Profetët e Izraelit numëroheshin midis pasardhësve të Abrahamit. Dhe kështu do të vazhdojë përgjithmonë. Më në fund, si pasojë e mërgimit të Tij, gjithë Evropa dhe pjesa më e madhe e Azisë u futën nën hijen mbrojtëse të Perëndisë së Izraelit. Shih se ç'fuqi është ajo që e bëri të aftë një Njeri Që ishte arratisur nga vendi i Tij të krijonte një familje të tillë, të vendoste një besim të tillë dhe të përhapte mësim të tilla. A mund të thotë ndonjëri se e gjithë kjo ndodhi rastësisht? Duhet të jemi të drejtë: a ishte ky Njeri një Edukator apo jo?

Derisa mërgimi i Abrahamit nga Uri në Aleppo, në Siri, solli këtë rezultat, duhet të mendojmë se cili do të jetë efekti i mërgimit të Bahá'u'lláh-ut në zhvendosjet e ndryshme të Tij nga Teherani në Bagdad, që këtej në Kostandinopojë, në Rumeli dhe në Tokën e Shenjtë.

Shihni se ç'edukator i përsosur ishte Abrahami!

5

MOISIU

Moisiu ishte për një kohë të gjatë bari në shkretëtirë. I parë nga ana e jashtme, Ai ishte një Njeri i rritur në një familje tirane dhe njihej midis njerëzve si Ai Që kishte bërë një vrasje dhe kishte përfunduar në bari. Ai urrehej e përbufej shumë nga qeveria e nga njerëzit e Faraonit.

E pra, ky njeri çliroi një komb të madh nga zinxhirët e robërisë, bëri të kënaqur popullin e vet, e nxorri atë nga Egjipti dhe e çoi në Tokën e Shenjtë.

Këta njerëz u ngritën nga thellësitë e degradimit deri në majat e lavdisë. Ata ishin robër dhe u bënë të lirë. Ata ishin populli më injorant dhe u bënë më të mençurit. Si rezultat i instituteve që u dha atyre Moisiu, ata arritën një pozitë që i bëri të nderuar midis të gjitha kombeve dhe fama e tyre u përhap në të gjitha vendet, në një shkallë të tillë me të vërtetë, sa që midis kombeve përreth, kur dikush donte të

⁷ Prejardhja e Báb-it ishte nga Muhameti.

lavdëronte një njeri thoshte “Sigurisht ai është izrealit”. Moisiu vendosi ligje e porosi; këto i dhanë jetë popullit të Izraelit dhe e çuan atë në shkallën më të lartë të qytetërimit për atë kohë.

Ata arritën një shkallë të tillë zhvillimi, saqë filozofët e Greqisë shkonin për të marrë dije nga njerëzit e mësuar të Izraelit. Një ndër ta ishte Sokrati, i cili vizitoi Sirinë dhe mori nga bijtë e Izraelit mësimet për Unitetin e Perëndisë dhe për pavdekësinë e shpirtit. Pas kthimit në Greqi, ai i përhap këto mësimet. Më pas populli i Greqisë u ngrit kundër tij, e akuzoi si të pafë, e nxorri para Aeropagut dhe e dënoi me vdekje me anë të helmit.

Tani, si mundi një Njeri Që i mbahej goja, Që ishte rritur në shtëpinë e Faraonit, Që njihej midis njerëzve si vrasës, Që nga frika kishte ndenjtur për një kohë të gjatë i fshehur dhe Që u bë bari, të themelonte një Kauzë aq të madhe, kur filozofët më të mençur të tokës nuk kishin mundur të arrinin as një të mijtën e këtij ndikimi? Kjo është me të vërtetë një mrekulli.

Një Njeri me një gjuhë që belbëzonte, i Cili nuk mundej as të bisedonte si duhet, ia doli mbanë të mbështeste këtë Kauzë të madhe! Po të mos ndihmohej nga një fuqi hyjnore, Ai kurrë nuk do të kishte qenë në gjendje të kryente këtë vepër të madhe. Këto janë fakte të pamohueshme. Filozofët materialistë, mendimtarët grekë, njerëzit e mëdhenj të Romës u bënë të famshëm në botë, duke u specializuar secili prej tyre vetëm në një degë të dijes. Kështu Galeni dhe Hipokrati u bënë të famshëm në mjekësi, Aristoteli në logjikë e arsyetim dhe Platoni në etikë e teologji. Si ndodhi, pra, që një bari mundi t’i fitonte të gjitha këto dije? Është tej çdo dyshimi që Ai duhej të jetë ndihmuar nga një pushtet i gjithëfuqishëm.

Vëreni gjithashtu se çfarë provash e vështirësish u dalin disa njerëzve. Për të penguar një akt mizor, Moisiu vrau një egjiptian dhe më pas u bë i njohur midis njerëzve si vrasës, për më tepër që njeriu që Ai vrau ishte i kombit sundues. Kështu, Ai u arratis dhe pas kësaj u ngrit në rangun e një Profeti!

Me gjithë namin e Tij të keq, Ai u udhëhoq mrekullisht prej një fuqie të mbinatyrshme për të vendosur institutet dhe ligjet e Tij të mëdha!

6

KRISHTI

Më pas erdhi Krishti, Që tha “Unë kam lindur nga Shpirti i Shenjtë”. Megjithëse tani është e lehtë për të krishterët ta besojnë këtë pohim, në atë kohë kjo ishte shumë e vështirë. Sipas tekstit të Ungjillit, farisenjtë thanë “A nuk është ky i biri i Josifit nga Nazareti, të Cilin ne e njohim? Pra, si mund të thotë Ai: Unë kam zbritur nga qielli?”⁸

Shkurt, ky Njeri, i Cili në dukje e në sytë e të gjithëve ishte nga vegjëlja, u ngrit me një fuqi të tillë të madhe saqë ndryshoi një fe që kishte vazhduar njëmijë e pesëqind vjet, në një kohë kur shmangia më e vogël prej saj e çonte në rrezik ose në vdekje atë që e kryente. Për më tepër, në kohën e Krishtit morali i gjithë botës dhe jetesa e izrealitëve ishte çoroditur e zvetënuar krejtësisht dhe Izraeli kishte rënë në një gjendje degradimi të skajshëm, në mjerim e robëri. Një kohë ata u pushtuan nga kaldeasit e persët; një herë tjetër ranë nën skllavërinë e asirianëve; pastaj u bënë nënshtetas e vasalë të grekëve; dhe më në fund u sunduan e u përçmuan nga romakët.

Ky Djalë i ri, Krishti, me ndihmën e një fuqie të mbinatyrshe, shfuqizoi Ligjin e lashtë të Moisiut, reformoi moralin e përgjithshëm dhe hodhi përsëri themelet e lavdisë së përjetshme për izrealitet. Për më tepër, Ai i solli njerëzimit lajmin e gëzuar të paqes universale dhe përhapit kudo mësimi që nuk ishin vetëm për Izraelin, por synonin lumturinë e përgjithshme të mbarë gjinisë njerëzore.

Ata që u përpoqën të parët ta hiqnin qafe Atë ishin izrealitet, vetë bashkëqytetarët e Tij. Në dukje të jashtme, ata e mposhtën Atë dhe e katandisën në gjendjen më të mjerueshme. Më në fund e kurorëzuan me një kurorë gjembash dhe e kryqëzuan. Por Krishti, ndërsa në dukje gjendej në mjerimin e vuajtjet më të rënda, deklaroi “Ky Diell do të shkëlqejë, kjo Dritë do të ndriçojë, mirësia Ime do të rrethojë botën dhe të gjithë armiqtë e Mi do të poshtërohen.” Dhe siç tha Ai, ashtu u bë;

⁸ Shih Gjoni 6:42.

sepse të gjithë mbretërit e tokës nuk qenë në gjendje ta përballonin Atë. Madje të gjithë flamujt e tyre janë rrëzuar, ndërsa flamuri i Atij të Shtypuri u ngrit në zenit.

Por kjo është në kundërshtim me të gjitha rregullat e arsyes njerëzore. Atëhere bëhet e qartë e duket vetiu se kjo Qenie e Lavdishme ishte një Edukator i vërtetë i botës së njerëzimit dhe se Ai u ndihmua e u mbështet nga një fuqi hyjnore.

7

MUHAMETI

Tani vijmë te Muhameti. Amerikanët dhe evropianët kanë dëgjuar shumë histori rreth Profetit, që ata mendonin se ishin të vërteta, edhe pse tregimtarët ishin ose injorantë ose kundërshtarë: pjesa më e madhe ishin klerikë; të tjerë ishin myslimanë injorantë që përsëritnin gojdhana të pabazuara rreth Muhametit, të cilat ata besonin me injorancë se dëshmonin për lavdinë e Tij.

Kështu, disa myslimanë të zhytur në errësirë e bënë poligaminë e Tij strumbullarin e lavdërimeve të tyre dhe e shihnin këtë si një gjë të mrekullueshme; ndërsa historianët evropianë, në pjesën më të madhe, mbështeten në përrallat e këtyre njerëzve injorantë.

Për shembull, një njeri budalla i tha një kleriku se prova e vërtetë e madhështisë është trimëria e gjakderdhja dhe se një ditë në fushën e betejës një pasues i Muhametit u preu kokat njëqind vetave! Kjo e çorientoi klerikun dhe ai konkludoi se vrasja konsiderohet si mënyra për të provuar besimin e njeriut ndaj Muhametit, ndërsa kjo është thjesht imagjinatë. Ekspeditat ushtarake të Muhametit, në të kundërtën, ishin gjithmonë veprime mbrojtëse: një provë e kësaj është se gjatë trembëdhjetë vjetëve, në Mekë, Ai dhe pasuesit e Tij vuajtën përndjekjet më të dhunshme. Në këtë periudhë ata ishin tabelë për shigjetat e urrejtjes: disa nga shokët e Tij u vranë dhe pronat e tyre u konfiskuan; të tjerë u arratisën në vende të huaja. Vetë Muhameti, pas përndjekjeve më të egra nga Kuraishitët [Qurayshites], të cilët më në fund vendosën ta vrisnin Atë, iku në Medinë në mes të natës. Megjithatë, edhe atëherë armiqtë e Tij nuk i ndërprejnë përndjekjet e

tyre, por e ndoqën Atë në Medinë, madje nxënësit e Tij edhe në Abisini.

Këto fise arabe ishin në humnerën më të thellë të egërsisë e të barbarizmit dhe, në krahasim me ta, njerëzit e egër të Afrikës dhe indianët primitivë të Amerikës ishin aq të përparuar sa një Platon.⁹ Të egrit e Amerikës nuk i varrosin të gjallë fëmijët e tyre, siç bënin këta Arabë me bijat e tyre, duke u lavdëruar me këtë si për një gjë të nderuar që duhej bërë.¹⁰ Kështu, shumë prej burrave i kërcënonin gratë e veta duke u thënë “Po linde vajzë, do të të vras”. Madje deri në kohën e tanishme, arabët e kanë tmerr të kenë vajza. Më tej, një burrë lejohej të merrte një mijë gra dhe shumë burra kishin mbi dhjetë gra në shtëpi. Kur këto fise bënin luftë, ai që fitonte i merrte robër gratë dhe fëmijët e fisit të mundur dhe i trajtonte si skllëvër.

Kur një burrë që kishte dhjetë gra vdiste, bijtë e këtyre grave turrehin te nënat e njëri-tjetrit; dhe në qoftë se njëri prej bijve e hidhte rrobën e tij mbi kryet e gruas së të atit dhe thërriste “Kjo grua është prona ime e ligjshme”, menjëherë gruaja e pafat bëhej robinë dhe skllave e tij. Ai mund të bënte me të ç’të donte. Ai mund ta vriste, ta mbyllte në një pus ose ta rrihte, ta mallkonte e ta torturonte derisa ta shpëtonte vdekja. Sipas zakoneve e dokeve arabe, ai ishte i zoti i saj. Është e qartë se shpirtligësia, xhelozia, urrejtja dhe armiqësia duhet të kenë ekzistuar ndërmjet grave e fëmijëve të një familjeje dhe nuk është, pra, e nevojshme të zgjatemi në këtë çështje. Merreni me mend se cila ishte gjendja dhe jeta e këtyre grave të shtypura! Për më tepër, mjetet me të cilat këto fise arabe siguronin jetesën ishin plaçkitja e grabitja, kështu që ato ishin vazhdimisht të angazhuara në përlëshje e luftëra, duke vrarë njëri-tjetrin, duke plaçkitur e shkatërruar pronat e njëri-tjetrit dhe duke kapur gra e fëmijë, të cilët ua shisnin të huajve. Sa shpesh ndodhte që bijat dhe bijtë e një princi, që e kalonin ditën në rehati e luks, e gjenin veten kur binte nata të katandisur në poshtërim, varfëri e

⁹ Është fjala për filozofin e madh të Greqisë së Lashtë Platonin.—Shën. i përkth.

¹⁰ Banú-Tamím, një prej fiseve arabe më barbare, e praktikonte këtë zakon të urrejtshëm.

robëri. Dje ishin princa, sot janë robër; dje ishin zonja të mëdha, sot janë skllave.

Muhameti e mori Revelacionin Hyjnor midis këtyre fiseve dhe pas trembëdhjetë vjet përndjekjesh nga ana e tyre, u arratis.¹¹ Por këta njerëz nuk e ndërprejnë shtypjen; ata u bashkuan për t'i shfarosur Atë dhe pasuesit e Tij. Në këto rrethana, Muhameti u detyrua të rrëmbente armët. Kjo është e vërteta: ne nuk jemi fanatikë dhe nuk duam ta mbrojmë Atë, por ne jemi të drejtë dhe themi atë që është e drejtë. Gjykojeni këtë me drejtësi. Sikur Vetë Krishti të ishte ndodhur në rrethana të tilla, midis të tilla fiseve tirane e barbare, dhe sikur për trembëdhjetë vjet Ai dhe dishepujt e Tij të kishin përjetuar të gjitha këto sprova me durim, duke arritur kulmin me arratisjen nga vendlindja e Tij—sikur, me gjithë këtë, këto fise pa ligje të kishin vazhduar ta ndiqnin Atë, për të masakruar burrat, për të plaçkitur pasurinë e tyre dhe për të robëruar gratë dhe fëmijët e tyre—cili do të kishte qenë qëndrimi i Krishtit ndaj tyre? Sikur kjo shtypje të kishte rënë vetëm mbi Atë Vetë, Ai do t'i kishte falur ata dhe një veprim i tillë ndjese do të kishte qenë shumë i lavdërueshëm; por po të kishte parë Ai se këta vrasës të pamëshirshëm e gjakpirës donin të vrisnin, të plaçkitnin e t'u bënin keq gjithë atyre të shtypurve, të robëronin gratë e fëmijët, me siguri Ai do t'i kishte mbrojtur ata dhe do t'u kishte qëndruar tiranëve. Çfarë qortimi mund t'i bëhet, pra, veprimit të Muhametit? A mos vallë qortimi se Ai dhe pasuesit e Tij, me gratë e fëmijët e tyre, nuk iu nënshtruan këtyre fiseve të egra? T'i çliroje këto fise nga gjakpirësia e tyre ishte mirësia më e madhe dhe t'i detyroje e kufizoje ato ishte një mëshirë e vërtetë. Ata ishin si një njeri që mban në dorë një kupë helmi, të cilën, kur është gati ta pijë, një mik ia thyen dhe kështu e shpëton. Sikur Krishti të ishte vënë në rrethana të tilla, është e sigurt se me një fuqi fitimtare Ai do t'i kishte shpëtuar burrat, gratë e fëmijët nga kthetrat e këtyre ujçërve gjakpirës.

Muhameti kurrë nuk luftoi kundër të krishterëve; përkundrazi, Ai i trajtoi ata me dashamirësi dhe u dha atyre liri të plotë. Një komunitet të krishterësh jetonte në Naxhran [Najrán] dhe ishin nën kujdesin e mbrojtjen e Tij. Muhameti tha “Në qoftë se ndokush ua shkel të drejtat

¹¹ Në Medinë.

atyre, Unë Vetë do të jem armiku i tij dhe do ta akuzoj atë në prani të Perëndisë.” Në dekretet që Ai shpalli, deklarohet qartë se jeta, pasuritë dhe nderi i të krishterëve e i hebrenjve janë nën mbrojtjen e Perëndisë; dhe në qoftë se një muhamedan martohet me një grua të krishterë, burri nuk duhet ta ndalojë atë të shkojë në kishë, as ta detyrojë të mbajë perçe; dhe nëse ajo vdes, ai duhet ta lërë trupin e saj në kujdesin e klerit të krishterë. Po të dëshironin të krishterët të ndërtonin një kishë, Islami duhej t’i ndihmonte ata. Në rast lufte midis Islamit dhe armiqve të tij, të krishterët duhej të përjashtoheshin nga detyrimi për të luftuar, veç po të dëshironin me vullnetin e tyre të luftonin për të mbrojtur Islamit, sepse ata ishin nën mbrojtjen e tij. Por, si shpërblim për këtë imunitet, ata duhet të paguanin çdo vit një shumë të vogël parash. Me pak fjalë, ka shtatë dekrete të detajuara për këto çështje, disa kopje të të cilave ekzistojnë ende në Jerusalem. Ky është një fakt i vërtetuar dhe nuk varet nga pohimi im. Dekreti i Kalifit të dytë¹² ekzistonte ende nën kujdestarinë e Patriarkut ortodoks të Jerusalemit dhe për këtë nuk ka dyshim.¹³

Megjithatë, pas njëfarë kohe, për shkak të shkeljeve si nga ana e muhamedanëve dhe e të krishterëve, midis tyre lindi urrejtja e armiqësia. Tej këtij fakti, të gjitha tregimet e myslimanëve, të të krishterëve dhe të tjerëve janë thjesht trillime, që e kanë burimin në fanatizëm ose injorancë, ose rrjedhin nga një armiqësi e madhe.

Për shembull, myslimanët thonë se Muhameti çau hënën dhe se ajo ra mbi malin e Mekës: ata mendojnë se hëna është një trup i vogël të cilin Muhameti e ndau në dysh dhe një pjesë e hodhi mbi këtë mal dhe pjesën tjetër mbi një mal tjetër.

Tregime të tilla janë fanatizëm i kulluar. Gjithashtu gojdhonat që citojnë klerikët (e krishterë) dhe incidentet për të cilat ata ankohen, janë të gjitha të ekzagjeruara, nëse jo krejt pa baza.

Me pak fjalë, Muhameti u shfaq në shkretëtirën e Hixhazit [Hijáz] në Gadishullin Arabik, që ishte një tokë e shkretë, sterile, plot rërë dhe e pabanuar. Disa pjesë si Meka dhe Medina, janë tepër të nxehta;

¹² I Omarit [‘Umar].

¹³ Shih librin e Jurji Zaydán *Umayyads and Abbasids* [Umajadët dhe Abasidët], përkthyer në anglisht nga D. S. Margoliouth.

njerëzit janë nomadë, kanë sjelljet e zakonet e banorëve të shkretëtirës dhe janë krejtësisht të pashkollë e pa shkencë. Vetë Muhamedi ishte analfabet dhe Kurani u shkrua fillimisht në shpatulla dhensh ose në gjethe palmash. Këto hollësi janë një tregues i gjendjes së popullit tek i ciili u dërgua Muhamedi. Pyetja e parë që Ai u bëri këtyre njerëzve ishte “Përse ju nuk e pranoni Pesëlibërshin¹⁴ e Ungjillin dhe përse nuk besoni te Krishti e te Moisiu?” Kjo thënie i vinte në vështirësi dhe ata thanë “Stërgjyshërit tanë nuk besonin te Pesëlibërshi e Ungjilli; na thuaj, pse kështu?” Ai u përgjigj “Ata janë gabuar; ju duhet t’i mohoni ata që nuk besojnë te Pesëlibërshi e Ungjilli, edhe pse ata janë etërit dhe stërgjyshërit tuaj.”

Në një vend të tillë dhe midis fışesh të tilla barbare, një Njeri analfabet hartoi një libër, në të cilin me një stil të përsosur e elokuent shpjegoi atributet e përsosuritë hyjnore, profetërinë e Lajmëtarëve të Perëndisë, ligjet hyjnore dhe disa fakte shkencore.

Për shembull, ju e dini se para vëzhgimeve të kohëve moderne—domethënë gjatë shekujve të parë e deri në shekullin e pesëmbëdhjetë të epokës Kristiane—të gjithë matematikanët e botës ishin të një mendjeje se toka ishte qendra e gjithësisë dhe se dielli lëvizte. Astronomi i famshëm që ishte protagonist i teorisë së re zbuloi lëvizjen e tokës dhe palëvizshmërinë e diellit.¹⁵ Deri në atë kohë të gjithë astronomët e filozofët e botës i përmbaheshin sistemit Ptolemeik dhe kushdo që thoshte ndonjë gjë kundër këtij sistemi konsiderohej injorant. Megjithëse Pitagora, dhe Platoni gjatë pjesës së fundit të jetës së tij, adoptuan teorinë se lëvizja vjetore e diellit rreth zodiakut nuk vjen nga dielli, por nga rrotullimi i tokës rreth diellit, kjo teori u harrua krejtësisht dhe sistemi Ptolemeik u pranua nga të gjithë matematikanët. Por ka disa vargje të reveluara në Kuran që janë në kundërshtim me teorinë e sistemit Ptolemeik. Një prej tyre thotë “Dielli lëviz në një vend të ngulët”, që tregon pozitën e ngulët të diellit dhe lëvizjen e tij rreth një boshti.¹⁶ Përsëri në një varg tjetër thuhet “Dhe çdo yll lëviz në

¹⁴ Pesëlibërsh ose Pentateuk quhen pesë librat e parë të Biblës, që shtjellojnë kohën dhe veprimtarinë e Moisiut.—Shën. i përkth.

¹⁵ Koperniku.

¹⁶ Shih Kurani 36:37.

qiellin e vet”.¹⁷ Kështu shpjegohet lëvizja e diellit, e hënës, e tokës dhe e trupave të tjerë. Kur doli Kurani, të gjithë matematikanët i vunë në lojë këto deklarata dhe thonin se kjo teori rrjedh nga injoranca. Madje edhe doktorët e Islamit, kur panë se këto vargje ishin në kundërshtim me sistemin e pranuar Ptolemeik, u detyruan të justifikoheshin për to.

Vetëm në shekullin e pesëmbëdhjetë të epokës Kristiane, afro nëntëqind vjet pas Muhametit, një astronom i famshëm bëri vëzhgime të reja dhe zbulime të rëndësishme me ndihmën e teleskopit që ai kishte shpikur.¹⁸ U zbuluan rrotullimi i tokës, pozita e ngulët e diellit, si dhe lëvizja e tij rreth një boshti. U bë e qartë se vargjet e Kuranit përputheshin me faktet e vërtetuara dhe se sistemi Ptolemeik ishte imagjinar.

Me pak fjalë, shumë popuj të Lindjes u edukuan për trembëdhjetë shekuj nën hijen e fesë së Muhametit. Gjatë Mesjetës, ndërsa Evropa ndodhej në humnerën më të thellë të barbarizmit, popujt arabë kishin epërsi ndaj popujve të tjerë të tokës në dije, në arte, matematikë, qytetërim, qeverisje e në shkenca të tjera. Përhapësi i dritës dhe Edukatori i këtyre fiseve arabe, Themeluesi i qytetërimit e i përsosurive njerëzore midis këtyre racave të ndryshme, ishte një Njeri analfabet, Muhameti. A ishte ky Njeri i shquar një Edukator i madh apo jo? Një gjykim i drejtë është i nevojshëm.

8

BÁB-I

Përsa i përket Báb-it—u flijoftë shpirti im për Të!—në rininë e Vet, domethënë kur kishte arritur vitin e njëzetepeshtë të jetës së Tij të bekuar, Ai u ngrit për të shpallur Kauzën e Tij.¹⁹ Është pranuar

¹⁷ Shih Kurani 36:38.

¹⁸ Galileu.

¹⁹ Báb-i përmendet këtu me titullin e Tij Hazreti Alá [Hāzrat-i-A‘lá], Lartësia e Tij Supreme; por për lehtësi të lexuesit ne do të vazhdojmë ta përmendim Atë me emrin nën të cilin Ai njihet në gjithë Evropën—dmth Báb-i.

përgjithësisht nga shiitët se Ai kurrë nuk pat studiuar në ndonjë shkollë dhe nuk pat marrë dije nga ndonjë mësues; gjithë popullsia e Shirazit dëshmon për këtë. Megjithatë, Ai papritur u shfaq para popullit i pajisur me erudicionin më të madh. Megjithësi s' ishte veçse një tregtar, Ai mahniti të gjithë ulamatë e Persisë.²⁰ Krejt i vetëm, në një mënyrë që kapërcen çdo imagjinatë, Ai përhap Kauzën midis persëve, që janë të njohur për fanatizmin e tyre fetar. Ky Shpirt i shquar u ngrit me një fuqi të tillë sa që lëkundit shtyllat e fesë, të moralit, kushtet, doket e zakonet e Persisë dhe vendosi rregulla të reja, ligje të reja dhe një fe të re. Edhe pse personalitetet e mëdha të shtetit, pothuajse të gjithë klerikët dhe ofiqarët publikë u ngritën për ta shpartalluar e për ta zhdukur Atë, Ai u bëri ballë atyre i vetëm dhe tronditi gjithë Persinë.

Shumë ulama e ofiqarë publikë, si dhe njerëz të tjerë, flijuan me gëzim jetën e tyre për Kauzën e Tij dhe nxituan në udhën e martirizimit.

Qeveria, kombi, doktorët e fesë dhe personalitetet e mëdha donin ta shuanin dritën e Tij, por nuk mundën ta arrinin këtë. Më në fund, hëna e Tij doli, ylli i Tij shkëlqeu, themelet e Tij u vendosën fort dhe vendagimi i Tij u bë i ndritshëm. Ai i dha edukim hyjnor një shumice të pandriçuar dhe arriti rezultate të mrekullueshme në fushën e mendimeve, të moralit, të zakoneve e të kushteve të persëve. Ai u shpalli pasuesve të Vet lajmin e gëzuar të manifestimit të Diellit të Bahá-it dhe i përgatiti ata që të besonin tek Ai.

Shfaqja e shenjave të tilla të mahnitshme dhe arritja e rezultateve të mëdha; efektet e krijuara mbi mendjet e njerëzve dhe mbi idetë mbizotëruese; hedhja e themeleve të përparimit; formulimi i parimeve të suksesit e të begatisë nga një i ri tregtar, përbëjnë provën më të madhe se Ai ishte një Edukator i përsosur. Një person i paanshëm kurrë nuk do të ngurrojë ta besojë këtë.

9

BAHÁ'U'LLÁH-U

²⁰ Ulama: Doktorë të fesë së Islamit.

Bahá'u'lláh-u²¹ u shfaq në një kohë kur Perandoria Persiane ishte zhytur në obskurantizëm e injorancë të thellë dhe kishte rënë në fanatizmin më të verbër.

Në librat e historisë të botuara në Evropë ju, padyshim, keni lexuar përshkrime të hollësishme për moralin, zakonet dhe idetë e persëve gjatë shekujve të fundit. Nuk është nevoja t'i përsërisim ato. Shkurt, do të themi se Persia kishte rënë aq poshtë, saqë të gjithë udhëtarëve të huaj u vinte keq që ky vend, i cili në kohët e mëparshme kishte qenë aq i lavdishëm e shumë i qytetëruar, tani ishte kalbëzuar, rrënuar e çrregulluar kaq shumë dhe që popullsia e tij kishte humbur dinjitetin.

Pikërisht në këtë kohë u shfaq Bahá'u'lláh-u. I ati i Tij ishte një ndër vezirët, jo nga ulamatë. Siç e dinë të gjithë në Persi, Ai kurrë nuk kishte studiuar në ndonjë shkollë, as nuk ishte shoqëruar me ulama ose me njerëz të shkolluar. Pjesa e parë e jetës së Tij kaloi në lumturinë më të madhe. Shokët dhe miqtë e Tij ishin persë të rangut më të lartë, por jo njerëz me shkollë.

Sapo u manifestua Báb-i, Bahá'u'lláh-u tha “Ky njeri i Madh është Zoti i të drejtëve dhe të gjithë duhet të besojmë tek Ai”. Kështu Bahá'u'lláh-u u ngrit për të mbështetur Báb-in dhe dha shumë prova e dëshmi pozitive për të vërtetën e Tij, megjithëse ulamatë e fesë shtetërore e kishin detyruar qeverinë persiane t'i kundërvihej e t'i rezistonte Báb-it dhe, për më tepër, kishin nxjerrë dekrete që urdhëronin masakrimin, plaçkitjen, përndjekjen dhe dëbimin e përkrahësve të Tij. Në të gjitha provincat filluan të vrisnin, të digjin, të plaçkitnin ata që kishin kthyer fenë, madje të sulmonin gratë e fëmijët. Pa marrë parasysh këtë, Bahá'u'lláh-u u ngrit për të përhapur fjalën e Báb-it me vendosmërinë e energjinë më të madhe. Për asnjë çast Ai nuk u fsheh, por futej hapur në mes të armiqve të Tij, merrej me parashtrimin e argumentave e të provave dhe u bë i njohur si Lajmëtari i Fjalës së Perëndisë. Në shumë raste e rrethana Ai përballoi fatkeqësitë më të mëdha dhe në çdo moment rrezikonte të martirizohej.

²¹ Xhemal-i-Mubarak [Jamál-i-Mubárák], Bukuria e Bekuar, është titulli që i jepet këtu Bahá'u'lláh-ut. Ai quhet gjithashtu Xhemal-i-Kidam [Jamál-i-Qidam], Bukuria e Paraqenëshme, ose e Lashtë. Por ne do ta përmendim atë si Bahá'u'lláh-u, Lavdia e Perëndisë, me emrin që Ai njihet në Perëndim.

Atij i vunë prangat dhe e mbyllën në një burg të nëndheshëm. Pronat e Tij të gjera e çdo gjë që kishte trashëguar u plaçkitën e u konfiskuan. Ai u syrgjynos katër herë nga një vend në tjetrin dhe gjeti pushim vetëm në “Burgun Më të Madh”.²²

Megjithëkëtë, Ai kurrë nuk pushoi për asnjë çast së shpalluri madhështinë e Kauzës së Perëndisë. Ai shfaqti virtyte, dije e përsosuri të tilla saqë u bë një çudi për gjithë popullin e Persisë. Kjo në një shkallë të tillë saqë në Teheran, në Bagdad, në Kostandinopojë, në Rumeli, madje edhe në Akra, të gjithë njerëzit e mësuar e shkencëtarët që vinin në prani të Tij, qoftë miq ose armiq, kurrë nuk mbetën pa marrë përgjigjen më të plotë e bindëse për çfarëdolloj pyetje që parashtronin. Të gjithë e pranonin shpesh se Ai ishte i vetmi e i pashoq në të gjitha përsosuritë.

Ka ndodhur shpesh në Bagdad që ulama muhamedanë, rabinë hebrej dhe të krishterë mblidheshin bashkë me studiues evropianë në një takim të bekuar: secili kishte ndonjë pyetje për t’i bërë Bahá’u’lláh-ut e, megjithëse kishin shkallë të ndryshme kulture, merrte secili një përgjigje të plotë e bindëse dhe largoheshin të kënaqur. Edhe ulamatë persianë që ishin në Qerbela [Karbilá] e Naxhaf [Najaf], zgjodhën një burrë të mençur, të cilin e dërguan me mision tek Ai; emri i tij ishte Mullá Hasan ‘Amú. Ai erdhi te Prania e Shenjtë dhe, në emër të ulamave, i parashtrori një numër pyetjesh, të cilave Bahá’u’lláh-u u dha përgjigje. Atëherë, Hasan ‘Amú tha “Ulamatë i njohin e i pranojnë pa ngurrim njohuritë dhe virtytin e Bahá’u’lláh-ut dhe janë të bindur njëzëri që përsa i përket dijes ai nuk ka shok ose të barabartë; dhe është, gjithashtu, e qartë se Ai kurrë nuk ka studiuar ose nuk e ka fituar këtë dije; por përsëri ulamatë thonë ‘Ne nuk jemi të kënaqur me këtë; ne nuk e njohim realitetin e misionit të tij për shkak të mençurisë e të jetës së virtytshme të tij. Prandaj i kërkojmë atij të na bëjë një mrekulli, me qëllim që të kënaqë e qetësojë zemrat tona’.”

Bahá’u’lláh-u u përgjigj “Edhe pse ju nuk kenë asnjë të drejtë ta kërkoni këtë, sepse Perëndia duhet t’i vërë në provë krijesat e Veta, dhe

²² I Internuar në fillim në Bagdad, pastaj në Konstantinopojë, pastaj në Adrianopojë, Ai u burgos më në fund në ‘Akká (Akra), “Burgun Më të Madh”, më 1868.

jo këto të vënë në provë Perëndinë, përsëri Unë e lejoj dhe e pranoj këtë kërkesë. Por Kauza e Perëndisë nuk është një lojë teatrale që shfaqet çdo orë, për të cilën mund të kërkohet të bëhet një ndryshim i ri çdo ditë. Po të ishte kështu, Kauza e Perëndisë do të bëhej thjesht një lojë fëmijësh.

“Ulamatë, pra, duhet të mblidhen e të bien dakord të caktojnë një mrekulli dhe ta japin me shkrim që pas kryerjes së kësaj mrekullie ata nuk do të kenë më dyshime për Mua dhe të gjithë do ta njohin e ta deklarojnë të vërtetën e Kauzës Sime. Le ta vulosin këtë letër dhe të ma sjellin Mua. Kriteri i pranuar duhet të jetë ky: në rast se mrekullia kryhet, për ta nuk do të mbetet asnjë dyshim; në rast se mrekullia nuk kryhet, Ne do të dënohemi për mashtrim.” Njeriu i ditur, Hasan ‘Amú, u ngrit dhe u përgjigj “Nuk ka se ç’ të thuhet më”; pastaj i puthi gjurin të Bekuarit, megjithëse nuk ishte besimtar, dhe u largua. Ai mblodhi ulamatë dhe u dha atyre mesazhin e shenjtë. Ata u konsultuan bashkarisht dhe thanë “Ky njeri është një magjisttar; ndoshta ai mund të bëjë një magji dhe pastaj neve s’na mbetet më gjë për të thënë.” Duke u mbështetur në këtë mendim, ata nuk guxuan ta çonin më tej çështjen.²³

Hasan ‘Amú e përmendi këtë fakt në shumë takime. Pasi u largua nga Qerbelaja, ai shkoi në Kirmánsháh e Teheran dhe përhapí gjithandej një përshkrim të hollësishëm për këtë, duke nxjerrë në pah frikën dhe tërheqjen e ulamave.

Me pak fjalë, të gjithë kundërshtarët e Tij në Lindje e njohën madhësinë, madhërinë, dijen dhe virtytin e Tij e, megjithëse ishin armiq të Tij, gjithmonë e quanin Atë “i famshmi Bahá’u’lláh.”

Kur kjo Dritë e madhe doli papritur në horizontin e Persisë, të gjithë, ministrat, ulamatë dhe njerëz të klasave të tjera u ngritën kundër Tij, duke e përndjekur Atë me zemërimin më të madh dhe duke deklaruar se “ky njeri dëshiron të zhdukë e të shkatërrojë fenë, ligjin, kombin dhe perandorinë.” Po këto gjëra qenë thënë edhe për Krishtin. Por Bahá’u’lláh-u, i vetëm e pa mbështetje, u bëri ballë të gjithë atyre, pa treguar kurrë as dobësinë më të vogël. Më në fund ata thanë “Përsa

²³ Gjykimi depërtues i Bahá’u’lláh-ut lidhur me këtë rast e mposhti keqdashjen e armiqve të Tij, të cilët, ishte e sigurt, kurrë nuk do të binin dakord për të caktuar se çfarë mrekullie të kërkonin.

kohë ky njeri do të jetë në Persi, nuk do të ketë paqë e qetësi; duhet ta dëbojmë atë, në mënyrë që në Persi të mund të kthehet qetësia.”

Ata përdorën dhunën kundër Tij për ta detyruar të kërkonte leje të largohej nga Persia, duke menduar se kështu drita e së vërtetës së Tij do të shuhej, por rezultati qe krejt i kundërt. Kauza u rrit dhe flaka e saj u bë më e fortë. Në fillim ajo u përhap vetëm në Persi, por mërgimi i Bahá'u'lláh-ut bëri që Kauza të përhapej në vende të tjera. Më pas armiqtë e Tij thanë “Iraki Arab [Irâq-i-'Arab]²⁴ nuk është larg nga Persia; duhet ta dërgojmë atë në një mbretëri më të largët.” Për këtë arsye qeveria Persiane vendosi ta dërgonte Bahá'u'lláh-un nga Iraku në Kostandinopojë. Përsëri ngjarjet treguan se Kauza nuk u dobësua aspak. Edhe një herë tjetër ata thanë “Kostandinopoja është vend kalimi e vend qëndrimi për shumë raca e popuj; midis tyre ka edhe shumë persë.” Për këtë arsye, persët e internuan Atë më larg, në Rumeli; por kur arriti atje, flaka u bë më e fuqishme dhe Kauza më e lartësuar. Më në fund, persët thanë “Asnjëri prej këtyre vendeve nuk është i paprekshëm nga ndikimi i tij; duhet ta çojmë atë në një vend ku të jetë i pafuqishëm dhe ku familja e pasuesit e tij t’u nënshtrohen fatkeqësive më të tmerrshme.” Kështu ata zgjodhën burgun e Akrës, të caktuar posaçërisht për vrasës, hajdutë e banditë rrugësh, dhe në fakt ata e vinin atë në një radhë me njerëz të tillë. Por fuqia e Perëndisë u manifestua: fjala e Tij u përhap dhe madhështia e Bahá'u'lláh-ut u bë e qartë, sepse pikërisht nga ky burg e në rrethana të tilla poshtëruese, Ai bëri që Persia të avanconte nga një gjendje në një gjendje tjetër. Ai i mposhti të gjithë armiqtë e Tij dhe u provoi atyre se nuk mund t’i rezistonin Kauzës. Mësimet e Tij të shenjta depërtuan në të gjitha rajonet dhe Kauza e Tij hodhi rrënjë.

Me të vërtetë, në çdo anë të Persisë armiqtë u ngritën kundër Tij me urrejtjen më të madhe, duke burgosur, vlarë e rrahur ata që përqafulan fenë e Tij, duke djegur e rrafshuar përtokë mijëra banesa, duke u përpjekur me çdo mjet të shkatërronin e dërrmonin Kauzën e Tij. Me gjithë këto, nga burgu i vrasësve, i banditëve të rrugës e i hajdutëve, ajo u lartësua. Mësimet e Tij u përhapën jashtë vendit dhe predikimet e Tij prekën shumë prej atyre që kishin ushqyer urrejtjen më të madhe, duke

²⁴ Iraku, i cili ndodhet përballë atij distrikti të Iranit që atëherë njihej si Iraki Azam [‘Irâq-i-A‘zam] dhe tani quhet Arák.

i bërë ata besimtarë të vendosur. Madje edhe vetë qeveria Persiane u zgjua e u pendua për atë që kishte ndodhur për faj të ulamave.

Kur Bahá'u'lláh-u erdhi në këtë burg në Tokën e Shenjtë, njerëzit e mençur e kuptuan se lajmi i gëzuar që Perëndia kishte dhënë përmes gojës së Profetëve dy ose tre mijë vjet më parë, ishte manifestuar përsëri dhe se Perëndia i kishte qëndruar besnik premtimit të Vet; sepse disa Profetëve Ai u kishte zbuluar e u kishte dhënë lajmin e mirë se “Zoti i Ushtrive do të shfaqet në Tokën e Shenjtë.” Të gjitha këto premtime u përmbushën; dhe është e vështirë të kuptohet sesi Bahá'u'lláh-u mund të ishte i detyruar të largohej nga Persia dhe ta ngrinte tendën e Tij në këtë Tokë të Shenjtë, po të mos ishin përndjekjet e armiqve të Tij, dëbimi e internimi i Tij. Armiqtë e Tij e burgosën Atë, duke menduar se burgimi do ta shkatërronte e eliminonte tërësisht Kauzën e bekuar, por ky burgim që në të vërtetë një ndihmë shumë e madhe dhe u bë mjete i zhvillimit të saj. Fama hyjnore e Bahá'u'lláh-ut u përhap në Lindje e në Perëndimin dhe rrezet e Diellit të së Vërtetës ndriçuan gjithë botën. Lëvduar qoftë Perëndia! Edhe pse ishte i burgosur, tenda e Tij u ngrit mbi Malin Karmel dhe Ai u shfaq me madhështinë më të madhe. Çdo njeri, mik ose i huaj, që vinte në prani të Tij thoshte “Ky është një princ, jo një i burgosur.”

Me të arritur në këtë burg,²⁵ Ai i drejtoi një letër Napoelonit,²⁶ të cilën e nisi me anë të ambasadorit francez. Thelbi i saj ishte ky: “Pyet cili është krimi Ynë dhe pse Na kanë mbyllur në këtë burg e në këtë birucë.” Napoleoni nuk dha përgjigje. Atëhere Bahá'u'lláh-u shkroi një letër të dytë, që përfshihet në Surenë e Hejkalit [Súriy-i-Haykal].²⁷ Përmbajtja e saj është: “O Napoleon, meqenëse ti nuk ia vure veshin kërkesës Sime dhe nuk iu përgjigje asaj, sundimi yt shumë shpejt do të rrëmbetet dhe ti do të shpartallohesh krejtësisht.” Kjo letër iu dërgua Napoelonit me postë, nën kujdesin e Cezar Ketafaku-t [Cesar Ketaphakou],²⁸ siç dihet prej të gjithë shokëve të Tij të mërgimit.

²⁵ Në Adrianopojë.

²⁶ Napoleoni III.

²⁷ Súriy-i-Haykal, një prej veprave të Bahá'u'lláh-ut, shkruar pas deklarimit të Tij. [Në shqip do të thotë Sureja e Hejkalit.—Shën. i përkth.]

²⁸ I biri i një konsulli francez në Siri, me të cilin Bahá'u'lláh-u kishte marrëdhënie miqësore.

Teksti i këtij paralajmërimi u bë i njohur në gjithë Persinë, sepse pikërisht në këtë periudhë u përhap në Persi Qitapi Hejkal [Kitáb-i-Haykal] dhe kjo letër përfshihej në përmbajtjen e këtij libri. Kjo ndodhi më 1869, dhe duke qenë se Sureja e Hejkalit qarkullonte në Persi e Indi dhe e kishin në dorë të gjithë besimtarët, ata prisnin të shihnin se ç’do të ndodhte. Jo shumë kohë më pas, më 1870, shpërtheu lufta midis Gjermanisë e Francës; dhe megjithëse në atë kohë askush nuk e priste fitoren e Gjermanisë, Napoleoni u mund e u turpërua; ai iu dorëzua armiqve dhe lavdia e tij u kthye në poshtërim të thellë.

Tabela²⁹ iu dërguan gjithashtu mbretërve të tjerë, e ndër to ishte edhe letra për Madhërinë e Tij Nasiridin Shah [H. M. Násiri’-d-Dín Sháh]. Në këtë letër Bahá’u’lláh-u thoshte: “Më thirr Mua, mblidh ulamatë dhe kërko prova e argumenta, që kështu e vërteta dhe e gënjeshtërtja të dalin në shesh.” M. T. Nasiridin Shahu ua dërgoi letrën e bekuar ulamave dhe u propozoi atyre të vepronin siç thoshte Bahá’u’lláh-u, por ata nuk patën guximin ta bënin këtë. Atëherë Shahu u kërkoi shtatë prej ulamave më të shquar të shkruanin një përgjigje për sfidën. Pas njëfarë kohe, ata e kthyen letrën e bekuar, duke thënë: “Ky njeri është kundërshtar i fesë dhe armik i Shahut”. Madhëria e Tij Shahu i Persisë u mërzi shumë dhe tha: “Kjo është çështje provash e argumentash dhe të vërtete ose gënjeshtre: ç’ka të bëjë kjo me armiqtësinë ndaj qeverisë? Medet! Sa i kemi respektuar këta ulama, që nuk janë në gjendje as t’i përgjigjen kësaj letre”.

Me pak fjalë, të gjitha ato që ishin shkruar në Tabelat për Mbretërit janë përmbushur: po t’i krahasojmë ngjarjet që kanë ndodhur nga viti 1870 e këtej, do të shohim se gjithçka që ka ndodhur është zhvilluar siç është parathënë; mbeten vetëm disa gjëra që do të manifestohen më pas.

Po kështu, edhe popuj të huaj dhe sekte të tjera që nuk ishin besimtarë, i atribuonin shumë gjëra të mahnitshme Bahá’u’lláh-ut. Disa besonin se Ai ishte shenjtör³⁰ dhe disa madje kanë shkruar traktate rreth Tij. Një ndër ta, Sijid Davudi [Siyyid Dávúdí], një dijetar sunit nga Bagdadi, shkroi një traktat të shkurtër në të cilin tregonte për disa akte të mbinatyrshme të Bahá’u’lláh-ut. Edhe tani, në të gjitha anët e Lindjes

²⁹ Emër që u është dhënë letrave të Bahá’u’lláh-ut.

³⁰ Valí.

ka njerëz që, edhe pse nuk besojnë te manifestimi i Tij, megjithatë besojnë se Ai është shenjtor dhe tregojnë për mrekulli që i atribuohen Atij.

Që ta përmbledhim, qoftë kundërshtarët qoftë përkrahësit e Tij, si dhe të gjithë ata që Ai i ka pritur në vendin e shenjtë, e kanë njohur dhe kanë dëshmuar për madhërinë e Bahá'u'lláh-ut. Edhe pse nuk besonin tek Ai, ata megjithatë e njihnin madhështinë e Tij, dhe sapo hynin në vendin e shenjtë, prania e Bahá'u'lláh-ut ushtronte një efekt të tillë mbi shumicën e tyre, saqë ata nuk ishin në gjendje të shqiptonin asnjë fjalë. Sa herë ka ndodhur që ndonjëri prej armiqve të Tij më të egër thoshte me vete “Unë do t'i them këto e ato e gjëra kur të jem në prani të Tij, dhe kështu do ta kundërshtoj e do të ndeshem me Të”, por kur hynte në Praninë e Shenjtë, habitej e hutohej dhe mbeste pa gojë.

Bahá'u'lláh-u kurrë nuk e pat studiuar gjuhën arabe; Ai nuk ka pasur ndonjë kujdestar ose mësues, as nuk ka ndjekur ndonjë shkollë. Megjithatë, elokuenca dhe eleganca e ligjëratave të Tij të bekuara në arabisht, ashtu si dhe shkrimet e Tij në gjuhën arabe, shkaktonin habi e mahnitje te dijetarët më të përkryer arabë, dhe të gjithë e pranonin dhe e deklaronin se Ai ishte i pakrahasueshëm e i pashoq.

Po të shqyrtojmë me kujdes tekstin e Torahut, do të shohim se Manifestimi Hyjnor kurrë nuk u thoshte atyre që e mohonin Atë: “Çfarë mrekullie të dëshironi Unë jam gati ta bëj dhe do t'i nështrohem çfarëdolloj prove që të propozoni”. Por në Letrën për Shahun Bahá'u'lláh-u e tha qartë “Mblidh ulamatë dhe më thirr Mua, që provat dhe faktet të mund të dalin në shesh”.³¹

Për pesëdhjetë vjet Bahá'u'lláh-u u bëri ballë armiqve të Tij si një mal: të gjithë donin ta eliminonin dhe kërkonin shkatërrimin e Tij. Një mijë herë ata planifikuan ta kryqëzonin e ta zhduknin Atë dhe gjatë këtyre pesëdhjetë vjetëve Ai ishte në rrezik të vazhdueshëm.

Në kohën e tanishme, Persia është në një gjendje të tillë rënieje e rrënim, saqë të gjithë njerëzit e zgjuar, qofshin persë ose të huaj, që e

³¹ Shih shënimin në f. 30. Duke i dhënë kaq rëndësi këtij shembulli të bonsensit të Bahá'u'lláh-ut, ‘Abdu’l-Bahá-i ka për qëllim të theksojë padobinë e mrekullive si një provë të së vërtetës së Manifestimeve të Perëndisë. Shih “Mrekullitë”, f. 100.

kuptojnë gjendjen e vërtetë të punëve, e njohin se përparimi, qytetërimi dhe rindërtimi i saj varen nga përhapja e mësimëve dhe nga zhvillimi i teorive të këtij Personaliteti të madh.

Krishti, në ditët e tij të bekuara, në të vërtetë edukoi vetëm njëmbëdhjetë veta: më i madhi ndër ta ishte Pjetri që, megjithatë, kur u vu në provë, e mohoi tri herë Krishtin. Megjithëkëtë, Kauza e Krishtit përshkoi më pas botën. Në kohën e sotme, Bahá'u'lláh-u ka edukuar mijëra shpirta, të cilët, duke qenë nën kërcënimin e shpatës, ngritën deri në qiell thirrjen “Ja Bahául Abhá [Yá Bahá'u'l-Abhá]”³²; dhe nën zjarrin e sprovave, fytyrat e tyre ndriçoheshin si ar. Mendoni, pra, se ç’do të ndodhë në të ardhmen.

Si përfundim, duhet të jemi të drejtë dhe të njohim se çfarë Edukatori ishte kjo Qenie e Lavdishme, çfarë shenjash të mrekullueshme u manifestuan prej Tij dhe çfarë pushteti e fuqie është realizuar në botë nëpërmjet Tij.

10

PROVAT TRADICIONALE TË MARRA SI SHEMBULL NGA LIBRI I DANIELIT

Sot, në tryezë, le të flasim pak për prova. Po të kishit ardhur në këtë vend të bekuar në ditët e manifestimit të Dritës së dukshme,³³ po të kishit arritur në oborrin e Pranisë së Tij dhe të kishit parë bukurinë e Tij të shndritshme, do ta kishit kuptuar se mësimet dhe përsosuria e Tij nuk kishin nevojë për dëshmi të tjera.

Vetëm nga nderi i ardhjes në prani të Tij shumë shpirta u bënë besimtarë të konfirmuar; ata nuk kishin nevojë për prova të tjera. Madje edhe ata që e kundërshtonin dhe e urrenin Atë për vdekje, kur e takuan dëshmuan për madhërinë e Bahá'u'lláh-ut, duke thënë: “Ç’neri i shkëlqyer, por sa keq që ka një pretendim të tillë! Përndryshe, të gjitha ato që thotë janë të pranueshme”.

³² Një thirrje që përdorej si deklaram i fesë nga Bahá'í-të; fjalë për fjalë do të thotë “O ti Lavdi e Lavdive!”

³³ Bahá'u'lláh-u.

Por tani që Drita e Realitetit ka perënduar, të gjithë kanë nevojë për prova; prandaj i jemi përveshur punës për të paraqitur prova logjike për të vërtetën e pretendimit të Tij. Do të citojmë një provë tjetër, e cila edhe e vetme është e mjaftueshme për të gjithë ata që janë të drejtë dhe të cilën askush nuk mund ta mohojë. Është fakt se kjo Qenie e ndritur e lartësoi Kauzën e Tij në “Burgun Më të Madh”;³⁴ nga ky Burg drita e Tij u përhap kudo, fama e Tij pushtoi botën dhe shpallja e lavdisë së Tij arriti në Lindje e në Perëndim. Deri më sot një gjë e tillë nuk ka ndodhur kurrë.

Po të kishte drejtësi, kjo do të pranohej; por ka njerëz që, edhe sikur t’u paraqiteshin të gjitha provat e botës, përsëri nuk do të gjykonin me drejtësi!

Kështu, kombe e shtete, me gjithë fuqinë e tyre, nuk mundën t’i bënin ballë Atij. Në të vërtetë, i vetëm e i izoluar, i burgosur e i shtypur, Ai bëri gjithçka deshi.

Nuk dua të përmend mrekullitë e Bahá’u’lláh-ut, sepse ndoshta mund të thuhet që ato janë legjenda, të lidhura qoftë me të vërtetën qoftë me gabimin, si tregimet për mrekullitë e Krishtit në Ungjill, që na vijnë jo nga dikush tjetër por nga apostujt e që hebrenjtë i mohojnë. Po të dëshiroja, sidoqoftë, të përmendja aktet e mbinatyrshe të Bahá’u’lláh-ut, ato janë të shumta dhe të njohura në Lindje, madje edhe nga jo-Bahá’í. Por këto tregime nuk përbëjnë prova e dëshmi vendimtare për të gjithë; dëgjuesi ndoshta mund të thotë se ajo që tregohet nuk përputhet me atë që ka ndodhur, sepse dihet që edhe sekte të tjera tregojnë mrekulli të kryera nga themeluesit e tyre. Për shembull, pasuesit e Brahmanizmit tregojnë mrekulli. Mbi bazën e çfarë provave mund ta dimë ne se ato janë të rreme kurse këto janë të vërteta? Po qe se ato janë përralla, edhe të tjerat janë përralla; po qe se ato pranohen përgjithësisht, atëherë edhe të tjerat pranohen përgjithësisht. Për rrjedhojë, këto rrëfime nuk përbëjnë prova të kënaqshme. Po, mrekullitë janë prova vetëm për atë që i ka parë me sytë e vet, madje edhe ai mund të mos i konsiderojë ato mrekulli por magji. Bëma të jashtëzakonshme tregohen edhe për magjistare të ndryshëm.

Me pak fjalë, dua të them se shumë gjëra të mrekullueshme janë kryer prej Bahá’u’lláh-ut, por ne nuk do t’i tregojmë ato, sepse nuk

³⁴ ‘Akká (Akra).

përbëjnë prova e dëshmi për të gjithë popujt e botës; ato nuk janë prova vendimtare madje as për ata që i kanë parë, sepse mund të mendojnë që janë thjesht magji.

Veç kësaj, pjesa më e madhe e mrekullive të Porfjetëve, për të cilat bëhet fjalë, kanë një domethënie të fshehtë. Për shembull, në Ungjill shkruhet se kur u martirizua Krishti u bë errësirë, bota u lëkund, perdja e Tempullit u ça nga kreu në fund dhe të vdekurit dolën prej varreve. Po të kishin ndodhur këto ngjarje, ato duhet të kishin qenë me të vërtetë të lemerishme dhe me siguri do të ishin regjistruar në historinë e atyre kohëve. Ato duhet të kishin shkaktuar shumë shqetësime në zemrat. Ushtarët ose do ta kishin zbritur Krishtin nga kryqi ose do të kishin ikur. Këto ngjarje nuk tregohen në asnjë histori; është, pra, e qartë se ato nuk duhet të merren fjalë për fjalë, por si të tilla që kanë një domethënie të fshehtë.³⁵

Nuk është qëllimi ynë t'i mohojmë mrekulli të tilla; duam vetëm të themi se ato nuk përbëjnë prova vendimtare dhe se ato kanë një domethënie të fshehtë.

Pra, sot në tryezë do t'i referohemi shpjegimit të provave tradicionale që përmbahen në Librat e Shenjtë. Deri tani kemi folur vetëm për prova logjike.

Gjendja në të cilën duhet ta verë veten ai që kërkon seriozisht të vërtetën i përngjet asaj të shpirtit të etur që digjet për ujin e jetës, të peshkut që lufton për të arritur detin, të të sëmurit që kërkon doktorin e vërtetë për të marrë mjekimin hyjnor, të karvanit të humbur që përpiqet të gjejë rrugën e drejtë, të anijes që ka humbur drejtimin dhe endet duke u përpjekur të arrijë bregun e shpëtimit.

Ja përse kërkuesi³⁶ duhet të jetë i pajisur me cilësi të caktuara. Para së gjithash, ai duhet të jetë i drejtë dhe i shkëputur nga gjithçka veç Perëndisë; zemra e tij duhet të jetë e kthyer krejtësisht ndaj horizontit suprem; ai duhet të jetë i lirë nga robëria e vetvetes dhe e pasionit, sepse të gjitha këto janë pengesa. Për më tepër, ai duhet të jetë i zoti të përballojë të gjitha vështirësitë. Ai duhet të jetë absolutisht i kulluar, i

³⁵ Shih “Mrekullitë”, f. 100.

³⁶ Është fjala për kërkuesin e së vërtetës fetare.—Shën. i red.

përkushtuar dhe i lirë nga dashuria ose nga urrejtja ndaj banorëve të botës. Pse? Sepse dashuria e tij për çdo person ose çdo gjë mund ta pengojë atë të shohë të vërtetën e një tjetër, dhe po kështu urrejtja për cilindo mund t'i bëhet pengesë për të parë të vërtetën. Ky është kushti i të kërkuarit dhe kërkuesi duhet t'i ketë këto cilësi e attribute. Pa plotësuar këtë kusht, është e pamundur që ai të arrijë Diellin e Realitetit.

Le të kthehemi tani te subjekti ynë. Të gjithë popujt e botës janë në pritje të dy Manifestimeve, të cilat duhet të jenë të njëkohshme; të gjithë presin përmbushjen e këtij premtimi. Në Bibël, hebrejtë kanë premtimin e Zotit të Ushtive dhe të Mesisë; në Ungjill premtohet kthimi i Krishtit dhe i Elias.

Në fenë e Muhametit është premtimi i Mihdiut e i Mesisë; e njëjta gjë ndeshet në besimin zoroastrian dhe në fetë e tjera, por po t'i shtjellonim këto çështje me hollësi, kjo do të kërkonte shumë kohë. Fakti thelbësor është se në të gjitha fetë ekziston premtimi për dy Manifestime, Që do të vinë njëri pas tjetrit. Është profetizuar se në kohën e këtyre dy Manifestimeve toka do transformohet, bota e ekzistencës do të ripërtërihet dhe qeniet do të vishen me rroba të reja. Drejtësia dhe e vërteta do të shtrihen në gjithë botën; armiqësia dhe urrejtja do të zhduken; të gjitha shkaqet e përçarjes ndërmjet popujve, racave e kombeve do të shuhet dhe do të shfaqet burimi i bashkimit, i harmonisë e i mirëkuptimit. I pavëmendshmi do të zgjohet, i verbri do të shikojë, i shurdhri do të dëgjojë, memeci do të flasë, i sëmuri do të shërohet dhe i vdekuri do të ngrihet. Lufta do t'ia lëshojë vendin paqes, armiqësia do të mposhtet nga dashuria, shkaqet e grindjeve e të zënieve do të zhduken krejtësisht dhe do të arrihet lumturia e vërtetë. Bota do të bëhet pasqyra e Mbretërisë Qiellore; njerëzimi do të bëhet Froni i Hyjnisë. Të gjitha kombet do të bëhen një komb i vetëm; të gjitha fetë do të bashkohen; të gjithë njerëzit do të jenë të një familjeje e të një fisi. Të gjitha rajonet e tokës do të bëhen një; paragjykimet e shkaktuara nga dallimet midis racave, vendeve, individëve, gjuhëve e politikave do të zhduken; dhe të gjithë njerëzit do të arrijnë jetën e pasosur, nën hijen e Zotit të Ushtive.

Tani duhet të provojmë nga Librat e Shenjtë se këto dy Manifestime kanë ardhur dhe duhet të gjejmë domethënien e fjalëve të Profetëve, sepse ne duam prova të nxjerra nga Librat e Shenjtë.

Disa ditë më parë, në tryezë, ne parashtruam prova racionale që tregojnë të vërtetën e këtyre dy Manifestimeve.

Që ta përfundojmë këtë: në Librin e Danielit, që nga rindërtimi i Jerusalemit deri në martirizimin e Krishtit, flitet për shtatëdhjetë javë; sepse me martirizimin e Krishtit sakrifica kryhet dhe altari shkatërrohet.³⁷ Kjo është një profeci e manifestimit të Krishtit. Këto shtatëdhjetë javë fillojnë me rimëkëmbjen dhe rindërtimin e Jerusalemit, gjë për të cilën u shpallën katër dekrete nga tre mbretër.

I pari u shpall nga Kiri në vitin 536 p.K.; kjo është shënuar në kreun e parë të Librit të Ezrës. Dekreti i dytë, që i referohet rindërtimit të Jerusalemit, është ai i Darit të Persisë në vitin 519 p.K.; kjo është shënuar në kreun e gjashtë të Ezrës. I treti është i Artakserksit në vitin e shtatë të mbretërimit të tij—pra më 457 p.K.; kjo është shënuar në kreun e shtatë të Ezrës. I katërti është ai i Artakserksit në vitin 444 p.K.; kjo është shënuar në kreun e dytë të Nehemisë.

Por Danieli i referohet në mënyrë të posaçme dekretit të tretë që u shpall në vitin 457 p.K. Shtatëdhjetë javë bëjnë katërqind e nëntëdhjetë ditë. Çdo ditë, sipas tekstit të Librit të Shenjtë, është një vit. Sepse në Biblën thuhet: “Dita e Zotit është një vit”.³⁸ Pra, katërqind e nëntëdhjetë ditë janë katërqind e nëntëdhjetë vjet. Dekreti i tretë i Artakserksit u shpall katërqind e pesëdhjetë e shtatë vjet para lindjes së Krishtit, dhe Krishti, kur u martirizua dhe u ngjiti në qiell ishte tridhjetë e tre vjeç. Po t’i shtoni tridhjetë e tre katërqind e pesëdhjetë e shtatës, rezultati është katërqind e nëntëdhjetë, që është koha e shpallur nga Danieli për manifestimin e Krishtit.

Por në vargun e njëzetepestë të kreut të nëntë të Librit të Danielit kjo është shprehur në një mënyrë tjetër, si shtatë javë dhe gjashtëdhjetë e dy javë; në dukje kjo ndryshon nga thënia e parë. Shumë njerëz janë vënë në mëdyshje nga ky ndryshim, duke u përpjekur t’i pajtojnë këto dy

³⁷ Shih Danieli 9:24.

³⁸ Shih Numra 14:34.

deklarata. Si mund të jenë shtatëdhjetë javë nga njëra anë, ndërsa gjashtëdhjetë e dy javë dhe shtatë javë nga na tjetër? Këto dy thënie nuk përputhen.

Mirëpo Danieli përmend dy data. Njëra prej këtyre datave fillon me urdhrin e Artakserksit dhënë Ezrës për të rindërtuar Jerusalemin: këto janë shtatëdhjetë javët që mbyllen me ngjitjen e Krishtit, kur me martirizimin e Tij sakrificat dhe blatimi morën fund.

Periodha e dytë, që gjendet në vargun e njëzet e gjashtë, do të thotë se pas përfundimit të rindërtimit të Jerusalemit deri në ngjitjen e Krishtit, do të kalojnë gjashtëdhjetë e dy javë: shtatë javë janë kohëzgjatja e rindërtimit të Jerusalemit, që vazhdoi dyzet e nëntë vjet. Po t'ua shtoni këto shtatë javë gjashtëdhjetë e dy javëve, bëhen gjashtëdhjetë e nëntë javë dhe në javën e fundit (69-70) ndodhi ngjitja e Krishtit. Këto shtatëdhjetë javë plotësohen kështu dhe nuk ka më asnjë kundërshti.

Tani që manifestimi i Krishtit është provuar nga profecitë e Danielit, le të provojmë manifestimet e Bahá'u'lláh-ut e të Báb-it. Deri tani kemi përmendur vetëm prova logjike; tani do të flasim për prova tradicionale.

Në kreun e tetë të Librit të Danielit, vargu trembëdhjetë, thuhet: “Atëherë dëgjova një shenjtor që fliste; dhe një shenjtor tjetër që i tha shenjtorit që fliste: Sa kohë do të kërkojë vizioni i flijimit të përditshëm e i mëkatit që shkakton shkretim, për të bërë që si vendi i shenjtë dhe ushtria të shkelen me këmbë?” Dhe ai u përgjigj (vargu 14): Deri në dy mijë e treqind ditë, mbrëmje e mëngjese; pastaj vendi i shenjtë do të pastrohet”; (vargu 17) “Por ai më tha...ky vizion është për kohën e fundit” Me fjalë të tjera: sa kohë do të zgjatë ky fat i keq, ky shkatërrim, ky poshtërim e ky degradim? Që do të thotë: kur do të agojë Manifestimi? Atëherë ai u përgjigj “Dy mijë e treqind ditë, mbrëmje e mëngjese; pastaj vendi i shenjtë do të pastrohet”. Me pak fjalë, domethënia e këtij fragmenti është se ai cakton dy mijë e treqind vjet, sepse në tekstin e Biblës çdo ditë është një vit. Kështu, nga data e nxjerrjes së dekretit të Artakserksit për rindërtimin e Jerusalemit deri në ditën e lindjes së Krishtit kemi 456 vjet, dhe nga lindja e Krishtit deri në ditën e manifestimit të Báb-it janë 1844 vjet. Po t'i shtoni 456 vjet këtij numri, bëhen 2300 vjet. Domethënë, përmbushja e vizionit të Danielit u bë në vitin 1844, dhe ky është viti i manifestimit të Báb-it,

sipas tekstit të Librit të Danielit. Vëreni sa qartë e përcakton ai vitin e manifestimit; nuk mund të kishte profeci më të qartë sesa kjo për një manifestim.

Te Mateu, kreu 24, vargu 3, Krishti e thotë qartë se ajo që nënkuptonte Danieli me këtë profeci ishte data e manifestimit; dhe ja vargu: “Ndërsa ishte ulur në malin e Ullinjve, dishepujt iu afruan Atij në konfidencë, duke i thënë ‘Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra? Dhe cila do të jetë shenja e ardhjes sate dhe e fundit të botës?’” Një prej shpjegimeve që Ai u dha atyre ishte ky (vargu 15): “Kur ju, pra, të shihni shkretimin e neveritshëm, për të cilin ka folur profeti Daniel, të qëndrojnë në vendin e shenjtë, (kush lexon le të kuptojë)”. Në këtë përgjigje ai i përcjell ata te kreu i tetë i Librit të Danielit, duke thënë se kush e lexon atë do ta kuptojë se kjo është koha për të cilën bëhet fjalë. Vëreni sa qartë flitet për manifestimin e Báb-it në Dhiatën e Vjetër dhe në Ungjill.

Për ta përfunduar, të shpjegojmë tani nga Bibla datën e manifestimit të Bahá'u'lláh-ut. Data e ardhjes së Bahá'u'lláh-ut llogaritet sipas viteteve hënore nga misioni dhe Hexhira [Hejira]³⁹ e Muhametit; sepse në fenë e Muhametit përdoret viti hënor, dhe gjithashtu është viti hënor që përdoret lidhur me të gjitha porositë e kultit.

Te Danieli, kreu 12, vargu 6, thuhet: “Dhe njëri e pyeti njeriun e veshur me rrobë liri, i cili ishte mbi ujët e lumit: “Pas sa kohësh do të vijë fundi i këtyre mrekullive?” Dhe unë dëgjova njeriun me rrobë liri, që ishte mbi ujët e lumit, i cili ngriti dorën e djathtë e të majtë nga qielli dhe u betua për Atë që jeton përgjithmonë se kjo do të ndodhë në një kohë të caktuar, në kohëra dhe një gjysmë kohe; dhe se kur Ai ta ketë thyer krejtësisht fuqinë e popullit të shenjtë, të gjitha këto gjëra do të marrin fund”⁴⁰

Duke qenë se e kam sqaruar tashmë domethënien e një dite, nuk është e nevojshme ta shpjegojmë më tej; por do të themi shkurt se çdo ditë e Atit llogaritet një vit dhe në çdo vit ka dymbëdhjetë muaj. Kështu tre vjet e gjysmë bëjnë dyzet e dy muaj dhe dyzet e dy muaj janë njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë. Báb-i, pararendësi i Bahá'u'lláh-

³⁹ “Hexhira”, në arabisht *hixhira* do të thotë shpërngulje (shpërngulja e Muhametit nga Meka në Medinë).—Shën. i përkth.

⁴⁰ Shih Danieli 12:6-7.

ut, doli në vitin 1260 nga Hexhira e Muhametit, sipas llogarive të Islamit.

Më pas, në vargun 11, thuhet: “Që nga koha që flijimi i përditshëm do të hiqet dhe shkretimi i neveritshëm do të vendoset, do të kalojnë një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë ditë. Lum ai që pret dhe që do të arrijë një mijë e treqind e tridhjetë e tre ditët!”⁴¹

Fillimi i kësaj llogaritjeje hënore bëhet që nga dita e shpalljes së profetërisë së Muhametit në vendin e Hixhaz-it; dhe kjo ishte tre vjet pas misionit të tij, sepse në fillim profetëria e Muhametit u mbajt e fshehtë dhe askush nuk dinte gjë për të veç Kadijes [Khadijah] dhe Ibn Naufalit [Ibn Nawfal].⁴² Pas tre vjetësh ajo u shpall. Dhe Bahá'u'lláh-u, në vitin 1290 nga shpallja e misionit të Muhametit, bëri të njohur manifestimin e Vet.⁴³

11

KOMENT PËR KREUN E NJËMBËDHJETË TË REVELACIONIT TË SHËN GJONIT

Në fillim të kreut të njëmbëdhjetë të Revelacionit të Shën Gjonit thuhet:

“Pastaj m’u dha një kallam, që i ngjante një shkopi: dhe engjëlli qëndronte aty dhe më tha: “Ngrihu dhe mate tempullin e Perëndisë, dhe altarin, dhe numëroi ata që adhurojnë aty.

“Por lëre oborrin që ndodhet jashtë Tempullit, atë mos e mat; sepse ai u është dhënë paganëve, dhe ata do ta shkelin qytetin e shenjtë për dyzet e dy muaj”.

⁴¹ Referenca duket në vargjet 11 dhe 12.

⁴² Varakat Ibn Naufal [Varaqat-Ibn-Nawfal], kushëri i Kadijes.

⁴³ Viti 1290 nga shpallja e misionit të Muhametit ishte viti 1280 i Hexhirës, ose viti 1863-64 i epokës sonë. Pikërisht në këtë epokë (prill 1863) Bahá'u'lláh-u, duke u larguar nga Bagdadi për në Kostandinopojë, u deklaroi atyre që e rrethonin se Ai ishte Manifestimi i njoftuar prej Báb-it.

Është kjo deklaratë që festohet prej Bahá'í-ve me festën e Rivánit, emër ky që i është dhënë kopshtit në hyrje të qytetit, ku Bahá'u'lláh-u qëndroi dymbëdhjetë ditë dhe ku Ai e bëri deklaratën.

Ky kallam është një Njeri i Përsosur i krahasuar me një kallam, dhe domethënia e këtij krahasimi është kjo: ashtu si pjesa e brendshme e kallamit, kur është e zbrazët dhe e lirë nga çdo gjë, nxjerr melodi të mrekullueshme, dhe meqë tingulli e meloditë nuk vijnë nga kallami, por nga ai që i bie fyellit, po kështu zemra e shenjtëruar e asaj Qenieje të bekuar është e lirë dhe e qëruar nga gjithçka veç Perëndisë, e dëlirë dhe e shkëputur nga lidhja me çdo kusht njerëzor, dhe në shoqëri me Shpirtin Hyjnor. Çdo gjë që thotë nuk vjen nga Vetja e Tij, por nga flautisti i vërtetë, është, pra, një frymëzim hyjnor. Ja përse Ai krahasohet me një kallam; dhe ky kallam është si një shkop—domethënë është ndihmë për çdo njeri të pafuqishëm dhe mbështetje për qeniet njerëzore. Kallami është shkopi i bariut hyjnor, me të cilin Ai ruan grigjën e Tij dhe e çon në kullotat e Mbretërisë.

Pastaj thuhet: “Engjëlli qëndronte aty dhe më tha: Ngrihu dhe mate tempullin e Perëndisë, dhe altarin, dhe numëroi ata që adhurojnë aty”.— domethënë krahaso dhe mat: të matësh do të thotë të zbulosh përmasat. Kështu engjëlli tha: krahasoje tempullin e Perëndisë dhe altarin dhe ata që po luten aty—domethënë zbulo cila është gjendja e tyre e vërtetë dhe gjej në ç’gradë e në ç’rrethana janë, si dhe ç’kushte, përsosuri, sjellje e cilësi zotërojnë ata; dhe njihi me misteret e këtyre shpirtëve të shenjtë që banojnë në të Shenjtin e të Shenjtëve në dëlirësi e shenjtëri.

“Por lëre oborrin që ndodhet jashtë Tempullit, atë mos e mat; sepse ai u është dhënë paganëve”.

Në fillim të shekullit të shtatë pas Krishtit, kur u pushtua Jerusalemi, i Shenjti i të Shenjtëve në dukje ishte i mbrojtur—domethënë tempulli që kishte ndërtuar Sollomoni; por jashtë të Shenjtit të të Shenjtëve, pra oborri i jashtëm u mor e iu dha paganëve. “Dhe ata do ta shkelin qytetin e shenjtë për dyzet e dy muaj”—me fjalë të tjera, paganët do ta qeverisin e sundojnë Jerusalemin për dyzet e dy muaj, që do të thotë njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë; dhe meqë çdo ditë nënkupton një vit, sipas kësaj llogaritjeje bëhen njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë vjet, që është kohëzgjatja e ciklit të Kuranit. Sepse në tekste e Librit të Shenjtë çdo ditë është një vit; siç thuhet në kreun e katërt të Ezekielit, vargu 6: “Ti do të mbash mbi vete paudhësitë e shtëpisë së Judës për dyzet ditë: unë ta kam caktuar një ditë për një vit”.

Kjo profetizon kohën e Dispensacionit të Islamit, kur Jerusalemi u shkel, që do të thotë se humbi lavdinë e vet—por i Shenjti i të Shenjtëve u ruajt, u mbrojt e u respektua—deri në vitin 1260. Këta 1260 vjet janë një profeci e manifestimit të Báb-it, të “Portës” së Bahá’u’lláh-ut, që ndodhi në vitin 1260 të Hexhirës së Muhametit, dhe meqenëse periudha e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë vjetëve ka mbaruar, Jerusalemi, Qyteti i Shenjtë, po fillon të begatohet, të popullohet e të lulëzojë. Kushdo që e ka parë Jerusalemin gjashtëdhjet vjet më parë dhe që e sheh tani, do të shohë sesa i populluar e i lulëzuar është bërë, dhe si po nderohet përsëri.

Kjo është domethënia e jashtme e këtyre vargjeve të Revelacionit të Shën Gjorit; por ato kanë edhe një shpjegim tjetër e një domethënie simbolike, si më poshtë: Ligji i Perëndisë ndahet në dy pjesë. Njëra është baza themelore që përfshin të gjitha gjërat shpirtërore—domethënë u referohet virtyteve shpirtërore e cilësive hyjnore; kjo nuk nuk ndryshon e as modifikohet: kjo është i Shenjti i të Shenjtëve që përbën thelbin e Ligjit të Adamit, të Nojit, të Abrahamit, të Moisiut, të Krishtit, të Muhametit, të Báb-it e të Bahá’u’lláh-ut, dhe që mbetet e ekziston në të gjitha ciklet profetike. Ky ligj nuk do të hiqet kurrë, sepse është e vërtetë shpirtërore e jo materiale; ai është besim, dije, siguri, drejtësi, devotshmëri, virtytshmëri, dashuri për Perëndinë, dashamirësi, dëlirësi, vetëmohim, përlësi, butësi, durim e besnikëri. Ai tregon mëshirë për të varfërit, mbron të shtypurit, u jep të mjerëve dhe ngrën të rënë.

Këto cilësi hyjnore, këto porosi të përjetshme nuk do të hiqen kurrë; madje ato do të vazhdojnë e do të mbeten për jetë të jetëve. Këto virtyte të njerëzimit do të ripërtërihen në secilin prej cikleve të ndryshme; sepse në fund të çdo cikli Ligji shpirtëror i Perëndisë—domethënë virtytet njerëzore—zhduken dhe vetëm forma mbetet.

Kështu, midis hebrejve, në fund të ciklit të Moisiut, që përkon me Manifestimin Kristian, Ligji i Perëndisë u zhduk, mbeti vetëm një formë pa shpirt. I Shenjti i të Shenjtëve u nda prej tyre, por oborri i jashtëm i Jerusalemit—që është shprehja e përdorur për formën e fesë—ra në duart e paganëve. Në të njëjtën mënyrë, parimet themelore të fesë së Krishtit, që janë virtytet më të mëdha të njerëzimit, janë zhdukur; dhe forma e tyre ka mbetur në duart e klerikëve e të

priftërinjve. Po kështu, themeli i fesë së Muhametit është zhdukur; por forma ka mbetur në duart e ulamave zyrtarë.

Këto themele të Fesë së Perëndisë, që janë shpirtërore dhe që janë virtytet e njerëzimit, nuk mund të hiqen; ato janë të pandryshueshme e të përjetshme dhe ripërtërihen në ciklin e çdo Profeti.

Pjesa e dytë e Fesë së Perëndisë, që i referohet botës materiale dhe që përfshin agjërimin, lutjen, format e adhurimit, martesën e shkurorëzimin, heqjen e skallavërisë, proceset legale, transaksionet, ndëshkimet për vrasje, dhunë, vjedhje e dëmtime—kjo pjesë e Ligjit të Perëndisë, që u referohet gjërave materiale, modifikohet e ndryshohet në çdo cikël profetik sipas nevojave të kohës.

Shkurt, me termin i Shenjti i të Shenjtëve nënkuptohet ai Ligj shpirtëror që kurrë nuk do të modifikohet, ndryshohet ose hiqet; kurse me Qytetin e Shenjtë nënkuptohet Ligji material që mund të hiqet; dhe ky Ligj material, i quajtur Qyteti i Shenjtë, do të shkelej për një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë vjet.

“Dhe Unë do të dërgoj dy dëshmitarët e mi që të profetizojnë për një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë, të veshur me petk thesi”.⁴⁴ Këta dy dëshmitarë janë Muhameti, Lajmëtari i Perëndisë, dhe Aliu, i biri i Abú Tálíb-it.

Në Kuran thuhet se Perëndia iu drejtua Muhametit, Lajmëtarit të Perëndisë, dhe i tha: “Ne të bëjmë Ty një Dëshmitar, një Kasnec të lajmeve të mira dhe një Paralajmërues”—që do të thotë Ne të caktuar Ty si dëshmitar, dhënë të lajmeve të gëzuara dhe si Atë që do të sjellë zemërimin e Perëndisë.⁴⁵ Me termin “një dëshmitar” nënkuptohet ai, me dëshminë e të cilit gjërat mund të verifikohen. Urdhrat e këtyre dy dëshmitarëve duhej të zbatoheshin për njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë, dhe çdo ditë nënkuptonte një vit. Tani, Muhameti ishte rrënja dhe Aliu ishte dega, ashtu si Moisiu dhe Jozuei. Thuhet se ata “janë veshur me petk thesi”, që do të thotë se ata, në dukje, ishin veshur me rroba të vjetra, jo me veshje të reja; me fjalë të tjera, në fillim, ata nuk do të shkëlqenin në sytë e njerëzve, as Kauza e tyre nuk do të dukej e re;

⁴⁴ Revelacioni 11:3.

⁴⁵ Kjo thënie është përkthimi persisht i tekstit arab të Kuranit, që është cituar.

sepse Ligji shpirtëror i Muhametit përkon me atë të Krishtit në Ungjill dhe pjesa më e madhe e ligjeve të Tij lidhur me gjërat materiale përputhet me ato të Pesëlibërshit. Kjo është domethënia e veshjes së vjetër.

Pastaj thuhet: “Ata janë dy ullinjë dhe dy shandanët që qëndrojnë para Zotit të tokës”.⁴⁶ Këta dy shpirtra krahasohen me dy drurë ulliri, sepse në atë kohë të gjitha llambat ndizeshin me vaj ulliri. Kuptimi është ky: këta janë dy persona, nga të cilët përhapet shpirti i urtisë së Perëndisë, që është burimi i ndriçimit të botës. Këto drita të Perëndisë duhet të rrezatojnë e të ndritin; prandaj ato krahasohen me dy shandanë: shandani është vendi i dritës dhe prej tij përhapet drita. Në të njëjtën mënyrë, drita e udhërrëfimit do të shkëlqente e do të përhapej nga këta shpirtra të ndriçuar.

Pastaj thuhet: “Ata qëndrojnë para Zotit”, domethënë ata janë vënë në shërbim të Perëndisë dhe edukojnë krijesat e Perëndisë, siç janë fiset nomade barbare arabe të gadishullit Arabik, të cilët ata i edukuan në mënyrë të tillë që në atë periudhë ato arritën shkallën më të lartë të qytetërimit dhe fama e zëri i tyre u bë i dëgjuar në mbarë botën.

“Dhe po qe se ndokush kërkon t’u bëjë keq, nga goja e tyre del zjarr dhe i përpin armiqtë e tyre”.⁴⁷ Domethënë se askush nuk do të jetë në gjendje t’u bëjë ballë atyre, se sikur ndokush të kërkojë të ulë mësimet dhe ligjin e tyre, ai do të rrethohet e asgjësohet nga vetë ligji që del prej gojës së tyre; dhe kushdo që do të përpiqej t’i godasë, t’u kundërvihet e t’i urrejë ata, do të eliminohet me një urdhër që do të dalë prej gojës së tyre. Dhe kështu ndodhi: të gjithë armiqtë u mposhtën, ua mbathën dhe u eliminuan. Ja në ç’mënyrë të qartë i ndihmoi ata Perëndia.

Më pas thuhet: “Këta kanë fuqi të mbyllin qiellin, që të mos bjerë më shi në ditët e profecisë së tyre”,⁴⁸ që do të thotë se në atë cikël ata do të ishin si mbretër. Ligji dhe mësimet e Muhametit dhe shpjegimet e komentet e Aliut janë një dhunti qiellore; në qoftë se ata dëshirojnë ta japin këtë dhunti, kanë fuqi ta bëjnë këtë. Nëse nuk duan, nuk do të bjerë shi: në këtë rast me shiun nënkuptohet dhuntia.

⁴⁶ Revelacioni 11:4.

⁴⁷ Shih Revelacioni 11:5.

⁴⁸ Revelacioni 11:6.

Pastaj thuhet: “Ata kanë fuqi ta shndërrojnë ujin në gjak”,⁴⁹ që do thotë se profetëria e Muhametit ishte e njëjtë si e Moisiut dhe se fuqia e Aliut ishte e njëjtë me atë të Jozueit: nëse dëshironin ata mund ta kthenin ujin e Nilit në gjak, për egjiptianët dhe për ata që i mohonin—domethënë se ajo që ishte burim jete për ta, për arsye të injorancës e të kryelartësisë së tyre u bë shkak i vdekjes së tyre. Kështu mbretëria, pasuria dhe pushteti i Faraonit e i popullit të tij, që ishin burim i jetës së kombit, u bë, për arsye të kundërvënies, të mohimit e të kryelartësisë së tyre, shkak vdekjeje, shkatërrimi, shpërbërjeje, degradimi e varfërie. Pra, këta dy dëshmitarë kanë fuqi të shkatërrojnë kombet.

Pastaj thuhet: “Dhe ta godasin tokën me çdo lloj lëngate sa herë të duan”,⁵⁰ që do të thotë se ata do të kenë gjithashtu fuqi dhe forcën e nevojshme materiale që t’i edukojnë të ligjtë shtypës e tiranë, sepse këtyre dy dëshmitarëve Perëndia u kishte dhënë si fuqi të brendshme dhe të jashtme që të mund t’i edukonin e ndreqnin nomadët arabë mizorë, gjakatarë e tiranë, që ishin si bisha të egra.

“Dhe kur ta kenë përfunduar dëshminë e tyre”⁵¹ do të thotë: kur ata ta kenë kryer atë që u është urdhëruar, dhe ta kenë dhënë mesazhin hyjnor, dhe të kenë përhapur Ligjin e Perëndisë e të kenë përçarë mësimet qiellore, me qëllim që shenjat e jetës shpirtërore të shfaqen në shpirtrat dhe drita e virtyeteve të botës së njerëzimit të shkëlqejë, derisa zhvillimi i plotë të çohet midis fiseve nomade.

“Bisha e egër që del nga humnera do të bëjë luftë kundër tyre dhe do t’i mundë e do t’i vrasë”.⁵² me këtë egërsirë nënkuptohen Umajadët [Ummayads] që i sulmonin ata nga humnera e gabimit dhe që u ngritën kundër fesë të Muhametit dhe kundër realitetit të Aliut—me fjalë të tjera kundër dashurisë së Perëndisë.

Thuhet “Bisha e egër që del nga humnera do të bëjë luftë kundër tyre”⁵³—domethënë luftë shpirtërore, gjë që do të thotë se bisha e egër do të veprojë në kundërvënie të plotë me mësimet, zakonet dhe

⁴⁹ Shih Revelacioni 11:6.

⁵⁰ Shih Revelacioni 11:6.

⁵¹ Revelacioni 11:7.

⁵² Shih Revelacioni 11:7.

⁵³ Shih Revelacioni 11:7.

institucionet e këtyre dy dëshmitarëve, në një shkallë të tillë që virtytet e përsosurisë që ishin përhapur nga fuqia e këtyre dy dëshmitarëve midis popujve e fiseve do të eliminohen krejtësisht dhe natyra shtazore e dëshirat epshore do të mbizotërojnë. Pra, kjo bishë e egër që bën luftë kundër tyre do të arrijë fitoren—gjë që do të thotë se errësira e gabimit që vjen nga kjo bishë do të mbizotërojë në horizontet e botës dhe do t'i vrasë këta dy dëshmitarë—me fjalë të tjera, ajo do ta shkatërrojë jetën shpirtërore që ata kishin përhapur gjerësisht në gjirin e kombit dhe do t'i zhdukë krejtësisht ligjet e mësimet hyjnore, duke shkelur me këmbë Fenë e Perëndisë. Asgjë nuk do të mbetet paskëtaj veç një trupi pa jetë e pa shpirt.

“Dhe kufomat e tyre do të mbeten shtrirë në sheshin e qytetit të madh, që shpirtërisht quhet Sodomë dhe Egjipt, ku është kryqëzuar edhe Zoti ynë”.⁵⁴ “Kufomat e tyre” do të thotë Feja e Perëndisë dhe “sheshi” do të thotë para syve të publikut. Kuptimi i “Sodomës dhe Egjiptit”, i vendit “ku është kryqëzuar edhe Zoti ynë”, ishte krahina e Sirisë dhe veçanërisht Jerusalemi, ku Umajadët kishin atëherë zotërimet e tyre; dhe pikërisht atje u zhdukën në fillim Feja e Perëndisë dhe mësimet hyjnore, duke mbetur një trup pa shpirt. Me “Kufomat e tyre” nënkuptohet feja e Perëndisë, e cila mbeti si një trup i vdekur pa shpirt.

“Dhe njerëzit nga të gjithë popujt dhe të gjitha fiset e gjuhët e kombet do t'i shohin kufomat e tyre për tri ditë e gjysmë, dhe nuk do të lënë që kufomat e tyre të varrosen”.⁵⁵

Siç e kemi shpjeguar, në terminologjinë e Librave të Shenjtë tri ditë e gjysmë do të thotë tre vjet e gjysmë, dhe tre vjet e gjysmë janë dyzet e dy muaj, dhe dyzet e dy muaj janë njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë, dhe çdo ditë sipas tekstit të Librit të Shenjtë do të thotë një vit. Kuptimi është, pra, se për një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë vjet, që është cikli i Kuranit, kombet, fiset dhe popujt do t'i shohin trupat e tyre, domethënë ata do ta bëjnë Fenë e Perëndisë një spektakël: megjithëse nuk do të veprojnë në pajtim me të, ata përsëri nuk do të lënë që trupat e tyre, domethënë feja e Perëndisë, të varrosen. Kjo do të thotë që në dukje ata do të mbahen pas Fesë së Perëndisë dhe nuk do të lejojnë që

⁵⁴ Revelacioni 11:8.

⁵⁵ Revelacioni 11:9.

ajo të zhduket krejtësisht midis tyre dhe as që trupi i saj të shkatërrohet e eliminohet tërësisht. Jo, në të vërtetë ata do ta braktisin atë, duke ruajtur në dukje të jashtme emrin dhe kujtimin e saj.

Këta “fise, popuj e kombe” nënkuptojnë ata që janë mbledhur nën hijen e Kuranit, që nuk lejojnë që Kauza dhe Ligji i Perëndisë, në dukje të jashtme, të shkatërrohet e të eliminohet krejtësisht, sepse ata kanë ruajtur lutjen dhe agjërimin, por parimet themelore të Fesë së Perëndisë, që janë morali dhe sjellja, bashkë me dijen për misteret hyjnore, janë zhdukur; drita e virtyeteve të botës së njerëzimit, që është rezultat i dashurisë e i njohjes së Perëndinë, është shuar dhe errësira e tiranisë, e shtypjes, e pasioneve dhe e dëshirave djallëzore ka triumfuar. Trupi i Ligjit të Perëndisë, si një kufomë, është ekspozuar para syve të publikut për një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë, çdo ditë e llogaritur si një vit, që është periudha e ciklit të Muhametit.

Njerëzit i braktisën të gjitha ato që kishin vendosur këta dy persona, që ishin themeli i Ligjit të Perëndisë, dhe i shkatërruan virtytet e botës së njerëzimit, që janë dhuntitë hyjnore dhe shpirti i kësaj feje, në një shkallë të tillë sa sinqeriteti, drejtësia, dashuria, uniteti, dëlirësia, shenjtëria, vetmohimi dhe të gjitha cilësitë hyjnore u zhdukën midis tyre. Në fe mbetën vetëm lutjet dhe agjërimi; kjo gjendje zgjati një mijë e dyqind vjet, që është kohëzgjatja e ciklit të Furkanit [Furqán].⁵⁶ Ishte sikur këta dy persona të kishin vdekur dhe trupat e tyre të kishin mbetur pa shpirt.

“Dhe banorët e tokës do të ngazëllohen për ta dhe do t’i dërgojnë dhurata njëri-tjetrit, sepse këta dy profetë i kishin torturuar banorët e tokës”.⁵⁷ “Banorët e tokës” do të thotë kombet dhe racat e tjera, si popujt e Evropës e të Azisë së largët, të cilët, kur panë se karakteri i Islamit kishte ndryshuar krejtësisht, se Ligji i Perëndisë ishte braktisur—se virtytet, zelli dhe nderi ishin larguar nga ata dhe se cilësitë e tyre kishin ndryshuar—u gëzuan dhe iu bë qejfi që zvetënimimi moral kishte infektuar popujt e Islamit dhe se ata, për rrjedhojë, do të mposhteshin nga kombe të tjera. Kështu ndodhi. Shihni sesi ai popull

⁵⁶ Një emër tjetër i Kuranit, që do të thotë Shquarsi.

⁵⁷ Shih Revelacioni 11:10.

që pat arritur majat e pushtetit, tani ka rënë aq poshtë dhe është marrë nëpër këmbë.

Kombet e tjera “do t’i dërgojnë dhurata njëri-tjetrit”, që do të thotë se do ta ndihmojnë njëri-tjetrin, sepse “këta dy profetë i kishin torturuar banorët e tokës”—domethënë ata i kishin mposhtur kombet dhe popujt e tjerë të botës dhe i kishin nënshtuar ata.

“Dhe pas tre ditë e gjysmë, shpirti i jetës nga Perëndia hyri në ta dhe ata u ngritën më këmbë; dhe një frikë e madhe i pushtoi ata që i shihnin”.⁵⁸ Tre ditë e gjysmë, siç e shpjeguam më lart, janë një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë vjet. Ata dy persona, trupat e të cilëve ishin të shtrirë pa shpirt, janë mësimet dhe ligji që vendosi Muhameti dhe Aliu i përhap, por nga të cilat u largua realiteti dhe mbeti vetëm forma. Shpirti hyri përsëri në ta do të thotë se ato parime themelore e mësimet u vendosën përsëri. Me fjalë të tjera, shpirtësia e Fesë së Perëndisë ishte shndërruar në materializëm dhe virtytet në vese; dashuria e Perëndisë ishte shndërruar në urrejtje, ndriçimi në errësirë, cilësitë hyjnore në djallëzore, drejtësia në tirani, mëshira në armiqësi, sinqeriteti në hipokrizi, udhërrëfimi në gabim dhe dëlirësia në epush. Pastaj, pas tre ditë e gjysmë, të cilat në terminologjinë e Librave të Shenjtë janë një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë vjet, këto mësimet hyjnore, këto virtyete qiellore, përsosuri e dhunti shpirtërore u përtërinë përsëri nga dalja e Báb-it dhe nga përkushtimi i Xhinabi Kudus-it [Jináb-i-Quddús].⁵⁹

Flladet e shenjta u përhapën, drita e së vërtetës ndriçoi, stina e pranverës jetëdhënëse erdhi dhe agimi i udhërrëfimit zbardhi. Këta dy trupa pa jetë u bënë përsëri të gjallë, këta dy njerëz të mëdhenj—njëri Themeluesi dhe tjetri përhapësi—u ngritën dhe ishin si dy shandanë, sepse ata ndriçuan botën me dritën e së vërtetës.

“Dhe dëgjuan një zë të madh nga qielli që u thoshte: Ngiituni këtu. Dhe ata u ngjitën në qiell”,⁶⁰ që do thotë se nga qielli i padukshëm ata dëgjuan zërin e Perëndisë që thoshte: Ju keni bërë çdo gjë që ishte e

⁵⁸ Shih Revelacioni 11:11.

⁵⁹ Haxhi Mulla Muhamet Ali Barfurushi [Ḥájí Mullá Muḥammad-‘Alíy-i-Bárfurúshí], një prej dishepujve kryesorë të Báb-it dhe një prej nëntëmbëdhjetë Shkronjave të të Gjallit.

⁶⁰ Revelacioni 11:12.

përshtatshme dhe e nevojshme në përhapjen e mësimëve e të lajmit të gëzuar; ju ua keni dhënë mesazhin Tim njerëzve dhe keni shpallur thirrjen e Perëndisë, dhe e keni kryer detyrën tuaj. Tani, ashtu si Krishti, ju duhet të flijoni jetën tuaj për të Shumëdashurin dhe të bëheni martirë. Dhe ai Diell i Realitetit dhe ajo Hënë e Udhërrëfimit,⁶¹ të dy, si Krishti, perënduan në qiellin e martirizimit më të madh dhe u ngjitën në Mbretërinë e Perëndisë.

“Dhe armiqtë e tyre i panë ata”,⁶² që do të thotë se shumë prej armiqve të tyre, pasi panë martirizimin e tyre, e kuptuan karakterin sublim të pozitës së tyre dhe virtytin e tyre të lartë, dhe dëshmuan për madhështinë e përsosurinë e tyre.

“Dhe në atë çast ra një tërmet i madh dhe një e dhjeta e qytetit u rrafshua përtokë, dhe shtatë mijë veta u vranë në atë tërmet”.⁶³

Ky tërmet ndodhi në Shiraz pas martirizimit të Báb-it. Qyteti u bë rrëmujë dhe shumë njerëz humbën jetën. Një tronditje e madhe u shkaktua gjithashtu nga sëmundje, kolera, vdekje, skamja, uria dhe vuajtje të tilla që nuk ishin parë kurrë më parë.

“Ata që shpëtuan i pushtoi tmerri dhe i ngritën lavde Perëndisë së qiellit”.⁶⁴

Kur tërmeti ra në Fars, të gjithë ata që mbetën qanin e vajtonin ditë e natë, duke i thurur lavde e duke iu lutur Perëndisë. Ata ishin kaq të shqetësuar e të tmerruar sa nuk i zinte gjumi e nuk gjenin prehje natën.

“Fatkeqësia e dytë ka kaluar; dhe ja, shpejt vjen e treta”.⁶⁵ Fatkeqësia e parë është shfaqja e Profetit, Muhametit, të birit të Abdulláhut [‘Abdu’lláh]—paqja qoftë mbi Të! Fatkeqësia e dytë është ajo e Báb-it—lavdia e lavdërimi qoftë mbi të! Fatkeqësia e tretë është dita e madhe e Manifestimit të Zotit të Ushtive dhe shkëlqimi i bukurisë së të Premtuarit. Shpjegimi i fjalës “fatkeqësi” përmendet në kreun e tridhjetë të Ezekielit, ku thuhet: “Fjala e Zotit më erdhi përsëri, duke thënë: Bir i njeriut, profetizo dhe thuaj: kështu tha Zoti Perëndia;

⁶¹ Báb-i dhe Xhinabi Kudus-i.

⁶² Revelacioni 11:12.

⁶³ Shih Revelacioni 11:13.

⁶⁴ Shih Revelacioni 11:13.

⁶⁵ Revelacioni 11:14.

Ulëriini e thoni: Medet ç'ditë! Sepse është afër dita, afër është dita e Zotit”.⁶⁶

Pra, është e sigurt se dita e fatkeqësisë është dita e Zotit; sepse në atë ditë fatkeqësia është për të pavëmendshmit, fatkeqësia është për mëkatarët, fatkeqësia është për injorantët. Ja përse thuhet “fatkeqësia e dytë ka kaluar; dhe ja shpejt vjen e treta!” Kjo fatkeqësi e tretë është dita e manifestimit të Bahá'u'lláh-ut, dita e Perëndisë; dhe ajo është afër ditës së shfaqjes së Báb-it.

“Dhe engjëlli i shtatë i ra borisë e në qiell jehuan zëra të fortë që thonin: “Mbretëritë e kësaj bote janë bërë mbretëri e Zotit tonë dhe e Krishtit të Tij; dhe Ai do të Mbretërojë për jetë të jetëve!”⁶⁷

Engjëlli i shtatë është një njeri i veshur me tipare qiellore, i cili do të dalë me cilësi e karakter qiellor. Do të ngrihen zëra, kështu që shfaqja e Manifestimit Hyjnor do të shpallet e përhapet. Në ditën e manifestimit të Zotit të Ushtrive dhe në epokën e ciklit hyjnor të Fuqiplotit, që është premtuar e përmendur në të gjithë librat e shkrimet e Profetëve—në atë ditë të Perëndisë, Mbretëria Shpirtërore e Hyjnore do të vendoset dhe bota do të ripërtërihet; një shpirt i ri do të futet në trupin e krijimit; stina e pranverës hyjnore do të vijë; retë e mëshirës do të reshin; dielli i realitetit do të shkëlqejë, do të fryjë flladi jetëdhënës; bota e njerëzimit do të vishet me një rrobë të re; sipërfaqja e tokës do të bëhet një parajsë sublime; njerëzimi do të edukohet; luftërat, mosmarrëveshjet, sherret e keqdashja do të zhduken; do të shfaqen sinqeriteti, jeta e virtutshme, paqja dhe adhurimi i Perëndisë; uniteti, dashuria dhe vëllazëria do të rrethojnë botën; dhe Perëndia do të sundojë përgjithmonë—që do të thotë se do të vendoset Mbretëria Shpirtërore dhe e Përjetshme. E tillë është dita e Perëndisë. Sepse të gjitha ditët që kanë ardhur e kanë shkuar ishin ditët e Abrahamit, të Moisiut e të Krishtit, ose të Profetëve të tjerë; por kjo është dita e Perëndisë, sepse Dielli i Realitetit do të ngrihet në këtë ditë me tërë ngrohtësinë e shkëlqimin e tij.

“Dhe të njëzet e katër krerët që rrinin në frone para Perëndisë, ranë përmbys dhe e adhuruan Perëndinë, duke thënë: Të falenderojmë, O

⁶⁶ Ezeieli 30:1-3.

⁶⁷ Revelacioni 11:15.

Zot Perëndi Fuqplotë, që je, që ishe e që do të vish, sepse Ti e more pushtetin tënd të madh dhe fillove të mbretërosh”.⁶⁸

Në çdo cikël ruajtësit dhe shpirtrat e shenjtë kanë qenë dymbëdhjetë. Kështu Jakovi kishte dymbëdhjetë djem; në kohën e Moisiut ishin dymbëdhjetë krerë apo kryetarë fisesh; në kohën e Krishtit ishin dymbëdhjetë Apostuj; në kohën e Muhametit ishin dymbëdhjetë Imamë. Por në këtë manifestim të lavdishëm janë njëzet e katër, dyfishi i nurmit të gjithë të tjerëve, sepse këtë e kërkon madhështia e këtij manifestimi. Këta shpirtra të shenjtë janë në prani të Perëndisë, të ulur në vendet e tyre, që do të thotë se ata mbretërojnë përjetë.

Këta njëzet e katër njerëz të mëdhenj, edhe pse janë ulur në fronet e sundimit të përjetshëm, megjithatë adhurojnë shfaqjen e Manifestimit universal dhe janë të përvuajtur e të nënshtruar, duke thënë “Të falenderojmë, O Zot Perëndi Fuqplotë, që je, që ishe e që do të vish, sepse Ti e more pushtetin tënd të madh dhe fillove të mbretërosh”—që do të thotë: Ti do t’i nxjerrësh të gjitha mësimet e Tua, do t’i mblësh të gjithë njerëzit e tokës nën hijen Tënde dhe do t’i çosh të gjithë njerëzit nën hijen e një tende. Megjithëse kjo është Mbretëria e Përjetshme e Perëndisë, dhe Ai gjithnjë ka pasur e ka një Mbretëri, Mbretëria këtu nënkupton manifestimin e Vetes së Tij;⁶⁹ dhe Ai do të nxjerrë të gjitha ligjet e mësimet që janë shpirti i botës së njerëzimit e i jetës së pasosur. Dhe ky Manifestim universal do ta nënshtrojë botën me anë të fuqisë shpirtërore, jo me anë të luftës e të betejave; Ai do ta bëjë këtë me paqe e qetësi, jo me shpatë e me armë; Ai do ta vendosë këtë Mbretëri Qiellore me anë të dashurisë së vërtetë e jo me forcën e luftës. Ai do t’i përçojë këto mësimet hyjnore me mirësi e drejtësi dhe jo me armë e me dhunë. Ai do t’i edukojë kështu kombet e njerëzit që, me gjithë kushtet e tyre të ndryshme, me gjithë zakonet e karakteristikat e tyre të ndryshme dhe me gjithë fetë e racat e ndryshme, ata, siç thuhet në Bibël, ashtu si ujku dhe qengji, leopardi, keci, fëmija i gjirit e gjarpri, do të bëhen shokë e miq. Konfliktet e racave, dallimet e feve dhe barrierat ndërmjet kombeve do të zhduken krejtësisht dhe të gjithë do të arrijnë unitet e pajtim të përsosur nën hijen e Pemës së Bekuar.

⁶⁸ Revelacioni 11:16-17.

⁶⁹ dmth manifestimin e Tij më të përkryer.

“Dhe kombet u pezmatuan”, sepse mësimet e Tua u kundërviheshin pasioneve të popujve të tjerë; “por arriti zemërimi Yt”⁷⁰—domethënë të gjithë do të pësojnë humbje të rëndë; sepse ata nuk do të ndjekin porosinë, këshillat e mësimet e Tua dhe do të privohen nga bujaria Jote e përjetshme e do të ndahen si me perde nga drita e Diellit të Realitetit.

“Dhe koha që të gjykohen të vdekurit” do të thotë se erdhi koha që të vdekurit⁷¹—domethënë ata që u është mohuar fryma e dashurisë së Perëndisë dhe që nuk kanë pjesë në jetën e pasosur e të shenjtëruar—do të gjykohen me drejtësi, duke nënkuptuar se ata do të ngrihen për të marrë atë që meritojnë. Ai do të nxjerrë në shesh realitetin e sekreteve të tyre, duke treguar se ç’shkallë të ulët zënë ata në botën e ekzistencës dhe se, në të vërtetë, ata ndodhen nën sundimin e vdekjes.

“Dhe që Ti t’u japësh shpërblimin shërbëtorëve të Tu, profetëve, dhe shenjtërorëve, dhe gjithë atyre që i druhen emrit Tënd, të vegjël e të mëdhenj”⁷²—që do të thotë se Ai do të shpërblejë të drejtët me bujari të pafund, duke bërë që ata të ndriçojnë në horizontin e nderimit të përjetshëm, si yjet në qiell. Ai do t’i ndihmojë ata duke i pajisur me sjellje e veprime që janë drita e botës së njerëzimit, shkaku i udhërrëfimit dhe mjeti i jetës së pasosur në Mbretërinë Hyjnore.

“Dhe që të rrënosh ata që rrënojnë tokën”⁷³ do të thotë se Ai do t’i ndëshkojë rreptësisht të pavëmendshmit; sepse verbëria e të verbërve do të dalë në shesh dhe shikimi i atyre që shohin do të bëhet i dukshëm; injoranca e padija e njerëzve që jetojnë në gabim do të njihen dhe dija e urtia e njerëzve që ecin në rrugë të drejtë do të jenë të dukshme; për rrjedhojë, ata që rrënojnë do të rrënohen.

“Dhe u hap tempulli i Perëndisë në qiell”⁷⁴ do të thotë se Jerusalemi hyjnor u gjend dhe se i Shenjti i të Shenjtëve u bë i dukshëm. I Shenjti i të Shenjtëve, sipas terminologjisë së të urtëve, është thelbi i Ligjit Hyjnor, janë mësimet qiellore e të vërteta të Zotit që, siç e thamë, nuk janë ndryshuar në ciklin e asnjë profeti. Altari i Jerusalemit nënkupton

⁷⁰ Revelacioni 11:18.

⁷¹ Revelacioni 11:18.

⁷² Shih Revelacioni 11:18.

⁷³ Revelacioni 11:18.

⁷⁴ Revelacioni 11:19.

realitetin e Ligjit të Perëndisë, që është i Shenjti i të Shenjtëve; dhe të gjitha ligjet, konvencionet, ritet e rregullat materiale janë qyteti i Jerusalemit—për këtë arsye quhet Jerusalemi hyjnor. Me pak fjalë, duke qenë se në këtë cikël Dielli i Realitetit do të bëjë që drita e Perëndisë të ndriçojë me shkëlqimin më të madh, thelbi i mësimëve të Perëndisë do të realizohet në botën e qenies dhe errësira e injorancës e padija do të zhduken. Bota do të bëhet një botë e re dhe ndriçimi do të mbizotërojë. Kështu i Shenjti i të Shenjtëve do të shfaqet.

“Dhe u hap tempulli i Perëndisë në qiell”⁷⁵ do të thotë gjithashtu se nëpërmjet përhapjes së mësimëve hyjnore, shfaqjes së këtyre mistereve qiellore dhe daljes së Diellit të Realitetit, dyert e suksesit e të begatisë do të hapen në të gjitha drejtimet dhe shenjat e mirësisë e të bekimeve qiellore do të bëhen të qarta.

“Dhe brenda tempullit të Tij u duk Arka e Dhiatës së tij”⁷⁶—do të thotë se Libri i Dhiatës së Tij do të duket në Jerusalemin e Tij, Mesazhi i Besëlidhjes⁷⁷ do të hartohet dhe kuptimi i Dhiatës e i Besëlidhjes do të bëhet i qartë. Emri i Perëndisë do të përhapet në Lindje e në Perëndim dhe shpallja e Kauzës së Perëndisë do të pushtojë botën. Dhunuesit e Besëlidhjes do të rrëzohen e do të shpërndahen andej këtej, ndërsa besnikët do të trajtohen me dashuri e do të lavdërohen, sepse ata mbahen pas Librit të Dhiatës dhe janë të vendosur e të patundur në Besëlidhje.

“Dhe pati vetëtima, gjëmime e rrufe, dhe ra tërmet e breshër i madh”.⁷⁸ që do të thotë se pas daljes së Librit të Dhiatës do të ketë një stuhitë të madhe dhe vetëtimat e zemërimit e të pezmatimit të Perëndisë do të shkreprijnë, do të gjëmojë zhurma e bubullimave të shkeljes së Besëlidhjes, do të bien tërmetet e dyshimeve, breshëri i mundimeve do të bjerë mbi shkelësit e Besëlidhjes, madje edhe ata që e ushtrojnë besimin do të ndeshen me sprova e tundime.

⁷⁵ Revelacioni 11:19.

⁷⁶ Revelacioni 11:19.

⁷⁷ Një prej veprave të Bahá'u'lláh-ut, në të cilën Ai shprehimisht përcakton se ‘Abdu'l-Bahá-i është Ai, tek i Cili të gjithë duhet të drejtohen pas vdekjes së Bahá'u'lláh-ut.

⁷⁸ Revelacioni 11:19.

12

KOMENT PËR KREUN XI TË ISAISË

Tek Isaia, kreu XI, vargjet 1 deri në 10, thuhet: “Dhe do të dalë një filiz nga trungu i Jeseut dhe një Degë do të rritet prej rrënjëve të tij. Dhe fryma e Zotit do të qëndrojë mbi të, fryma e urtisë dhe e të kuptuarit, fryma e këshillës dhe e fuqisë, fryma e dijes dhe e druajtjes së Zotit. Dhe ai do të ketë kënaqësi në frikë të Zotit. Dhe nuk do të gjykojë sipas asaj që shohin sytë e tij, as nga ajo që dëgjojnë veshët e tij; por do të gjykojë me drejtësi të varfërit dhe do të tregojë mirëkuptim për të përvuajturit e tokës. Dhe do ta godasë tokën me shkopin e gojës së tij dhe me frymën e buzëve të tij do të vrasë të paudhët. Dhe drejtësia do të jetë brezi i kryqeve të tij e vërtetësia brezi i ijeve të tij. Ujku do të banojë me qengjin, dhe leopardi do të shtrihet me kecin; dhe viçi dhe luani i ri dhe kafsha e majmur bashkë do të rrinë; dhe një fëmijë i vogël do t’i ruajë. Dhe lopa e arusha do të kullotin së bashku, dhe të vegjëlit e tyre do të shtrihen me njëri-tjetrin; dhe luani do të hajë kashtë si kau. Dhe foshnja e gjirit do të luajë pranë vrimës së gjarprit helmues, dhe fëmija i vogël do të futë dorën në folenë e nepërkës. Ata nuk do të dëmtojnë e as do të shkatërrojnë asgjë në gjithë malin Tim të shenjtë; sepse toka do të jetë e mbushur plot me dijen e Zotit, ashtu si ujërat mbushin detet”.

Kjo degë e dalë nga trungu i Jeseut mund të përshtatej me të drejtë për Krishtin, sepse Josifi ishte pasardhës i Jeseut, i të atit të Davidit; por duke qenë se Krishti fitoi ekzistencë përmes Shpirtit të Perëndisë, Ai e quajti Vetën Biri i Perëndisë. Po të mos kishte bërë këtë, ky përskrim do t’i referohej Atij. Veç kësaj, ngjarjet që ai (Isaia) tregoi se do të ndodhnin në ditët e asaj dege, po të interpretohen në mënyrë simbolike, u përmbushën pjesërisht në kohën e Krishtit, por jo të gjitha; dhe po të mos interpretohen kështu, atëhere pa fjalë asnjëra prej këtyre shenjave nuk ndodhi. Për shembull, leopardi dhe qengji, luani dhe viçi, fëmija dhe gjarpëri janë metafora e simbole që nënkuptojnë kombe e popuj të ndryshëm, sekte kundërshtarë e raca armike, që janë po aq të kundërta e

në armiqësi sa dhe ujku e qengji. Ne themi se me frymën e shpirtit të Krishtit, ata gjetën mirëkuptim e harmoni, u gjallëruan dhe jetuan së bashku.

Por “Ata nuk do të dëmtojnë e as do të shkatërrojnë asgjë në gjithë malin Tim të shenjtë; sepse toka do të jetë e mbushur plot me dijen e Zotit, ashtu si ujërat mbushin detet”. Këto kushte nuk mbizotëruan në kohën e manifestimit të Krishtit; sepse deri më sot në botë ekzistojnë kombe të ndryshme e kundërshtare: shumë pak prej tyre e njohin Perëndinë e Izraelit dhe shumica nuk e dinë Perëndinë. Po kështu, paqja universale nuk u vu në jetë në kohën e Krishtit—me fjalë të tjera, midis kombeve kundërshtare e armike nuk kishte as paqe as mirëkuptim, grindjet e mosmarrëveshjet nuk pushuan dhe pajtimi e sinqeriteti nuk u shfaqën. Kështu, edhe sot e kësaj dite, midis sekteve kristiane dhe vetë kombeve vërehen armiqësi, urrejtje dhe kundërvënia më e egër.

Por këto vargje përshtaten fjalë për fjalë për Bahá'u'lláh-un. Po kështu, në këtë cikël të mahnitshëm toka do të transformohet dhe bota e njerëzimit do të stoliset me qetësi e bukuri. E vërteta, paqja e pajtimi do të zëvendësojnë armiqësinë, grindjet e vrasjet; midis kombeve, popujve, racave e vendeve do të shfaqen dashuria e miqësia. Do të vendosen kooperimi e bashkimi dhe, më në fund, lufta do të eliminohet krejtësisht. Kur ligjet e Librit Më të Shenjtë të vendosen, grindjet e mosmarrëveshjet do të gjejnë gjykimin përfundimtar me drejtësi absolute para një gjykate të përgjithshme të kombeve e të mbretërive dhe vështirësitë që mund të lindin do të zgjidhen. Të pesë kontinentet e botës do të formojnë një të vetëm, kombet e shumta do të bëhen një i vetëm, sipërfaqja e tokës do të bëhet një vend dhe njerëzimi do të jetë një bashkësi e vetme. Marrëdhëniet midis vendeve—përzjerja, bashkimi e miqësia e popujve dhe e komuniteteve—do të arrijnë një shkallë të tillë saqë raca njerëzore të jetë si një familje e një fis i vetëm. Drita e dashurisë qiellore do të shkëlqejë dhe errësira e armiqësisë dhe e urrejtjes do të dëbohet nga bota. Paqja e përgjithshme do ta ngrejë tendën e saj në qendër të tokës dhe Pema e bekuar e Jetës do të rritet e do të shtrihet aq gjerë sa do të mbulojë Lindjen e Perëndimin. Të fortët e të dobët, të pasurit e të varfërit, sektet kundërshtare e kombet armike,—që janë si ujku dhe qengji, leopardi dhe keci, luani dhe viçi,—do të sillen ndaj njëri-tjetrit me dashurinë, miqësinë e drejtësinë më të

madhe. Bota do të mbushet me shkencë, me njohuri për realitetin e mistereve të qenieve dhe me dije të Perëndisë.

Tani shihni sa ka përparuar shkenca dhe dija në këtë shekull të madh, që është cikli i Bahá'u'lláh-ut, sa sekrete të ekzistencës janë zbuluar, sa shpikje të mëdha kanë dalë në dritë e po rriten në numër nga dita në ditë. Së shpejti shkenca materiale e dituria, si dhe dija për Perëndinë, do të bëjnë aq përparime dhe do të tregojnë mrekulli të tilla saqë njerëzit do të habiten. Atëhere misteri i këtij vargu të Isaisë “Sepse toka do të jetë e mbushur plot me dijen e Zotit” do të bëhet krejt e qartë.

Pa mendoni gjithashtu se gjatë kohës së shkurtër që kur u shfaq Bahá'u'lláh-u, njerëz nga të gjitha vendet, kombet e racat janë futur nën hijen e kësaj Kauze. Të krishterë, hebrenj, zoroastrianë, budistë, hindu e persë, të gjithë shoqërohen së bashku me miqësinë e dashurinë më të madhe, sikur me të vërtetë këta njerëz të ishin lidhur ndërmjet tyre, ata dhe njerëzit e tyre, prej një mijë vjetësh; sepse ata janë si at e fëmijë, nënë e vajzë, motër e vëlla. Ky është njëri nga kuptimet e shoqërimit të ujkut me qengjin, të leopardit me kecin dhe të luanit me viçin.

Një nga ngjarjet e mëdha që do të ndodhë në Ditën e manifestimit të asaj Dege të Pakrahasueshme (të Bahá'u'lláhu-t) është ngritja e Flamurit të Perëndisë midis të gjitha kombeve. Kjo do të thotë se të gjitha kombet e fiset do të mblidhen së bashku nën hijen e këtij Flamuri Hyjnor, që s'është veçse Dega e vetë Zotit, dhe do të bëhen një komb i vetëm. Antagonizmi fetar e sektar, armiqësia e racave dhe popujve, si dhe kontrastet midis kombeve, do të eliminohen. Të gjithë njerëzit do të aderojnë në një fe, do të kenë një besim të përbashkët, do të shkrihen në një racë të vetme dhe do të bëhen një popull i vetëm. Të gjithë do të jetojnë në një atdhe të përbashkët, që është vetë planeti. Paqja e mirëkuptimi universal do të realizohen midis të gjitha kombeve dhe ajo Degë e Pakrahasueshme do të grumbullojë bashkë gjithë Izraelin, që do të thotë se në këtë cikël Izraeli do të mblidhet në Tokën e Shenjtë dhe se populli hebraik, që është shpërndarë në Lindje e Perëndim, në Jug e Veri, do të mblidhet së bashku.

Shihni tani: këto ngjarje nuk ndodhën në ciklin kristian, sepse kombet nuk u mblodhën nën Një Flamur të Vetëm, që është Dega Hyjnore. Por në këtë cikël të Zotit të Ushtrive, të gjithë kombet e popujt do të futen nën hijen e këtij Flamuri. Po kështu, Izraeli, i shpërndarë në

të gjithë botën, nuk u mbledh në Tokën e Shenjtë në ciklin kristian; por në fillim të ciklit të Bahá'u'lláh-ut ky premtim hyjnor, i shpallur qartë në të gjithë Librat e Profetëve, ka filluar të realizohet. Ju mund të shihni se nga të gjitha anët e botës fise hebrejsh po vijnë në Tokën e Shenjtë; ata jetojnë në fshatra e toka që i bëjnë të tyret dhe nga dita në ditë po shtohen në një shkallë të tillë saqë gjithë Palestina do të bëhet shtëpia e tyre.

13

KOMENT PËR KREUN XII TË REVELACIONIT TË SHËN GJONIT

Kemi shpjeguar më parë se ç'kuptohej zakonisht me Qytetin e Shenjtë, Jerusalemin e Perëndisë, që përmendet në Librin e Shenjtë dhe që është Ligji i Perëndisë. Nganjëherë ai krahasohet me një nuse, nganjëherë me Izraelin dhe ndonjëherë me qiellin e ri e me tokën e re. Kështu në kreun 21 të Revelacionit të Shën Gjonit (vargjet 1, 2 e 3) thuhet: “Dhe pashë një qiell të ri e një tokë të re, sepse qielli i parë dhe toka e parë ishin zhdukur, dhe deti nuk ishte më. Dhe unë Gjoni pashë qytetin e shenjtë, Jerusalemin e ri, që zbriste nga qielli, prej Perëndisë, i përgatitur si një nuse e stolisur për burrin e saj. Dhe dëgjova një zë të fortë nga froni, që thoshte: “Ja, tenda e Perëndisë është me njerëz, dhe Ai do të banojë midis tyre dhe ata do të jenë populli i Tij, dhe Vetë Perëndia do të jetë me ta, do të jetë Perëndia i tyre”.

Vëreni sa e qartë dhe e dukshme është që qielli dhe toka e parë nënkuptojnë Ligjin e mëparshëm. Sepse thuhet që qielli dhe toka e parë janë zhdukur dhe nuk ka më det—që do të thotë se toka është vendi i gjykimit, dhe mbi këtë tokë të gjykimit nuk ka det, domethënë se mësimet dhe Ligji i Perëndisë do të përhapen në gjithë tokën dhe të gjithë njerëzit do të hyjnë në Kauzën e Perëndisë, dhe toka do të bahohet tërësisht nga besimtarë; pra nuk do të ketë më det, sepse vendi i banimit e i jetesës së njeriut është toka e thatë. Me fjalë të tjera, në atë epokë, fusha e atij Ligji do të bëhet kopshti i njeriut. Një tokë e tillë është e fortë; këmbët nuk shkasin mbi të.

Ligji i Perëndisë quhet gjithashtu Qyteti i Shenjtë, Jerusalemi i Ri. Është e qartë se Jerusalemi i Ri që zbret nga qielli nuk është një qytet guri, llaçi, tullash, dheu e druri. Ai është Ligji i Perëndisë që zbret nga qielli dhe quhet i ri, sepse është e qartë që Jerusalemi prej guri e dheu nuk zbret nga qielli dhe se ai nuk përtërihet; kurse ajo që përtërihet është Ligji i Perëndisë.

Ligji i Perëndisë krahasohet gjithashtu me një nuse të stolisur që del me zbukurimet më tërheqëse, siç thuhet në kreun 21 të Revelacionit të Shën Gjoni: “Dhe në Gjoni pashë qytetin e shenjtë, Jerusalemin e ri, që zbriste nga qielli, prej Perëndisë, i përgatitur si një nuse e stolisur për burrin e saj”.⁷⁹ Dhe në kreun 12, vargu 1, thuhet: “Dhe në qiell u duk një shenjë e madhërueshme: një grua e veshur me diellin, me hënën nën këmbë dhe me një kurorë me dymbëdhjetë yje në kokë”. Kjo grua është ajo nusja, Ligji i Perëndisë që zbriti mbi Muhametin. Dielli me të cilin ajo ishte veshur dhe hëna që ishte nën këmbët e saj, janë dy kombet që qëndrojnë nën hijen e atij Ligji, mbretëritë Persiane e Otomane, sepse emblema e Persisë është dielli dhe ajo e Perandorisë Otomane është gjysmehëna. Kështu dielli dhe hëna janë emblemat e dy mbretërive që ndodhen nën pushtetin e Ligjit të Perëndisë. Më tej thuhet: “me një kurorë me dymbëdhjetë yje në kokë”. Këta dymbëdhjetë yje janë dymbëdhjetë imamët, që ishin përkrahësit e Ligjit të Muhametit dhe edukatorët e popullit, të cilët shkëlqejnë si yje në qiellin e udhërrëfimit.

Pastaj në vargun e dytë thuhet: “Dhe duke qenë shtatzënë, ajo thërriste”, që do të thotë se ky Ligj ra në vështirësitë më të mëdha dhe kaloi shqetësime e vuajtje të mëdha, derisa u krijua një filiz i përsosur—domethënë Manifestimi i ardhshëm, i Premtuari, i Cili është filizi i përsosur Që u rrit në gjirin e këtij Ligji, që është si nëna e tij. Fëmija për të Cilin bëhet fjalë është Báb-i, Pika Parësore, Që në të vërtetë lindi nga Ligji i Muhametit—domethënë, Realiteti i Shenjtë, Që është fëmija dhe produkti i Ligjit të Perëndisë, nënës së Tij, dhe Që është premtuar nga ajo fe, gjen një realitet në mbretërinë e atij Ligji; por, për shkak të despotizmit të dragoit, fëmija u çua te Perëndia. Pas njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditësh dragoi u asgjësua dhe fëmija i Ligjit të Perëndisë, i Premtuari, u manifestua.

⁷⁹ Revelacioni 21:2.

Vargjet 3 dhe 4. “Dhe në qiell u duk një shenjë tjetër: një dragua i madh flakë i kuq, me shtatë krerë e dhjetë brirë, e në çdo kokë kishte një kurorë. Bishti i tij tërhiqte pas vetes një të tretën e yjeve të qiellit, dhe i hodhi mbi tokë”.⁸⁰ Këto shenja janë një aluzion për dinastinë e Umajadëve që dominoi fenë muhamedane. Shtatë krerë dhe shtatë kurora nënkuptojnë shtatë kombe e dominione mbi të cilat kishin pushtet Umajadët: ato ishin dominioni romak rreth Damaskut; dhe dominionet persiane, arabe e egjiptiane, bashkë me dominionet e Afrikës (dmth. Tunizinë, Marokun e Algjerinë); dominioni i Andaluzisë, që tani është Spanja; dhe dominioni i Turqve të Transoksanisë.⁸¹ Umajadët kishin pushtet mbi këto vende. Dhjetë brirët nënkuptojnë emrat e sunduesve Umajadë—domethënë, pa përsëritur, ishin dhjetë emra sundimtarësh, pra dhjetë emra të komandantëve e shefave—i pari është Abu Sufjan-i [Abú Sufyán] dhe i fundit Marván-i, por disa prej tyre kanë të njëjtin emër. Kështu ka dy Muavi [Mu’ávíya], tre Jezidë [Yazíd], dy Valí dhe dy Marvánë; por po të numërohen emrat pa përsëritje, ishin dhjetë. Umajadët, prej të cilëve i pari ishte Abu Sufjan-i, Emir i Mekës dhe kryetar i dinastisë së Umajadëve, dhe i fundit Marván-i, shkatërruan një të tretën e njerëzve të shenjtë e të bekuar që ridhnin nga Muhameti e që ishin si yjet e qiellit.

Vargu 4. “Dhe dragoi qëndroi para gruas që po lindte fëmijën, në mënyrë që sapo ta lindte atë t’ia hante”.⁸² Siç e kemi shpjeguar më parë, kjo grua është Ligji i Perëndisë. Dragoi qëndronte pranë gruas për të gllabëruar fëmijën e saj, dhe ky fëmijë ishte Manifestimi i premtuar, filizi i Ligjit të Muhametit. Umajadët ishin gjithnjë në pritje për të shtënë në dorë të Premtuarin, i Cili do të vinte nga linja e Muhametit, për ta asgjësuar e zhdukur Atë; sepse ata i trembeshin shumë shfaqjes së Manifestimit të premtuar dhe kërkonin të vrisnin çdo pasardhës të Muhametit që mund të çmohej shumë.

Vargu 5. “Dhe gruaja lindi një djalë, i Cili do të sundonte të gjitha kombet me një shkop të hekurt”. Ky bir i madh është Manifestimi i

⁸⁰ Shih Revelacioni 12:3-4.

⁸¹ Territori përtej lumit Oksus (emri i vjetër i lumit Amu-Darjá), që rrjedh nga rrafshnalta e Pamirit dhe derdhet në liqenin e Aralit.

⁸² Shih Revelacioni 12:4.

premtuar, i Cili lindi prej Ligjit të Perëndisë dhe u rrit në gjirin e mësimeve hyjnore. Shkopi i hekurt është simbol i pushtetit e i fuqisë— nuk është shtatë—dhe do të thotë se me fuqi e pushtet hyjnor Ai do të jetë bariu i të gjitha kombeve të tokës. Ky bir është Báb-i.

Vargu 5. “Dhe djali i saj u rrëmbye e u çua pranë Perëndisë, pranë fronit të Tij”. Kjo profeci ka të bëjë me Báb-in, i Cili u ngjit në mbretërinë qiellore, në Fronin e Perëndisë e në qendrën e Mbretërisë së Tij. Shih sesi e gjithë kjo përputhet me atë që ndodhi.

Vargu 6. “Dhe gruaja iku në një vend të shkretë”—që do të thotë se Ligji i Perëndisë iku në një vend të shkretë, duke nënkuptuar shkretëtirën e gjerë të Hixhazit dhe gadishullin Arabik.

Vargu 6. “Ku Perëndia i kishte përgatitur një vend”.⁸³ Gadishulli Arabik u bë shtëpia e vendbanimi dhe qendra e Ligjit të Perëndisë.

Vargu 6. “Ku të ushqejej për një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë”. Në terminologjinë e Librit të Shenjtë këto një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë nënkuptojnë një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë vitet që Ligji i Perëndisë u vendos në shkretëtirën e Arabisë, shkretëtirën e madhe: prej saj erdhi i Premtuari. Pas një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë vjetëve ai Ligj nuk do ketë më ndikim, sepse fryti i asaj peme do të jetë shfaqur dhe rezultati do të jetë arritur.

Shihni sesi profecitë përkojnë me njëra-tjetrën. Në Apokalipsin dalja e të Premtuarit është caktuar pas dyzet e dy muajsh dhe Danieli e shpreh si tre herë e gjysmë, që gjithashtu është dyzet e dy muaj, që janë një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë. Në një pasazh tjetër të Revelacionit të Gjonit flitet qartë për një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë dhe në Librin e Shenjtë thuhet se çdo ditë shënon një vit. Nuk ka gjë më të qartë sesa kjo përputhje e profecive me njëra-tjetrën. Báb-i u shfaq në vitin 1260 të Hexhirës së Muhametit, që është fillimi i llogaritjes kohore për gjithë Islamin. Nuk ka prova më të qarta sesa kjo në Librat e Shenjtë për çdo Manifestim. Për atë që është i drejtë, përputhja e kohëve të treguara nga gjuhët e të Mëdhenjve është prova më vendimtare. Nuk ka shpjegim tjetër të mundshëm për këto profeci. Bekuar qofshin shpirtrat e drejtë që kërkojnë të vërtetën. Por atje ku

⁸³ Shih Revelacioni 12:6.

mungon drejtësia njerëzit e sulmojnë, e kundërshtojnë dhe e mohojnë hapur atë që duket vetiu, si Farisenjtë, të cilët në Manifestimin e Krishtit mohuan me kokëfortësi të madhe shpjegimet e Krishtit e të dishepujve të Tij. Ata errësuan Kauzën e Krishtit para njerëzve injorantë, duke thënë: “Këto profeci nuk janë për Jesuin, por për të Premtuarin Që do të vijë më vonë, sipas kushteve që përmenden në Bibël”. Disa nga këto kushte ishin se Ai duhej të kishte një mbretëri, të rrinte në fronin e Davidit, të bënte të detyrueshëm Ligjin e Biblës dhe të shfaqte një drejtësi të tillë sa që ujku dhe qengji të vinin bashkë në të njëjtin burim.

Dhe kështu ata i pengun njerëzit që ta njihnin Krishtin.

Shënim.—Në këto biseda të fundit, ‘Abdu’l-Bahá-i dëshiron të pajtojë në një interpretim të ri profecitë apokaliptike të hebrenjve, të të krishterëve e të myslimanëve, sesa të tregojë karakterin e tyre të mbinatyrshëm. Për fuqitë e Profetëve shih “Dija e Manifestimeve Hyjnore”, f. 157; dhe “Vizionet dhe komunikimi me Shpirtrat”, f. 251.

14

PROVA SHPIRTËRORE

Në këtë botë materiale koha ka cikle; vendet ndryshojnë me ndryshimin e stinëve, dhe për shpirtrat ka përparim, kthim prapa dhe edukim.

Një herë është stina e pranverës; një herë tjetër stina e vjeshtës; dhe pastaj stina e verës ose stina e dimrit.

Në pranverë ka re që lëshojnë shiun e çmuar; fllade erëndshme e zefire jetëdhënës; ajri është fare i butë, bie shi, ndriçon dielli, era pllenuese shtyn retë, bota përtërihet dhe fryma e jetës shfaqet te bimët, te kafshët e te njerëzit. Gjërat tokësore kalojnë nga një gjendje në një tjetër. Të gjitha gjërat vishen me një rrobë të re dhe toka e zezë mbulohet me barëra; male e pllaja stolisen me gjelbërim; drurët nxjerrin gjethe e sythe; kopshtet rritin lule e bimësi erëmirë. Bota bëhet botë

tjetër dhe fiton përsëri një shpirt jetëdhënës. Toka, që ishte si një trup i pajetë, gjen një shpirt të ri dhe prodhon bukuri të pafund, hijeshi e freski. Kështu, pranvera sjell një jetë të re dhe ngjall një shpirt të ri.

Pastaj vjen vera, kur nxehtësia shtohet dhe rritja e zhvillimi arrijnë shkallën më të lartë. Energjia e jetës në mbretërinë bimore arrin shkallën e përsosurisë, dalin frytet dhe vjen koha e vjeljes së prodhimit; një farë është bërë një kalli dhe ushqimet mblidhen e ruhen për dimër. Pastaj vjen vjeshta e trazuar, kur fryjnë erëra të pashëndetshme e shterpe; është stina e lëngatës, kur të gjitha gjërat vyshken dhe ajri i butë prishet. Flladet e pranverës kthehen në erëra vjeshte; drurët e gjelbër pjellorë zverdhën e zhvishen; lulet dhe bari erëmirë humbasin; oborri i mrekullueshëm bëhet një grumbull pluhuri. Pas kësaj vjen stina e dimrit, me të ftohtë e stuhi. Bie borë, shi, breshër, shpërthejnë furtuna, bubullin e vetëtin, vijnë të ftohtët e ngricat; të gjitha bimët vdesin dhe kafshët lëngojnë e janë të drobitura.

Pasi arrihet kjo gjendje, kthehet përsëri pranvera jetëdhënëse dhe cikli ripërtërihet. Stina e pranverës, plot gjelbërim e bukuri, hap tendën e vet mbi fusha e male gjithë salltanet e madhështi. Për herë të dytë forma e krijesave përtërihet dhe krijimi i qenieve fillon sërish; trupat rriten e zhvillohen; fushat dhe shkretëtirat bëhen të blerta e pjellore, drurët lulëzojnë dhe pranvera e vitit të shkuar rikthehet me gjithë tërësinë e lavdinë e saj. I tillë është dhe i tillë duhet të jetë cikli dhe vazhdimësia e ekzistencës. I tillë është cikli dhe rrokullisja e botës materiale.

E njëjta gjë ndodh edhe me ciklet shpirtërore të Profetëve—pra dita e daljes së Manifestimeve të Shenjta është pranvera shpirtërore; është shkëlqimi hyjnor; është dhuntia qiellore, flladi i jetës, dalja e Diellit të Realitetit. Mendjet e njerëzve gjallërohen; zemrat rir freskohen e fuqizohen; shpirtat bëhen të mirë, ekzistenca vihet në lëvizje; realitetet njerëzore gëzohen dhe rriten e zhvillohen me cilësi e përsosuri të bukura. Arrihet përparimi i përgjithshëm dhe kryhet ringjallja, sepse ajo është dita e ringjalljes, koha e gjallërimit dhe e tharmëtimit, dhe stina e lumturisë, e gëzimit dhe e një ekstaze të thellë.

Pastaj pranvera jetëdhënëse përfundon me një verë frytdhënëse. Fjala e Perëndisë lartësohet, Ligji i Perëndisë përhapet; të gjitha gjërat arrijnë përsosuri. Tryeza qiellore shtrohet, flladet e shenjta erëmojnë

Lindjen e Perëndimin, mësimet e Perëndisë pushtojnë botën, njerëzit fitojnë dituri, arrihen rezultate të lavdërueshme, në botën e njerëzimit duket një përparim i përgjithshëm dhe dhuntitë hyjnore rrethojnë të gjitha gjërat. Dielli i Realitetit ngrihet nga horizonti i Mbretërisë me fuqinë e nxehtësinë më të madhe. Kur ai arrin zenitin, do të fillojë të zbresë e të ulet dhe vera shpirtërore do të pasohet nga vjeshta, kur rritja e zhvillimi ndalen. Flladet shndërrohen në erëra shkatërruese dhe stina e pashëndetshme fshin bukurinë e freskinë e oborreve, të luadheve e të pjergullave—domethënë nuk mbeten më tërheqja e dashamirësia, tiparet hyjnore ndërrohen, ndriçimi i zemrave errësohet, bota shpirtërore e njerëzve ndryshon, virtytet zëvendësohen nga veset dhe shenjtëria e dëlirësia zhduken. Mbeten vetëm emri i Fesë së Perëndisë dhe format e errëta të mësimave hyjnore. Themelet e Fesë së Perëndisë shkatërrohen e zhduken dhe nuk mbetet tjetër veç formës e zakoneve. Shfaqen përçarje, qëndrueshmëria kthehet në paqëndrueshmëri dhe shpirtrat vdesin; zemrat lëngojnë, shpirtrat humbasin gjallërinë dhe vjen dimri—domethënë ftohtësia e injorancës përfshin botën dhe mbizotëron errësira e gabimit njerëzor. Pas kësaj vjen indiferenca, mosbindja, moskokëçarja, plogështia, poshtërsia, instiktet shtazore dhe ftohtësia e pandjeshmëria prej guri. Është si stina e dimrit, kur rruzulli tokësor, i zhveshur nga efekti i ngrohtësisë së diellit, bëhet i shkretë e i zymtë. Kur bota e inteligjencës dhe e mendimit arrin këtë gjendje, s'mbetet veçse një vdekje e vazhdueshme e një mosekzistencë e përhershme.

Kur stina e dimrit e ka bërë efektin, kthehet përsëri pranvera shpirtërore dhe shfaqet një cikël i ri. Fryjnë fllade shpirtërore, shkëlqen agimi i ndritshëm, retë hyjnore japin shi, rrezet e Diellit të Realitetit ndriçojnë, bota e rastësishme fiton një jetë të re dhe vishet me një rrobë të mahnitshme. Të gjitha shenjat e dhuntitë e pranverës së shkuar rishfaqen, ndoshta me shkëlqim edhe më të madh, në këtë stinë të re.

Ciklet shpirtërore të Diellit të Realitetit janë si ciklet e diellit material: ato janë gjithnjë në qarkullim dhe ripërtërihen. Dielli i Realitetit, ashtu si dielli material, ka shumë vende të ngritjes e të agimit: një ditë ngrihet nën shenjën zodiake të Gaforres, një ditë tjetër nën shenjën e Peshores ose të Akuariumit; një herë tjetër i përhap rrezet e veta nën shenjën e Dashit. Por Dielli është një diell i vetëm e një realitet i vetëm; njerëzit e dijesh e duan diellin dhe nuk mahniten nga

vendet nga ngrihet e agon ai. Njerëzit që kanë intuitë janë kërkues të së vërtetës e jo të vendeve ku ajo shfaqet, as të pikave të agimit të saj; prandaj, ata do ta adhurojnë Diellin në çdo pikë të zodiakut që të shfaqet dhe do ta kërkojnë Realitetin te çdo Shpirt i Shenjtëruar Që e manifeston atë. Njerëz të tillë e gjejnë gjithnjë të vërtetën dhe nuk janë të ndarë me perde nga Dielli i Botës Hyjnore. Kështu, ai që e do diellin dhe kërkuesi i dritës do të kthehet gjithnjë drejt diellit, qoftë kur ky shkëlqen nën shenjën e Dashit ose kur e përhap dhuntinë e Vet nën shenjën e Gaforres, ose kur shkëlqen nga Binjakët; por injorantët e të paditurit i duan shenjat e zodiakut dhe janë dashuruar e magjepsur pas vendeve të daljes së diellit dhe jo pas vetë diellit. Kur ishte shenja e Gaforres, ata ktheheshin drejt saj, megjithëse më pas dielli kalonte nën shenjën e Peshores; meqë ishin dashuruar pas shenjës, ata ktheheshin drejt saj dhe i përkushtoheshin asaj, duke i mohuar vetes ndikimet e diellit thjesht sepse ai kishte ndërruar vend. Për shembull, dikur Dielli i Realitetit i lëshonte rrezet e veta nën shenjat e Abrahamit, ndërsa më pas agoi nën shenjën e Moisiut dhe ndriçoi horizontin. Pas kësaj, ai u ngrit me fuqinë e shkëlqimit më të madh nën shenjën e Krishtit. Ata që ishin kërkues të Realitetit e adhuronin këtë Realitet kudo që e shihnin, por ata që i ishin përkushtuar Abrahamit u privuan nga ndikimet e tij kur ai shkëlqeu mbi Sinain dhe ndriçoi Realitetin e Moisiut. Ata që mbaheshin fort pas Moisiut, kur Dielli i Realitetit shkëlqeu nga Krishti me ndriçimin e lavdinë më të madhe, gjithashtu ishin të ndarë me perde; e kështu me radhë.

Pra, njeriu duhet të jetë kërkues i Realitetit, dhe ai do ta gjejë këtë Realitet në secilin prej Shpirtëve të Shenjtëruar. Ai duhet të magjepsset, rrëmbehet e tërhiqet nga dhuntia hyjnore; ai duhet të jetë si flutura që dashuron dritën nga cilado llampë që të ndriçojë dhe si bilbili që dashuron trëndafilin në çfarëdo kopshti që të rritet.

Sikur dielli të ngrihej në Perëndim, ai përsëri do të ishte dielli; askush nuk duhet të heqë dorë prej tij për shkak të vendit ku ngrihet, dhe as të mos e konsiderojë Perëndimin si vendin ku gjithmonë dielli ulet. Po kështu, njeriu duhet të kërkojë dhuntitë qiellore dhe Agimin Hyjnor. Në çdo vend që ai shfaqet, duhet dashuruar marrëzisht pas tij. Mendoni që, sikur hebrenjtë të mos vazhdonin t'i mbanin sytë nga horizonti i Moisiut dhe sikur vetëm të shikonin Diellin e Realitetit, ata

padyshim do ta kishin njohur Diellin në vendagimin e realitetit të Krishtit, në shkëlqimin më të madh hyjnor. Por medet! një mijë herë medet! Duke e lidhur veten pas fjalëve të jashtme të Moisiut, ata u privuan nga dhuntitë hyjnore e nga shkëlqimet e madhërishme!

15

PASURIA E VËRTETË

Nderimi dhe lartësimi i çdo qenieje që ekziston varet nga shkaqet e rrethanat.

Bukuria, stolisja dhe përsosuria e tokës së gjelbëruar e pjellore i detyrohen bujarisë së reve pranverore. Bimët rriten; lulet e barërat erëmirë zhvillohen; pemët frytdhënëse mbushen plot sythe dhe nxjerrin fryte të reja e të freskëta. Kopshtet zbukurohen dhe livadhet stolisen; malet e fushat veshin një rrobë të gjelbër dhe kopshtet, arat, fshatrat e qytetet hijeshohen. Kjo është begatia e botës minerale.

Arritja e kulmit të lartësimit e të përsosurisë së botës bimore kërkon që një pemë të rritet anës një rryme me ujë të freskët, që një flad i butë të fryjë mbi të, që ngrohtësia e diellit të derdhet mbi të, që një kopshtar të kujdeset për kultivimin e saj dhe që nga dita në ditë pema të zhvillohet e të japë fryte. Por begatia e saj e vërtetë është që të përparojë në botën shtazore e atë njerëzore dhe të zëvendësojë atë që ka shteruar në trupat e kafshëve e të njerëzve.

Lartësimi i botës shtazore është të zotërojë gjymtyrë, organe e aftësi të përkryera dhe t'i plotësohen të gjitha kërkesat e saj. Kjo është lavdia e saj kryesore, nderi e lartësimi i saj. Pra, lumturia më e madhe e një kafshe është të ketë një livadh të blertë e pjellor, ujë të rrjedhshëm krejt të kulluar dhe një pyll të bukur e të gjelbër. Po qe se atyre u sigurohen këto gjëra, begati më e madhe as që mund të përfytyrohet. Për shembull, në qoftë se një zog e ndërton follenë në një pyll të gjelbër e plot fryte, në një vend të lartë e të bukur, mbi një pemë të fortë e në majë të një dege të lartë, dhe ai i gjen të gjitha farat e ujin që i nevojiten, kjo është për të një begati e përsosur.

Por begatia e vërtetë për kafshën është kalimi nga bota shtazore në botën njerëzore, ashtu si qeniet mikroskopike që, përmes ujit e ajrit, futen brenda njeriut e asimilohen, dhe zëvendësojnë atë që është konsumuar në trupin e tij. Ky është nderi e begatia më e madhe për botën shtazore; nuk mund të mendohet nder më i madh për të.

Prandaj është e qartë e duket vetiu se kjo pasuri, ky komoditet e ky bollëk material formojnë begatinë e plotë të botës minerale, bimore e të asaj shtazore. Asnjë pasuri, bollëk, komoditet ose rehati e botës materiale nuk barazohet me pasurinë që ka një zog; të gjitha fushat e malet janë vendbanimi i tij, të gjitha farat e të korrat janë ushqimi e pasuria e tij dhe të gjitha tokat, fshatrat, livadhet, kullotat, pyjet e shkretëtirat janë zotërimet e tij. Tani, kush është më i pasur, ky zog apo njeriu më i pasur? Sepse sado fara që ai mund të marrë ose të grumbullojë, pasuria e tij nuk pakësohet.

Është, pra, e qartë se nderi dhe lartësimi i njeriut duhet të jetë diçka më tepër sesa pasuritë materiale. Të mirat materiale janë vetëm një degë, por rrënja e lartësisë të njeriut janë vetitë e virtytet e mira që stolisin realitetin e tij. Këto janë shfaqjet hyjnore, dhuntitë qiellore, emocionet sublime, dashuria e njohja e Perëndisë; urtia universale, intuita mendore, zbulimet shkencore, drejtësia, barazia, vërtetësia, dashamirësia, kurajoja e natyrshme dhe forca e brendshme; respekti për të drejtat dhe mbajtja e marrëveshjeve dhe e besëlidhjeve; ndershmëria në të gjitha rrethanat; shërbimi ndaj së vërtetës në të gjitha kushtet; flijimi i jetës së vet për të mirën e të gjithë njerëzve; dashamirësia e nderimi për të gjitha kombet; bindja ndaj mësimëve të Perëndisë; shërbimi në Mbretërinë Hyjnore; udhëheqja e njerëzve dhe edukimi i kombeve e i racave. Kjo është begatia e botës njerëzore! Ky është lartësimi i njeriut në botë! Kjo është jetë e përjetshme dhe nder qiellor!

Këto virtyte nuk shfaqen nga realiteti i njeriut, veçse përmes fuqisë së Perëndisë dhe mësimëve qiellore, sepse ato kanë nevojë për fuqi të mbinatyrshme që të manifestohen. Mund të ndodhë që në botën e natyrës të shfaqet një gjurmë e këtyre përsosurive, por ato janë të paqëndrueshme e jetëshkurtër; ato janë si rrezet e diellit mbi mur.

Meqenëse Perëndia i mëshirshëm ka vendosur një kurorë të tillë të mahnitshme mbi kokën e njeriut, njeriu duhet të përpiqet që margaritarët e saj të çmuar të bëhen të dukshëm në botë.

Pjesa e Dytë

DISA TEMA TË KRISHTËRIMIT

16

FORMAT E JASHTME DHE SIMBOLET DUHEN PËRDORUR PËR TË SHPREHUR KONCEPTE INTELEKTUALE

Një pikë, që është thelbësore⁸⁴ për të kuptuar çështjet që kemi përmendur dhe të tjerat për të cilat do të flasim, në mënyrë që të kapet thelbi i problemeve, është kjo: që dija njerëzore është dyllojës. Njëra është dija për gjërat e perceptueshme nga shqisat—me fjalë të tjera, gjëra që syri, ose veshi, ose të nuhaturit, ose të shijuarit, ose të prekurit mund t'i perceptojë, të cilat quhen objektive ose shqisore.⁸⁵ Kështu dielli, meqenëse mund të shikohet, thuhet se është objektiv; dhe po kështu tingujt janë shqisore sepse veshi i dëgjon ato; aromat janë shqisore sepse mund të thithen dhe shqisa e të nuhaturit i percepton ato; ushqimet janë shqisore sepse qiellza percepton ëmbëlsinë, thartësinë ose shijën e kripur të tyre; i nxehti dhe i ftohti janë shqisore sepse ndijimet i perceptojnë ato. Këto quhen realitete shqisore.

Lloji tjetër i dijes njerëzore ka karakter mendor—domethënë është një realitet i mendjes; ajo nuk ka formë të jashtme e as nuk ze vend (fizik—Shën. i përkth.) dhe nuk është e perceptueshme nga shqisat. Për shembull, dhuntia e intelektit nuk është shqisore; asnjë nga vetitë e brendshme të njeriut nuk është diçka shqisore; në të kundërtën, ato janë realitete intelektuale. Kështu, dashuria është një realitet mendor e jo shqisor; sepse këtë realitet nuk e dëgjon veshi, nuk e sheh syri, nuk e percepton nuhatja, nuk e dallon shija, nuk e ndien prekja. Madje edhe

⁸⁴ Fjalë për fjalë “strumbullari”.

⁸⁵ Termi “shqisor” përdoret në kuptimin “i kapshëm nga organet e shqisave”, domethënë material, fizik, trupor, objektiv.—Shën. i përkth.

lënda eterore, forcat që në fizikë i quajnë nxehtësi, dritë, elektricitet e magnetizëm janë një realitet intelektual e jo shqisor. Po kështu edhe natyra është në thelbin e saj një realitet intelektual e jo shqisor; shpirti njerëzor është një realitet intelektual e jo shqisor. Për t'i shpjeguar këto realitete intelektuale, njeriu është i detyruar t'i shprehë ato me anë figurash shqisore, sepse në ekzistencën e jashtme nuk ka asgjë që nuk është materiale⁸⁶. Prandaj, për të shpjeguar realitetin e shpirtit—gjendjen e tij, pozitën e tij,—njeriu është i detyruar të japë shpjegime në formën e gjërave shqisore, sepse në botën e jashtme gjithçka që ekziston është shqisore. Për shembull, pikëllimi dhe lumturia janë gjëra intelektuale; kur doni t'i shprehni këto veti shpirtërore, ju thoni: “E kam zemrën të ndrydhur; m'u bë zemra mal”, megjithëse zemra e njeriut as nuk ndrydhet as nuk bëhet mal. Kjo është një gjendje mendore apo shpirtërore, për shpjegimin e së cilës ju jeni të detyruar të përdorni figura shqisore. Një tjetër shembull: ju thoni “Ky njeri ka bërë përparim të madh”, edhe pse ai ka mbetur në të njëjtin vend; ose “pozita e aksh personi është lartësuar”, megjithëse ai, si gjithkush tjetër, ecën mbi tokë. Ky lartësim e përparim janë gjendje shpirtërore dhe realitete intelektuale, por për t'i shpjeguar ato ju jeni të detyruar të përdorni figura shqisore, sepse në botën e jashtme nuk ka asgjë që nuk është shqisore.

Kështu simboli i dijes është drita, ndërsa ai i injorancës—errësira; por pa mendoni, a është dija dritë e perceptueshme, ose injoranca errësirë e perceptueshme? Jo, ato janë thjesht simbole. Këto janë vetëm gjendje intelektuale, por kur doni t'i shprehni ato nga ana e jashtme, ju e quani dijen dritë dhe injorancën errësirë. Ju thoni: “E kisha zemrën në terr dhe u ndriçua”. Tani, ajo dritë e dijes dhe ajo errësirë e injorancës

⁸⁶ Në libër, krahas dukurive të tills shpirtërore si dashuria, emocionet e ndryshme etj., të cilat quhen “intelektuale”, dmth që merren me mend dhe nuk janë të kapshme nga organet e shqisave, cilësohen si intelektuale edhe dukuri të ndryshme fizike, si elektriciteti, magnetizmi, nxehtësia, drita etj., madje edhe natyra në përgjithësi. Kjo thuhet në kuptimin që nuk është i kapshëm nga organet e shqisave, por është një përgjithësim intelektual, mekanizmi i këtyre dukurive. Po kështu natyra është një realitet intelektual në kuptimin që ajo nuk është diçka konkrete, e kapshme drejtpërdrejt nga shqisat, por një përgjithësim mendor i gjithë botës materiale që na rrethon.—Shën. i red.

janë realitete intelektuale e jo shqisore; por kur përpigemi të gjejmë shpjegim në botën e jashtme, jemi të detyruar t'u japim atyre formë shqisore.

Është, pra, e qartë se pëllumbi që zbriti mbi Krishtin nuk ishte një pëllumb material, por një gjendje shpirtërore, e cila, për të qenë e kuptueshme, është shpjeguar me një figurë shqisore. Kështu, në Dhiatën e Vjetër thuhet se Perëndia u shfaq si një shtyllë zjarri: kjo jo në kuptimin e një forme materiale; është një realitet intelektual që është shprehur me një figurë shqisore.

Krishti thotë “Ati është në Birin dhe Biri është në Atin”. A ishte Krishti brenda Perëndisë ose Perëndia brenda Krishtit? Jo, për Perëndi! Përkundrazi, kjo është një gjendje intelektuale e shprehur me një figurë shqisore.

Vijmë te shpjegimi i fjalëve të Bahá'u'lláh-ut, kur Ai thotë: “O mbret! Unë isha vetëm një njeri si të tjerët, në gjumë mbi shtratin Tim, kur ja, flladet e Lavdiplotit frynë mbi Mua dhe Më mësuam çdo gjë që ka ndodhur. Kjo gjë nuk është nga Unë, por nga Ai Që është Fuqiploti e i Gjithëdijshmi”.⁸⁷ Kjo është gjendje e manifestimit: ajo nuk është shqisore; është një realitet intelektual, i përjashtuar e i çliruar nga koha, nga e shkuara, nga e tashmja dhe nga e ardhmja; është një shpjegim, një përngjasim, një metaforë dhe nuk duhet marrë fjalë për fjalë; nuk është një gjendje që mund të kuptohet nga njeriu. Të fjeturit dhe zgjimi janë kalim nga një gjendje në një tjetër. Të fjeturit është gjendja e prehjes dhe zgjimi është gjendja e lëvizjes. Të fjeturit është gjendja e heshtjes; zgjimi është gjendja e të folurit. Të fjeturit është gjendja e misterit; zgjimi është gjendja e manifestimit.

Për shembull, ka një shprehje persiane dhe arabe për të thënë se toka ishte në gjumë dhe erdhi pranvera e ajo u zgjua; ose toka ishte e vdekur dhe erdhi pranvera e ajo u ringjall. Këto shprehje janë metafora, alegori, shpjegime mistike në botën e domethënies.

Me pak fjalë, Manifestimet e Shenjta kanë qenë dhe do të jenë gjithnjë realitete të Ndryshme; asnjë ndryshim ose ndërrim nuk bëhet në thelbin e Tyre. Përpara se të deklarojnë manifestimin e Tyre Ata janë

⁸⁷ Ekstrakt nga letra drejtuar Nasiridin Shahut [Ná•iri'd-Dín Sháh].

të heshtur e të qetë, si një njeri që fle, dhe pas manifestimit të Tyre Ata flasin e janë të ndriçuar, si një njeri që është i zgjuar.

17

LINDJA E KRISHTIT

Pyetje.—Si lindi Krishti nga Shpirti i Shenjtë?

Përgjigje.—Lidhur me këtë çështje teologët dhe materialistët nuk janë të një mendjeje. Teologët besojnë se Krishti lindi nga Shpirti i Shenjtë, ndërsa materialistët mendojnë se kjo është e pamundur dhe e papranueshme dhe se, padyshim, Ai ka pasur një atë njerëzor.

Në Kuran thuhet: “Dhe Ne dërguam Shpirtin Tonë tek ajo dhe Ai iu shfaq asaj krejt në formën e një njeriu”,⁸⁸ që do të thotë se Shpirti i Shenjtë mori ngjashmërinë e një forme njerëzore, ashtu siç pasqyrohet një figurë në pasqyrë, dhe iu drejtua Maries.

Materialistët besojnë se duhet të ketë pasur martesë dhe thonë se një trup i gjallë nuk mund të krijohet nga një trup i pajetë, se pa bashkim të mashkullit e të femrës nuk mund të ketë pllenim. Dhe ata mendojnë se jo vetëm te njerëzit, por edhe te kafshët e bimët kjo është e pamundur. Sepse ky bashkim i mashkullit e i femrës ekziston tek të gjitha qeniet e gjalla e bimët. Ky çiftëzim i gjërave tregohet madje edhe në Kuran: “Lavdi Atij Që ka krijuar të gjitha çiftet: të çdo gjëje që prodhon toka, edhe të vetë atyre; dhe të gjërave që ata nuk i dinë”⁸⁹ —domethënë njerëzit, kafshët dhe bimët janë të gjithë në çifte—“dhe nga gjithçka Ne kemi krijuar dy lloje”—që do të thotë “Ne i kemi krijuar të gjitha qeniet me anë të çiftëzimit”.

Me pak fjalë, materialistët thonë se nuk mund të përfytyrohet një njeri pa një atë njerëzor. Në përgjigje, teologët thonë: “Kjo nuk është e pamundur dhe e paarritshme, por diçka që nuk është parë; dhe ka një ndryshim të madh midis diçkaje që është e pamundur dhe diçkaje që

⁸⁸ Shih Kurani 19:17.

⁸⁹ Kurani 36:36.

nuk dihet. Për shembull, në kohët e shkuara telegrafi, që bëri të komunikojnë Lindja dhe Perëndimi, ishte i panjohur, por jo i pamundur; fotografia dhe fonografia nuk njiheshin, por nuk ishin të pamundura”.

Materialistët ngulin këmbë në këtë besim, ndërsa teologët përgjigjen: “A është ky rruzull i përjetshëm apo i natyrës fenomenale?” Materialistët përgjigjen se, sipas shkencës e zbulimeve të rëndësishme, është gjetur se është i natyrës fenomenale; në fillim ishte një rruzull flakësh dhe gradualisht u ftoh; rreth tij u formua një kore dhe mbi këtë kore të fortë u krijuan bimët, pastaj kafshët e më në fund njeriu.

Teologët thonë: “Atëherë nga thënia juaj del qartë se ekzistenca e njerëzimit në rruzull është e natyrës fenomenale dhe jo e përjetshme. Pra, sigurisht njeriu i parë nuk kishte as baba as nënë, sepse ekzistenca e njeriut është e natyrës fenomenale. A nuk është krijimi i një njeriu pa atë e pa nënë, edhe sikur kjo të ketë ndodhur gradualisht, më i vështirë sesa ai thjesht të ketë lindur pa baba? Derisa ju e pranoni që njeriu i parë është krijuar pa at ose nënë—qoftë gradualisht ose menjëherë,—nuk mbetet pikë dyshimi se një njeri pa at njerëzor është gjithashtu i mundshëm e i pranueshëm; ju nuk mund ta quani këtë të pamundur; përndryshe nuk jeni logjikë. Për shembull, në rast se ju thoni që kjo llampë është ndezur dikur pa fitil e pa vaj dhe pastaj thoni se është e pamundur që ajo të ndizet pa fitil, kjo nuk është logjike”. Krishti kishte një nënë; njeriu i parë, siç besojnë materialistët, nuk kishte as atë as nënë.⁹⁰

18

MADHËSHTIA E KRISHTIT U DETYROHET PËRSOSURIVE TË TIJ

⁹⁰ Kjo bisedë tregon kotësinë e diskutimeve për çështje të tilla; mësimet e ‘Abdu’l-Bahá-it për lindjen e Krishtit janë në kreun tjetër.

Një njeri i madh është njeri i madh, qoftë nëse ka lindur prej një ati njerëzor ose jo. Po qe se të qënit pa baba është një virtyt, Adami është më i madhi e më i larti ndër të gjithë Profetët e Lajmëtarët, sepse Ai nuk kishte as atë as nënë. Ajo që sjell nderim e madhështi është shkëlqimi e begatia e përsosurive hyjnore. Dielli ka lindur nga substanca e forma, të cilat mund të krahasohen me atin e nënën, dhe ai është përsosuri absolute; ndërsa errësira nuk ka as substancë as formë, as atë as nënë, dhe është papërsosuri absolute. Substanca e jetës fizike të Adamit ishte pluhuri i dheut, ndërsa substanca e Abrahamit ishte spermë e kulluar; është e qartë se sperma e kulluar dhe e papërlyer është më e lartë se pluhuri.

Për më tepër, në kreun e parë të Ungjillit të Gjonit, vargu 12 e 13, thuhet: “Por të gjithë atyre që e pranuan Atë, Ai u dha të drejtën të bëhen bij të Perëndisë, madje edhe atyre që besonin në emrin e Tij:

“Që kanë lindur jo nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i njeriut, por nga Perëndia”.⁹¹

Nga këto vargje duket vetiu se edhe dishepujt nuk krijohen nga forca fizike, por nga realiteti shpirtëror. Nderi dhe madhështia e Krishtit nuk i detyrohet faktit që ai nuk kishte një atë njerëzor, por përsosurive të Tij, dhuntive e lavdisë hyjnore. Në qoftë se madhështia e Krishtit është qenia e Tij pa atë, atëhere Adami është më i madh se Krishti, sepse Ai nuk kishte as atë as nënë. Në Dhiatën e Vjetër thuhet: “Dhe Zoti Perëndia e formoi njeriun nga pluhuri i dheut, dhe i shtiu nëpër flegrat e hundës frymën jetëdhënëse; dhe njeriu u bë shpirt i gjallë”.⁹² Vini re që thuhet se Adami u krijua nga Shpirti i jetës. Për më tepër, shprehja që përdor Gjoni lidhur me dishepujt provon se edhe ata vijnë nga Ati Qiellor. Është, pra, e qartë se realiteti i shenjtë, që nënkupton ekzistencën reale të çdo njeriu të madh, vjen nga Perëndia dhe ia detyron qenien e tij frymës së Shpirtit të Shenjtë.

Ideja është që, në qoftë se të jesh pa atë është lavdia më e madhe njerëzore, atëhere Adami është më i madh se të gjithë, sepse ai nuk kishte as atë as nënë. A është më mirë për njeriun të jetë krijuar nga një substancë e gjallë apo nga dheu? Sigurisht është më mirë të jetë krijuar

⁹¹ Shih Gjoni 1:12-13.

⁹² Zanafilla 2:7.

nga një substancë e gjallë. Por Krishti lindi dhe erdhi në jetë nga Shpirti i Shenjtë.

Që të konkludojmë: shkëlqimi e nderi i shpirttrave të shenjtë dhe i manifestimeve hyjnore vijnë nga përsosuritë qiellore, nga dhuntitë e lavdia e Tyre dhe nga asgjë tjetër.

19

PAGËZIMI I KRISHTIT

Pyetje—Në Ungjillin e Shën Mateut, kreu 3, vargjet 13, 14, 15, thuhet: “Atëherë Jesui erdhi nga Galileja në Jordan te Gjoni për t’u pagëzuar prej tij. Gjoni kërkoi t’ia kthente mendjen dhe tha: “Unë duhet të pagëzohem prej teje, dhe Ti vjen te unë?” Por Jesui iu përgjigj e i tha: “Tani le të bëhet kështu: sepse ne duhet të kryejmë çdo gjë që është e drejtë. Atëhere Gjoni nuk e pengoi më”.

Ç’urti ka këtu: derisa Krishti zotëronte të gjitha përsosuritë thelbësore, përse kishte nevojë për pagëzim?

Përgjigje.—Parimi i pagëzimit është dëlirja nëpërmjet pendesës. Gjoni i qortonte e i këshillonte njerëzit, i bënte të pendohen, pastaj i pagëzonte ata. Shihet qartë, pra, se pagëzimi është një simbol i pendesës nga të gjitha mëkatet: Kuptimi i kësaj shprehet në këto fjalë: “O Perëndi! Ashtu si trupi im është dëlirur e pastruar prej papastërtive fizike, kështu dëlire e spastroje shpirtin tim nga papastërtitë e botës së natyrës, që nuk janë të denja për Pragu e Unitetit Tënd!” Pendesa është kthimi nga mosbindja në bindje. Njeriu, pas largimit e privimit nga Perëndia, pendohet dhe i nënshtrohet dëlirjes: Dhe ky është një simbol që do të thotë “O Perëndi! Bëje zemrën time të mirë e të dëlirë, të lirë e të spastruar nga çdo gjë veç dashurisë për Ty”.

Duke qenë se Krishti dëshironte që ky institucion i Gjonit të përdorej në atë kohë prej të gjithëve, Ai Vetë iu nënshtroa atij me qëllim që t’i zgjonte njerëzit dhe të plotësonte ligjin e fesë së mëparshme. Megjithëse larja e pendesës ishte një institucion i Gjonit, në të vërtetë ajo ishte praktikuar më parë në fenë e Perëndisë.

Krishti nuk kishte nevojë për pagëzim; por meqë në atë kohë ky ishte një veprim i pranueshëm e i lavdërueshëm dhe një shenjë e lajmit të mirë të ardhjes së Mbretërisë së Perëndisë, Ai për këtë arsye e konfirmoi atë. Sidoqoftë, më pas Ai tha se pagëzimi i vërtetë nuk është me ujë material, por duhet të jetë me shpirt e me ujë. Në këtë rast uji nuk do të thotë ujë material, sepse në një rast tjetër është thënë shprehimisht se pagëzimi është me shpirt e me zjarr, prej ku del qartë se nuk është fjala për zjarr material e ujë material, sepse pagëzimi me zjarr është i pamundur.

Pra, shpirti është dhuntia e Perëndisë, uji është dije e jetë dhe zjarri është dashuria për Perëndinë. Sepse uji material nuk e dëlir zemrën e njeriut; jo, ai pastron trupin e tij. Por uji dhe shpirti qiellor, që janë dije e jetë, e bëjnë zemrën njerëzore të mirë e të dëlirë; zemra që përfiton një pjesë nga dhuntia e Shpirtit bëhet e spastruar, e mirë dhe e dëlirë—domethënë realiteti i njeriut dëlirë e spastrohet nga papastërtitë e botës së natyrës. Këto papastërti natyrore janë vetitë e liga: zemërimi, epshi, rendja pas gjërave të kësaj bote, kryelartësia, gënjeshtria, hipokrizia, mashtrimi, egoizmi, etj.

Njeriu nuk mund ta çlirojë veten nga furia e pasioneve ephore, veçse me ndihmën e Shpirtit të Shenjtë. Ja përse Ai thotë se pagëzimi me shpirt, me ujë e me zjarr, është i nevojshëm, dhe se ai është thelbësor—domethënë, shpirti i dhuntisë hyjnore, uji i dijes e i jetës dhe zjarri i dashurisë së Perëndisë. Njeriu duhet të pagëzohet me këtë shpirt, me këtë ujë e me këtë zjarr, në mënyrë që të mbushet me dhunti të përjetshme. Përndryshe, ç'dobi do të kishte pagëzimi me ujë material? Jo, ky pagëzim me ujë është një simbol i pendesës dhe i kërkimit të faljes së mëkatave.

Por në ciklin e Bahá'u'lláh-ut nuk nevojitet më ky simbol; sepse realiteti i tij, domethënë pagëzimi me shpirtin e me dashurinë e Perëndisë, është kuptuar e vendosur.

Pyetje.—A është larja e pagëzimit e dobishme dhe e nevojshme, apo është e padobishme dhe e panevojshme? Në rastin e parë, nëse është e dobishme, përse hiqet? Dhe në rastin e dytë, nëse është e padobishme, përse Gjoni e praktikonte atë?

Përgjigje.—Ndryshimi i kushteve të jetesës, ndërrimet e transformimet e saj janë nevoja të thelbit të qenieve, dhe nevojat thelbësore nuk mund të ndahen nga realiteti i gjërave. Kështu, është absolutisht e pamundur ta ndash të nxehtin nga zjarri, lagështinë nga uji ose dritën nga dielli, sepse ato janë nevoja thelbësore. Ashtu si ndryshimi e modifikimi i kushteve janë të nevojshme për qeniet, edhe ligjet ndryshohen e modifikohen në përputhje me ndryshimet dhe lëvizjen e kohërave. Për shembull, në kohën e Moisiut, ligji i Tij u ishte përshtatur e adaptuar kushteve të kohës; por në kohën e Krishtit këto kushte kishin ndryshuar e ishin ndërruar në një shkallë të tillë sa që Ligji i Moisiut nuk ishte më i përshtatshëm dhe nuk u përgjigjej nevojave të njerëzimit; për rrjedhojë, ai u hoq. Kështu ndodhi që Krishti theu sabbathin dhe ndaloi shkurorezimin. Pas Krishtit, katër dishepuj, ndër të cilët Pjetri dhe Pali, lejuan përdorimin e ushqimit shtazor të ndaluar nga Bibla, me përjashtim të ngrënies së atyre kafshëve që ishin mbytur duke u zënë frymën ose të atyre që u flijoheshin idhujve, si dhe të gjakut.⁹³ Ata ndaluan gjithashtu prostitucionin. Ata i ruajtën këto katër porosi. Më pas Pali lejoi madje edhe ngrënien e kafshëve të mbytura, të atyre që u flijoheshin idhujve dhe të gjakut, dhe ruajti vetëm ndalimin e prostitucionit. Kështu, në kreun 14, vargu 14, të Letrës së Tij drejtuar romakëve, Pali shkruan: “Unë e di dhe jam i bindur te Zoti Jesu se nuk ka asgjë të papastër në vetvete, por në qoftë se dikush mendon se diçka është e papastër, për të ajo është e papastër”.

Edhe në Letrën e Palit dërguar Titit, kreu 1, vargu 15, thuhet: “Të gjitha gjërat janë të pastra për ata që janë të pastër. Kurse për ata që janë të papastër e që nuk besojnë, asgjë nuk është e pastër; por të papastra janë mendja dhe ndërgjeja e tyre”.

Tani, ky ndryshim, këto ndërrime e ky anulim u bënë për shkak se ishte e pamundur të krahasohej koha e Krishtit me atë të Moisiut.

⁹³ Veprat (e Apostujve) 15:20.

Kushtet e kërkesat në periudhën e mëvonshme kishin ndryshuar e ishin ndërruar krejtësisht. Prandaj Ligjet e mëparshme u hoqën.

Ekzistenca e botës mund të krahasohet me atë të një njeriu dhe Profetët e Lajmëtarët e Perëndisë me mjekë të aftë. Qenia njerëzore nuk mund të mbetet në të njëjtën gjendje: ndodhin sëmundje të ndryshme që kërkojnë secila një mjekim të posaçëm. Mjeku i aftë nuk jep të njëjtin ilaç për të shëruar çdo sëmundje e lëngatë, por i ndryshon mjekimin e ilaçet sipas nevojave të ndryshme të sëmundjeve e të organizmit. Një person mund të ketë një sëmundje të rëndë, të shkaktuar nga ethet, dhe doktori i aftë do t'i japë atij ilaçe që ulin temperaturën; e kur në një kohë tjetër gjendja e këtij personi ka ndryshuar dhe ethja është zëvendësuar nga të dridhura, padyshim që doktori i aftë do t'i heqë ilaçet që ulin temperaturën dhe do të lejojë përdorimin e pijeve të nxehta. Këtë ndryshim e ndërrim e kërkon gjendja e sëmurit dhe ai është një provë e qartë e aftësisë së mjekut.

Pa mendoni, a mund të zbatohet Ligji i Dhiatës së Vjetër në këtë kohë e në këtë epokë? Jo, për Perëndi! Ai do të ishte i pamundur e i pazbatueshëm; prandaj, sigurisht që Perëndia i hoqi ligjet e Dhiatës së Vjetër në kohën e Krishtit. Mendoni, gjithashtu, se pagëzimi në kohët e Gjon Pagëzorit përdorej për t'i zgjuar e për t'i qortuar njerëzit që të pendoheshin për të gjitha mëkatet dhe të qëndronin në pritje të shfaqjes së Mbretërisë së Krishtit. Por në Azinë e tanishme, kishat katolike e ortodokse i zhytin fëmijët e posalindur në ujë të përzier me vaj ulliri, dhe shumë prej tyre sëmuren nga tronditja; në kohën e pagëzimit ata përpiqen e lëvizin të shqetësuar. Në vende të tjera, priftërinjtë u spërkatin ballin me ujin e pagëzimit. Por as nga praktika e parë as nga e dyta fëmijët nuk kanë ndonjë përfitim shpirtëror. Çfarë rezultati arrihet, pra, nga kjo praktikë? Popuj të tjerë habiten e vrasin mendjen përse zhytet foshnja në ujë, derisa kjo nuk është as shkaku i zgjimit shpirtëror të fëmijës, as i besimit të tij ose i ndërrimit të fesë, por vetëm një zakon që ndiqet. Në kohën e Gjon Pagëzorit nuk ishte kështu; jo, në fillim Gjoni i qortonte njerëzit, i çonte ata në pendesë për mëkatet dhe i mbushte ata me dëshirën për të pritur manifestimin e Krishtit. Kushdo që merrte larjen e pagëzimit dhe pendoej për mëkatet me përlujë e bindje absolute, lante e pastronte edhe trupin e tij nga papastërtitë e

jashtme. Me dëshirë të zjarrtë, ai priste natë e ditë manifestimin e Krishtit dhe arritjen e Mbretërisë së Shpirtit të Perëndisë.⁹⁴

Që ta përmbledhim: Siç e kuptojmë ne, ndryshimi e ndërimi i kushteve dhe kërkesat e ndryshuara të shekujve e të epokave të ndryshme janë shkaku i anulimit të ligjeve. Sepse vjen një kohë, kur këto ligje nuk u përshtaten më si duhet kushteve. Pa mendoni sa të ndryshme janë kërkesat e shekujve të hershëm, të mesjetës dhe të kohëve moderne. A është e mundur që ligjet e shekujve të hershëm të zbatohen në kohën e sotme? Është e qartë që kjo do të ishte e pamundur dhe e pazbatueshme. Po kështu, me kalimin e disa shekujve, kërkesat e kohës së sotme nuk do të jenë po ato të së ardhmes dhe sigurisht do të pësojnë ndryshime e ndërrime. Në Evropë ligjet ndryshohen e ndërrohen pareshtur; sa ligje ekzistonin në vitet e kaluara në organizatat e sistemet e Evropës, të cilat tashmë janë hequr! Këto ndryshime e ndërrime i detyrohen ndryshimit dhe evolucionit të mendimit, të kushteve e të zakoneve. Po të mos ishte kështu, begatia e botës së njerëzimit do të shembej.

Për shembull, në Pesëlibërshin ishte një ligj që, nëse ndokush shkelte Sabathin dënohej me vdekje. Për më tepër, në Pesëlibërshin ka dhjetë dënime me vdekje. A do të ishte e mundur të ruheshin këto ligje në kohën e sotme? Është e qartë se kjo do të ishte krejt e pamundur. Pra, ka ndryshime e ndërrime në ligje dhe ato janë një provë e mjaftueshme e urtisë supreme të Perëndisë.

Kjo temë ka nevojë të mendohet thellë. Atëherë shkaku i këtyre ndryshimeve do të bëhet i qartë e i dukshëm.

Lum ata që reflektojnë!

⁹⁴ dmth të Krishtit, të Cilin myslimanët shpesh e thërresin me titullin *Rúbu'lláh*, Shpirti i Perëndisë.

21

SIMBOLIZMI I BUKËS DHE I VERËS

Pyetje.— Krishti tha: “Unë jam buka e gjallë që ka zbritur nga qielli. Kush ha nga kjo bukë, do të jetojë përgjithmonë”.⁹⁵ Cila është domethënia e këtyre fjalëve?

Përgjigje.—Kjo bukë do të thotë ushqimi qiellor dhe përsosuritë hyjnore. Kështu, “Kush ha nga kjo bukë” do të thotë që, në qoftë se një njeri fiton dhunti qiellore, merr dritën hyjnore ose bëhet pjesëtar i përsosurive të Krishtit, ai përmes kësaj fiton jetë të pasosur. Gjaku gjithashtu do të thotë shpirt i jetës e përsosuri hyjnore, shkëlqim i Zotit e dhunti e përrjetshme. Sepse të gjitha organet e trupit marrin lëndë jetësore nga qarkullimi i gjakut.

Në ungjillin e Shën Gjjonit, kreu 6, vargu 26, shkruhet: “Ju më kërkoni jo sepse keni parë mrekulli, por sepse hëngrët bukë dhe u ngitë”.

Shihet qartë se buka që hëngrën e me të cilën u nginë dishepujt ishte dhuntia qiellore; sepse në vargun 33 të po atij kreu thuhet: “Sepse buka e Perëndisë është Ai që zbret nga qielli dhe i jep jetë botës”. Është e qartë se trupi i Krishtit nuk zbriti nga qielli, por doli nga mitra e Marisë, ndërsa ai që zbriti nga qielli i Perëndisë ishte Shpirti i Krishtit. Duke qenë se hebrenjtë mendonin që Krishti e kishte fjalën për trupin e Vet, ata kundërshtuan, siç thuhet në vargun 42 të po atij kreu: “Dhe ata thonin: vallë a nuk është ky Jesui, i biri i Josifit, atin dhe nënën e të cilit ne i njohim? Si thotë ai tani: Unë kam zbritur nga qielli?”

Mendoni sa e qartë është se ajo që donte të thoshte Krishti me bukë qiellore ishin shpirti i Tij, dhuntitë e Tij, përsosuritë e Tij dhe mësimet e Tij, sepse në vargun 63 thuhet: “Është shpirti që sjell jetë; mishi nuk sjell asnjë dobi”.

Është, pra, e qartë se shpirti i Krishtit është një hir qiellor që zbret nga qielli; kush merr nga ai shpirt dritë të bollshme—domethënë

⁹⁵ Shih Gjoni 6:51, 50.

mësime qiellore—fiton jetë të pasosur. Ja përse thuhet në vargun 35: “Dhe Jesui u tha atyre: Unë jam buka e jetës; kush vjen tek Unë kurrë nuk do të jetë i uritur; dhe kush beson tek Unë kurrë nuk do të jetë i etur”.

Vëreni se “vajtjen tek Ai” ai e shpreh me të ngrënë, dhe “besimin tek Ai” me të pirët. Atëherë është e qartë dhe e sigurt që ushqimi qiellor janë dhuntitë hyjnore, shkëlqimet shpirtërore, mësimet qiellore, domethënia universale e Krishtit. Të hash është të afroresh pranë Tij dhe të pish është të besosh tek Ai. Sepse Krishti kishte një trup të përbërë prej elementesh dhe një formë qiellore. Trupi prej elementesh u kryqëzua, por forma qiellore është e gjallë dhe e përjetshme, është shkaku i jetës së pasosur; e para ishte natyra njerëzore dhe e dyta është natyra hyjnore. Disa mendojnë se eukaristi⁹⁶ është realiteti i Krishtit dhe se Hyjnia e Shpirti i Shenjtë zbresin e ekzistojnë në të. Mirëpo, pasi eukaristi (kungata) është marrë, pas pak çastesh ai thjesht shpërbëhet e transformohet krejtësisht. Atëherë, si mund të konceptohet një mendim i tillë? Mos e dhëntë Zoti! Sigurisht që kjo është këmbë e krye fantazi.

Që ta përfundojmë: përmes manifestimit të Krishtit, mësimet qiellore, që janë dhunti e përjetshme, u përhapën kudo, shkëlqeu drita e udhërrëfmit dhe njeriut iu dhurua shpirti i jetës. Kush gjeti rrugën fitoi jetën; kush nuk e gjeti atë u mbërthye nga vdekja e përhershme. Kjo bukë që zbriti nga qielli ishte trupi hyjnor i Krishtit, elementet e Tij shpirtërore, që dishepujt i hëngrën, duke fituar kështu jetën e pasosur.

Dishepujt kishin ngrënë shumë herë nga duart e Krishtit; përse darka e fundit dallohet nga të tjerat? Është e qartë se buka qiellore nuk donte të thoshte bukë materiale, por ushqimin hyjnor të trupit shpirtëror të Krishtit, hiret hyjnore dhe përsosuritë qiellore, nga të cilat dishepujt e Tij morën pjesë dhe u nginë.

Po kështu, pa mendoni se kur Krishti e bekoj bukën dhe ua dha dishepujve të Vet duke thënë “Ky është trupi Im”,⁹⁷ dhe u shprehu atyre dashamirësi, Ai ishte me ta personalisht, në prani të tyre dhe në

⁹⁶ Kungimi. Sipas doktrinës katolike, në formën e bukës e të verës, me të cilat kungohen besimtarët, është realisht i pranishëm Jesu Krishti, trupi, gjaku, shpirti dhe hyjësia e Tij.—Shën. i përkth.

⁹⁷ Mateu 26:26.

formën e Tij. Ai nuk ishte shndërruar në bukë e në verë; po të ishte shndërruar në bukë e në verë, Ai nuk do të kishte mbetur me dishepujt me trupin e Tij, si person e në prani të tyre.

Është, pra, e qartë se buka dhe vera ishin simbole që donin të thonin: Unë ju kam dhënë juve dhuntitë e përsosuritë e Mia dhe kur keni marrë këtë dhunti, ju keni fituar jetën e pasosur dhe keni marrë pjesën tuaj të ushqimit qiellor.

22

MREKULLITË

Pyetje.—Është shkruar se Krishti ka bërë mrekulli. A janë raportimet për këto mrekulli për t'u pranuar vërtet fjalë për fjalë, apo kanë ndonjë kuptim tjetër? Është provuar nga shkenca e saktë se thelbi i gjërave nuk ndryshon dhe se të gjitha qeniet i nënshtrohen një ligji e një organizimi të vetëm universal, nga i cili ato nuk mund të shmangen; prandaj ajo që është në kundërshtim me ligjin universal është e pamundur.

Përgjigje.—Manifestimet e Shenjta janë burime të mrekullive dhe nismëtarë të shenjave të mrekullueshme. Për Ta çdo gjë e vështirë dhe e parealizueshme është e mundur dhe e lehtë. Sepse përmes një fuqie të mbinatyrshe ata shfaqin mrekulli; dhe me anë të kësaj fuqie, që është tej natyrës, ata ndikojnë mbi botën e natyrës. Të gjitha Manifestimet kanë shfaqur gjëra të mrekullueshme.

Por në Librat e Shenjtë përdoret një terminologji e posaçme, dhe për Manifestimet këto mrekulli e shenja të mrekullueshme nuk kanë rëndësi. Ata madje nuk duan as t'i përmendin ato. Sepse, po qe se ne i shohim mrekullitë si një provë të madhe, ato janë prova e argumente vetëm për ata që janë të pranishëm kur ato kryhen, dhe jo për ata që nuk janë të pranishëm.

Për shembull, po t'i tregojmë një kërkuesi, që është i huaj për Moisiun e Krishtin, shenja mrekullish, ai do t'i mohojë ato dhe do të thotë: “Shenja të mahnitshme tregohen vazhdimisht edhe për perëndi të

reme, të dëshmuara nga shumë njerëz, dhe ato afirmohen në Librat. Brahmanët kanë shkruar një libër për bëma të mrekullueshme të kryera nga Brahma”. Ai do të thotë gjithashtu: “Si mund ta dimë ne se çifutët e të krishterët thonë të vërtetën dhe se brahmanët gënjejnë? Sepse si të parat dhe të dytat janë tradita përgjithësisht të pranuar, të cilat janë mbledhur në libra, dhe mund të supozohet se janë të vërteta ose të reme”. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fetë e tjera: po qe se njëra është e vërtetë, të gjitha janë të vërteta; po qe se njëra pranohet, të gjitha duhet të pranohen. Prandaj mrekullitë nuk janë një provë. Sepse në rast se ato janë prova për ata që janë të pranishëm, nuk janë prova për ata që nuk janë të pranishëm.

Por në ditën e Manifestimit njerëzit me intuitë e shohin se të gjitha kushtet e Manifestimit përbëjnë mrekulli, sepse Ata janë superiorë ndaj gjithë të tjerëve, dhe kjo është në vetvete një mrekulli absolute. Sillni ndër mend se Krishti, i vetmuar e i vetëm, pa askënd që ta ndihmonte ose mbronte, pa ushtri e legjione dhe duke iu nënshtruar shtypjes më të madhe, ngriti flamurin e Perëndisë para gjithë popujve të botës, u qëndroi dhe më në fund i bëri të gjithë për vete, megjithëse nga ana e jashtme Ai u kryqëzua. E pra, kjo është një mrekulli e vërtetë që nuk mund të mohohet kurrë. Nuk ka nevojë për ndonjë provë tjetër për të vërtetën e Krishtit.

Mrekullitë e jashtme nuk kanë rëndësi për njerëzit e Realitetit. Për shembull, në qoftë se një i verbër fiton dritën e syve, ai në fund të fundit përsëri do ta humbasë atë, sepse do të vdesë e do të privohet nga të gjitha shqisat e aftësitë. Prandaj, ta bësh një të verbër të shohë është diçka relativisht pak e rëndësishme, sepse kjo aftësi e të parit më në fund do të zhduket. Në qoftë se trupi i një të vdekuri ringjallet, ç’dobi ka kjo, duke qenë se trupi do të vdesë përsëri? Por e rëndësishme është të jepet perceptim dhe jetë e pasosur—domethënë jetë shpirtërore e hyjnore. Sepse kjo jetë fizike nuk është e pavdekshme dhe ekzistenca e saj është e njëllotjë me mosekzistencën. Për këtë arsye Krishti i tha njërit prej dishepujve të Tij: “Lërinini të vdekurit të varrosin të vdekurit e tyre”; sepse “Ajo që ka lindur prej mishit është mish; dhe ajo që ka lindur prej Shpirtit është shpirt”.⁹⁸

⁹⁸ Mateu 8:22; Gjoni 3:6.

Vëreni: Ata që në dukje ishin fizikisht të gjallë, Krishti i konsideronte të vdekur; sepse jetë është jeta e pasosur, dhe ekzistencë është ekzistenca e vërtetë. Çdo herë që në librat e Shenjtë flitet për ngritjen e të vdekurve, kjo do të thotë se të vdekurit u bekuan në jetën e pasosur; kur thuhet se të verbërit iu dha shikimi, domethënia është se ai fitoi të kuptuarit e vërtetë; atje ku thuhet se një i shurdhër fitoi dëgjim, kuptimi është se ai fitoi dëgjim shpirtëror e qiellor. Këtë e vërteton teksti i Ungjillit, ku Krishti thotë: “Këta janë si ata për të cilët Isaija thotë: kanë sy e nuk shikojnë, kanë veshë e nuk dëgjojnë; dhe Unë i shërova”.⁹⁹

Kjo nuk do të thotë se Manifestimet s’janë në gjendje të bëjnë mrekulli, sepse Ata i kanë të gjitha aftësitë. Por për Ta gjëra të vlefshme e të rëndësishme janë intuita e brendëshme, shërimi shpirtëror dhe jeta e pasosur. Për rrjedhojë, sa herë që në Librat e Shenjtë shkruhet se dikush ishte i verbër dhe fitoi sërish shikimin, kuptimi është se ishte i verbër nga brenda dhe fitoi shikimin shpirtëror, ose se ishte injorant dhe u bë i ditur, ose se ishte moskokëçarës dhe u bë i vëmendshëm, ose se ishte i kësaj bote dhe u bë qiellor.

Duke qenë se kjo intuitë e brendshme, të dëgjuarit, jeta dhe shërimi janë të përjetshme, ato janë të rëndësishme. Në krahasim me këtë, ç’rëndësi, vlerë e dobi ka kjo jetë shtazore me të gjitha aftësitë e saj? Në pak ditë ajo do të marrë fund si ndonjë mendim kalimtar. Për shembull, nëse dikush ndez sërish një llambë të fikur, ajo përsëri do të fiket, kuse drita e diellit është gjithnjë e ndritshme. Kjo është e rëndësishme.

23

RINGJALLJA E KRISHTIT

Pyetje.—Cila është domethënia e ringjalljes së Krishtit pas tri ditësh?

⁹⁹ Shih Mateu 13:14 dhe Gjoni 12:40-41.

Përgjigje.—Ringjalljet e Manifestimeve Hyjnore nuk i përkasin trupit. Të gjitha gjendjet e Tyre, kushtet e Tyre, veprat e Tyre, gjërat që Ata vendosin, mësimet e Tyre, shprehjet e Tyre, shëmbëlltyrat e Tyre dhe porosinë e Tyre kanë një domethënie shpirtërore e hyjnore dhe nuk kanë të bëjnë me gjëra materiale. Për shembull, është çështja e ardhjes së Krishtit nga qielli: në shumë vende të Ungjillit thuhet qartë se i Biri i njeriut erdhi nga qielli, është në qiell dhe do të shkojë në qiell. Kështu, në kreun 6, vargun 38, të Ungjillit të Gjonit shkruhet: “Sepse Unë kam zbritur nga qielli”; edhe në vargun 42 gjejmë: “Ata thanë: A nuk është ky Jesui, i biri i Josifit nga Nazareti, të Cilin ne e njohim? Pra, si mund të thotë Ai: Unë kam zbritur nga qielli?” Po kështu, te Gjoni, kreu 3, vargu 13 thuhet: “Dhe askush nuk është ngjitur në qiell, veç atij që ka zbritur nga qielli, domethënë të Birit të Njeriut që është në qiell”.

Vini re që thuhet “Biri i njeriut është në qiell”, ndërkohë që Krishti ishte në tokë. Vini re gjithashtu se thuhet që Krishti erdhi nga qielli, megjithëse Ai doli nga mitra e Maries dhe trupi i Tij lindi nga Maria. Është e qartë, pra se kur thuhet që i Biri i Njeriut erdhi nga qielli, kjo nuk ka një kuptim të jashtëm, por një domethënie të brendshme; ky është një fakt shpirtëror e jo material. Kuptimi është që, ndërsa në dukje Krishti lindi nga barku i Maries, në të vërtetë Ai erdhi nga qielli, nga qendra e Diellit të Realitetit, nga Bota Hyjnore e nga Mbretëria Shpirtërore. Dhe duke qenë se ishte e qartë që Krishti erdhi nga qielli shpirtëror i Mbretërisë Hyjnore, atëherë zhdukja e Tij nën tokë për tre ditë ka një domethënie të brendshme dhe nuk është një fakt i jashtëm. Po kështu, ringjallja e Tij nga brendësia e tokës është gjithashtu simbolike; është një fakt shpirtëror e hyjnor, dhe jo material; dhe po ashtu, ngjitja e Tij në qiell është një ngjitje shpirtërore e jo materiale.

Veç këtyre shpjegimeve, shkenca ka vërtetuar se qielli i dukshëm është një hapësirë e pakufishme, e zbrazët e bosh, ku rrotullohen yje e planete të panumërta.

Prandaj ne themi se domethënia e ringjalljes së Krishtit është kjo: dishepujt e kishin humbur e ishin tronditur pas martirizimit të Krishtit. Realiteti i Krishtit, domethënë mësimet e Tij, bujaria e Tij, përsosuritë e Tij dhe fuqia shpirtërore e Tij, u fsheh e u mbulua për dy ose tri ditë pas martirizimit të Tij dhe nuk ishte i ndritshëm e i dukshëm. Madje kishte humbur, sepse besimtarët ishin të paktë në numër dhe të brengosur e të

tronditur. Kauza e Krishtit ishte si një trup pa jetë; dhe kur pas tre ditësh dishepujt u bënë të sigurt e të patundur, dhe filluan t'i shërbenin Kauzës së Krishtit, dhe vendosën të përhapin mësimet hyjnore, duke vënë në praktikë këshillat e Tij e duke u ngritur për t'i shërbyer Atij, Realiteti i Krishtit u bë i ndritshëm e u shfaq bujaria e Tij; feja e Tij mori jetë; mësimet dhe këshillat e Tij u bënë të qarta e të dukshme. Me fjalë të tjera, Kauza e Krishtit ishte si një trup pa jetë, derisa jeta dhe dhuntia e Shpirtit të Shenjtë e rrethuan atë.

Ky është kuptimi i ringjalljes së Krishtit dhe kjo ishte një ringjallje e vërtetë. Por duke qenë se kleri nuk i kuptoi as logjikën e Ungjillit as simbolet e tij, është thënë se feja është në kundërshtim me shkencën dhe se shkenca i kundërvihet fesë, si për shembull në çështjen e ngjites së Krishtit me një trup të përbërë prej elementesh në qiellin e dukshëm, që është në kundërshtim me shkencat matematike. Por, kur e vërteta e kësaj çështjeje bëhet e qartë dhe simboli shpjegohet, shkenca kurrsesi nuk është në kundërshtim me këtë; madje, në të kundërtën, shkenca dhe arsyeja e konfirmojnë atë.

24

ZBRITJA E SHPIRTIT TË SHENJTË MBI APOSTUJT

Pyetje.—Cila është mënyra dhe cila është domethënia e zbritjes së Shpirtit të Shenjtë mbi Apostujt, siç përshkruhet në Ungjill?

Përgjigje.—Zbritja e Shpirtit të Shenjtë nuk është si hyrja e ajrit tek njeriu; ajo është një shprehje e një përngjasim, sesa një imazh i saktë apo fjalë për fjalë. Jo, më tepër i përngjet reflektimit të imazhit të diellit në pasqyrë—domethënë se shkëlqimi i tij bëhet i dukshëm në të.

Pas vdekjes së Krishtit dishepujt ishin të tronditur dhe idetë e mendimet e tyre nuk përputheshin e ishin në kundërshtim; më pas ata u bënë të qëndrueshëm e të bashkuar dhe në festën e Rrëshajëve ata u mblodhën së bashku dhe u shkëputën nga gjërat e kësaj bote. Pa menduar për vete, ata hoqën dorë nga rehatia e nga lumturia tokësore, duke bërë fli trupin dhe shpirtin për të Shumëdashurin, duke braktisur

shtëpitë dhe duke u bërë endacakë e të pastrehë, duke harruar madje edhe vetë ekzistencën e tyre. Pastaj ata patën ndihmën e Perëndisë dhe u shfaq fuqia e Shpirtit të Shenjtë; fryma shpirtërore e Krishtit triumfoi dhe mbretëroi dashuria e Perëndisë. Ata patën ndihmë në atë kohë dhe u shpërndanë në drejtime të ndryshme, duke shpjeguar Kauzën e Perëndisë dhe duke dhënë prova e dëshmi.

Pra, zbritja e Shpirtit të Shenjtë mbi Apostujt do të thotë tërheqje e tyre nga Shpirti i Krishtit, duke fituar qëndrueshmëri e vendosmëri. Përmes shpirtit të dashurisë së Perëndisë ata fituan një jetë të re, dhe ata e panë Krishtin të gjallë, që i ndihmonte e i mbronte ata. Ata ishin si pika e u bënë dete; ishin si insekte të dobëta e u bënë shqipë madhështore; ishin të dobët e u bënë të fuqishëm. Ata ishin si pasqyra përballë diellit; e me të vërtetë një pjesë e dritës u manifestua tek ata.

25

SHPIRTI I SHENJTË

Pyetje.—Çfarë është Shpirti i Shenjtë?

Përgjigje.—Shpirti i Shenjtë është Dhuntia e Perëndisë dhe rrezet e ndritshme që përhapen nga Manifestimet; sepse vatra e rrezeve të Diellit të Realitetit ishte Krishti dhe nga kjo vatër e lavdishme, që është Realiteti i Krishtit, dhuntia e Perëndisë, u reflektua mbi pasqyrat e tjera, që ishin realiteti i Apostujve. Zbritja e Shpirtit të Shenjtë mbi apostujt do të thotë se dhuntitë e lavdishme hyjnore u reflektuan e u shfaqën në realitetin e tyre. Për më tepër, hyrja dhe dalja, zbritja dhe ngjitja janë karakteristika të trupave e jo të shpirtave—domethënë se realitetet shqisore hyjnë e dalin, kurse aftësitë e realitetet mendore, si inteligjenca, dashuria, dija, imagjinata e mendimi, nuk hyjnë, as dalin, as zbresin, por më tepër janë në lidhje të drejtpërdrejtë me qenien.

Për shembull, dija, e cila është një gjendje e fituar nga inteligjenca, është një gjendje intelektuale; dhe hyrja e dalja nga mendja janë kushte imagjinare; por mendja është e lidhur me të fituarit e dijes, si figura që reflektohen në pasqyrë.

Është pra e qartë që realitetet intelektuale nuk hyjnë e nuk zbresin, dhe është absolutisht e pamundur që Shpirti i Shenjtë të ngjitet e të zbresë, të hyjë, të dalë ose të depërtojë, mund të ndodhë vetëm që Shpirti i Shenjtë të shfaqet me shkëlqim, siç shfaqet dielli në pasqyrë.

Në disa pasazhe të Librave të Shenjtë, flitet për Shpirtin si për ndonjë person të caktuar, siç thuhet zakonisht duke folur e biseduar se një person është një shpirt i trupëzuar, ose se ai është personifikim i mëshirës e i zemërgjerësisë. Në këtë rast, ne shohim dritën e jo qelqin.

Në Ungjillin e Gjonit, kur flitet për të Premtuarin Që do të vinte pas Krishtit, në kreun 16, vargjet 12, 13 thuhet: “Kam ende shumë gjëra për t’ju thënë, por tani nuk i mbani dot. Por kur të vijë Ai, Shpirti i së Vërtetës, do t’ju udhëheqë që të njihni gjithë të vërtetën: sepse Ai nuk do të flasë nga Vetja; por do t’ju thotë gjërat që ka dëgjuar”.

Shikoni tani me vëmendje se nga fjalët “sepse Ai nuk do të flasë nga Vetja, por do t’ju thotë gjërat që ka dëgjuar” del qartë se Shpirti i së vërtetës është trupëzuar në një Njeri Që ka individualitet, Që ka veshë për të dëgjuar e gjuhë për të folur. Po kështu emri “Shpirti i Perëndisë” përdoret lidhur me Krishtin, ashtu si ju flisni për një dritë, duke nënkuptuar edhe dritën edhe llambën.

26

ARDHJA E DYTË E KRISHTIT DHE DITA E GJYQIT

Në Librat e Shenjtë thuhet se Krishti do të vijë përsëri dhe se ardhja e Tij varet nga përmbushja e disa shenjave: kur Ai të vijë, do të shoqërohet nga këto shenja. Për shembull, “Dielli do të errësohet, dhe hëna nuk do të japë dritën e saj, dhe yjet do të bien nga qielli....Dhe atëherë do të shfaqet në qiell shenja e Birit të njeriut: dhe atëherë të gjitha fiset e tokës do të vajtojnë dhe do të shohin Birin e njeriut duke ardhur mbi retë e qiellit me pushtet e me lavdi të madhe”.¹⁰⁰ Bahá'u'lláh-u i ka shpjeguar këto vargje në Qitapi Ikan [Kitáb-i-

¹⁰⁰ Shih Mateu 24:29-30.

Iqán].¹⁰¹ Nuk është nevoja t'i përsërisim; referojuni atyre dhe do t'i kuptoni këto thënie.

Por unë kam diçka për të shtuar lidhur me këtë çështje. Edhe në ardhjen e Tij të parë, Krishti erdhi nga qielli, siç thuhet shprehimisht në Ungjill. Vetë Krishti thotë: “Dhe askush nuk është ngjitur në qiell, veç atij që ka zbritur nga qielli, domethënë të Birit të Njeriut që është në qiell”.¹⁰²

Është e qartë për të gjithë se Krishti erdhi nga qielli, megjithëse në dukje ai doli nga mitra e Maries. Në ardhjen e parë, Ai erdhi nga qielli, edhe pse në dukje doli nga mitra; po kështu edhe në ardhjen e Tij të dytë Ai do të vijë nga qielli, edhe pse në dukje do të dalë nga mitra. Kushtet që tregohen në Ungjill për ardhjen e dytë të Krishtit janë të njëllojta si ato që u përmendën për ardhjen e parë, siç thamë më sipër.

Libri i Isaisë shpall se Mesia do të pushtojë Lindjen e Perëndimin dhe të gjitha kombet e botës do të hyjnë nën hijen e Tij, se do të vendoset Mbretëria e Tij, se Ai do të vijë nga një vend i panjohur, se mëkatarët do të gjykohen dhe se drejtësia do të mbizotërojë në një shkallë të tillë sa ujku dhe qengji, leopardi dhe keci, foshnja e gjirit dhe nepërka do të mblidhen tek i njëjti burim, e në të njëjtin livadh, e në të njëjtin banesë.¹⁰³ Ardhja e parë u krye gjithashtu në këto rrethana, megjithëse në pamje të jashtme asnjëra prej tyre nuk ndodhi. Prandaj hebrejët e hodhën poshtë Krishtin dhe, mos e dhëntë Zoti! e quajtën Mesian masikh,¹⁰⁴ e konsideronin Atë shkatërrues të godinës së Perëndisë, e shihnin si shkelës të Sabbathit e të ligjit dhe e dënuan me vdekje. Megjithatë, secili prej këtyre kushteve kishte një domethënie që hebrejtë nuk e kuptonin; prandaj ata u privuan nga të kuptuarit e së vërtetës së Krishtit.

¹⁰¹ Qitapi Ikan, një nga veprat e para të Bahá'u'lláh-ut, e shkruar në Bagdad para deklarimit të manifestimit të Tij.

¹⁰² Gjoni 3:13.

¹⁰³ Në këto biseda, siç mund ta ketë vënë re lexuesi, ‘Abdu'l-Bahá-i më tepër kërkon të tregojë domethënien e disa pasazheve të Shkrimeve të Shenjta sesa të citojë tekstin e saktë.

¹⁰⁴ Masikh, domethënë përbindëshi. Në arabisht ka një lojë fjalësh me fjalët *Masih*, Mesia, dhe masikh, përbindëshi.

Ardhja e dytë e Krishtit do të bëhet gjithashtu në mënyrë të ngjashme: shenjat e kushtet, për të cilat është folur, të gjitha kanë kuptime dhe nuk duhen marrë fjalë për fjalë. Ndër të tjera thuhet se yjet do të bien në tokë. Yjet janë të pafundmë e të panumërt dhe matematikanët e sotëm kanë zbuluar e provuar shkencërisht se globi i diellit çmohet të jetë një milion e gjysmë herë më i madh se toka, dhe secili prej yjeve të palëvizshme është një mijë herë më i madh se dielli. Sikur këto yje të binin mbi sipërfaqen e tokës, si do të mund të gjenin vend aty? Do të ishte sikur një mijë milionë male Himalaja të binin mbi një farë sinapi. Sipas logjikës e shkencës, kjo është krejt e pamundur. Madje edhe më e çuditshme është që Krishti thotë: “Ndoshta Unë do të vij kur ju të jeni ende në gjumë, sepse ardhja e Birit të Njeriut është si ardhja e një hajduti”.¹⁰⁵ Ndoshta hajduti do të jetë në shtëpi dhe i zoti i shtëpisë nuk do ta dijë këtë.

Është e qartë e eduket vetiu që këto shenja kanë një domethënie simbolike dhe se nuk duhen marrë fjalë për fjalë. Ato janë shpjeguar plotësisht në Qitapi Ikan. Referojuni atij.

27

TRINIA

Pyetje.—Cila është domethënia e Trinisë së tre Personave në Një?

Përgjigje.—Realiteti hyjnor, i dëlirur e i spastruar nga të kuptuarit e genieve njerëzore dhe që kurrë nuk mund të përfytyrohet nga njerëzit e mençur e inteligjentë, qëndron jashtë çdo konceptimi. Ky Realitet i Zotit nuk pranon asnjë ndarje; sepse ndarja e shumësia përbëjnë veti të krijesave që janë ekzistenca të rastësishme, e jo rastësi që i ndodhin të vetëqenëshmit

Realiteti Hyjnor është i spastruar nga veçanësia, e pra aq më tepër nga shumësia. Ulja e atij Realiteti Hyjnor në kushte e shkallë të ndryshme do të ishte baras me papërsosurinë e në kundërshtim me

¹⁰⁵ Shih Letra e parë drejtuar selanikasve 5:2; Letra e dytë e Pjetrit 3:10.

përsosurinë dhe, prandaj, është absolutisht e pamundur. Ky realitet gjithmonë ka qenë, dhe është, i lartësuar në shenjtëri e adhurim. Të gjitha ato që thuhet për Manifestimet dhe Vendagimet e Perëndisë janë një reflektim hyjnor e jo një ulje në kushtet e ekzistencës.¹⁰⁶

Perëndia është përsosuri e kulluar dhe krijesat s'janë veçse papërsosuri. Për Perëndinë ulja në kushtet e ekzistencës do të ishte papërsosuria më e madhe; përkundrazi, manifestimi i Tij, shfaqja e Tij, ngritja e Tij janë si reflektimi i diellit në një pasqyrë të pastër, të kulluar, të lëmuar. Të gjitha krijesat janë shenja të qarta të Perëndisë, si të gjitha qeniet tokësore mbi të cilat ndritin rrezet e diellit. Por mbi fushat, malet, drurët e frytet ndriçon vetëm një sasi drite, përmes së cilës ato bëhen të dukshme, rriten dhe arrijnë qëllimin e ekzistencës së tyre, ndërsa Njeriu i Përsosur¹⁰⁷ është si një pasqyrë e pastër, në të cilën Dielli i Realitetit bëhet i dukshëm e manifestohet me të gjitha cilësitë e përsosuritë e veta. Kështu, Realiteti i Krishtit ishte një pasqyrë e qartë dhe e lëmuar që kishte pastërtinë e hijeshinë më të madhe. Dielli i Realitetit, Thelbi i Hyjnisë reflektoheshin në këtë pasqyrë dhe manifestonin dritën e ngrohtësinë e tyre në të; por nga lartësia e shenjtërisë së tij dhe nga qielli i adhurimit të tij, Dielli nuk zbriti për të ndenjur e për të banuar në pasqyrë. Jo, ai vazhdon të jetojë në epërsinë e në pozitën e vet sublime, ndërkohë që duket e manifestohet në pasqyrë me bukuri e përsosuri.

Tani, po të themi se e kemi parë Diellin në dy pasqyra—njëra Krishti dhe tjetra Shpirti i Shenjtë,—domethënë se kemi parë tre Diej, njërin në qiell dhe dy të tjerët në tokë, ne themi të vërtetën. Dhe po të themi se ka një Diell, se ai është veçanësi e kulluar dhe nuk ka shok e të barabartë, përsëri themi të vërtetën.

Në mënyrë të përmbledhur, Realiteti i Krishtit ishte një pasqyrë e kulluar dhe Dielli i Realitetit—domethënë Thelbi i Njëshmërisë, me përsosuritë e atributet e veta të pafundme—bëhet i dukshëm në pasqyrë. Kuptimi nuk është që Dielli, i cili është Thelbi i Hyjnisë, u nda e u shumua—sepse Dielli është një,—por u shfaq në pasqyrë. Ja përse

¹⁰⁶ Shih “Panteizmi”, f.290.

¹⁰⁷ Manifestimi Hyjnor.

Krishti tha “Ati është në Birin”, duke dashur të thotë se dielli është i dukshëm e manifestohet në këtë pasqyrë.

Shpirti i Shenjtë është Dhuntia e Perëndisë që bëhet e dukshme e shihet qartë në Realitetin e Krishtit. Pozita e të qenit Bir është zemra e Krishtit dhe Shpirti i Shenjtë është pozita e shpirtit të Krishtit. Kështu vërtetohet e provohet se Thelbi i Hyjnisë është absolutisht i vetëm dhe nuk ka të barabartë, as të ngjashëm, as të barasvlefshëm me Të.

Kjo është domethënia e Tre Personave të Trinisë. Po të ishte ndryshe, themeli i fesë së Perëndisë do të mbështetej mbi një skemë jologjike, që mendja kurrë nuk mund ta konceptojë; dhe si mund të detyrohet mendja të besojë një gjë që nuk e koncepton dot? Një gjë mund të kapet nga inteligjenca vetëm kur është e veshur në një formë të kuptueshme; përndryshe s’është veçse një përpjekje e imagjinatës.

Pas këtij shpjegimi është bërë e qartë domethënia e Tre Personave të Trinisë. Është provuar gjithashtu Njëshmëria e Perëndisë.

28

SHPJEGIM I VARGUT PESË, KREU SHTATËMBËDHJETË, TË UNGJILLIT TË SHËN GJONIT

“Dhe tani, O Atë, përlëvdomë faqe vetes Tënde, me atë lavdi që kisha pranë Teje para se të ishte bota!”¹⁰⁸

Ka dy lloje përparësish: njëra është thelbësore dhe nuk paraprihet nga asnjë shkak, por ekziston në vetvete, ashtu si, për shembull, dielli ka dritë në vetvete, sepse ndriçimi i tij nuk varet nga drita e yjeve të tjera. Kjo quhet dritë thelbësore. Por drita e hënës merret nga dielli, sepse hëna varet nga dielli për dritën e saj; pra, dielli, përsa i përket dritës, është shkaku dhe hëna bëhet rrjedhoja. I pari është i lashti, paraardhësi, paraprijësi, ndërsa e dyta është pasardhësja dhe e fundit.

¹⁰⁸ Gjoni 17:5.

Lloji i dytë i paraqenies është paraqenia në kohë dhe ajo nuk ka fillim. Fjala e Perëndisë¹⁰⁹ është e lirë nga koha. E shkuara, e tashmja, e ardhmja, të gjitha, në krahasim me Perëndinë janë njësoj. Dje, sot, nesër nuk ekzistojnë në diell.

Po kështu ka një përparësi lidhur me lavdinë—domethënë më i lavdishmi vjen para të lavdishmit. Pra, Realiteti i Krishtit, i Cili është Fjala e Perëndisë, përse i përket thelbit, attributeve e lavdisë, me siguri vjen para krijesave. Para se të shfaqej në formën njerëzore, Fjala e Perëndisë ishte në shenjtërinë e lavdinë më të madhe, duke ekzistuar me bukuri e shkëlqim të përsosur në lartësinë e madhësisë së vet. Kur falë urtisë së Perëndisë, Më të Lartit, ajo shkëlqeu nga majat e lavdisë në botën e trupit, Fjala e Perëndisë, përmes këtij trupi, u shtyp, kështu që ra në duart e hebrenjve dhe u bë rob i tiranëve e i injorantëve, dhe më në fund u kryqëzua. Ja përse Ai iu drejtua Perëndisë duke thënë: “Më çliro nga zinxhirët e botës së trupit e më lësho nga ky kafaz, që të ngjitem në majat e nderit e të lavdisë dhe të arrij madhësitinë e fuqinë e mëparshme, që ekzistonte para botës trupore, që të gëzohem në botën e përjetshme dhe të ngjitem në banesën e hershme, në botën e pafundësisë, në mbretërinë e padukshme”.

E kështu ju shihni edhe në mbretërinë e kësaj bote—domethënë në mbretërinë e njerëzve e të vendeve—që lavdia dhe madhështia e Krishtit u shfaq në tokë pas ngjitjes së Tij në qiell. Kur ndodhej në botën e trupit, Ai iu nënshtrua përbuzjes e talljeve të kombit më të dobët të botës, hebrenjve, që e gjykuan të përshtatshme të vendosnin një kurorë gjembash mbi kokën e Tij të shenjtë. Por pas ngjitjes së Tij në qiell, kurorat e stolitura me gurë të çmuar të të gjithë mbretërve u poshtëruan e u përulën para kurorës së gjembave.

Shihni lavdinë që arriti Fjala e Perëndisë madje edhe në këtë botë!

29

SHPJEGIM I VARGUT NJËZET E DY, KREU PESËMBËDHJETË, TË LETRËS

¹⁰⁹ dmth Realiteti i Krishtit.

SË PARË TË SHËN PAVLIT DREJTUAR KORINTASVE

Pyetje.—Në vargun 22 të kreut 15 të Letrës së parë drejtuar korintasve shkruhet: “Sepse ashtu si në Adamin të gjithë vdesin, po kështu në Krishtin të gjithë do të rifitojnë jetën”. Cili është kuptimi i këtyre fjalëve?

Përgjigje.—Dije se te njeriu ka dy natyra: natyra fizike dhe natyra shpirtërore. Natyra fizike është trashëguar nga Adami, kurse natyra shpirtërore është trashëguar nga Realiteti i Fjalës së Perëndisë, që është fryma shpirtërore e Krishtit. Natyra fizike ka lindur nga Adami, ndërsa natyra shpirtërore ka lindur nga dhuntia e Shpirtit të Shenjtë. E para është burimi i të gjitha përsosurive; e dyta është burimi i të gjitha përsosurive.

Krishti flijoi Vetën e Tij që njerëzit të mund të çliroheshin nga papërsosuritë e natyrës fizike dhe të mund të zotëronin virtytet e natyrës shpirtërore. Kjo natyrë shpirtërore, që lindi falë dhuntisë së Realitetit Hyjnor, është bashkimi i të gjitha përsosurive dhe shfaqet përmes flladit të Shpirtit të Shenjtë. Ajo do të thotë përsosuri hyjnore; dritë, shpirtësi, udhërrëfim, aspirata të larta, drejtësi, dashuri, hir, dashamirësi për të gjithë, bamirësi dhe është thelbi i jetës. Ajo është refleksi i shkëlqimit të Diellit të Realitetit.

Krishti është pika qendrore e Shpirtit të Shenjtë: Ai lindi nga Shpirti i Shenjtë; Ai u rrit prej Shpirtit të Shenjtë; Ai e ka prejardhjen nga Shpirti i Shenjtë—që do të thotë se Realiteti i Krishtit nuk vjen nga Adami; jo, ai lindi nga Shpirti i Shenjtë. Pra, ky varg i Letrës drejtuar korintasve: “Ashtu si në Adamin të gjithë vdesin, po kështu në Krishtin të gjithë do të rifitojnë jetën”, sipas kësaj terminologjie do të thotë se Adami është ati i njeriut,¹¹⁰—domethënë ai është burimi i jetës fizike të njerëzimit; atësia e Tij ishte atësia fizike. Ai është një shpirt i gjallë, por Ai nuk është dhënësi i jetës shpirtërore, ndërsa Krishti është burimi i jetës shpirtërore të njeriut, dhe përsa i përket shpirtit, atësia e Tij ishte

¹¹⁰ Abu'l-bashar, dmth ati i njeriut, është një prej titujve që i kanë dhënë Adamit muslimanët.

atësi shpirtërore. Adami është një shpirt i gjallë; Krishti është një shpirt gjallërues.

Kjo botë fizike e njeriut i nënshtrohet fuqisë së epsheve, dhe mëkati është pasoja e kësaj fuqie të epsheve, e cila nuk u nënshtrohet ligjeve të drejtësisë e të shenjtërisë. Trupi i njeriut është rob i natyrës; ai vepron në përshtatje me çdo gjë që i urdhëron natyra. Është, pra, e sigurt se mëkate të tilla si zemërimi, xhelozia, grindjet, zilia, kopracia, injoranca, paragjykimi, urrejtja, kryelartësia dhe tirania ekzistojnë në botën fizike. Të gjitha këto veti brutale ekzistojnë në natyrën e njeriut. Një njeri që nuk ka marrë edukim shpirtëror është kafshë. Ashtu si njerëzit e egër të Afrikës, veprimet, zakonet dhe morali i të cilëve janë krejt shqisore, ata veprojnë sipas kërkesave të natyrës deri në një shkallë të tillë saqë shqyejnë e hanë njëri-tjetrin. Është, pra, e qartë se bota fizike e njeriut është bota e mëkatit. Në këtë botë fizike njeriu nuk dallohet nga kafsha.

Çdo mëkat vjen nga kërkesat e natyrës, dhe këto kërkesa që rrjedhin nga vetitë fizike nuk janë mëkate përsa u përket kafshëve, ndërsa për njeriun ato janë mëkat. Kafsha është burimi i papërsosurive, si egërsia, epshi, xhelozia, kopracia, mizoria, kryelartësia: të gjitha këto të meta gjenden te kafshët, por nuk përbëjnë mëkate. Kurse te njeriu ato janë mëkate.

Adami është burimi i jetës fizike të njeriut; por Realiteti i Krishtit—domethënë Fjala e Perëndisë—është burimi i jetës shpirtërore. Ai është “një shpirt gjallërues”, gjë që do të thotë se të gjitha papërsosuritë që vijnë nga kërkesat e jetës fizike të njeriut shndërrohen në përsosuri njerëzore me anë të mësimave e të edukimit të atij shpirti. Krishti ishte, pra, një shpirt gjallërues dhe burimi i jetës për gjithë njerëzimit.

Adami ishte burimi i jetës fizike e, duke qenë se bota fizike e njeriut është bota e papërsosurive, dhe papërsosuritë janë baras me vdekjen, Pavli i krahasoi papërsosuritë fizike me vdekjen.

Por masa e të krishterëve besojnë se, meqë Adami hëngri nga pema e ndaluar, Ai mëkatoi sepse nuk u bind dhe se pasojat rrënuese të kësaj mosbindjeje janë transmetuar si një trashëgimi dhe kanë mbetur midis pasardhësve të Tij. Kështu pra, Adami u bë shkaku i vdekjes së njerëzimit. Ky shpjegim është i paarsyeshëm dhe duket qartë që është i gabuar, sepse sipas tij të gjithë njerëzit, madje edhe Profetët e

Lajmëtarët e Perëndisë, pa bërë ndonjë mëkat ose faj, por thjesht sepse janë pasardhës të Adamit u bënë pa asnjë shkak mëkatarë fajtorë, dhe deri në ditën e flijimit të Krishtit ishin mbajtur të burgosur në ferr në kushte vuajtjesh të dhimbshme. Kjo është larg drejtësisë së Perëndisë. Në rast se Adami ishte mëkatar, ç'mëkat ka bërë Abrahami? Cili ishte fjaji i Isakut ose i Josifit? Për çfarë ishte fajtor Moisiu?

Por Krishti, Që është Fjala e Perëndisë, e bëri fli Vetën e Tij. Kjo ka dy domethënie, një domethënie të dukshme dhe një të fshehtë. Domethënia e jashtme është kjo: qëllimi i Krishtit ishte të paraqiste e të përhapte një Kauzë që do të edukonte botën njerëzore, do të gjallëronte bijtë e Adamit dhe do të ndriçonte gjithë njerëzimin; dhe meqë paraqitja e një Kauze kaq të madhe—një Kauzë që ishte në kundërshtim me të gjithë njerëzit e botës dhe me të gjitha kombet e mbretëritë—kërkonte që Ai të vritej e të kryqëzohej, Krishti duke shpallur misionit e Tij flijoi jetën e Vet. Ai e shihte kryqin si një fron, plagën si balsam, helmin si mjaltë e sheqer. Ai doli për t'i mësuar dhe edukuar njerëzit, duke sakrifikuar kështu Vetveten për të dhënë shpirtin e jetës. Ai vdiq në trup që të gjallëronte të tjerët në shpirt. Domethënia e dytë e flijimit është kjo: Krishti ishte si një farë, dhe kjo farë bëri fli formën e vet në mënyrë që pema të mund të rritej e të zhvillohej. Megjithëse forma e farës u shkatërrua, realiteti i saj u bë i dukshëm me madhështi e bukuri të përkryer në formën e një peme.

Pozita e Krishtit ishte ajo e përsosurisë absolute; ai bëri që përsosuritë e tij hyjnore të shkëlqenin si dielli mbi të gjithë shpirttrat që besonin, dhe dhuntitë e dritës shkëlqyen e rrezatuan në realitetin e njerëzve. Ja përse ai thotë: “Unë jam buka që zbriti nga qielli; kush do të hajë nga kjo bukë do të jetojë përgjithmonë”¹¹¹—që do të thotë se cilido që do të provojë këtë ushqim hyjnor do të fitojë jetën e pasosur: domethënë që kush merr nga kjo dhunti e pajiset me këto përsosuri do të gjejë jetën e pasosur, do të fitojë favore të përjetshme, do të çlirohet nga errësira e gabimit dhe do të ndriçohet nga drita e udhëheqjes së Tij.

Forma e farës u flijua për pemën, por përsosuritë e saj, për shkak të kësaj flije, u bënë të qarta e të dukshme—duke qenë se pema, degët, gjethet dhe sythet ishin të fshehura në farën. Kur forma e farës u bë fli,

¹¹¹ Shih Gjoni 6:41, 50, 58.

përsosuritë e saj u shfaqën në formën e përkryer të gjetheve, të sytheve e të fryteve.

30

ADAMI DHE EVA

Pyetje.—Cila është e vërteta lidhur me historinë e Adamit dhe me ngrënien e frytit nga pema prej Tij?

Përgjigje.—Në Bibël shkruhet se Perëndia e vendosi Adamin në kopshtin e Edenit, që ta punonte e të kujdesej për të, dhe i tha: “Ha nga çdo pemë e kopshtit përveç pemës së të mirës e së keqes, sepse po hëngre prej saj do të vdesësh”.¹¹² Pastaj thuhet se Perëndia e vuri në gjumë Adamin dhe mori një prej brinjëve të Tij dhe krijoi gruan që ajo të ishte shoqja e Tij. Pas kësaj thuhet se gjarpri e tundoj gruan që të hante frytin e pemës, duke thënë “Perëndia ta ka ndaluar të hash nga kjo pemë, në mënyrë që të mos të hapen sytë dhe të mos dallosh të mirën nga e keqja”.¹¹³ Pastaj Eva hëngri nga pema e i dha edhe Adamit, i Cili hëngri gjithashtu; sytë e tyre u hapën, ata panë se ishin lakuriq dhe i mbuluan disa pjesë të trupit me gjethe. Për shkak të këtij veprimi, Perëndia i qortoi ata. Perëndia i tha Adamit: “A hëngre nga pema e ndaluar?” Adami u përgjigj. “Eva më tundoj dhe Unë hëngra”. Atëherë Perëndia qortoi Evën; Eva tha: “Gjarpri më tundoj dhe Unë hëngra”. Për këtë gjarpri u mallkua dhe u krijua armiqësi midis gjarprit e Evës, si dhe midis pasardhësve të tyre. Dhe Perëndia tha: “Njeriu u bë i ngjashëm me Ne, duke njohur të mirën e të keqen, dhe ndoshta do të hajë nga pema e jetës dhe do të jetojë përgjithmonë”. Kështu Zoti e ruajti pemën e jetës.¹¹⁴

Po ta marrim këtë ngjarje në kuptimin e dukshëm, sipas intepretimt popullore, ajo është me të vërtetë e jashtëzakonshme. Logjika nuk mund ta pranojë atë, as ta afirmojë ose ta përfytyrojë, sepse masa të tilla,

¹¹² Shih Zanafilla 2:16-17.

¹¹³ Shih Zanafilla 3:5.

¹¹⁴ Shih Zanafilla 3:11-15, 22.

hollësi të tilla, fjalë e qortime të tilla janë larg atyre të një njeriu të arsyeshëm, aq më tepër të Hyjnisë—të asaj Hyjnie Që ka organizuar këtë gjithësi të pafundme në formën më të përkryer dhe banorët e tij të panumërt me rregull, aftësi e përsosuri absolute.

Le të reflektojmë pak: sikur domethënia fjalë për fjalë e kësaj historie t'i atribuohet një njeriu të mençur, me siguri që të gjithë logjikisht do ta mohonin që ky veprim, kjo shpikje të mund të ketë ardhur nga një qenie e arsyeshme. Prandaj kjo histori e Adamit dhe Evës që hëngrën nga pema dhe e dëbimit të tyre nga Parajsa duhet parë thjesht si një simbol. Ajo përmban mistere hyjnore e domethënie universale dhe ka vetinë e shpjegimeve të mrekullueshme. Vetëm ata që marrin vesh nga misteret dhe ata që qëndrojnë pranë Oborrit të Fuqplotit janë në dijeni të këtyre sekreteve. Këto vargje të Biblës kanë, pra, shumë domethënie.

Ne do të shpjegojmë njërën prej tyre dhe do të themi: Adami ka kuptimin e frymës qiellore të Adamit dhe Eva atë të shpirtit të Tij njerëzor. Sepse në disa pasazhe të këtyre Librave të Shenjtë ku përmenden gratë, ato përfaqësojnë shpirtin e njeriut. Pema e së mirës dhe e së keqes do të thotë bota njerëzore; sepse bota shpirtërore e hyjnore është krejt e mirë dhe absolutisht e ndritshme, por në botën njerëzore drita dhe errësira, e mira dhe e keqja ekzistojnë si gjendje të kundërta.

Kuptimi i gjarprit është lidhja me botën njerëzore. Kjo lidhje e shpirtit me botën njerëzore e çoi shpirtin dhe frymën e Adamit nga bota e lirisë në botën e robërisë dhe u bë shkak që Ai të kthejë nga bota e Mbretërisë së Unitetit në botën njerëzore. Kur shpirti dhe fryma e Adamit hynë në botën njerëzore, Ai doli nga parajsa e lirisë dhe ra në botën e robërisë. Nga majat e dëlirësisë e të mirësisë absolute, ai hyri në botën e së mirës e të së keqes.

Pema e jetës është shkalla më e lartë e botës së ekzistencës: është pozita e Fjalës së Perëndisë dhe e Manifestimit suprem. Pra, kjo pozitë u ruajt; dhe me shfaqjen e Manifestimit më fisnik e suprem, u bë e dukshme dhe e qartë. Sepse pozita e Adamit, kundrejt shfaqjes e manifestimit të përsosurive hyjnore, ishte në gjendje embrionale; pozita

e Krishtit ishte gjendja e pjekurisë dhe mosha e arsyes; ndërsa dalja e Yllit Më të Madh¹¹⁵ ishte gjendja e përsosurisë së thelbit e të cilësive. Ja përse në Parajsën supreme pema e jetës është shprehja e kulmit të shenjtërisë absolutisht të kulluar—pra, e Manifestimit hyjnor suprem. Që nga koha e Adamit deri në kohën e Krishtit, u fol pak për jetë të pasosur e për përsosuri qiellore universale. Pema e jetës ishte pozita e Realitetit të Krishtit; nëpërmjet manifestimit të Tij ajo u mboll e u stolis me fryte të pavdekshme.

Shihni tani sesa kjo domethënie përputhet me realitetin. Sepse fryma dhe shpirti i Adamit, kur ato u lidhën pas botës njerëzore, kaluan nga bota e lirisë në botën e robërisë dhe pasardhësit e Tij vazhduan në robëri. Kjo lidhje e shpirtit dhe e frymës pas botës njerëzore, që është mëkat, u trashëguua nga pasardhësit e Adamit; ajo është gjarpri, që ndodhet gjithnjë midis tyre dhe është në armiqësi me shpirtrat e me pasardhësit e Adamit. Kjo armiqësi vazhdon e mbetet. Sepse lidhja pas botës ka çuar në robërinë e shpirtërave, dhe kjo robëri është njëlloj me mëkatën, i cili u përçua nga Adami te pasardhësit e Tij. Për shkak të kësaj lidhjeje, njerëzve u është hequr shpirtësia thelbësore e pozita e tyre e lartësuar.

Kur flladet e shenjtëruara të Krishtit dhe drita e shenjtë e Yllit Më të Madh¹¹⁶ u përhapën gjerësisht, realitetet njerëzore—domethënë ata që u kthyen drejt Fjalës së Perëndisë dhe morën begatinë e dhuntive të Tij—shpëtuan nga kjo lidhje e mëkat, fituan jetë të pasosur, u çliruan nga zinxhirët e robërisë dhe arritën botën e lirisë. Ata u çliruan nga veset e botës njerëzore dhe u bekuan me virtytet e Mbretërisë. Kjo është domethënia e fjalëve të Krishtit “Unë dhashë gjakun Tim për jetën e botës”¹¹⁷—që do të thotë: Unë zgjodha gjithë këto mundime, vuajtje e fatkeqësi, madje edhe martirizimin më të madh, për të arritur këtë objektiv, larjen e mëkateve (domethënë shkëputjen e shpirtërave nga bota njerëzore dhe tërheqjen e tyre në botën hyjnore), në mënyrë që të dalin shpirtra, të cilët do të jenë vetë thelbi i udhëheqjes së njerëzimit dhe manifestimet e përsosurive të Mbretërisë Supreme.

¹¹⁵ Bahá’u’lláh-u.

¹¹⁶ Bahá’u’lláh-u.

¹¹⁷ Shih Gjoni 6:51.

Vëreni se sikur, sipas supozimeve të Njerëzve të Librit,¹¹⁸ domethënia të merrej në kuptimin e saj të thjeshtësuar, kjo do të ishte padrejtësi absolute dhe diçka krejt e paracaktuar. Në qoftë se Adami mëkatoi duke shkuar pranë pemës së ndaluar, cili ishte mëkati i Abrahamit të lavdishëm dhe cili ishte gabimi i Moisiut, Bashkëbiseduesit? Cili ishte krimi i Nojit, Profetit? Cila ishte shkelja e Josifit, të Sinqertit? Cila ishte paudhësia e Profetëve të Perëndisë, dhe cili ishte mëkati i Gjonit, të Virtytshmit? A do të kishte lejuar drejtësia e Perëndisë që, për shkak të mëkatisë të Adamit, këto Manifestime të ndriçuara të pësonin vuajtjet e ferrit, derisa erdhi Krishti dhe, duke bërë fli Vetveten, i shpëtoi ata nga tortura të tmerrshme? Një ide e tillë është tej çdo ligji e rregulli dhe nuk mund të pranohet nga asnjë njeri i arsyeshëm.

Jo, domethënia është ajo që shpjeguem: Adami është fryma e Adamit dhe Eva shpirti i Tij; pema është bota njerëzore dhe gjarpri është lidhja pas kësaj bote që përbën mëkat dhe që ka molepsur pasardhësit e Adamit. Krishti, me flladet e Tij të shenjta, i shpëtoi njerëzit nga kjo lidhje dhe i çliroi ata nga mëkati. Mëkati tek Adami ka të bëjë me pozitën e Tij. Megjithëse nga kjo lidhje vijnë rrjedhoja, megjithatë lidhjet me botën tokësore, në raport me botën shpirtërore, shihen si mëkat. Veprat e mira të njeriut të virtytshëm janë si mëkatet e të Zgjedhurve. Kjo është e vërtetuar. Kështu, fuqia trupore jo vetëm është e metë kundrejt fuqisë shpirtërore; në krahasim me të ajo është dobësi. Në të njëjtën mënyrë, jeta fizike, në krahasim me jetën e pasosur në Mbretërinë konsiderohet si vdekje. Kështu Krishti e quante jetën fizike vdekje dhe tha: “Lërinë të vdekurit të varrosin të vdekurit e tyre”.¹¹⁹ Edhe pse këta shpirta zotëronin jetë fizike, megjithatë në sytë e Tij ajo jetë ishte vdekje.

Kjo është një nga domethëniet e historisë biblike të Adamit. Reflektoni derisa të zbuloni të tjerat.

Ju përshëndes.

¹¹⁸ të hebrenjve e të të krishterëve.

¹¹⁹ Mateu 8:22.

31

SHPJEGIM I BLASFEMISË KUNDËR SHPIRITIT TË SHENJTË

Pyetje.—“Prandaj ju them: çdo lloj mëkati e blasfemie do t’u falen njerëzve, por blasfemia kundër Shpirtit të Shenjtë nuk do t’u falet atyre. Atij që thotë një fjalë kundër Birit të njeriut do t’i falet, por atij që flet kundër Shpirtit të Shenjtë nuk do t’i falet as në këtë botë as në botën e ardhshme”.—(Mateu 12:31-32)

Përgjigje.—Realitetet e shenjta të Manifestimeve të Perëndisë kanë dy pozita shpirtërore. Njëra është vendi i manifestimit, që mund të krahasohet me pozitën e rruzullit të diellit, ndërsa tjetra është shkëlqimi i manifestimit, që është si drita e rrezatimi i tij; këto janë përsosuritë e Perëndisë—me fjalë të tjera, Shpirti i Shenjtë. Sepse Shpirti i Shenjtë është dhunti hyjnore e përsosuri fisnike, dhe këto përsosuri hyjnore janë si rrezet e ngrohtësia e diellit. Rrezet e ndritshme të diellit përbëjnë qenien e tij dhe pa to nuk do të kishte diell. Në qoftë se manifestimi dhe pasqyrimi i përsosurive hyjnore nuk do të ishin te Krishti, Jesui nuk do të ishte Mesia. Ai është një Manifestim, sepse pasqyron në Vetën e Tij përsosuritë hyjnore. Profetët e Perëndisë janë manifestime të përsosurive të madhërishtme—domethënë Shpirti i Shenjtë bëhet i dukshëm tek Ata.

Në qoftë se një shpirt qëndron larg manifestimit, ai edhe mund të zgjohet; sepse ai nuk e njohu manifestimin e përsosurive hyjnore. Por në qoftë se ai urren vetë përsosuritë hyjnore—me fjalë të tjera Shpirtin e Shenjtë,—është e qartë se ai i përngjet një lakuriqi nate që urren dritën.

Kjo përbuzje për dritën nuk ka shërim e nuk mund të falet—domethënë ai e ka të pamundur të afrohet te Perëndia. Kjo llambë është një llambë për shkak të dritës së saj; pa dritën ajo nuk do të ishte llambë. Tani, në qoftë se një shpirt ka neveri për dritën e llambës, është njëlloj sikur ai të ishte i verbër dhe të mos e kuptonte dritën; dhe verbëria është shkaku i mërgimit të përjetshëm nga Perëndia.

Është e qartë që shpirtat marrin hir nga bujaria e Shpirtit të Shenjtë që shfaqet te Manifestimet e Perëndisë, e jo nga personaliteti i Manifestimit. Prandaj, po qe se një shpirt nuk merr hir nga bujaria e Shpirtit të Shenjtë, ai mbetet i zhveshur prej bujarisë hyjnore dhe vetë mërgimi e mban shpirtin larg ndjesës.

Ja përse shumë njerëz që ishin armiq të Manifestimeve dhe që nuk i njihnin Ata, me t' u njohur me Ta u bënë miq të Tyre. Kështu armiqësia ndaj Manifestimit nuk u bë shkak mërgimi të përjetshëm, sepse ata që e bënë këtë ishin armiq të dritëbartësve pa e ditur se Ata ishin dritat xixëlluese të Perëndisë. Ata nuk ishin armiq të dritës dhe, sapo e kuptuan se dritëbartësi ishte vendi i manifestimit të dritës, ata u bënë miq të sinqertë të tij.

Domethënia është kjo: të mbetesh larg nga dritëbartësi nuk do të thotë mërgim i përjetshëm, sepse njeriu mund të zgjohet e të bëhet syhapur; por armiqësia ndaj dritës është shkak mërgimi të përjetshëm dhe kjo nuk ka shërim.

32

SHPJEGIM I VARGUT “SEPSE TË SHUMTË JANË ATA QË THIRREN, POR TË PAKTË ATA QË ZGJIDHEN”

Pyetje.—Në Ungjill Krishti thotë: “të shumtë janë ata që thirren, por të paktë ata që zgjidhen”,¹²⁰ dhe në Kuran shkruhet: “Ai do t’i japë mëshirë të posaçme atij që Ai dëshiron”. Ç’urti ka në këtë?

Përgjigje.—Dijeni se rendi e përsosuria e tërë gjithësisë kërkon që ekzistenca të shfaqet në forma të panumërta. Sepse qeniet ekzistuese nuk mund të mishërohen vetëm në një shkallë, në një gjendje, në një lloj, në një specie e në një klasë; padyshim, ndryshimi në shkallët e dallimi i formave, larmia e llojeve dhe e specieve janë të nevojshme—domethënë shkallët e substancave minerale, bimore, shtazore dhe të

¹²⁰ Mateu 22:14.

njeriut janë të pashmangshme; sepse bota nuk do të mund të rregullohej, stolisej e përsosej vetëm me njeriun. Po kështu, vetëm me kafshët, vetëm me bimët ose vetëm me mineralet, kjo botë nuk do të mund të paraqiste një pamje të bukur, një organizim të saktë dhe një stolisje të hollë. Padyshim, ekzistenca shkëlqen me përsosurinë më të madhe falë shkallëve, gjendjeve, llojeve e klasave të ndryshme.

Për shembull, nëse kjo pemë do të ishte e tëra fryt, përsosuritë bimore nuk do të mund të arriheshin, sepse gjethet, lulet e frytet janë të gjitha të nevojshme që pema të stoliset me bukurinë e përsosurinë më të madhe.

Shihni po kështu trupin e njeriut. Ai duhet të përbëhet prej organesh, pjesësh e gjymtyrësh të ndryshme. Bukuria e përsosuria njerëzore kërkojnë ekzistencën e veshit, të syrit, të trurit, madje edhe të thonjve e të qimeve. Sikur njeriu të ishte vetëm tru, sy ose veshë, ai të ishte i papërsosur. Kështu, mungesa e flokëve, e qerpikëve, e dhëmbëve dhe e thonjve do të ishte një e metë e padyshimtë, megjithëse në krahasim me syrin ata nuk kanë ndjeshmëri dhe në këtë u ngjajnë mineraleve e bimëve; por mungesa e tyre në trupin e njeriut është pa fjalë një cen dhe diçka e pakëndshme.

Duke qenë se shkallët e ekzistencës janë të ndryshme e të larmishme, disa qenie janë në një shkallë më të lartë nga disa të tjera. Pra, është me vullnetin e me dëshirën e Perëndisë që disa krijesa janë zgjedhur për shkallën më të lartë, si njeriu, kurse disa të tjera janë vendosur në shkallën e mesme, si bimët, dhe disa janë lënë në shkallën më të ulët, si minerali.

Është falë bujarisë së Perëndisë që njeriu është zgjedhur për shkallën më të lartë; dhe dallimet që ekzistojnë midis njerzve përsa i përket përparimit shpirtëror e përsosurive qiellore i detyrohen gjithashtu zgjedhjes së bërë nga i Mëshirshmi. Sepse besimi, që është jetë e pasosur, është shenjë e bujarisë e jo rezultat i drejtësisë. Flaka e zjarrit të dashurisë, në këtë botë prej dheu e uji, vjen përmes fuqisë së tërheqjes dhe jo nga përpjekjet e orvatjet. Megjithatë, me përpjekje e këmbëngulje, me dije e shkencë dhe me përsosuri të tjera, kjo mund të fitohet; por vetëm drita e Bukurisë Hyjnore mund të rrëmbejë e vërë në

lëvizje shpirtat përmes forcës së tërheqjes. Prandaj thuhet: “Të shumtë janë ata që thirren, por të paktë ata që zgjidhen”.¹²¹

Por qeniet materiale nuk përbuzen, as gjykohen e mbahen përgjegjëse për shkallën e për gjendjen e tyre. Për shembull, mineralet, bimët dhe kafshët në shkallët e tyre janë të pranueshme; por në qoftë se ato mbeten të papërsosura në vetë shkallën e tyre, janë të qortueshme, duke qenë se shkalla në vetvete është krejt e përsosur.

Ndryshimet në gjirin e njerëzimit janë dy llojesh: njëri është dallimi në pozitën dhe ky dallim nuk është i qortueshëm. Tjetri është dallimi në besimin e në sigurinë; humbja e këtyre është e qortueshme, sepse atëhere shpirti mposhtet nga dëshirat e pasionet e tij, të cilat e zhveshin atë nga këto bekime dhe e pengojnë të ndjejë forcën e tërheqjes së dashurisë për Perëndinë. Megjithëse njeriu është i lavdërueshëm e i pranueshëm në pozitën e tij, por meqë i mungojnë përsosuritë e asaj shkalle, ai do të bëhet burim papërsosurish, për të cilat do të jetë përgjegjës.¹²²

33

“KTHIMI” PËR TË CILIN FLASIN PROFETËT

Pyetje.—A do të na e shpjegoni temën e Kthimit?

Përgjigje.—Bahá'u'lláh-u e ka shpjeguar këtë çështje gjerësisht e qartë në Ikan.¹²³ Lexojeni dhe e vërteta e kësaj teme do të bëhet e qartë. Por meqenëse më pyetët për të, do ta shpjegoj shkurt. Do të fillojmë ta sqarojmë atë nga Ungjilli, sepse atje thuhet qartë se kur Gjoni, i Biri i Zaharisë, doli e u dha njerëzve lajmin e gëzuar të Mbretërisë së Perëndisë, ata e pyetën: “Cili je ti? A je ti Mesia i Premtuar?” Ai u përgjigj: “Nuk jam Mesia”. Atëherë e pyetën: “Mos je Elia?” Ai tha: “Nuk jam”.¹²⁴ Këto fjalë provojnë e tregojnë se Gjoni, i biri i Zaharisë,

¹²¹ Mateu 22:14.

¹²² Shih “Shkaqet e dallimeve në karakteret e njerëzve”, f. 212.

¹²³ Shih f. 110, shën. 2.

¹²⁴ Shih Gjoni 1:19-21.

nuk ishte Elia i premtuar. Por në ditën e transfigurimit në malin Tabor, Krishti e tha qartë se Gjoni, i biri i Zaharisë, ishte Elia i premtuar.

Në kreun 9, vargjet 11-13, të Ungjillit të Markut thuhet: “Dhe e pyetën¹²⁵: “Përse shkruesit thonë që më parë duhet të vijë Elia?” Dhe Ai u përgjigj e tha: “Vërtet Elia vjen më parë dhe vë përsëri çdo gjë në vendin e vet; por përse është shkruar për të Birin e njeriut se duhet të pësojë shumë vuajtje e të përbuzet? Por unë po ju them se Elia me të vërtetë erdhi dhe bënë me të si deshën, siç është shkruar për të”.

Në kreun 17, vargu 13, të Mateut thuhet: “Atëhere dishepujt e kuptuan se Ai u kishte folur për Gjon Pagëzorin”.

Ata e pyetën Gjon Pagëzorin: “A je ti Elia?” Ai u përgjigj: “Jo, nuk jam”, megjithëse në Ungjill thuhet se Gjoni ishte Elia i premtuar, dhe Krishti gjithashtu e tha të qartë që ishte.¹²⁶ Atëherë, në qoftë se Gjoni ishte Elia, përse ai tha: “Nuk jam”? Dhe në qoftë se ai nuk ishte Elia, përse Krishti tha se ishte?

Shpjegimi është ky: Nuk është fjala për personin, por për realitetin e përsosurive—domethënë se të njëjtat përsosuri që ishin tek Elia ekzistonin te Gjon Pagëzori dhe ishin të mishëruara saktë në të. Pra, Gjon Pagëzori ishte Elia i premtuar. Në këtë rast nuk shihet thelbi,¹²⁷ por cilësitë. Për shembull, vitin e kaluar ishte një lule dhe sivjet është gjithashtu një lule; unë them lulja e vitit të kaluar u kthye. Me këtë nuk dua të them se e njëjta lule me individualitetin e saj të saktë është kthyer prapë; por me qenë se kjo lule ka të njëjtat cilësi të asaj të vitit të kaluar—meqë ka të njëjtën aromë, bukuri, ngjyrë e formë—unë them se lulja e vitit të kaluar është kthyer dhe se kjo lule është lulja e mëparshme. Kur vjen pranvera, ne themi se pranvera e vitit të kaluar është kthyer përsëri, sepse çdo gjë që ishte pranverën e vitit të kaluar është edhe këtë pranverë. Ja përse Krishti tha: “Ju do të shihni çdo gjë që ka ndodhur në ditët e profetëve të mëparshëm”.

Do të japim një ilustrim tjetër. Fara e vitit të kaluar mbillet, degët e gjethet rriten, dalin lulet e frytet dhe gjithçka kthehet përsëri te fara. Kur kjo farë e dytë të mbillet, një pemë do të dalë prej saj, kështu edhe

¹²⁵ Jesu Krishtin.—Shën. i përkth.

¹²⁶ Shih Gjoni 1:21.

¹²⁷ dmth individi.

një herë tjetër këto gjethe, degë, lule e fryte do të kthehen, dhe ajo pemë do të shfaqet e përsosur. Meqenëse në fillim ishte një farë dhe fundi është një farë, ne themi se fara është kthyer. Po të shohim thelbin e pemës, ai është një tjetër, por po të shohim lulet, gjethet e frytet, do të kemi të njëjtën aromë, bukuri e shije. Pra, përsosuria e pemës është kthyer për herë të dytë.

Po kështu, në qoftë se shohim kthimin e individit, ai është një individ tjetër; por në qoftë se shohim cilësitë e përsosuritë, është kthyer po ai. Prandaj kur Krishti tha “Ky është Elia”, Ai donte të thoshte: ky person është një manifestim i bujarisë, i përsosurive, i karakterit, i vetive e i virtyteve të Elias. Gjon Pagëzori tha “Unë nuk jam Elia”. Krishti shihte cilësitë, përsosuritë, karakterin dhe virtutin e të dyve, ndërsa Gjoni thelbin e individualitetin e tij. Është si kjo llambë: ajo ishte këtu mbrëmë dhe sonte është ndezur gjithashtu, edhe nesër mbrëma gjithashtu do të ndriçojë. Ne themi se llamba e kësaj nate është e njëjta dritë si ajo e natës së kaluar, dhe ajo është rikthyer. Kjo i referohet dritës, dhe jo vajt, fitilit ose mbajtëses.

Kjo çështje është shpjeguar plotësisht dhe qartë në Qitapi Ikan.

34

DEKLARIMI I BESIMIT NGA PJETRI

Pyetje.—Në Ungjillin e Shën Mateut thuhet: “Ti je Pjetri dhe mbi këtë shkëmb Unë do të ndërtoj kishën Time”.¹²⁸ Cila është domethënia e këtij vargu?

Përgjigje.—Kjo thënie e Krishtit është një konfirmim i deklaratës së Pjetrit, kur Krishti pyeti: “Cili beson se jam Unë?” dhe Pjetri u përgjigj: unë besoj se “Ti je Biri i Perëndisë së gjallë”. Pastaj Krishti i tha atij: “Ti je Pjetri”¹²⁹—sepse Cephas në aramishte do të thotë shkëmb—“Dhe mbi këtë shkëmb Unë do të ndërtoj kishën Time”. Sepse të tjerët,

¹²⁸ Mateu 16:18.

¹²⁹ Është e ditur se emri i vërtetë i Pjetrit ishte Simon, por Krishti e quajti atë Cefas, që në greqisht i korrespondon fjalës *petras*, që do të thotë shkëmb.

në përgjigje të pyetjes së Krishtit thanë se Ai ishte Elia, kurse disa thanë Gjon Pagëzori, dhe disa të tjerë Jeremia ose njëri prej Profetëve.¹³⁰

Krishti dëshironte që me anë të një sugjerimi, ose të një aluzioni, të konfirmonte fjalët e Pjetrit; kështu, në përshtatje me emrin Pjetër, Ai tha: “Dhe mbi këtë shkëmb Unë do të ndërtoj kishën Time”, duke dashur të thotë se besimi yt që Krishti është Biri i Perëndisë së gjallë do të jetë themeli i Fesë së Perëndisë, dhe mbi këtë besim do të ngrihet themeli i kishës së Perëndisë, që është Ligji i Perëndisë.

Ka dyshime për ekzistencën e varrit të Pjetrit në Romë, ajo nuk është vërtetuar. Disa thonë se ai është në Antiokí.

Për më tepër, le të krahasojmë jetët e disa prej Papëve me fenë e Krishtit. Krishti i uritur e pa çati mbi kokë, ushqehet me barishte në shkretëtirë dhe nuk dëshironte të fyente ndjenjat e askujt. Papa shëtit me një karrocë të mbuluar me ar dhe e kalon kohën në shkëlqimin më të madh, midis kënaqësive e luksit, pasurive e një adhurimi të tillë, që mbretërit kurrë nuk i kanë pasur.

Krishti nuk i bëri keq askujt, por disa Papë kanë vranë njerëz të pafajshëm: referojuni historisë. Sa gjak kanë derdhur papët thjesht për të mbajtur pushtetin shekullar! Thjesht sepse kishin pikëpamje të ndryshme nga të tyret, ata kanë arrestuar, burgosur e vranë mijëra shërbëtorë të botës së njerëzimit e dijetarë që kanë zbuluar të fshehtat e natyrës. Ja gjer në ç’shikallë i janë kundërvënë ata së vërtetës!

Pa mendoni për mësimet e Krishtit dhe vëreni zakonet e shprehitë e papëve. Shihni: a ka ndonjë ngjashmëri midis mësimëve të Krishtit dhe mënyrës sesi kanë qeverisur Papët? Nuk na pëlqen të bëjmë kritika, por historia e Vatikanit është tepër e jashtëzakonshme. Thelbi i argumentimit tonë është ky: mësimet e Krishtit janë një gjë dhe metodat e qeverisjes papale janë diçka tjetër; ato nuk pajtohen. Shihni sesa protestantë janë vranë me urdhër të Papëve, sa tirani e shtypje janë ushqyer dhe sa dënime janë dhënë e sa vuajtje janë shkaktuar! A mund të gjurmohet qoftë edhe një prej aromave të ëmbla të Krishtit në këto veprime? Jo! Për Perëndi! Këta njerëz nuk i janë bindur Krishtit, ndërsa

¹³⁰ Shih Mateu 16:14-18.

Shën Barbara, portretin e së cilës e kemi përpara, i bindej Krishtit, ndoqi gjurmët e Tij dhe vuri në jetë porosinë e Tij. Ndër Papët ka edhe disa shpirtra të bekuar që kanë ndjekur gjurmët e Krishtit, veçanërisht në shekujt e parë të epokës Kristiane, kur gjërat shekullare mungonin dhe sprovat e imponuara nga Perëndia ishin të ashpra. Por kur papët futën në dorë pushtetin shtetëror dhe arritën nderime e begati tokësore, qeverisja papale e la krejt në harresë Krishtin dhe u mor me pushtetin shekullar, madhështinë, rehatinë e luksin. Ajo vrau njerëz, iu kundërvu përhapjes së diturisë, torturoi njerëz të shkencës, i vuri pengesa dritës së dijes dhe nxorri urdhra për vrasje e plaçkitje. Mijëra shpirtra, njerëz të shkencës e dijetarë, dhe njerëz të pafajshëm, gjetën vdekjen në burgjet e Romës. Me gjithë këto metoda e veprime, si mund t'u besohet Mëkëmbësve të Krishtit?

Selia Papale i është kundërvënë vazhdimisht dijes; madje në Evropë pranohet që feja i kundërvihet shkencës dhe që shkenca shkatërron themelet e fesë. Ndërsa feja e Perëndisë mbështet të vërtetën, është themeluesja e shkencës dhe e dijes, është plot dashamirësi për njerëzit e ditur; është qytetëruësja e njerëzimit, zbulon të fshehtat e natyrës dhe ndriçon horizontet e botës. Pra, si mund të thuhet se ajo i kundërvihet dijes? Mos e dhëntë Zoti! Madje për Perëndinë dija është dhuntia më e lavdishme e njeriut dhe më fisnikja ndër përsosuritë njerëzore. T'i kundërvihesh dijes është injorancë, dhe ai që urren dijen e shkencën nuk është njeri, por më tepër një kafshë pa inteligjencë. Sepse dija është dritë, jetë, lumturi, përsosuri, bukuri dhe mjet për t'u afruar te Pragu i Unitetit. Ajo është nderi e lavdia e botës së njerëzimit dhe bujaria më e madhe e Perëndisë. Dija është udhëheqje, kurse injoranca është gabim i mirëfilltë.

Lum ata që i kalojnë ditët e tyre duke fituar dije, duke zbuluar të fshehtat e natyrës dhe duke depërtuar në hollësitë e së vërtetës së kulluar! Mjerë ata që kënaqen me injorancën, zemrat e të cilëve pëlqejnë imitimim pa mend, ata që kanë rënë në humnerat më të thella të injorancës e të marrëzisë dhe që i kanë humbur kot jetët e tyre!

Pyetje.—Po qe se Perëndia ka dijëni për një veprim që do të kryhet nga dikush dhe kjo është e shkruar në Tabelën e Fatit, a është e mundur t'i kundërvihesh kësaj?

Përgjigje.—Parashikimi i diçkaje nuk është shkaku i realizimit të saj; sepse dija thelbësore e Perëndisë rrethon, në të njëjtën mënyrë, realitetet e gjërave, si para dhe pas ekzistencës së tyre, pa u bërë shkaku i ekzistencës së tyre. Dija është një përsosuri e Perëndisë. Por ajo që është profetizuar me frymëzim të Perëndisë përmes gojës së profetëve lidhur me shfaqjen e të Premtuarit të Biblës nuk ishte shkaku i manifestimit të Krishtit.

Sekretet e fshehura të së ardhmes iu reveluan Profetëve dha Ata u vunë kështu në dijëni për ngjarjet e së ardhmes që njoftuan. Kjo dije e këto profeci nuk ishin shkaku i atyre që ndodhën. Për shembull, sonte gjithkush e di se pas shtatë orësh do të dalë dielli, por kjo paradije e përgjithshme nuk është shkaku i lindjes e i daljes së diellit.

Pra, dija e Perëndisë në mbretërinë e së rastësishmes nuk krijon format e gjërave. Në të kundërtën, ajo është e spastruar nga e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja. Ajo është e njëjtë me realitetin e gjërave, por nuk është shkaku që ato të ndodhin.

Po kështu, shënimi e pëmendja e diçkaje në Librin nuk bëhet shkaku i ekzistencës së saj. Profetët, përmes frymëzimit hyjnor, e dinin atë që do të ndodhte. Për shembull, përmes frymëzimit hyjnor Ata e dinin se Krishti do të martirizohej dhe e shpallën këtë. Tani, a ishte dija dhe njoftimi i Tyre shkaku i martirizimit të Krishtit? Jo; kjo dije është një përsosuri e Profetëve dhe nuk shkaktoi martirizimin.

Matematikanët, me anë përllogaritjesh astronomike, e dinë se në një moment të caktuar do të ndodhë një eklips i hënës ose i diellit. Sigurisht që ky zbulim nuk është shkaku që të ndodhë eklipsi. Kjo, sigurisht, është vetëm një analogji e jo një paraqitje e saktë.

Pjesa e Tretë

PËR FUQINË DHE KUSHTET E MANIFESTIMEVE TË PERËNDISË

36

PESË ASPEKTET E SHPIRTIT

Dijeni se, në përgjithësi, ka pesë ndarje të shpirtit. I pari është shpirti bimor: ky është një fuqi që buron nga kombinimi i elementeve e ndërthurja e lëndëve me urdhër të Perëndisë Supreme dhe nga ndikimi, efekti e ndërlidhja e ekzistencave të tjera. Kur këto elemente e lëndë ndahen nga njëra-tjetra, edhe fuqia e rritjes pushon së ekzistuari. Kështu, që të përdorim një figurë tjetër, elektriciteti lind nga kombinimi i elementeve, dhe kur këta elemente ndahen, forca elektrike ikën e humbet. I tillë është shpirti bimor.

Pastaj vjen shpirti shtazor që, gjithashtu, lind nga ndërthurja e kombinimi i elementeve. Por ky kombinim është më i plotë dhe, me urdhër të Zotit Fuqplotë, arrihet një ndërthurje e përsosur dhe përftohet shpirti shtazor, me fjalë të tjera aftësia e shqisave. Ky do ta dallojë realitetin e gjërave nga ajo që mund të shihet e duket, të dëgjohet, të hahet, të preket e të nuhatet. Pas ndarjes e shpërbërjes së elementeve të gërshetuara, edhe ky shpirt natyrisht do të zhduket. Është si kjo llambë që shihni: kur vaji, fitili e zjarri gërshetohen lind drita; por kur vaji të ketë mbaruar e fitili të jetë konsumuar, edhe drita do të zhduket e do të humbasë.

Shpirti njerëzor mund të krahasohet me bujarinë e diellit që shkëlqen mbi një pasqyrë. Trupi i njeriut, që përbëhet prej elementesh, është i kombinuar e i përzierë në formën më të përkryer; ai është konstruksioni më i fortë, kombinimi më fisnik, forma më e përsosur e ekzistencës. Ai rritet e zhvillohet nëpërmjet shpirtit shtazor. Ky trup i përkryer mund të krahasohet me një pasqyrë, dhe shpirti njerëzor me diellin. Megjithatë, ndërsa pasqyra thyhet, bujaria e diellit vazhdon; dhe

ndërsa pasqyra shkatërrohet ose pushon së qëni, asgjë nuk i ndodh bujarisë së diellit, që është e përjetshme. Ky shpirt ka aftësinë të bëjë zbulime; ai përfshin të gjitha gjërat. Të gjitha këto shenja të mahnitshme, këto zbulime shkencore, këto ndërmarrje të mëdha e ngjarje të rëndësishme historike, që ju i dini, ndodhin falë kësaj. Nga mbretëria e së padukshmes dhe e së fshehurës, me anë të fuqisë shpirtërore, gjërat nxirren në planin e së dukshmes. Kështu, njeriu është në tokë, megjithatë bën zbulime në qiell. Nga realitete të njohura—domethënë nga gjërat që njihen e shihen—ai zbulon gjëra të panjohura. Për shembull, njeriu është në këtë hemisferë; por ashtu si Kolombi, përmes aftësisë së arsytimit zbulon një hemisferë tjetër—domethënë Amerikën—që deri në atë kohë ishte e panjohur. Trupi i tij është i rëndë, por me ndihmën e mjeteve që ai shpik, mund të fluturojë. Ai është i ngadalshëm në lëvizjet, por me anë të mjeteve të transportit që shpik, udhëton nga Lindja në Perëndim me shpejtësi të madhe. Me një fjalë, kjo aftësi shtrihet në të gjitha gjërat.

Por shpirti i njeriut ka dy aspekte: një hyjnor e një satanik—domethënë ai është i aftë për përsosurinë më të madhe, si dhe për papërsosurinë më të madhe. Në qoftë se fiton virtyte, ai është më fisnikja e qenieve ekzistuese; në qoftë se fiton vese, bëhet qënia më e ulët.

Shkalla e katërt e shpirtit është shpirti qiellor; ky është shpirti i besimit e i bujarisë së Perëndisë; ai vjen nga fryma e Shpirtit të Shenjtë dhe falë fuqisë hyjnore bëhet shkak i jetës së pasosur. Është fuqia që e bën qiellor njeriun tokësor dhe përsos njeriun e papërsosur. Ai e bën të kulluar atë që është i papastër, të heshturin e bën elokuent; ai dëlir e shenjtëron ata që janë bërë skllevër të epsheve trupore; e bën injorantin të mençur.

Shpirti i pestë është Shpirti i Shenjtë. Ky Shpirt i Shenjtë është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe krijesave të Tij. Ai është si një pasqyrë përballë diellit. Ashtu si pasqyra e mirë merr dritë nga dielli dhe ua përçon këtë bujari të tjerëve, po kështu Shpirti i Shenjtë është ndërmjetësi i Dritës së Shenjtë të Diellit të Realitetit, të cilën ua jep realiteteve të shenjtëruara. Ai është i stolisur me të gjitha përsosuritë hyjnore. Sa herë që ai shfaqet, bota përtërihet dhe krijohet një cikël i ri. Trupi i botës së njerëzimit vesh një rrobë të re. Ai mund të krahasohet

me pranverën; sa herë vjen ajo, bota kalon nga një gjendje në një tjetër. Me ardhjen e stinës së pranverës, toka e zezë dhe fushat e shkretëtirat do të gjelbërohen e do të lulëzojnë dhe do të rriten gjithfarë lulesh e barërash erëmirë; pemët do të marrin jetë të re e do të dalin fryte të reja, dhe fillon një cikël i ri. Shfaqja e Shpirtit të Shenjtë i përngjet kësaj. Kurdo që shfaqet, ai përtërin botën e njerëzimit dhe u jep një shpirt të ri realiteteve njerëzore: e stolis botën e ekzistencës me një veshje të çmuar, shpërndan errësirën e injorancës dhe rrezaton dritën e përsosurive. Krishti, me fuqinë e Tij, e ripërtëriu këtë cikël; pranvera qiellore me freskinë e ëmbëlsinë më të madhe e shtriu tendën e vet në botën e njerëzimit dhe flladi jetëdhënës erëmoi flegrat e të ndriçuarve.

Po kështu, dalja e Bahá'u'lláh-ut ishte si një pranverë e re që u shfaq me fllade të shenjta, me ushtritë e jetës së pasosur e me fuqi qiellore. Ajo e vendosi Fronin e Mbretërisë Hyjnore në qendër të botës dhe, falë fuqisë së Shpirtit të Shenjtë, ringjalli shpirtat dhe krijoi një cikël të ri.

37

HYJNIA MUND TE KUPTOHET VETEM PËRMES MANIFESTIMEVE HYJNORE

Pyetje.—Ç'lidhje ka Realiteti i Hyjnisë me vendet e Zbardhëllimeve e të Agimeve Hyjnore?

Përgjigje.—Dijeni se Realiteti i Hyjnisë apo përmbajtja e Thelbit të Njëshmërisë është shenjtëri e kulluar e absolute—domethënë është i shenjtëruar e tej çdo lëvdate. Të gjitha atributet supreme të shkallëve të ekzistencës, të para në këtë rrafsh, janë vetëm imagjinata. Ai është i padukshëm, i pakuptueshëm, i paarritshëm, thelb i kulluar që nuk mund të përshkruhet, sepse Thelbi Hyjnor rrethon të gjitha gjërat. Në të vërtetë, ajo që rrethon është më e madhe se ajo që rrethohet, dhe ajo që rrethohet nuk mund ta përfshijë atë që e rrethon, as ta kuptojë realitetin e saj. Sado të përparojë mendimi, edhe pse mund të arrijë shkallën e fundit të të kuptuarit, vetë kufirin e tij, ai i sodit shenjat e atributet hyjnore në botën e krijimit e jo në botën e Perëndisë. Sepse thelbi e

atributet e Zotit të Unitetit janë në majat e shenjtërisë dhe për mendjen e për të kuptuarit nuk ka rrugë për t'iu avitur kësaj pozite. “Rruga është e mbyllur dhe të kërkosh është e ndaluar”.

Është e qartë se të kuptuarit njerëzor është një cilësi e ekzistencës së njeriut dhe se njeriu është një shenjë e Perëndisë: si mundet cilësia e shenjës të rrethojë krijuesin e shenjës?—domethënë si mundet të kuptuarit, që është një cilësi e ekzistencës së njeriut, të kuptojë Perëndinë? Pra, Realiteti i Hyjnisë është i fshehur për çdo kuptim dhe i mbuluar për mendjen e të gjithë njerëzve. Është krejt e pamundur të ngjitesh në atë sferë. Ne shohim se çdo gjë që qëndron më poshtë është e pafuqishme të kuptojë realitetin e asaj që qëndron më lart. Kështu guri, toka, pema, sado të evoluojnë, nuk mund të kuptojnë realitetin e njeriut dhe nuk mund ta përfytyrojnë aftësinë e të parit, të të dëgjuarit e të shqisave të tjera, megjithëse janë krijuar në të njëjtën mënyrë. Pra, si mundet njeriu, i krijuari, të kuptojë realitetin e Thelbit të kulluar të Krijuesit? Kjo sferë është e pakapshme nga të kuptuarit; asnjë shpjegim nuk është i mjaftueshëm për ta kuptuar atë dhe nuk ka asnjë fuqi që të mund ta tregojë. Ç’lidhje ka një grimcë pluhuri me tërë botën dhe ç’lidhje ka midis mendjes së kufizuar dhe botës së pakufishme? Mendjet janë të pafuqishme ta kuptojnë Perëndinë dhe shpirtat hutohen kur e shpjegojnë Atë. “Asnjë shikim s’e kap dot Atë, por Ai kap çdo shikim. Ai është Mendjemprehti, Gjithëshikuesi”.¹³¹

Për rrjedhojë, lidhur me këtë sferë të ekzistencës, çdo thënie e sqarim është i metë, çdo përshkrim e lëvdatë janë të papërshtatshme, çdo konceptim është i kotë e çdo përsiatje është pa vlerë. Por për këtë Thelb të thelbeve, këtë të Vërtetë të të vërtetave, këtë Mister të mistereve, ka pasqyrime, agime, shfaqje e shkëlqime në botën e ekzistencës. Vendagimi i këtyre shkëlqimeve, vendi i këtyre pasqyrimeve dhe shfaqja e këtyre manifestimeve janë Vendagimet e Shenjta, Realitet Universale dhe Qeniet Hyjnore, të Cilat janë pasqyrat e vërteta të Thelbit të shenjtëruar të Perëndisë. Të gjitha përsosuritë, bujaritë, shkëlqimet që vijnë prej Perëndisë janë të dukshme e të qarta në Realitetin e Manifestimeve të Shenjta, ashtu si dielli, që në një pasqyrë të pastër e të lëmuar shkëlqen me të gjitha përsosuritë e bujaritë

¹³¹ Kurani 6:103.

e tij. Po të thuhej se pasqyrat janë manifestimet e diellit dhe vendagimet e yllit që lind, kjo nuk do të thotë që dielli ka zbritur nga lartësitë e shenjtërisë së tij dhe është mishëruar në pasqyrën, as që Realiteti i Pakufizuar është kufizuar në këtë vend të shfaqjes së tij. Mos e dhëntë Zoti! Kështu besojnë ithtarët e antropomorfizmit. Jo; të gjitha lëvdatat, përshkrimet e lartësimet u referohen Manifestimeve të Shenjta— domethënë të gjitha përshkrimet, cilësitë, emrat dhe atributet që përmendim kthehen ndaj Manifestimeve Hyjnore; por duke qenë se askush nuk e ka arritur realitetin e Thelbit të Hyjnisë, atëherë askush nuk është në gjendje ta përshkruajë, shpjegojë, lëvdojë ose t'i thurë lavdi atij. Prandaj, gjithçka di, zbulon e kupton realiteti njerëzor për emrat, atributet e përsosuritë e Perëndisë u referohet këtyre Manifestimeve të Shenjta. Nuk ka rrugë tjetër: “Rruga është e mbyllur dhe të kërkosh është e ndaluar”.

Megjithatë, ne flasim për emrat dhe atributet e Realitetit Hyjnor, e lëvdojmë Atë duke i atribuar shikim, dëgjim, fuqi, jetë e dije. Ne i afirmojmë këto emra e attribute jo për të provuar përsosuritë e Perëndisë, por për të mohuar që Ai është në gjendje të ketë papërsosuri. Kur vërejmë botën ekzistuese, shohim se injoranca është papërsosuri dhe dija është përsosuri; prandaj themi se Thelbi i shenjtëruar i Perëndisë është urtí. Dobësia është papërsosuri dhe fuqia është përsosuri; për rrjedhojë ne themi se Thelbi i Shenjtëruar i Perëndisë është kulmi i fuqisë. Jo se ne e kuptojmë dijen e Tij, shikimin e Tij, fuqinë dhe jetën e Tij, sepse kjo është tej të kuptuarit tonë; sepse emrat e atributet thelbësore të Perëndisë janë të njëjta me Thelbin e Tij, dhe Thelbi i Tij është jashtë çdo të kuptuari. Në qoftë se atributet nuk janë të njëjta me Thelbin, duhet të ketë edhe një larmi paraqeniesh, dhe duhet të ketë gjithashtu dallime midis attributeve e Thelbit; dhe me qenë se Paraqenia është e nevojshme, atëherë vargu i paraqenieve do të bëhej i pafundmë. Ky është një gabim që duket vetiu.

Kështu, të gjitha këto attribute, emra, lëvdata e panegjerike përshtaten për Vendet e Manifestimit; dhe çdo gjë që ne përfytyrojmë e supozojmë jashtë tyre është thjesht imagjinatë, sepse ne nuk kemi mjete për të kuptuar atë që është e padukshme dhe e pakapshme. Ja përse është thënë: “Çdo gjë që keni shquar përmes iluzionit të imagjinatës në përfytyrimet tuaja mendore të rafinuara s’është veçse një krijesë si vetë

vetja juaj, dhe kthehet tek ju”.¹³² Është e qartë që në rast se dëshirojmë të përfytyrojmë Realitetin e Hyjnisë, ky përfytyrim është e rrethuar dhe ne jemi ajo që rrethon; dhe sigurisht ajo që rrethon është më e madhe se ajo që rrethohet. Që këtë është e sigurt dhe e qartë që, po ta përfytyrojmë realitetin Hyjnor jashtë manifestimeve të Shenjta, kjo është imagjinatë e kulluar, sepse nuk ka rrugë për t’iu avitur realitetit të Hyjnisë që të mos jetë e mbyllur për ne, dhe çdo gjë që ne përfytyrojmë është thjesht supozim.

Mendoni, pra, që popujt e ndryshëm të botës vërtiten rreth përfytyrimeve të tyre dhe adhurojnë idhujt e mendimeve e të hamendjeve. Ata nuk janë të vetëdijshëm për këtë; ata i konsiderojnë imagjinatat e tyre sikur janë Realiteti i paarritshëm nga çdo kuptim dhe i spastruar nga çdo përkrim. Ata e shohin vetveten si populli i Unitetit, ndërsa të tjerët si adhurues të idhujve; por idhujt kanë të paktën një ekzistencë materiale, kurse idhujt e mendimit dhe përfytyrimet e njeriut janë vetëm fantazi; ato nuk kanë madje as ekzistencë materiale. “Kini mendjen ju njerëz me intuitë”.¹³³

Dijeni se atributet e përsosurisë, shkëlqimi i bujarive hyjnore dhe dritat e frymëzimit janë të dukshme e të qarta në të gjitha Manifestimet e Shenjta; por Fjala e lavdishme e Perëndisë, Krishti dhe Emri Më i Madh, Bahá’u’lláh-u, janë manifestime e prova që shkojnë tej përfytyrimit, sepse Ata zotërojnë të gjitha përsosuritë e Manifestimeve të mëparshme; dhe për më tepër, ata zotërojnë disa përsosuri që i bëjnë Manifestimet e tjera të varura prej Tyre. Kështu të gjithë Profetët e Izraelit ishin qendra frymëzimi; edhe Krishti mori frymëzim, por sa ndryshim ka midis frymëzimit të Fjalës së Perëndisë dhe revelacioneve të Isaisë, të Jeremisë e të Elias!

Pa mendoni që drita është shprehja e dridhjeve të materies eterike: nervat e syrit preken nga këto dridhje dhe lind shikimi. Drita e llambës ekziston falë dridhjes së materies; e po kështu ndodh edhe me atë të diellit; por sa ndryshim ka midis dritës së diellit dhe asaj të yjeve ose të llambës!

¹³² Nga një hadith që i atribuohet Profetit Muhamet.

¹³³ Kurani 59:2.

Shpirti i njeriut shfaqet e manifestohet në gjendjen embrionale dhe gjithashtu në moshën e fëmijërisë e të pjekurisë, dhe është i shndritshëm e i dukshëm në gjendjen e përsosurisë. Shpirti është po ai, por në gjendjen embrionale mungon aftësia e të shikuarit dhe e të dëgjuarit. Në gjendjen e pjekurisë e të përsosurisë kjo aftësi shfaqet me shkëlqimin e ndriçimin më të madh. Po kështu fara në fillim bëhet gjethe dhe është vendi ku shfaqet shpirti bimor; në gjendjen e frytit ajo manifeston të njëjtin shpirt—domethënë aftësia e rritjes shfaqet në përsosurinë më të madhe; por sa ndryshim ka midis gjendjes së gjetheve dhe të asaj të frytit! Sepse nga fryti dalin njëqind mijë gjethe, edhe pse ato rriten e zhvillohen përmes të njëjtit shpirt bimor. Shikoni ndryshimin midis virtyteve e përsosurive të Krishtit, shkëlqimeve e ndriçimit të Bahá'u'lláh-ut dhe virtyteve të Profetëve të Izraelit, si Ezekieli e Samueli. Të gjithë ishin manifestime të frymëzimit, por midis tyre ka një ndryshim të pafundmë. Përshëndetje!

38

TRI POZITAT E MANIFESTIMEVE HYJNORE

Dijeni se Manifestimet e Shenjta, edhe pse kanë shkallët e përsosurive të pafundme, megjithatë, në përgjithësi, kanë vetëm tri pozita. Pozita e parë është ajo fizike; pozita e dytë është ajo njerëzore, që është ajo e shpirtit racional; e treta është ajo e shfaqjes hyjnore dhe e shkëlqimit qiellor.

Pozita fizike është e natyrës fenomenale; ajo përbëhet prej elementesh, dhe çdo gjë e përbërë i nënshtrohet medoemos shpërbërjes. Nuk është e mundur që një gjë e përbërë të mos shpërbëhet.

E dyta është pozita e shpirtit racional, që është realiteti njerëzor. Edhe kjo është e natyrës fenomenale dhe Manifestimet e Shenjta e kanë atë si gjithë njerëzia.

Dijeni se megjithëqë ndërgjegja njerëzore ka ekzistuar mbi tokë prej shumë e shumë kohësh e epokash, përsëri ajo është e natyrës fenomenale.¹³⁴ Por me qenë se ajo është një shenjë hyjnore, sapo vjen

¹³⁴ dmth nga pikëpamja e prejardhjes së saj.

në jetë bëhet e përjetshme. Shpirti i njeriut ka fillim, por nuk ka fund; ai vazhdon përjetësisht. Po kështu llojet që ekzistojnë mbi tokë janë të natyrës fenomenale, sepse është vërtetuar se ka qenë një kohë kur këto lloje nuk ekzistonin në sipërfaqen e tokës. Për më tepër, toka nuk ka ekzistuar gjithmonë, por bota e ekzistencës kurdoherë ka qenë, sepse gjithësia nuk kufizohet me këtë rruzull tokësor. Kjo do të thotë që, edhe pse ndërgjegjet njerëzore janë të natyrës fenomenale, ato megjithatë janë të pavdekshme, të përhershme e të vazhdueshme; sepse bota e sendeve është botë e papërsosurive në krahasim me atë të njeriut, dhe bota e njeriut është botë e përsosurisë në krahasim me atë të sendeve. Kur papërsosuritë arrijnë pozitën e përsosurisë, ato bëhen të përjetshme.¹³⁵ Ky është një shembull, domethënien e të cilit ju duhet ta kuptoni.

Pozita e tretë është ajo e shfaqjes hyjnore dhe e shkëlqimit qiellor: ajo është Fjala e Perëndisë, Bujaria e Përjetshme, Shpirti i Shenjtë. Ajo nuk ka as fillim as fund, sepse këto gjëra lidhen me botën e së rastësishmes e jo me botën hyjnore. Për Perëndinë fundi është i njëjllotë si fillimi. Kështu llogaritja e ditëve, e javëve, e muajve dhe e viteve, e së djeshmes dhe e së sotmes lidhet me rruzullin tokësor; por në diell nuk ka një gjë të tillë—nuk ka as dje, as sot e as nesër, as muaj e as vite: të gjitha janë njëlloj. Po kështu, Fjala e Perëndisë është e spastruar nga të gjitha këto kushte dhe është e liruar nga kufijtë, ligjet e kufizimet e botës së të rastësishmes. Prandaj realiteti i profetërisë, që është Fjala e Perëndisë dhe gjendja e përsosur e manifestimit, kurrë nuk ka pasur fillim dhe nuk do të ketë fund; dalja e saj ndryshon nga të gjitha të tjerat dhe i përngjet asaj të diellit. Për shembull, agimi i saj nën shenjën e Krishtit u bë me shkëlqimin e ndriçimin më të madh, dhe kjo është e përjetshme dhe e pasosur. Shih sa mbretër pushtues, sa burra shteti e princa, organizatorë të fuqishëm ka pasur; që të gjithë janë zhdukur, ndërsa flladet e Krishtit ende fryjnë; drita e Tij ende ndriçon; melodia e Tij ende kumbon; flamuri i Tij ende valëvitet; ushtritë e Tij ende luftojnë; zëri i Tij qiellor vazhdon të jetë i ëmbël e melodioz; retë e Tij

¹³⁵ dmth në mbretërinë e njeriut, ku vetëm Shpirti manifeston pavdekësi. Shih “Pesë aspektet e Shpirtit”, f. 143; “Gjendja e njeriut dhe përparimi i tij pas vdekjes”, f. 235, etj.

ende reshin margaritarë; vetëtima e tij vazhdon të flakërojë; pasqyrimi i Tij është ende i qartë e i shkëlqyeshëm; llamburitja e Tij ende rrezatuese dhe e shndritshme; dhe po kështu ndodh me ata shpirtra që janë nën mbrojtjen e Tij dhe shkëlqejnë me dritën e Tij.

Është pra e qartë se Manifestimet zotërojnë tri pozita: pozitën fizike, pozitën e shpirtit racional dhe pozitën e shfaqjes hyjnore e të shkëlqimit qiellor. Pozita fizike me siguri do të shpërbëhet, por pozita e shpirtit racional, edhe pse ka fillim nuk ka fund: madje është e pajisur me jetë të pasosur. Por Realiteti i Shenjtë, për të cilin Krishti thotë “Ati është në Birin”,¹³⁶ nuk ka as fillim as fund. Kur flitet për fillim nënkuptohet gjendja e manifestimit; dhe simbolikisht gjendja e heshtjes krahasohet me gjumin. Për shembull, një njeri është duke fjetur—kur fillon të flasë, ai zgjohet—por është gjithnjë i njëjti person, qoftë kur fle ose kur është zgjuar; asnjë ndryshim nuk ndodh në pozitën e tij, në ngritjen e Tij, në lavdinë e tij, në realitetin ose natyrën e tij. Gjendja e heshtjes krahasohet me gjumin dhe gjendja e manifestimit me zgjimin. Një njeri, qoftë kur fle ose është zgjuar, është i njëjti njeri; gjumi është një gjendje, kurse zgjimi një gjendje tjetër. Koha e heshtjes krahasohet me gjumin, kurse manifestimi e udhërrëfimi me zgjimin.

Në Ungjill thuhet “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë”.¹³⁷ Nga kjo është e qartë e duket vetiu se Krishti nuk i arriti pozitën e Mesisë dhe përsosuritë e saj në kohën e pagëzimit, kur Shpirti i Shenjtë zbriti mbi Të me pamjen e një pëllumbi. Përkundrazi, Fjala e Perëndisë në përjetësi kurdoherë ka qenë e do të jetë në lartësinë e shenjtërimin.

39

POZITA NJERËZORE DHE POZITA SHPIRTËRORE E MANIFESTIMEVE HYJNORE

Thamë se Manifestimet kanë tre plane. I pari, realiteti fizik, që varet nga trupi; i dyti, realiteti individual, domethënë shpirti racional; i treti,

¹³⁶ Shih Gjoni 14:11; 17:21.

¹³⁷ Gjoni 1:1.

shfaqja hyjnore, e përbërë prej përsosurive hyjnore, që është shkaku i jetës së qenies, i edukimit të shpirttrave, i udhëheqjes së njerëzve dhe i ndriçimit të botës së të rastësishmes.

Gjendja fizike është gjendje njerëzore që vdes, sepse është e përbërë prej elementesh, dhe çdo gjë e përbërë prej elementesh medoemos do të shpërbëhet e zhduket.

Por realiteti individual i Manifestimeve të Perëndisë është një realitet i shenjtë e për këtë arsye është i dëlirë dhe përse i përket natyrës e cilësisë dallohet nga të gjitha gjërat e tjera. Ai është si dielli, i cili nga natyra e tij thelbësore prodhon dritë, dhe nuk mund të krahasohet me hënën, pikërisht si grimcat që përbëjnë rruzullin e diellit nuk mund të krahasohen me ato që përbëjnë hënën. Grimcat dhe ndërtimi i të parit prodhojnë rreze, ndërsa grimcat prej të cilave përbëhet hëna nuk prodhojnë rreze, por kanë nevojë të huazojnë dritë. Kështu janë realitete të tjera njerëzore ata shpirttra që, ashtu si hëna, marrin dritë nga dielli; por Realiteti i Shenjtë është i ndritshëm në Vetvete.

Plani i tretë i asaj Qenieje¹³⁸ është Bujaria Hyjnore, shkëlqimi i Bukurisë Paraqenëse dhe rrezatimi i dritës së Fuqiplotit. Realitetet individuale të Manifestimeve Hyjnore nuk ndahen nga Bujaria e Perëndisë dhe e Shkëlqimit Sovran. Po kështu lëmshi i diellit nuk ndahet nga drita. Prandaj mund të thuhet se ngjitja në qiell e Manifestimeve të Shenjta është thjesht braktisja e kësaj forme të përbërë prej elementesh. Për shembull, në qoftë se një llambë e ndriçon këtë kamare, dhe në qoftë se drita e saj e ndërpret ndriçimin e saj për shkak se kamarja është shkatërruar, drita që jep llamba nuk ka pushuar. Me pak fjalë, në Manifestimet e Shenjta Bujaria Paraqenëse është si drita, individualiteti përfaqësohet nga globi prej qelqi, ndërsa trupi njerëzor është si kamarja: në qoftë se shkatërrohet kamarja, llamba vazhdon të ndriçojë. Manifestimet Hyjnore janë një mori pasqyrash të ndryshme, sepse Ata kanë secili një individualitet të veçantë, por ajo që reflektohet në pasqyra është një diell i vetëm. Është e qartë se realiteti i Krishtit ndryshon nga ai i Moisiut.

¹³⁸ i Manifestimit.

Në të vërtetë, që nga fillimi ky Realitet i Shenjtë¹³⁹ e di sekretin e ekzistencës dhe shenja të madhështisë shfaqen e janë të dukshme tek Ai që në moshën e fëmijërisë. Prandaj si është e mundur që Ai të mos jetë i vetëdijshëm për të gjitha këto bujari e përsosuri?

Ne e kemi thënë se Manifestimet e Shenjta kanë tre plane. Gjendja fizike, realiteti individual dhe qendra e manifestimit të përsosurisë: është si dielli, drita dhe nxehtësia e tij. Individë të tjerë zotërojnë planin fizik, planin e shpirtit racional—frymën dhe mendjen.¹⁴⁰ Kështu thënia “Unë isha në gjumë dhe flladet hyjnore kaluan mbi Mua, dhe u zgjova”, është si thënia e Krishtit “Trupi është i trishtuar, por shpirti është i lumtur”, ose edhe “Jam i mërzhitur”, ose “Jam i qetë”, ose “Jam i shqetësuar”—këto u referohen gjendjes fizike dhe nuk kanë të bëjnë me realitetin individual as me manifestimin e Realitetit Hyjnor. Shihni, pra, sa mijëra ndryshime të papritura mund të ndohdin në trupin e njeriut, por shpirti nuk preket prej tyre; madje mund të ndodhë që disa pjesë të trupit të gjymtohen tërësisht, por thelbi i mendjes mbetet dhe është i përjetshëm. Një mijë aksidente mund t’i ndodhin rrobave, por për atë që i vesh nuk ka rrezik. Këto fjalë që ka thënë Bahá’u’lláh-u “Unë isha në gjumë, dhe flladi kaloi mbi Mua e më zgjoi” i referohen trupit.

Në botën e Perëndisë nuk ka të shkuar, as të ardhme e as të tashme; të gjitha janë një. Kështu, kur Krishti tha “Në fillim ishte Fjala”¹⁴¹—kjo do të thotë se ajo ishte, është e do të jetë; sepse në botën e Perëndisë nuk ka kohë. Koha ndikon mbi krijesat por jo mbi Perëndinë. Për shembull, në lutjet Krishti thotë “U shenjtëroftë emri Yt”; kuptimi është që emri Yt ishte, është dhe do të jetë i shenjtëruar.¹⁴² Mëngjesi, dita dhe mbrëmja kanë të bëjnë me këtë tokë, ndërsa në diell nuk ka as mëngjes, as ditë as mbrëmje.

40

¹³⁹ Manifestimi.

¹⁴⁰ Shih “Shpirti, Fryma dhe Mendja”, f. 208.

¹⁴¹ Shih Gjoni 1:1.

¹⁴² Mateu 6:9; Luka 11:2.

DIJA E MANIFESTIMEVE HYJNORE

Pyetje.—Një prej aftësive që zotërojnë Manifestimet Hyjnore është dija. Cilat janë kufijtë e saj?

Përgjigje.—Dija është dy llojesh. Njëra është dije subjektive, tjetra objektive; domethënë njëra dije është intuitive, ndërsa tjetra është dije që rrjedh nga perceptimi.

Dija e gjërave që kanë njerëzit në përgjithësi fitohet nga reflektimi ose nga provat—domethënë koncepti i një objekti formohet ose me forcën e mendjes ose duke e parë një objekt, forma e të cilit krijohet në pasqyrën e zemrës. Rrethi i kësaj dije është shumë i kufizuar, ajo varet nga përpjekja e arritja.

Por lloji i dytë i dijes, që është dija e të qenit, është intuitive; ajo i përngjet njohjes e vetëdijës që ka njeriu për vetveten.

Për shembull, mendja dhe shpirti i njeriut janë në dijeni të kushteve e të gjendjeve të gjymtyrëve e të pjesëve përbërse të trupit dhe janë të vetëdijshme për të gjitha ndijimet fizike; po kështu, ato janë të vetëdijshme për aftësinë e tyre, për ndjenjat e tyre dhe për gjendjet e tyre shpirtërore. Kjo është dija e të qenit, të cilën njeriu e kupton dhe e percepton, sepse shpirti e rrethon trupin dhe është i vetëdijshëm për ndijimet e aftësitë e tij. Kjo dije nuk është rezultat i përpjekjes e i studimit. Ajo është diçka që ekziston në vetvete; është një dhunti absolute.

Duke qenë se Realitetet e Shenjtëruara, Manifestimet supreme të Perëndisë rrethojnë thelbin dhe vetitë e krijesave, kapërcejnë e përfshijnë realitetet ekzistuese dhe kuptojnë të gjitha gjërat, dija e tyre është, pra, dije hyjnore e jo dije e fituar—domethënë ajo është një dhunti e shenjtë; është një revelacion hyjnor.

Do të përmendim një shembull enkas që të kuptohet kjo çështje. Genia më fisnike mbi tokë është njeriu. Ai përfshin mbretëritë shtazore, bimore e minerale—domethënë këto kushte përmbahen tek ai në një shkallë të tillë, që ai është zotëruesi i këtyre kushteve e gjendjeve; ai është i vetëdijshëm për misteret e tyre dhe për sekretet e ekzistencës së tyre. Ky është thjesht një shembull e jo një analogji. Me pak fjalë, Manifestimet supreme të Perëndisë janë të vetëdijshme për realitetin e

mistereve të qenieve. Prandaj Ata vendosin ligje që janë të përshtatshme e që i përgjigjen gjendjes së botës së njeriut, sepse feja është lidhja thelbësore që rrjedh nga realitetet e gjërave. Manifestimi—dmth Ligjvënësi i Shenjtë—po të mos ishte i vetëdijshëm për realitetet e qenieve, nuk do ta kuptonte lidhjen thelbësore që rrjedh nga realiteti i gjërave dhe me siguri nuk do të ishte në gjendje të krijonte një fe që përputhet me faktet dhe u përshtatet kushteve. Profetët e Perëndisë, Manifestimet supreme janë si mjekë të aftë dhe bota e së rastësishmes është si trupi i njeriut: ligjet hyjnore janë mjekimi e ilaçi. Për rrjedhojë, mjeku duhet të jetë i vetëdijshëm e të njohë të gjithë gjymtyrët e pjesët, si dhe konstruktin e gjendjen e të sëmurit, në mënyrë që të mund të japë një ilaç të dobishëm kundër helmit të fortë të sëmundjes. Në të vërtetë, doktori e nxjerr nga vetë sëmundja trajtimin që i përshtatet të sëmurit, sepse ai diagnostikon sëmundjen dhe pastaj jep ilaçin për të. Pa u zbuluar sëmundja, si mund të përcaktohen ilaçi e mjekimi i saj? Doktori duhet të ketë dijeni të plotë për konstruktin, gjymtyrët, organet e gjendjen e të sëmurit dhe të njohë të gjitha sëmundjet e të gjitha mjekimet, në mënyrë që të japë një ilaç të përshtatshëm.

Feja është, pra, lidhja e nevojshme që rrjedh nga realiteti i gjërave; dhe duke qenë se Manifestimet supreme të Perëndisë janë të vetëdijshëm për misteret e qenieve, Ata e kuptojnë këtë lidhje thelbësore dhe falë kësaj dije vendosin Ligjin e Perëndisë.

41

CIKLET UNIVERSALE

Pyetje.—Cili është shpjegimi i vërtetë i cikleve që ndodhin në botën e ekzistencës?

Përgjigje.—Secili prej trupave të ndritshëm në këtë kupë qiellore të paanë ka një cikël rrotullimi me kohëzgjatje të ndryshme; secili rrotullohet në orbitën e vet dhe fillon sërish një cikël i ri. Kështu, toka çdo treqind e gjashtëdhjetë e pesë ditë, pesë orë, dyzet e tetë minuta e disa fraksione, plotëson një rrotullim; dhe pastaj fillon një cikël i ri—domethënë cikli i parë përtërihet sërish. Po kështu për tërë gjithësinë,

qoftë për qiejt ose për njerëzit, këto janë cikle të ngjarjeve të mëdha, të fakteve e të ndodhive të rëndësishme. Kur një cikël merr fund, fillon një cikël i ri dhe i vjetri harrohet krejtësisht për shkak të ngjarjeve të mëdha që ndodhin, kështu që nuk mbetet asnjë gjurmë ose dëshmi për të. Siç e shikoni, ne nuk kemi dëshmi për njëzet mijë vjet më parë, megjithëse e kemi provuar më parë me argumenta se jeta mbi këtë tokë është shumë e lashtë. Ajo nuk ka nisur njëqind mijë, ose dyqind mijë, ose një a dy milionë vjet më parë; ajo është shumë e lashtë dhe dëshmitë e gjurmët e lashta janë fshirë krejtësisht.

Secili prej Manifestimeve Hyjnore ka po kështu një cikël, dhe gjatë ciklit mbizotërojnë e zbatohen ligjet e porositë e tij. Kur cikli i Tij plotësohet nga dalja e një Manifestimi të ri, nis një cikël i ri. Pra ciklet fillojnë, mbarojnë e përtërihen, derisa në botë të plotësohet një cikël universal, kur do të ndodhin ngjarje të rëndësishme e rrethana të mëdha, të cilat do të fshijnë krejtësisht çdo gjurmë e çdo dëshmi të së kaluarës; pastaj fillon një cikël i ri universal në botë, sepse kjo gjithësi nuk ka fillim. Më parë kemi dhënë prova e dëshmi lidhur me këtë çështje; nuk është nevoja t'i përsërisim.

Me një fjalë, ne themi se një cikël universal në botën e ekzistencës përbën një shtrirje të gjatë kohe dhe përfshin periudha e epoka të panumërta e të pallogaritshme. Në një cikël të tillë, Manifestimet shfaqen me shkëlqim në mbretërinë e së dukshmes, derisa një Manifestim i madh e suprem e bën tokën qendrën e rrezatimit të Tij. Dalja e Tij bën që bota të arrijë pjekurinë dhe shtrirja e ciklit të Tij është shumë e madhe. Pastaj Manifestime të tjera do të dalin nën hijen e Tij, të Cilat sipas nevojave të kohës do të përtërijnë disa porosi që kanë të bëjnë me çështje e punë materiale, duke qëndruar ndërkohë nën hijen e tij.

Ne jemi në ciklin që filloi me Adamin dhe Manifestimi suprem i tij është Bahá'u'lláh-u.

Pyetje.—Cilat janë shkalla e fuqisë dhe përsosuritë e Froneve të Realitetit, Manifestimeve të Perëndisë, dhe cili është kufiri i ndikimit të Tyre?

Përgjigje.—Shihni botën e ekzistencës—domethënë botën e gjërave materiale. Sistemi diellor është i errët; në të dielli është qendra e dritës dhe të gjitha planetet e sistemit vërtiten rreth fuqisë së tij dhe përfitojnë nga bujaria e tij. Dielli është shkaku i jetës e i ndriçimit, si dhe mjeti falë të cilit rriten e zhvillohen të gjitha qeniet e sistemit diellor; sepse pa bujarinë e diellit nuk do të mund të ekzistonte asnjë qenie e gjallë: çdo gjë do të ishte e errët e do të shkatërrohej. Është, pra, e qartë e duket vetiu se dielli është qendra e dritës dhe shkaku i jetës së qenieve të sistemit diellor.

Po kështu, Manifestimet e Shenjta të Perëndisë janë qendrat e dritës së realitetit, të burimit të mistereve dhe të bujarive të dashurisë. Ato janë shkëlqim në botën e zemrave e të mendimeve dhe përhapin hire të përjetshme mbi botën e shpirtave; ato japin jetë shpirtërore dhe shkëlqejnë me dritën e realitetit e të domethënies. Ndriçimi i botës së mendimit vjen nga këto qendra të dritës e burime të mistereve. Pa bujarinë e shkëlqimit dhe udhëzimet e këtyre Qenieve të Shenjta, bota e shpirtave dhe e mendimeve do të ishte errësirë e padepërtueshme. Pa mësimet e pakundërshtueshme të atyre burimeve të mistereve bota njerëzore do të bëhej kullotë e oreksve dhe e cilësive shtazarake, ekzistenca e gjithçkaje do të ishte irreale dhe nuk do të kishte jetë të vërtetë. Prandaj thuhet në Ungjill “Në fillim ishte Fjala”, që do të thotë se ajo u bë shkaku i çdo forme të jetës.¹⁴³

Shihni tani ndikimin e diellit mbi qeniet tokësore, çfarë shenjash e rezultatesh bëhen të dukshme e të qarta nga afërsia dhe largësia e tij, nga lindja ose perëndimi i tij. Një herë është vjeshtë, një herë tjetër pranverë; ose përsëri verë ose dimër. Kur dielli kalon vijën e Ekuatorit, pranvera jetëdhënëse shfaqet me shkëlqim, dhe kur është solstici veror frytet arrijnë kulmin e përsosurisë, drithërat e bimët japin prodhimin e tyre, dhe qeniet tokësore arrijnë zhvillimin e rritjen më të madhe.

¹⁴³ Gjoni 1:1.

Po kështu, kur Manifestimi i Shenjtë i Perëndisë, Që është dielli i botës së krijimit të Tij, shkëlqen mbi botën e shpirtave, të mendimeve e të zemrave, atëherë shfaqet pranvera shpirtërore dhe jeta e re, duket fuqia e pranverës së mahnitshme dhe dalin në pah përfitime të mrekullueshme. Siç e keni vënë re, në kohën e shfaqjes së çdo Manifestimi të Perëndisë kanë ndodhur përparime të jashtëzakonshme në botën e mendjeve, të mendimeve e të shpirtave. Shihni, për shembull, çfarë zhvillimi është arritur në këtë epokë hyjnore në botën e mendjeve e të mendimeve, edhe pse tani është vetëm fillimi i agimit të saj. Së shpejti do të shihni se bujari të reja e mësimë hyjnore do ta ndriçojnë këtë botë të errët dhe do t'i shndërrojnë këto rajone të zymta në parajsë të Edenit.

Po të shpjegonim shenjat e bujaritë e secilit prej Manifestimeve të Shenjta, kjo do të merrte shumë kohë. Mendoni e reflektoni vetë për këtë dhe do të arrini të vërtetën për këtë çështje.

43

DY KATEGORITË E PROFETËVE

Pyetje.—Sa lloje Profetësh ka?

Përgjigje.—Në përgjithësi, Profetët janë dy llojesh. Njëri janë Profetët e pavarur, të Cilët kanë pasues; ata të llojit tjetër nuk janë të pavarur dhe janë vetë pasues.

Profetët e pavarur janë ligjdhënësit dhe themeluesit e një cikli të ri. Me daljen e tyre bota vesh një rrobë të re, vendosen themelet e fesë dhe revelohet një libër i ri. Pa ndonjë ndërmjetës, Ata marrin dhunti nga Realiteti i Hyjnisë dhe ndriçimi i tyre është një ndriçim thelbësor. Ata janë si dielli që është i ndritshëm në vetvete: drita është nevoja e tij thelbësore; ai nuk merr dritë nga ndonjë yll tjetër. Këto Vendagime të mëngjesit të Unitetit janë burimet e bujarisë dhe pasqyrat e Thelbit të Realitetit.

Profetët e tjerë janë pasues e mbështetës, sepse ata janë degë e jo të pavarur; ata marrin bujari prej Profetëve të pavarur dhe përfitojnë nga

drita Udhërrëfyese e Profetëve universalë. Ata janë si hëna, e cila nuk është e ndritshme e rrezatuese në vetvete, por e merr dritën nga dielli.

Manifestimet e Profetërisë universale, të Cilët shfaqen në mënyrë të pavarur, janë, për shembull, Abrahami, Moisiu, Krishti, Muhameti, Báb-i dhe Bahá'u'lláh-u. Por ka të tjerë që janë pasues e mbështetës, si Sollomoni, Davidi, Isaia, Jeremia dhe Ezekieli. Sepse Profetët e pavarur janë themelues; Ata krijojnë një fe të re dhe i bëjnë njerëzit krijesa të reja; ata ndryshojnë moralin e përgjithshëm, nxjerrin zakone e rregulla të reja, përtërijnë ciklin dhe Ligjin. Dalja e tyre është si stina e pranverës, që i stolis të gjitha qeniet tokësore me një rrobë të re dhe u jep atyre një jetë të re.

Përsa u përket llojit të dytë të Profetëve, që janë pasues, edhe këta përhapin Ligjin e Perëndisë, bëjnë të njohur Fenë e Perëndisë dhe shpallin Fjalën e Tij. Ata nuk kanë pushtet e fuqi të vetën, veç asaj që marrin prej Profetëve të pavarur.

Pyetje.— Cilës kategori i përkasin Buda dhe Konfuci?

Përgjigje.—Buda gjithashtu themeloi një fe të re, dhe Konfuci përtëriu moralin dhe virtytet e lashta, por institucionet e tyre janë shkatërruar krejtësisht. Besimet dhe ritet e Budistëve e të Konfucianëve nuk vazhduan në përputhje me mësimet e tyre themelore. Themeluesi i Budizmit ishte një shpirt i mrekullueshëm. Ai vendosi Njëshmërinë e Perëndisë, por më pas parimet fillestare të doktrinave të Tij graduaisht u zhdukën dhe zakone e ceremoni rituale injorante lindën e u përhapën derisa më në fund çuan në adhurimin e statujave e të figurave.

Shihni tani: Krishti e ka përsëritur shpesh se Dhjetë Porositë e Pesëlibërshit duhej të zbatoheshin dhe këmbënguli se ato duheshin mbajtur. Ndër Dhjetë porositë njëra thotë: “Mos adhuro asnjë pikturë e shëmbëlltyrë”.¹⁴⁴ Sot, në disa prej kishave të krishtera ka shumë piktura e shëmbëlltyra. Është, pra, e qartë e duket vetiu se Feja e Perëndisë nuk i ruan parimet e veta fillestare midis njerëzve, por ka ndryshuar e është ndërruar gradualisht, derisa është shkatërruar e eliminuar krejtësisht. Për këtë arsye manifestimi përtërihet dhe krijohet një fe e re. Por sikur

¹⁴⁴ Shih Eksodi 20:4; Deut. 5:8-9.

fetë të mos ndryshonin e modifikoheshin, nuk do të kishte nevojë për përtëritje.

Në fillim, pema ekzistonte në tërë bukurinë e vet, plot sythe e fryte, por, më në fund, u vjetërua e u bë krejtësisht shterpë, u tha e u kalb. Ja përse Kopshtari i Vërtetë mbjell sërish një pemë të re e të pakrahasueshme të të njëjtit lloj e specie, e cila rritet e zhvillohet dita ditës, përhap një hije të madhe në oborrin hyjnor dhe jep fryte të admirueshme. Kështu ndodh edhe me fetë; me kalimin e kohës, ato ndryshojnë në krahasim me themelin e tyre fillestar, e vërteta e Fesë së Perëndisë zhduket krejtësisht dhe nuk mbetet as fryma e saj; lindin herezi dhe ajo bëhet një trup pa shpirt. Ja përse ajo përtërihet.

Kuptimi është që budistët dhe konfucianët tani adhurojnë shëmbëlltyra e statuja. Ata tregohen krejt të pavëmendshëm ndaj Njëshmërisë së Perëndisë dhe besojnë në perëndi imagjinare si grekët e lashtë. Por në fillim nuk ishte kështu; kishte parime e rregulla të tjera.

Gjithashtu, mendoni sesi parimet e fesë së Krishtit janë harruar dhe sa herezi janë shfaqur. Për shembull, Krishti i ndaloi hakmarrjen e krimin; për më tepër, Ai porosiste që dashamirësia e mëshira të ishin përgjigja ndaj fyerjes e së keqes. Pa mendoni tani sa luftëra të përgjakshme kanë ndodhur dhe sa shtypje, mizori, egërsi e etje për gjak ka pasur midis vetë kombeve të krishtera! Shumë perj këtyre luftërave janë zhvilluar me urdhër të Papëve. Është, pra, e qartë e duket vetiu se me kalimin e kohës fetë ndryshojnë e ndërrohen krejtësisht. Prandaj përtërihen.

44

SHPJEGIM I QORTIMEVE QË PERËNDIA U KA BËRË PROFETËVE

Pyetje.—Në Librat e Shenjtë ka disa fjalë qortimi e vërejtjeje që u drejtohen Profetëve. Kujt i drejtohen e për kë janë qortimet?

Përgjigje.—Të gjitha thëniet hyjnore që përmbajnë qortime, edhe pse në dukje u drejtohen profetëve, në të vërtetë u drejtohen njerëzve,

me një urtí që është mëshirë absolute, me qëllim që njerëzit të mos dekurajohen e të mos humbasin besimin në vetvete. Pra, ato duket sikur u drejtohen Profetëve; por megjithëse nga ana e jashtme janë për Profetët, në të vërtetë janë për njerëzit e jo për Profetët.

Për më tepër, një mbret i fuqishëm e i pavarur përfaqëson vendin e tij: ajo që ai thotë është fjalë e të gjithëve, dhe çdo marrëveshje që ai bën është marrëveshje e të gjithëve, sepse dëshirat e aspiratat e të gjithë nënshtetasve të tij përfshihen në dëshirat e aspiratat e tij. Po kështu, çdo Profet është shprehja e një populli të tërë. Kështu që premtimi dhe fjala e Perëndisë që i drejtohet Atij u drejtohet të gjithëve. Në përgjithësi fjala e qortimit dhe e vërejtjes është tepër e ashpër për njerëzit dhe do t'ua thyente zemrën atyre. Prandaj Urtia e Përsosur përdor këtë formë të foluri, siç tregohet qartë në vetë Biblën, si për shembull kur bijtë e Izraelit u rebeluan e i thanë Moisiut: “Ne nuk mund të luftojmë me amalekitët, sepse ata janë të fuqishëm, të fortë e të guximshëm”. Atëherë Perëndia qortoi Moisiun dhe Aaronin, edhe pse Moisiu ishte plotësisht i bindur e jo i rebeluar. Sigurisht një Njeri i tillë i madh, I Cili është ndërmjetësi i Bujarisë Hyjnore dhe sjellësi i Ligjit, duhet medoemos t'u bindet urdhërave të Perëndisë. Këta Shpirtra të Shenjtë janë si gjethet e një peme, që vihen në lëvizje prej erës që fryn e jo prej dëshirës së Tyre; sepse Ata i tërheq flladi i dashurisë së Perëndisë dhe vullneti i Tyre është krejt i nënshtuar. Fjala e Tyre është fjala e Perëndisë; porosia e Tyre është porosia e Perëndisë; ajo që ndalojnë Ata është e ndaluar prej Perëndisë. Ata janë si qelqi i globit që e merr dritën nga llamba. Megjithëse drita duket sikur del nga qelqi, në të vërtetë ajo ndriçon nga llamba. Kështu është edhe me Profetët e Perëndisë, qendrat e manifestimit, lëvizja dhe prehja e Tyre vijnë nga frymëzimi hyjnor e jo nga pasione njerëzore. Po të mos ishte kështu, si mund të ishte i denjë për t'u besuar Profeti dhe si mund të ishte Ai Lajmëtar i Perëndisë, që sjell porositë dhe ndalimet e Perëndisë? Të gjitha mangësitë që përmenden në Librat e Shenjtë lidhur me Manifestimet u referohen çështjeve të këtij lloji.

Lavdi Zotit që ju erdhët këtu dhe njohët shërbëtorët e Perëndisë! A keni vënë re tek ata gjë tjetër veç aromës së pëlqimit të Perëndisë? Me të vërtetë, jo. Ju e keni parë me sytë tuaj se ata ditë e natë përpiqen e luftojnë, dhe ata nuk kanë tjetër qëllim veç lartësimit të fjalës së

Perëndisë, edukimit të njerëzve, përmirësimit të masave, përparimit shpirtëror, sigurimit të paqes universale, dashamirësisë për gjithë njerëzimin dhe mirësisë ndaj të gjitha kombeve. Duke flijuar veten për të mirën e njerëzimit, ata janë të shkëputur nga përfitimet materiale dhe punojnë për t'i dhënë njerëzimit virtyte.

Por le të kthehemi te subjekti ynë. Për shembull, në Dhiatën e Vjetër, në Librin e Isaisë, kreu 48, vargu 12, thuhet: “Më dëgjo, o Jakov, Izrael, që të kam thirrur. Unë jam Ai; Unë jam i pari, dhe Unë jam i fundit”. Duket vetiu se kjo nuk nënkupton Jakovin që ishte Izraeli, por popullin e Izraelit. Po kështu në Librin e Isaisë, kreu 43, vargu 1, thuhet: “Dhe tani kështu thotë Zoti Që të ka krijuar ty, o Jakov, dhe Që të ka formuar ty, o Izrael: Mos ki frikë, sepse Unë të kam shpëtuar, të kam thirrur me emër—ti je Imi”.

Për më tepër, në Numrat, kreu 20, vargu 23, është shkruar: “Dhe Zoti i foli Moisiut dhe Aaronit në malin Hor, në kufirin e tokës së Edomit, dhe tha: “Aaroni do të bashkohet me popullin e vet: ai nuk do të shkelë në tokën që u kam dhënë bijve të Izraelit, sepse ju ngritët krye kundër urdhrit Tim te ujët e Meribës”;¹⁴⁵ dhe në vargun 13: “Ky është ujët e Meribës, ku bijtë e Izraelit u zunë me Zotin, dhe Ai u bë i shenjtëruar midis tyre”.

Shikoni: populli i Izraelit u rebelua, por në dukje qortimi iu drejtua Moisiut dhe Aaronit. Siç thuhet në Librin e Deuteronomisë, kreu 3, vargu 26: “Por Zoti u zemërua me Mua për shkakun tuaj dhe nuk deshi të më dëgjojë; dhe Zoti Më tha: “Mjaft me kaq; mos Më fol më për këtë!”

Pra, këto fjalë e ky qortim në të vërtetë u referohen bijve të Izraelit, të cilët, për shkak se u rebeluan kundër urdhrit të Perëndisë, u mbajtën rob për një kohë të gjatë në shkretëtirën e thatë, në anën tjetër të Jordanit, deri në kohën e Jozueit—përsëritur qoftë ai. Këto fjalë e ky qortim dukej sikur ishin për Moisiun e Aaronin, por në të vërtetë ishin për popullin e Izraelit.

Po kështu në Kuran Muhametit i thuhet: “Ne të kemi dhënë Ty një fitore të shquar, që Perëndia të mund të Ta falë mëkatin Tënd të

¹⁴⁵ Numrat 20:23-24.

mëparshëm e të pastajmë”.¹⁴⁶ Këto fjalë, megjithëse në dukje i drejtohen Muhametit, ishin në të vërtetë për gjithë popullin. Kjo mënyrë të foluri, siç e kemi thënë, është përdorur nga urtia e përsosur e Perëndisë, që të mos shqetësohen, tronditen e torturohen zemrat e njerëzve.

Sa shpesh Profetët e Perëndisë dhe Manifestimet e Tij supreme pranojnë në lutjet e Tyre mëkatet e fajet e Veta! Kjo bëhet vetëm për t’i mësuar njerëzit e tjerë, për t’i inkurajuar e nxitur ata të jenë të përlulur e të butë dhe për t’i shtyrë të pranojnë mëkatet e fajet e veta. Sepse këta Shpirtra të Shenjtë janë të pastër nga çdo mëkat e të lirë nga fajet. Në Ungjill thuhet se një njeri erdhi te Krishti dhe e quajti “Mjeshtër i mirë”. Krishti u përgjegj “Përse më quan i mirë? Nuk ka të mirë, veçse Një: Perëndia”.¹⁴⁷ Kjo nuk do të thotë—mos e dhëntë Zoti!—se Krishti ishte mëkatar; por qëllimi ishte t’i mësonte njeriut të cilit i foli të ishte i nënshtruar, i përlulur, i butë e modest. Këto qenie të Shenjta janë drita, dhe drita nuk bashkohet me errësirën. Ata janë jetë, dhe jeta e vdekja nuk ngatërrohen. Ata janë udhërrëfim, dhe udhërrëfimi e gabimi nuk mund të jenë bashkë. Ata janë thelbi i bindjes, dhe bindja nuk mund të bashkëjetojë me rebelimin.

Si përfunfim, të folurit në formë qortimi që gjendet në Librat e Shenjtë, edhe pse në dukje u drejtohet Profetëve, domethënë Manifestimeve të Perëndisë, në të vërtetë synon popullin. Kjo do të jetë e qartë e do të duket vetiu kur të keni studiuar me zell Librat e Shenjtë.

Ju përshëndes.

45

SHPJEGIM I VARGUT TË QITAPI AKDAS-IT “NUK KA SHOK PËR ATË QË ËSHTË AGIMI I REVELACIONIT NË

¹⁴⁶ Shih Kurani 48:1-2.

¹⁴⁷ Mateu 19:16, 17.

PAGABUESHMËRINË E TIJ SUPREME¹⁴⁸

Thuhet në vargun e shenjtë: “Nuk ka shok për Atë Që është Agimi i Revelacionit¹⁴⁸ në Pagabueshmërinë e Tij Supreme. Ai, në të vërtetë, është shprehje e fjalëve ‘Perëndia bën çdo gjë që dëshiron’ në mbretërinë e krijimit. Në të vërtetë, Fuqiploti e ka rezervuar këtë pozitë vetëm për Vetën e Tij dhe askush nuk ka pjesë në këtë shquarsí sublime e tepër të lartësuar”.¹⁴⁹

Dijeni se pagabueshmëria është dy llojesh: pagabueshmëri thelbësore dhe pagabueshmëri e fituar. Po kështu ka dije thelbësore dhe dije të fituar; e kështu ndodh edhe me emra e attribute të tjera. Pagabueshmëria thelbësore është veti e veçantë e Manifestimit suprem, sepse përbën një kërkesë thelbësore të Tij, dhe një kërkesë thelbësore nuk mund të ndahet nga vetë objekti. Rrezet përbëjnë domosdoshmërinë thelbësore të diellit dhe janë të pandara prej tij. Dija është një domosdoshmëri thelbësore e Perëndisë dhe është e pandarë prej Tij. Fuqia është një domosdoshmëri thelbësore e Perëndisë dhe është e pandarë prej Tij. Sikur të mund të ndahej prej Tij, Ai nuk do të ishte Perëndi. Sikur rrezet të mund të ndaheshin nga dielli, ai nuk do të ishte diell. Prandaj, po qe se dikush imagjinon ndarje të Pagabueshmërisë Supreme nga Manifestimi suprem, Ai nuk do të ishte Manifestim suprem, dhe nuk do të kishte përsosuritë thelbësore.

Por pagabueshmëria e fituar nuk është një domosdoshmëri e natyrshme; përkundrazi është një rreze e dhuntisë së pagabueshmërisë që ndriçon mbi zemrat nga Dielli i Realitetit dhe u jep shpirttrave një pjesë nga vetvetja. Edhe pse këta shpirttra nuk kanë pagabueshmëri thelbësore, por ato janë nën mbrojtjen e Perëndisë, domethënë Perëndia i mbron nga gabimi. Kështu shumë prej qenieve të shenjta që nuk ishin agime të Pagabueshmërisë Supreme, përsëri u përmbajtën e u ruajtën nga gabimi nën hijen e mbrojtjes e të kujdesit të Perëndisë, sepse ata ishin ndërmjetësit e hirit midis Perëndisë e njerëzve. Në qoftë se

¹⁴⁸ Manifestimi i Perëndisë.

¹⁴⁹ Qitapi Akdas [Kitáb-i-Aqdas]: dmth Libri Më i Shenjtë. Vepra kryesore e Bahá'u'lláh-ut, që përmban pjesën më të madhe të porosive të Tij. Është baza e parimeve të Besimit Bahá'í.

Perëndia nuk do t'i mbronte ata nga gabimi, gabimi i tyre do të bëhej shkak që shpirtat besimtarë të binin në gabim dhe kështu themelet e Fesë së Perëndisë do të lëkundeshin, gjë që nuk do të ishte as e përshtatshme as e denjë për Perëndinë.

Që ta përmbledhim: pagabueshmëria thelbësore u përket posaçërisht Manifestimeve supreme, kurse pagabueshmëria e fituar i jepet çdo shpirti të shenjtë. Për shembull, Shtëpia Universale e Drejtësisë,¹⁵⁰ po qe se vendoset në kushtet e nevojshme—me anëtarë të zgjedhur nga gjithë populli—ajo Shtëpi e Drejtësisë do të jetë nën mbrojtjen dhe udhëheqjen e pagabuar të Perëndisë. Në rast se ajo Shtëpi e Drejtësisë do të vendosë njëzëri, ose me shumicë votash, për çdo çështje që nuk përmendet në Libër,¹⁵¹ ai vendim e ajo porosi do të ruhet nga gabimi. Tani, anëtarët e Shtëpisë së Drejtësisë individualisht nuk kanë pagabueshmëri thelbësore; por Shtëpia e Drejtësisë si organ është nën mbrojtjen e udhëheqjen e pagabueshme të Perëndisë: kjo quhet pagabueshmëri e dhënë.

Me pak fjalë, thamë se “Agimi i Revelacionit” është manifestim i fjalëve “Ai bën çdo gjë që dëshiron”; kjo gjendje është e veçantë për atë Qenie të Shenjtë, dhe të tjerët nuk kanë pjesë në këtë përsosuri thelbësore. Domethënë, meqë Manifestimet supreme sigurisht zotërojnë pagabueshmëri thelbësore, çdo gjë që del prej tyre është baras me të vërtetën e në përputhje me realitetin. Ata nuk janë nën hijen e ligjeve të mëparshme. Çdo gjë që thonë Ata është Fjalë e Perëndisë dhe çdo gjë që bëjnë është veprim i drejtë. Asnjë besimtar nuk ka të drejtë të kritikojë; pozita e tij duhet të jetë ajo e nënshtimit absolut, sepse Manifestimi del me urti të përsosur—kështu që çdo gjë që thotë e bën Manifestimi suprem është urti absolute e në përputhje me realitetin.

¹⁵⁰ Shtëpia e Drejtësisë (*Baytu'l-Adl*) është një institucion i krijuar nga Bahá'u'lláh-u. Ai u referohet dy niveleve të këtij institucioni: Shtëpitë Lokale të Drejtësisë, përgjegjëse për çdo qytet e fshat, dhe Shtëpia Universale e Drejtësisë. ‘Abdu'l-Bahá-i, në Vullnetin e Testamentin e Tij shtoi një nivel ndërmjetës, Shtëpitë Dytësore të Drejtësisë. Vetëm Shtëpisë Universale të Drejtësisë i është dhënë pagabueshmëria. Në kohën e tanishme, për të theksuar funksionet e tyre thjesht shpirtërore, Shtëpitë Lokale e Dytësore të Drejtësisë janë quajtur Asamble Shpirtërore Lokale e Kombëtare.

¹⁵¹ Në Librin Më të Shenjtë.

Në qoftë se disa nuk e kuptojnë sekretin e fshehur të ndonjë prej porosive e veprimeve të Tij, ata nuk duhet t'i kundërvihen, sepse Manifestimi suprem bën atë që dëshiron. Sa shpesh ka ndodhur që, kur një veprim është kryer nga një njeri i urtë, i përsosur e i zgjuar, të tjerë, të paaftë për të kuptuar urtinë e tij, e kanë kundërshtuar atë dhe janë habitur sesi ky njeri i urtë mund të thotë ose të bëjë një gjë të tillë. Kjo kundërvënie vjen nga injoranca e tyre, dhe mençuria e të urtit është e kulluar dhe e përjashtuar nga gabimi. Po kështu, doktori i aftë në trajtimin e të sëmurit bën atë që dëshiron, dhe i sëmuri nuk ka të drejtë ta kundërshtojë; çdo gjë që thotë e bën doktori është e drejtë; të gjithë duhet ta konsiderojnë atë shprehje të fjalëve “Ai bën çdo gjë që dëshiron dhe urdhëron çdo gjë që dëshiron”. Është e sigurt se doktori do të përdorë disa ilaçe që janë në kundërshtim me mendimin që kanë disa njerëz të tjerë; dhe kundërshtimi nuk u lejohet atyre që nuk kanë epërsinë të njohin shkencës e artin mjekësor. Jo, për Perëndi! Përkundrazi, të gjithë duhet të jenë të nënshtuar e të bëjnë atë që thotë doktori i aftë. Prandaj doktori i aftë bën atë që dëshiron, dhe i sëmuri nuk ka pjesë në këtë të drejtë. Më parë duhet siguruar për aftësinë e doktorit; por kur aftësia e doktorit është e sigurt, ai bën atë që dëshiron.

Po kështu, edhe kur udhëheqësi i një ushtrie është i pashoq në artin e luftës, në atë që ai thotë e urdhëron bën atë që dëshiron. Kur kapiteni i një anije është me përvojë në artin e lundrimit, në çdo gjë që ai thotë e urdhëron bën atë që dëshiron. Dhe, me qenë se edukatori i vërtetë është Njeriu i Përsosur, në çdo gjë që thotë e urdhëron Ai bën atë që dëshiron.

Me pak fjalë, kuptimi i thënies “Ai bën atë që dëshiron” është që, në rast se Manifestimi thotë diçka, ose jep një urdhër, ose kryen një veprim dhe besimtarët nuk e kuptojnë urtinë e kësaj, ata përsëri nuk duhet ta kundërshtojnë këtë qoftë edhe me një mendim të vetëm, duke kërkuar të dinë përse Ai foli kështu ose përse bëri një gjë të tillë. Shpirtrat e tjerë që janë nën hijen e Manifestimeve supreme i nënshtrohen porosive të Ligjit të Perëndisë dhe nuk duhet të shmangen qoftë edhe një fije floku prej tyre; ata duhet t'ia përshtatin veprimet dhe fjalët e tyre Ligjit të Perëndisë. Po u shmangën prej tij, ato do të mbajnë përgjegjësi e do të qortohen në prani të Perëndisë. Është e sigurt se ata

nuk kanë pjesë në “Ai bën çdo gjë që dëshiron”, sepse kjo është një gjendje e posaçme e Manifestimeve supreme.

Kështu Krishti—u bëftë fli shpirti im për Të!—Ishte manifestimi i fjalëve “Ai bën çdo gjë që dëshiron”, por dishepujt nuk kishin pjesë në këtë pozitë; sepse, duke qenë nën hijen e Krishtit, ata nuk mund të shmangeshin nga porositë e vullneti i Tij.

Pjesa e Katërt

PËR PREJARDHJEN, AFTËSITË DHE KUSHTET E NJERIUT

46

NDRYSHIMI I LLOJEVE

Kemi arritur të çështja e ndryshimit të llojeve dhe e zhvillimit organik—domethënë në pikën e hulumtimit nëse njeriu vjen nga kafsha.

Kjo teori ka gjetur besim në mendjen e disa filozofëve evropianë dhe tani është shumë vështirë të kuptohet gabueshmëria e saj, por në të ardhmen kjo do të bëhet e dukshme dhe e qartë, dhe filozofët evropianë do ta kuptojnë vetë pavërtetësinë e saj. Sepse, në të vërtetë, ajo është gabim që duket sheshit. Kur njeriu i shikon qeniet me sy depërtues dhe shqyrton me vëmendje kushtet e ekzistencës, dhe kur sheh gjendjen, organizimin dhe përsosurinë e botës, ai do të bindet se në botën e mundshme nuk ka asgjë më të mahnitshme sesa ajo që tashmë ekziston. Sepse të gjitha qeniet ekzistuese, tokësore e qiellore, si dhe kjo hapësirë e paanë dhe çdo gjë që është në të, janë krijuar e organizuar, janë formuar, rregulluar e përsosur ashtu si duhet; gjithësia nuk ka papërsosuri, kështu që, sikur të gjitha qeniet të bëheshin inteligjencë e kulluar e të reflektonin përjetë e pareshtur, do të ishte e pamundur që ato të imagjinonin diçka më të mirë se ajo që ekziston.

Megjithatë, sikur në të kaluarën krijimi të mos kish qenë stolisur me përsosurinë më të madhe, atëhere ekzistenca do të kish qenë e papërsosur e pa kuptim dhe në këtë rast krijimi do të kish qenë jo i plotë. Kjo çështje duhet shqyrtuar me vëmendjen e kujdesin më të madh. Për shembull, përfytyroni që bota e rastësishme i përngjet përgjithësisht trupit të njeriut. Po që se kjo përbërje, ky organizim, kjo përsosuri, bukuri e plotësi që ekzistojnë tani në trupin njerëzor do të ishin të ndryshme, kjo do të ishte papërsosuri absolute. Tani, sikur të përfytyrojmë një kohë kur njeriu i përkiste botës shtazore, ose kur ai ishte thjesht një kafshë, do të shohim se ekzistenca do të kishte qenë e papërsosur—domethënë nuk do të kishte qenë njeriu, dhe kjo pjesë kryesore, që në trupin e botës është si truri dhe mendja tek njeriu, do të mungonte. Atëherë bota do të kishte qenë krejt e papërsosur. Kështu provohet që, po të kishte pasur një kohë kur njeriu bënte pjesë në mbretërinë shtazore, përsosuria e ekzistencës do të ishte asgjësuar; sepse njeriu është pjesëtari më i madh i kësaj bote dhe, në qoftë se trupi do të kish qenë pa këtë pjesë kryesore, ai me siguri do të ish i papërsosur. Ne e konsiderojmë njeriun si pjesëtarin më të madh, sepse midis krijesave ai është tërësia e të gjitha përsosurive ekzistuese. Kur flasim për njeriun, kemi parasysh njeriun e përsosur, individin numër një në botë, që është tërësia e përsosurive shpirtërore e të dukshme dhe që është si dielli midis qenieve. Atëherë mendoni sikur dielli dikur të mos ekzistonte, por ai të ishte një planet; me siguri që në atë kohë marrëdhëniet e ekzistencës do të ishin të çrregulluara. Si mund të përfytyrohet një gjë e tillë? Për një njeri që e studion botën e ekzistencës, kjo që thamë është e mjaftueshme.

Ka edhe një provë tjetër më të hollë: të gjitha këto qenie të panumërta që banojnë në botë, njerëz, kafshë, bimë a minerale qofshin—çfarëdo që të jenë—janë sigurisht, secila prej tyre, të përbëra prej elementesh. Nuk ka dyshim se kjo përsosuri që ekziston në të gjitha qeniet e ka shkakun në krijimin e kryer nga Perëndia me elementet përbërës, në ndërthurjen e tyre të përshtatshme e në sasi të përpjesëtuara; në mënyrën e përbërjes së tyre dhe në ndikimin e qenieve të tjera. Sepse të gjitha qeniet janë të lidhura së bashku si një zinxhir; dhe ndihma e ndërsjelltë, përkrahja e ndërveprimi që kanë vetitë e gjërave janë shkaqet e ekzistencës, të zhvillimit e të rritjes së qenieve të

krijua. Është vërtetuar me fakte e prova se çdo qenie përgjithësisht vepron mbi qenie të tjera, qoftë në mënyrë absolute ose të tërthortë. Më në fund, përsosuria e çdo qenieje individuale—domethënë përsosuria që ju tani e shihni te njeriu ose jashtë tij, përsa u përket atomeve, pjesëve ose aftësive të tyre—i detyrohet përbërjes së elementeve, përmasës së tyre, baraspeshës së tyre, mënyrës së kombinimit të tyre dhe ndikimit të ndërsjelltë. Kur të gjitha këto mblidhen së bashku, atëherë ekziston njeriu.

Duke qenë se përsosuria e njeriut i detyrohet tërësisht përbërjes së atomeve të elementeve, masës së tyre, mënyrës së kombinimit të tyre dhe ndikimit e ndërveprimit të ndërsjelltë të qenieve të ndryshme—atëherë, derisa njeriu është krijuar dhjetë ose njëqind mijë vjet më parë prej këtyre elementeve tokësore me të njëjtën masë e baraspeshë, me të njëjtën mënyrë kombinimi e ndërthurjeje dhe me të njëjtin ndikim mbi qeniet e tjera, bash ky njeri ka ekzistuar atëherë si dhe tani. Kjo është e qartë dhe nuk ia vlen të diskutohet. Sikur pas një mijë milionë vjetësh këto elemente të njeriut të mblidheshin së bashku dhe të rregulloheshin në këto përmasa të posaçme, dhe sikur elementet të kombinoheshin sipas së njëjtës mënyrë, dhe sikur mbi ta të ushtrohej i njëjti ndikim i qenieve të tjera, do të ekzistonte bash i njëjti njeri. Për shembull, në qoftë se pas njëqind mijë vjetësh ka naftë, zjarr, një fitil, një llambë dhe është ai që e ndez llambën—me një fjalë, në qoftë se janë të gjitha gjërat e nevojshme që ekzistojnë tani, do të kemi bash të njëjtën llambë.

Këto janë fakte përfundimtare e që duken sheshit. Por argumentet që kanë përdorur këta filozofë evropianë mbështeten në prova të dyshimta dhe nuk janë vendimtare.

47

GJITHËSIA NUK KA FILLIM

PREJARDHJA E NJERIUT

Dijeni se një prej të vërtetave më të ndërlikuara shpirtërore është se bota e ekzistencës—domethënë kjo gjithësi e pafundme—nuk ka fillim.

E kemi shpjeguar tashmë se vetë emrat e atributet e Hyjnisë kërkojnë ekzistencën e qenieve. Megjithëse ky subjekt është shpjeguar me hollësi, do të flasim përsëri shkurtimisht për të. Dijeni se një edukator pa nxënës nuk mund të përfytyrohet; një monark pa nënshtetas nuk mund të ekzistojë; një mësues pa shkollarë nuk ka përse të caktohet; një krijues pa krijesë është i pamundur; një drejtues pa të drejtuar nuk mund të konceptohet; sepse të gjithë emrat e atributet hyjnore kërkojnë ekzistencën e qenieve. Po të mund të përfytyronim një kohë kur nuk ekzistonin kurrfarë qeniesh, ky përfytyrim do të sillte mohimin e Hyjnisë së Perëndisë. Për më tepër, mosekzistenca absolute nuk mund të bëhet ekzistencë. Sikur qeniet të ishin absolutisht mosekzistuese, ekzistenca nuk mund të krijohej. Prandaj, meqenëse Thelbi i Unitetit (domethënë ekzistenca e Perëndisë) është i pasosur e i përjetshëm—domethënë nuk ka as fillim as fund—është e sigurt se kjo botë e ekzistencës, kjo gjithësi e pafundme, nuk ka as fillim as fund. Po, mund të ndodhë që një prej pjesëve të gjithësisë, një prej rruzujve, për shembull, të lindë ose të shpërbëhet, por vazhdojnë të ekzistojnë rruzuj të tjerë të panumërt; gjithësia as do të pësjellohej as do të shkatërrohetj Përkundrazi, ekzistenca është e përjetshme dhe e përhershme. Çdo rruzull ashtu siç ka një fillim, patjetër ka edhe një fund, për arsye se çdo gjë e përbërë, kolektive ose e veçantë, medoemos duhet të shpërbëhet. I vetmi ndryshim është se disa gjëra shpërbëhen shpejt dhe të tjera më ngadalë, por është e pamundur që një gjë e përbërë të mos shpërbëhet më në fund.

Është, pra, e nevojshme të dimë se çfarë ka qenë në fillim secila prej ekzistencave të rëndësishme—sepse nuk ka dyshim që në fillim prejardhja ka qenë një: prejardhja e të gjithë numrave është një e jo dy. Pra është e qartë se në fillim materia ishte një dhe se kjo materie shfaqej në aspekte të ndryshme në çdo element. Kështu, u krijuan forma të ndryshme dhe këto aspekte të ndryshme, pasi u krijuan, u bënë të qëndrueshme dhe çdo element u specializua. Por kjo qëndrueshmëri nuk ishte e përcaktuar dhe nuk e arriti realizimin e ekzistencën e përsosur veçse pas një kohe shumë të gjatë. Patsaj këto elemente u përbënë, u organizuan e u kombinuan në forma të panumërta; ose më mirë të themi, nga përbërja e kombinimi i këtyre elementeve u krijuan qenie të panumërta.

Kjo përbërje e ky rregullim, falë urtisë së Perëndisë dhe fuqisë së Tij të paraqenëshme, u krijuan nga një organizim natyror, të përbërë e të kombinuar me forcën më të madhe, në pajtim me urtinë e sipas një ligji universal. Që këtej del qartë se kjo është krijim i Perëndisë dhe jo një renditje e rregullim i rastësishëm. Ja përse prej çdo përbërjeje natyrore mund të krijohet një qenie, por nga një përbërje e rastësishme nuk mund të krijohet asnjë qenie. Për shembull, në qoftë se një njeri me mendjen e inteligjencën e tij mbledh disa elemente dhe i kombinon ato, nuk do të krijohet një qenie e gjallë meqë sistemi nuk është i natyrshëm. Kjo është përgjigja për pyetjen e nënkuptuar që, meqenëse qeniet formohen nga përbërja e kombinimi i elementeve, përse nuk është e mundur që ne t'i mbledhim këto elemente, t'i përziejmë së bashku dhe të krijojmë kështu një qenie të gjallë. Kjo është një hipotezë e gabuar, sepse prejardhja e kësaj përbërjeje është nga Perëndia; është Perëndia që bën kombinimin dhe kjo bëhet sipas sistemit natyror, nga çdo kombinim krijohet një qenie dhe realizohet një ekzistencë. Një kombinim i bërë nga njeriu nuk jep asgjë, sepse njeriu nuk është në gjendje të krijojë.¹⁵²

Me pak fjalë, thamë se nga përbërja dhe kombinimi i elementeve, nga shpërbërja e tyre, nga masa e tyre dhe nga veprimi i qenieve të tjera mbi to, kanë rezultuar forma, realitete të pafundme dhe qenie të panumërta. Por është e qartë se ky rruzull tokësor në formën e tij të tanishme nuk është krijuar menjëherë, se kjo ekzistencë universale ka kaluar gradualisht përmes fazash të ndryshme, derisa është stolisur me përsosurinë e tij të tanishme. Qeniet universale ngjasin e mund të krahasohen me qenie të veçanta, sepse të dyja i nënshtrohen një sistemi të vetëm natyror, një ligji universal e një organizimi të vetëm hyjnor. Kështu, do të shihni se atomet më të vogla në sistemin universal janë të ngjashme me qeniet më të mëdha të gjithësisë. Është e qartë se ato vijnë nga i njëjti laborator i fuqisë, që i nënshtrohet një sistemi natyror e një ligji të vetëm universal; prandaj ato mund të krahasohen me njëra-tjetrën. Kështu embrioni i njeriut në barkun e nënës rritet e zhvillohet

¹⁵² Kur thuhet se “njeriu nuk mund të krijojë”, autori ka parasysh se ai nuk është në gjendje të krijojë qenie të gjalla duke kombinuar elementet përbërëse të tyre; p.sh. ai nuk është në gjendje të krijojë një bimë, në kafshë ose një njeri tjetër përmes kombinimesh të tilla.—Shën. i red.

gradualisht, shfaqet në forma e gjendje të ndryshme, derisa në shkallën e bukurisë së përsosur arrin pjekurinë dhe shfaqet në një formë të përkryer me hijeshinë më të madhe. Dhe po kështu, fara e kësaj luleje që shihni ishte në fillim diçka e papërfillshme e shumë e vogël; ajo u rrit e u zhvillua në gjirin e tokës dhe, pasi mori forma të ndryshme, u shfaq në këtë gjendje me freski e hijeshi të përkryer. Në të njëjtën mënyrë, është e qartë se ky rruzull tokësor, pasi erdhi në jetë, u rrit e u zhvillua në mitrën e gjithësisë dhe u shfaq në forma e gjendje të ndryshme, derisa arriti gradualisht përsosurinë e tij të tanishme dhe u stolis me qenie të panumërta, dhe u shfaq si një organizim i përkryer.

Është, pra, e qartë se materia fillestare, që është gjendja embrionale, dhe elementet e përzier e të kombinuar që ishin format e saj më të hershme, u rritën e u zhvilluan gradualisht gjatë shumë epokave e cikleve, duke kaluar nga njëra trajtë e formë në tjetrën, derisa u shfaqën në këtë përsosuri, në këtë sistem, organizim e ndërtim, falë urtisë supreme të Perëndisë.

Të kthehemi në subjektin tonë që njeriu, në filim të ekzistencës së tij e në gjirin e tokës, ashtu si embrioni në barkun e nënës, gradualisht u rrit e u zhvillua, kaloi nga një formë në tjetrën, nga një trajtë në tjetrën, derisa u shfaq me këtë bukuri e përsosuri, me këtë forcë e fuqi që ka sot. Është e sigurt se në fillim ai nuk kishte këtë bukuri, hir e hijeshi, dhe se vetëm shkallë-shkallë arriti këtë trajtë, këtë formë, këtë bukuri e këtë hir. Nuk ka dyshim se embrioni njerëzor nuk u shfaq menjëherë në këtë formë; dhe as u bë që atëherë manifestim i fjalëve “Bekuar qoftë, pra, Alláhu, më i miri i Krijuesve”.¹⁵³ Ai ka kaluar gradualisht përmes gjendjesh e trajtash të ndryshme, derisa arriti këtë formë e bukuri, këtë përsosuri, këtë hir e hijeshi. Është, pra, e qartë dhe e provuar se zhvillimi dhe rritja e njeriut mbi këtë tokë, derisa arriti përsosurinë e tanishme, i përngjet rritjes e zhvillimit të embrionit në barkun e nënës: shkallë-shkallë ai kaloi nga gjendja në gjendje, nga forma në formë, nga një trajtë në tjetrën, sepse kjo është në pajtim me kërkesën e sistemit universal e të Ligjit Hyjnor.

Pra, embrioni kalon përmes gjendjesh të ndryshme dhe ngjit shkallë të shumta, derisa arrin formën në të cilën manifeston fjalët “Lëvduar

¹⁵³ Kurani 23:14.

qoftë Perëndia, më i miri i Krijuesve” dhe shfaqen shenjat e arsyes e të pjekurisë. Dhe po kështu, ekzistenca e njeriut mbi këtë tokë, që nga fillimi derisa arrin këtë gjendje, këtë formë e kusht, vazhdon medoemos një kohë të gjatë dhe kalon përmes shumë shkallësh derisa arrin këtë kusht. Por që nga fillimi i ekzistencës së njeriut, ai është një specie më vete. Po kështu, embrioni i njeriut në mitrën e nënës ka në fillim një formë të çuditshme; pastaj ky trup kalon nga trajta në trajtë, nga gjendja në gjendje, nga forma në formë, derisa shfaqet me bukurinë e përsosurinë më të madhe. Por edhe kur është në mitrën e nënës e në atë formë të çuditshme, krejt të ndryshme nga forma e figura e tij e sotme, ai është embrioni i species eprore e jo i një kafshe; specia dhe thelbi i tij nuk pësojnë ndryshim. Tani, edhe sikur ta zemë se gjurmët e organeve që janë zhdukur ekzistojnë me të vërtetë, kjo nuk është një provë e mosvazhdimësisë dhe e mosorigjinalitetit të species. Të shumtën kjo provon se forma, pamja dhe organet e njeriut kanë ecur përpara. Njeriu gjithnjë ka qenë një specie e veçantë, njeri e jo kafshë. Kështu, meqenëse embrioni i njeriut në barkun e nënës kalon nga një formë në një tjetër, aq të ndryshme saqë forma e dytë nuk ngjason kurrsesi me të parën, a përbën kjo një provë se specia ka ndryshuar? se në fillim ai ishte një kafshë dhe se organet e tij kanë përparuar e janë zhvilluar derisa ai u bë njeri? Jo, përnjëmend. Sa foshnjarak e pa baza është ky koncept e ky mendim! Sepse prova e origjinalitetit të species njerëzore dhe e vazhdimësisë së natyrës së njeriut është e qartë e duket vetiu.

48

DALLIMI MIDIS NJERIUT DHE KAFSHËS

Kemi folur tashmë nja dy herë për çështjen e shpirtit, por fjalët tona nuk janë mbajtur shënim.

Dijeni se njerëzit u përkasin dy kategorive—domethënë ata përbëjnë dy grupe. Njëri grup e mohon shpirtin dhe thotë se edhe njeriu është një lloj kafshe; sepse ata thonë: A nuk shohim ne se kafshët dhe njerëzit kanë të njëjtat aftësi e shqisa? Këto elemente të thjeshta e të veçanta që mbushin hapësirën janë të kombinuar pambarimisht, dhe nga secili prej

këtyre kombinimeve formohet një prej qenieve. Ndër këto qenie është edhe ajo që zotëron shpirt,¹⁵⁴ aftësi e shqisa. Sa më i përsosur të jetë kombinimi, aq më fisnike është qenia. Kombinimi i elementeve në trupin e njeriut është më i përsosur se përbërja e çdo qenieje tjetër; ai është i ndërthurur në baraspeshë absolute; prandaj është më fisnik e më i përsosur. “Nuk është puna”, thonë ata, “se ai ka ndonjë aftësi e shpirt të veçantë që u mungon kafshëve të tjera: kafshët kanë trup të ndjeshëm, por njeriu në disa aftësi ka më shumë ndjeshmëri, megjithëse përsa u përket shqisave të jashtme, si të dëgjuarit, të parët, të nuhaturit, të prekurit, madje edhe disa aftësi të brendshme si kujtesa, kafsha është e pajisur më mirë se njeriu”. “Edhe kafsha”, thonë ata, “ka inteligjencë e perceptim”. E shumta që ata pranojnë është se inteligjenca e njeriut është më e madhe.

Kjo është ajo që deklarojnë filozofët e sotëm; kjo është ajo që ata thonë, ky është supozimi i tyre, kështu urdhëron imagjinata e tyre. Pra, me argumente e prova të fuqishme ata e çojnë prejardhjen e njeriut prapa deri te kafsha dhe thonë se ka qenë një kohë kur njeriu ishte kafshë, se pastaj specia ndryshoi dhe përparoi pak nga pak, derisa arriti gjendjen e tanishme të njeriut.

Por teologët thonë: Jo, nuk është kështu. Edhe pse njeriu ka aftësi e shqisa të jashtme të përbashkëta me kafshën, megjithatë tek ai ekziston një aftësi e jashtëzakonshme, që kafsha nuk e ka. Shkencat, artet, shpikjet, tregtia e zbulimet e realiteteve janë rezultate të kësaj aftësie shpirtërore. Kjo është një aftësi që përfshin të gjitha gjërat, kupton realitetet e tyre, zbulon të gjitha misteret e fshehura të qenieve dhe falë kësaj dije i kontrollon ato. Ajo madje percepton gjëra që nuk ekzistojnë nga ana e jashtme—domethënë realitete intelektuale që nuk janë shqisore, dhe që nuk kanë ekzistencë të jashtme sepse janë të padukshme; kështu ajo kupton mendjen, shpirtin, vetitë, karakteret, dashurinë e brengën e njeriut, që janë realitete intelektuale. Për më tepër, këto shkenca, arte, ligje ekzistuese e shpikje të pafund të njeriut, ishin dikur sekrete të padukshme, të mistershme e të fshehura; ishte vetëm aftësia gjithëpërfshirëse e njeriut që i ka zbuluar e i ka nxjerrë ato nga sfera e së padukshmes në sferën e së dukshmes. Kështu

¹⁵⁴ Njeriu.

telegrafia, fotografia, fonografia dhe gjithfarë shpikjesh e artesh të tilla të mrekullueshme dikur ishin mistere të fshehura. Realiteti njerëzor i zbuloi e i nxorri ato nga sfera e së padukshmes në sferën e së dukshmes. Ka pasur madje një kohë, kur vetitë e këtij hekuri që shihni—në fakt të të gjitha mineraleve—ishin mistere të fshehura, njerëzit e zbuluan këtë mineral dhe e përpunuan atë në këtë formë industriale. Kështu ka ndodhur me të gjitha zbulimet e shpikjet e tjera të njeriut, që janë të panumërta.

Këtë nuk mund ta mohojmë. Në qoftë se ne themi që këto janë efekte të aftësive që i kanë edhe kafshët dhe të aftësive të shqisave trupore, ne e shohim në mënyrë të qartë e të hapur se kafshët, përsa u përket këtyre aftësive, kanë epërsi ndaj njeriut. Për shembull, shikimi i disa kafshëve është shumë më i mprehtë se i njeriut; po kështu aftësia e tyre e të nuhaturit dhe e të shijuarit. Me pak fjalë, në aftësitë që kafshët dhe njerëzit i kanë të përbashkëta, kafsha është shpesh më e fuqishme. Të marrim, për shembull, aftësinë e kujtesës. Po ta çosh një pëllumb që këtu në një vend të largët e ta lësh të lirë, ai do të kthehet, sepse e mban mend rrugën. Çoni një qen që këtu deri në qendër të Azisë, lëreni të lirë dhe ai do të kthehet përsëri këtu e asnjëherë nuk do ta humbë rrugën. Kështu ndodh edhe me aftësitë e tjera si të dëgjuarit, të parët, të nuhaturit, të shijuarit e të prekurit.

Është, pra, e qartë që po të mos kishte te njeriu një aftësi të ndryshme nga secila prej atyre që kanë kafshët, këto të fundit do të kishin epërsi ndaj njeriut në shpikje e në të kuptuarit e realitetit. Duket, pra, vetiu se njeriu ka një dhunti që kafsha nuk e zotëron. Tani, kafsha percepton gjëra shqisore, por nuk percepton realitete intelektuale. Për shembull, kafsha e sheh atë që është brenda fushës së saj të shikimit, por atë që është tej fushës së saj të shikimit ajo nuk ka mundësi ta perceptojë dhe nuk mund ta përfytyrojë. Kështu kafsha e ka të pamundur të kuptojë që toka ka formën e një rruzulli. Por njeriu prej gjërash të njohura provon gjëra të panjohura dhe zbulon të vërteta të panjohura. Për shembull, njeriu e sheh harkun e horizontit dhe nga kjo nxjerr konkluzionin për rrumbullakësinë e tokës. Ylli Polar në Akra është, për shembull, në 33° —domethënë është në 33° mbi horizont. Kur një njeri shkon drejt Polin të Veriut, Ylli Polar ngrihet një gradë mbi horizont për çdo gradë largësie që ai kalon—domethënë lartësia e

Yllit Polar do të jetë 34^o, pastaj 40^o, pastaj 50^o, pastaj 60^o, pastaj 70^o. Në qoftë se arrin Polin e Veriut, lartësia e Yllit Polar do të jetë 90^o ose do të ketë arritur zenitin—domethënë do të jetë drejtpërdrejt mbi kokë. Ylli Polar dhe ngjitja e tij janë gjëra të ndijueshme. Sa më shumë të shkosh drejt Polit, aq më lart ngrihet Ylli Polar; nga këto dy të vërteta të njohura u zbulua një gjë e panjohur—që horizonti është i harkuar, gjë që do të thotë se horizonti në çdo gradë tokësore është një horizont i ndryshëm nga ai i një grade tjetër. Njeriu e kupton këtë dhe nga një gjë e padukshme provon rumbullakësinë e tokës. Kjo është e pamundur të kuptohet nga kafsha. Po kështu, ajo nuk mund ta kuptojë se dielli është qendra dhe se toka rrotullohet rreth tij. Kafsha është rob i shqisave dhe e lidhur prej tyre; çdo gjë që është tej shqisave, gjërat që janë jashtë kontrollit të tyre, kafsha kurrë nuk mund t'i kuptojë, edhe pse përta u përket shqisave të jashtme ajo është më e fortë se njeriu. Kështu, është provuar e verifikuar se te njeriu ka një aftësi zbuluese, falë së cilës ai dallohet prej kafshëve dhe kjo është shpirti i njeriut.

Lavdi Zotit! Njeriu është i kthyer gjithnjë drejt lartësive dhe aspirata e tij është e lartë; ai gjithnjë dëshiron të arrijë një botë më të madhe sesa bota në të cilën ndodhet dhe të ngjitet në një sferë më të lartë sesa ajo në të cilën është. Dëshira e ngjitjes është një prej karakteristikave të njeriut. Unë habitem që disa filozofë të Amerikës e të Evropës lakmojnë t'i afrohen gradualisht botës shtazore dhe kështu të ecin prapa; sepse prirja e ekzistencës duhet të jetë drejt lartësimit. Megjithatë, po t'i thuash ndonjërit prej tyre “Ju jeni kafshë”, ai do të fyhej e zemërohej shumë.

Ç'dallim i madh midis botës njerëzore dhe botës shtazore, midis lartësisë së njeriut dhe ultësisë së kafshës, midis përsosurive të njeriut dhe injorancës së kafshës, midis dritës së njeriut dhe errësirës së kafshës, midis lavdisë së njeriut dhe poshtërimin të kafshës! Një fëmijë arab dhjetëvjeçar mund të kullandrisë treqind deve në shkretëtirë dhe me zërin e tij t'i çojë ato përpara ose t'i kthejë prapa. Një indian i dobët mund të drejtojë një goxha elefant të madh në mënyrë të tillë që elefanti të bëhet shërbëtori më i bindur. Të gjitha gjërat nënshtrohen nga dora e njeriut; ai mund t'i bëjë ballë natyrës, ndërsa të gjitha krijesat e tjera janë robër të natyrës: asnjëra nuk mund të shmanget nga kërkesat e saj. Vetëm njeriu mund t'i bëjë ballë natyrës. Natyra i tërheq trupat drejt

qendrës së tokës; njeriu me anë mjetesh mekanike i largohet asaj dhe fluturon në ajër. Natyra e ndalon njeriun të kalojë detet; njeriu ndërton një anije dhe udhëton e lundron përmes oqenit të madh, e kështu me radhë pafund. Për shembull, njeriu shkon me mjete transporti mbi male e përmes shkretëtirave, dhe grumbullon në një vend të rejtat për ngjarjet në Lindje e Perëndim. E gjithë kjo është në kundërshtim me natyrën. Deti me madhësinë e vet nuk mund të shmanget as edhe një thërrime nga ligjet e natyrës; dielli me gjithë madhësinë e vet nuk mund të shmanget as edhe një majë gjilpëre nga ligjet e natyrës dhe kurrë nuk mund t'i kuptojë kushtet, gjendjen, cilësitë, lëvizjen dhe natyrën e njeriut.¹⁵⁵

Ç'aftësi ka, pra, në këtë trup të vogël të njeriut, që i përmban të gjitha këto? Ç'aftësi drejtuese ka ai, me të cilën nënshton të gjitha gjërat?

Mbetet edhe një pikë. Filozofët e sotëm thonë: “Ne kurrë nuk e kemi parë shpirtin te njeriu, dhe me gjithë kërkimet tona në të fshehtat e trupit njerëzor, nuk kemi perceptuar ndonjë fuqi shpirtërore. Si mund të përfytyrojmë ne një fuqi që nuk është shqisore?” Teologët përgjigjen: “Shpirti i kafshës gjithashtu nuk është shqisor dhe nuk mund të perceptohet përmes aftësive të tij trupore. Me çfarë e provoni ju ekzistencën e shpirtit të kafshës? Nuk ka dyshim se nga efektet e tij ju e provoni se te kafsha ka një aftësi që nuk është te bima, dhe kjo është aftësia e shqisave—domethënë shikimi, dëgjimi dhe aftësi të tjera; nga kjo ju nxirrni përfundimin se ka një shpirt shtazor. Po kështu, nga provat e shenjat që kemi përmendur, ne argumentojmë se ka një shpirt njerëzor. Meqenëse te kafsha ka shenja që nuk gjenden te bima, ju thoni se kjo aftësi e ndijimit është një veti e shpirtit shtazor; ju gjithashtu shihni te njeriu shenja, aftësi e përsosuri që nuk ekzistojnë te kafsha, prandaj thoni se tek ai ka një aftësi të cilën kafsha nuk e ka”.

¹⁵⁵ Kur thuhet se njeriu mund t'i qëndrojë apo kundërvihet natyrës, dmth të veprojë në kundërshtim me disa ligje të saj, p.sh. të fluturojë duke iu kundërvënë ligjit të gravitacionit, kjo nuk duhet kuptuar sikur ai i anulonligjet e natyrës, por vetëm që kundërvepron ndaj tyre duke u mbështetur në ligje të tjera të natyrës. Shën. i red.

Në qoftë se duam të mohojmë gjithçka që nuk është shqisore, atëherë duhet të mohojmë edhe realitete që ekzistojnë në mënyrë të padiskutueshme. Për shembull, eteri¹⁵⁶ nuk është i kapshëm nga shqisat, megjithëse ka një ekzistencë të padyshimtë. Forca tërheqëse nuk është e kapshme nga shqisat, megjithatë ajo ekziston me siguri. Nga çfarë i afirmojmë ne këto ekzistenca? Nga shenjat e tyre. Kështu, kjo dritë është dridhja e eterit dhe nga kjo dridhje ne nxjerrim përfundimin për ekzistencën e eterit.

49

RRITJA DHE ZHVILLIMI I GJINISË NJERËZORE

Pyetje.—Ç'mund të thoni lidhur me teoritë e disa filozofëve evropianë për rritjen dhe zhvillimin e qenieve?

Përgjigje.—Për këtë çështje folëm një ditë më parë, por do të flasim përsëri. Me pak fjalë, kjo çështje do të zgjidhet duke përcaktuar nëse speciet janë origjinale apo jo—domethënë a është krijuar specia e njeriut që nga origjina e saj apo ka rrjedhur më pas nga kafshët?

Disa filozofë evropianë e pranojnë se specia rritet e zhvillohet dhe se madje ndryshimi e transformimi janë gjithashtu të mundura. Një ndër provat që ata japin në mbështetje të kësaj teorie është se, përmes studimit të vëmendshëm e verifikimit të kryer nga shkenca e gjeologjisë, është bërë e qartë se ekzistenca e bimëve i ka paraprirë asaj të kafshës dhe se ekzistenca e kafshës i ka paraprirë asaj të njeriut. Ata e pranojnë se si speciet bimore dhe ato shtazore kanë ndryshuar, sepse në disa shtresa të tokës ata kanë zbuluar bimë që kanë ekzistuar në të

¹⁵⁶ Autori flet për “materien eterike” ose “eterin”. Teoria e “eterit kozmik” ka qenë e përhapur në shkencë në shekullin e kaluar, por më pas u la mënjanë nga shkenca, duke u zëvendësuar me teori të tjera fizike. E ardhmja do të thotë fjalën e fundit për këtë çështje.—Shën. i red.

kaluarën dhe që tani janë zhdukur; ato kanë përparuar, janë rritur në forcë, forma dhe pamja e jashtme e tyre ka ndryshuar, dhe kështu speciet janë transformuar. Po kështu, në shtresa të tokës ka disa specie kafshësh të cilat kanë ndryshuar e janë transformuar. Një prej këtyre kafshëve është gjarpri. Ka të dhëna se gjarpri dikur kishte këmbë, por me kalimin e kohës këto gjymtyrë janë zhdukur. Po kështu, në shtyllën kurrizore të njeriut ka një tregues që provon se, ashtu si kafshët e tjera, ai dikur kishte bisht. Dikur ky organ ishte i dobishëm, por kur njeriu u zhvillua ai nuk nevojitej më, prandaj gradualisht u zhduk. Kur gjarpri u strehua nën tokë dhe u bë një kafshë zvarritëse, ai nuk kishte më nevojë për këmbë, kështu që ato u zhdukën; por gjurmët e tyre kanë mbetur. Argumenti i tyre kryesor është ky: ekzistenca e gjurmëve të gjymtyrëve provon se këto dikur ekzistonin dhe, meqë tani nuk shërbejnë më, gradualisht u zhdukën. Pra, ndërsa gjymtyrët e përsosura e të nevojshme janë ruajtur, ato që janë të panevojshme janë zhdukur gradualisht me ndryshimin e specieve, kurse gjurmët e tyre vazhdojnë të ruhen.

Përgjigja e parë për këtë argument është se fakti që kafsha i ka paraprirë njeriut nuk është një provë e evolucionit, e ndryshimit dhe e transformimit të species, as që njeriu është ngjitur nga bota shtazore në botën njerëzore. Sepse ndërsa shfaqja e veçantë e këtyre qenieve të ndryshme është e sigurt, është e mundur që njeriu të jetë krijuar pas kafshës. Kështu, kur vëzhgojmë mbretërinë bimore, shohim se frytet e pemëve të ndryshme nuk e arrijnë pjekurinë në të njëjtën kohë; përkundrazi, disa formohen më parë dhe disa më vonë. Kjo përparësi nuk provon se fryti i mëvonshëm i një peme ka ardhur nga fryti i mëparshëm i një peme tjetër.

Së dyti, këto shenja e gjurmë të lehta të gjymtyrëve kanë ndoshta një arsye të madhe që të ekzistojnë, të cilën mendja ende nuk e kupton. Sa gjëra ekzistojnë, që ne ende nuk ua dimë arsyen! Kështu shkenca e fiziologjisë—domethënë dija për përbërjen e organeve—tregon se arsyeja e shkaku i dallimeve në ngjyrën e kafshëve dhe të flokëve të njeriut, i ngjyrës së kuqe të buzëve dhe i larmisë së ngjyrave të zogjve, është ende i panjohur; kjo është sekret dhe e fshehur. Por dihet se bebëza e syrit është e zezë që të thithë rrezet e diellit, sepse po të ishte në ngjyrë tjetër—domethënë syri të ishte i gjithë i bardhë—nuk do t'i

thithte rrezet e diellit. Pra, meqë arsyeja e gjërave që përmendëm nuk njihet, është e mundur që arsyeja e urtia e këtyre gjurmëve të gjymtyrëve, qofshin te kafsha ose te njeriu, të jenë po kështu të panjohura. Sigurisht që ka një arsye, edhe pse ajo nuk dihet.

Së treti, le të supozojmë se ka qenë një kohë, kur disa kafshë, madje edhe njeriu, kishin disa organe që tani janë zhdukur; kjo nuk është një provë e mjaftueshme e ndryshimit dhe e evolucionit të species. Sepse njeriu, që nga fillimi i periudhës embrionale derisa arrin shkallën e pjekurisë, kalon përmes formash e pamjesh të ndryshme. Dukja e tij, forma e tij, pamja dhe ngjyra e tij ndryshojnë; ai kalon nga një formë në një tjetër dhe nga një pamje në një tjetër. Megjithatë, që nga fillimi i periudhës embrionale ai i përket species njerëzore—domethënë është një embrion njeriu e jo i një kafshe; por kjo në fillim nuk duket, ndërsa më vonë bëhet e dukshme dhe e qartë. Për shembull, le të supozojmë se njeriu dikur i ngjante kafshës dhe se tani ai ka përparuar e ndryshuar. Duke e supozuar këtë si të vërtetë, kjo përsëri nuk përbën një provë të ndryshimit të species. Jo, siç e kemi përmendur më parë, kjo është thjesht si ndryshimi e transformimi i embrionit të njeriut derisa ai arrin shkallën e arsyes e të përsosurisë. Ta themi më qartë. Le të supozojmë se ka qenë një kohë, kur njeriu ecte me duar e me këmbë, ose kishte bisht; ky ndryshim e transformim është si ai i fetusit në barkun e nënës. Megjithëse ndryshon në të gjitha mënyrat, dhe rritet e zhvillohet derisa arrin formën e përkryer, ai që nga fillimi është një specie e veçantë. Shohim gjithashtu në mbretërinë bimore se speciet origjinale të genit nuk ndryshojnë e transformohen, por forma, ngjyra dhe madhësia ndryshojnë e ndërrohen, madje përparojnë.

Që ta përmbledhim: ashtu si njeriu në barkun e nënës kalon nga forma në formë, nga trajta në trajtë, ndryshon e zhvillohet dhe është prapë specie njerëzore që nga fillimi i periudhës embrionale—po kështu njeriu, që nga fillimi i ekzistencës së tij në mitrën e botës, është gjithashtu një specie e veçantë—dmth njeri—dhe gradualisht ka evoluar nga njëra formë në tjetrën. Prandaj ky ndryshim i paraqitjes, ky evolucion i gjymtyrëve, ky zhvillim e kjo rritje, edhe po të pranojmë

realitetin e rritjes e të zhvillimit,¹⁵⁷ nuk e pengon specien që të jetë origjinale. Njeriu që nga fillimi ka qenë në këtë formë e përbërje të përsosur, dhe ka pasur aftësi e prirje për të fituar përsosuri materiale e shpirtërore, dhe ka qenë manifestimi i këtyre fjalëve “Ne do ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës e ngjasimit Tonë”.¹⁵⁸ Ai vetëm është bërë më i këndshëm, më i bukur e më i hijshëm. Qytetërimi e ka nxjerrë atë nga gjendja e tij e egër, ashtu si frytet e egra që kultivohen nga kopshtari bëhen më të bukura, më të ëmbla dhe fitojnë më shumë freski e shije.

Kopshtarët e botës së njerëzimit janë Profetët e Perëndisë.

50

PROVA SHPIRTËRORE TË PREJARDHJES SË NJERIUT

Provat që kemi parashtruar lidhur me prejardhjen e species njerëzore janë prova logjike. Tani do të japim prova shpirtërore, të cilat janë thelbësore. Sepse, ashtu siç kemi provuar Hyjninë me argumente logjike, dhe siç kemi provuar gjithashtu në mënyrë logjike se njeriu ekziston si njeri që nga origjina e krijimi i tij, dhe se specia e tij ka ekzistuar në përjetësi, tani do të japim prova shpirtërore se ekzistenca njerëzore—domethënë specia e njeriut—është një ekzistencë e domosdoshme dhe se pa njeriun përsosuritë e Hyjnisë nuk do të shfaqeshin. Por këto janë prova shpirtërore, jo prova logjike.

¹⁵⁷ dmth në qoftë se pranojmë, për shembull, që më parë njeriu ka qenë një katërkëmbësh, ose se ka pasur bisht.

¹⁵⁸ Shih Zanafilla 1:26.

Shumë herë kemi treguar e argumentuar se njeriu është më fisnikja e qenieve, tërësia e të gjitha përsosurive dhe se të gjitha qeniet e të gjitha ekzistencat janë qendrat nga të cilat pasqyrohet lavdia e Perëndisë—domethënë shenjat e Hyjnisë së Perëndisë shfaqen në realitetet e gjërave e të krijesave. Ashtu si rruzulli tokësor është vendi ku pasqyrohen rrezet e diellit—sepse drita e tij, nxehtësia e tij dhe ndikimi i tij shfaqen e duken në të gjitha atomet e tokës—po kështu atomet e qenieve, në këtë hapësirë të pafundme, shpallin e provojnë njërën prej përsosurive hyjnore. Asgjë nuk është e privuar nga ky përfitim; kjo ose është një shenjë e mëshirës së Perëndisë, ose është një shenjë e fuqisë të Tij, e madhësisë së Tij, e drejtësisë së Tij, e përkujdesjes së Tij të ngrohtë; ose kjo është një shenjë e zemërgjerësisë së Perëndisë, e vizionit të Tij, e dëgjimit të Tij, e dijes së Tij, e hirit të Tij e kështu me radhë.

Nuk ka dyshim që çdo qenie është qendra e shkëlqimit të lavdisë së Perëndisë—domethënë përsosuritë e Perëndisë duken e shkëlqejnë në të. Është si dielli, që shkëlqen në shkretëtirë, mbi det, në drurët, në frytet e në lulet dhe mbi të gjitha gjërat tokësore. Bota, në të vërtetë çdo qenie e gjallë, na thotë një prej emrave të Perëndisë, por realiteti i njeriut është realiteti kolektiv, realiteti i përgjithshëm dhe qendra ku shkëlqejnë lavdia dhe të gjitha përsosuritë e Perëndisë—domethënë për çdo emër, për çdo atribut, për çdo përsosuri që i njohim Perëndisë ekziston një shenjë te njeriu. Po të ishte ndryshe, njeriu nuk do të mund t'i përfytyronte këto përsosuri dhe as t'i kuptonte ato. Kështu ne themi se Perëndia është shikuesi dhe syri është shenja e vizionit të Tij; po të mos ishte ky shikim te njeriu, si do të mund ta përfytyronim vizionin e Perëndisë? Sepse i verbri (dmth një njeri që ka lindur i verbër) nuk mund ta përfytyrojë shikimin; dhe shurdhi (dmth një njeri i shurdhër që nga lindja) nuk mund ta përfytyrojë të dëgjuarit, dhe i vdekuri nuk mund ta kuptojë jetën. Për rrjedhojë, Hyjnia e Perëndisë, që është tërësia e të gjitha përsosurive, e pasqyron veten në realitetin e njeriut—domethënë Thelbi i Njëshmërisë është grumbullimi i të gjitha përsosurive, dhe nga ky unitet ai lëshon një pasqyrim mbi realitetin njerëzor. Njeriu, pra, është pasqyra e përsosur përballë Diellit të së Vërtetës dhe është qendra e rrezatimit: Dielli i së Vërtetës ndriçon në këtë pasqyrë. Pasqyrimi i përsosurive hyjnore shfaqet në realitetin e

njeriut, kështu ai është përfaqësuesi i Perëndisë, lajmëtari i Perëndisë. Po të mos ekzistonte njeriu, gjithësia do të ishte pa rezultat, sepse qëllimi i ekzistencës është shfaqja e përsosurive të Perëndisë.

Pra, nuk mund të thuhet se ka pasur një kohë kur njeriu nuk ishte. E gjithë ajo që mund të themi është se ky rruzull tokësor një herë e një kohë nuk ekzistonte dhe njeriu nuk u shfaq në të në fillimet e tij. Por që nga fillimi që nuk ka fillim e deri në fundin që nuk ka fund, ekziston kurdoherë një Manifestim i Përsosur. Ky Njeri për të Cilin flasim nuk është çdo njeri; ne kemi parasysh Njeriun e Përsosur. Sepse pjesa më fisnike e pemës është fryti, i cili është arsyeja e ekzistencës së saj. Në qoftë se pema nuk nuk do të kishte fryt, ajo do të ishte pa kuptim. Prandaj nuk mund të përfytyrohet që botët e ekzistencës, yjet apo kjo tokë qoftë, të kenë qenë të banuara dikur nga gomari, lopa, miu e macja dhe që ata të kenë qenë pa njeriun! Ky supozim është i rremë e pa kuptim. Fjala e Perëndisë është e qartë si dielli.¹⁵⁹ Kjo është një provë shpirtërore, por e tillë që nuk mund t’u parashtrohet që në fillim materialistëve. Në krye ne duhet të flasim për provat logjike dhe pastaj për provat shpirtërore.

51

SHPIRTI DHE MENDJA E NJERIUT KANË EKZISTUAR QË NGA FILLIMI

Pyetje.—A ka pasur njeriu në fillim mendje dhe shpirt, apo ato janë rezultat i evolucionit të tij?

¹⁵⁹ Në tekst thuhet se “nuk mund të përfytyrohet që botët e ekzistencës, qofshin yjet ose kjo tokë, të kenë qenë banuar dikur nga gomari, lopa, miu e macja dhe të kenë qenë pa njeriun”. Ndërsa në kreun e mëparshëm zihet se “është e mundur që njeriu të jetë krijuar pas kafshës”. Kjo kundërshti në dukje zgjidhet po të kemi parasysh se autori i përmbahet pikëpamjes që, edhe në qoftë se njeriu i zakonshëm mund të jetë krijuar mbi tokë pas kafshëve, ka ekzistuar që në fillim e gjithmonë Njeriu i Përsosur, dmth Manifestimet e Perëndisë.—Shën. i red.

Përgjigje.—Fillimi i ekzistencës së njeriut në rruzullin tokësor i ngjan formimit të tij në barkun e nënës. Embrioni në barkun e nënës rritet e zhvillohet gradualisht deri në lindje, pas së cilës vazhdon të rritet e të zhvillohet derisa arrin moshën e gjykimit e të pjekurisë. Edhe pse në fëmijëri shenjat e mendjes e të shpirtit shfaqen te njeriu, ato nuk arrijnë shkallën e përsosurisë; ato janë të papërsosura. Vetëm kur njeriu arrin pjekurinë, mendja dhe shpirti shfaqen e bëhen të dukshme në përsosurinë më të madhe.

Kështu, edhe formimi i njeriut në mitrën e botës ishte në fillim si embrioni; pastaj gradualisht ai përparoi në pikëpamje të përsosurisë dhe u rrit e u zhvillua derisa arriti gjendjen e pjekurisë, kur mendja dhe shpirti u bënë të dukshme me fuqinë më të madhe. Në fillim të formimit të tij, mendja dhe shpirti gjithashtu ekzistonin, por ishin të fshehura; më pas ato u shfaqën. Në gjirin e botës mendja dhe shpirti gjithashtu ekzistonin në embrion, por u ishin të fshehura; më pas ato u dukën. Kështu edhe pema ekziston në farën, por është e fshehur dhe e mbuluar; kur fara zhvillohet e rritet, shfaqet pema e plotë. Po ashtu rritja e zhvillimi i të gjitha qënieve janë graduale; ky është organizimi universal hyjnor dhe sistemi natyror. Fara nuk bëhet menjëherë pemë; embrioni nuk bëhet menjëherë njeri; minerali nuk bëhet papritur gur. Jo, ato rriten e zhvillohen gradualisht dhe arrijnë kufirin e përsosurisë.

Të gjitha qeniet, të mëdha a të vogla qofshin, janë krijuar të përsosura e të plota që nga fillimi, por përsosuritë e tyre shfaqen në to shkallë-shkallë. Organizimi i Perëndisë është një; evolucioni i ekzistencës është një; sistemi hyjnor është një. Qofshin ato qenie të vogla ose të mëdha, të gjitha i nënshtrohen një sistemi e një ligji. Çdo farë ka brenda saj që nga fillimi të gjitha përsosuritë bimore. Për shembull, të gjitha përsosuritë bimore ekzistojnë në farë që në fillim, por nuk janë të dukshme; më pas, pak nga pak ato shfaqen. Kështu i pari nga fara del llastari, pastaj dalin degët, gjethet, lulet dhe frytet; por që nga fillimi i ekzistencës së saj, të gjitha këto gjëra janë në farë, potencialisht, edhe pse nuk duken.

Po kështu, embrioni ka që nga fillimi të gjitha përsosuritë, siç janë shpirti, mendja, të parët, të nuhaturit, të shijuarit—me një fjalë, të gjitha aftësitë—por ato nuk janë të dukshme dhe bëhen të tilla vetëm shkallë-shkallë.

Në mënyrë të ngjashme, rruzulli tokësor që nga fillimi u krijua me të gjitha elementet, substancat, mineralet, atomet e organizmat e tij; por këto u shfaqën vetëm shkallë-shkallë: në fillim minerali, pastaj bima, më pas kafsha dhe më në fund njeriu. Por që nga fillimi këto lloje e specie ekzistonin, veçse ishin të pazhvilluara në këtë rruzull tokësor, dhe më pas u shfaqën vetëm gradualisht. Sepse organizimi suprem i Perëndisë dhe sistemi natyror universal rrethon të gjitha qeniet dhe të gjitha i nënshtrohen këtij ligji. Kur shqyrton këtë sistem universal, sheh se nuk ka asnjë qenie e cila që kur vjen në jetë të ketë arrirë kufirin e përsosurisë. Jo, ato rriten e zhvillohen gradualisht dhe pastaj arrijnë shkallën e përsosurisë.

52

SHFAQJA E SHPIRTIT NE TRUPIN

Pyetje.—Ç'urti ka në shfaqjen e shpirtit në trup?

Përgjigje.—Urtia e shfaqjes së shpirtit në trup është kjo: shpirti njerëzor është një e Mirë Hyjnore Besuar njeriut, dhe ai duhet të kalojë përmes të gjitha kushteve, sepse kalimi e lëvizja përmes kushteve të ekzistencës do të jetë mjeti me anën e të cilit shpirti do të fitojë përsosuritë e tij. Kështu, kur një njeri udhëton e kalon nëpër krahina të ndryshme e vende të shumta me metodë e sistem, ky sigurisht është një mjet që ai të fitojë përsosuri, sepse do të shohë vende, ngjarje e shtete, nga të cilat do të zbulojë kushtet e gjendjet e kombeve të tjera. Ai do të njihet kështu me gjeografinë e vendeve, me bukuritë e artet e tyre; do të familjarizohet me zakonet, doket e shprehitë e popujve; do të shohë qytetërimin dhe përparimin e epokës; do të marrë dijeni për politikën e qeverive dhe për fuqinë e kapacitetin e çdo vendi. E njëjta gjë ndodh kur shpirti kalon përmes kushteve të ekzistencës: ai do të bëhet zotëruesi i çdo shkalle e pozite. Madje edhe përsa u përket kushteve të trupit me siguri do të fitojë përsosuri.

Veç kësaj, është e nevojshme që shenjat e përsosurisë së shpirtit të jenë të dukshme në këtë botë, në mënyrë që bota e krijimit të mund të japë rezultate të pasosura dhe ky trup të mund të fitojë jetë e të

manifestojë bujaritë hyjnore. Kështu, për shembull, rrezet e diellit duhet të shkëlqejnë mbi tokë dhe ngrohtësia diellore të zhvillojë qeniet tokësore; po qe se rrezet dhe nxehtësia e diellit nuk do të shkëlqenin mbi tokë, toka do të ishte e pabanuar, pa kuptim; dhe zhvillimi i saj do të vonohej. Po kështu, po qe se përsosuritë e shpirtit nuk do të shfaqeshin në këtë botë, kjo botë do të ishte e pandriçuar e krejt e pagdhendur. Falë shfaqjes së shpirtit në formën fizike, kjo botë ndriçohet. Duke qenë se shpirti i njeriut është shkaku i jetës së trupit, bota është, pra, në rolin e trupit, ndërsa njeriu në rolin e shpirtit. Po të mos ishte njeriu, përsosuritë e shpirtit nuk do të shfaqeshin dhe drita e mendjes nuk do të shkëlqente në këtë botë. Kjo botë do të ishte si një trup pa shpirt.

Kjo botë është gjithashtu në rolin e një peme frytore, dhe njeriu është si fryti i saj; pa fryt pema do të ishte e padobishme.

Për më tepër, këto gjymtyrë, këto elemente, kjo përbërje që gjenden në organizmin e njeriut janë një tërheqje e magnet për shpirtin; është e sigurt se shpirti do të shfaqet në të. Kështu, një pasqyrë që është e pastër do t'i tërheqë me siguri rrezet e diellit. Ajo do të bëhet e shndritshme dhe në të do të shfaqen pamje të mahnitshme—domethënë, kur këto elemente ekzistuese grumbullohen së bashku sipas rregullit natyror e me fuqi të përsosur, ato bëhen magnet për shpirtin dhe shpirti do të manifestohet në to me të gjitha përsosuritë e tij.

Në këto kushte nuk mund të thuhet “Pse duhet që rrezet e diellit të zbresin mbi pasqyrë?—Sepse lidhja që ekziston midis realitetit të gjërave, shpirtërore a materiale qofshin, kërkon që, kur pasqyra është e pastër e ndodhet përballë diellit, drita e diellit të duket në të. Po kështu, kur elementet renditen e kombinohen në sistemin, organizimin e mënyrën më të përkryer, shpirti njerëzor do të shfaqet e manifestohet në to. Ky është urdhri i të Fuqishmit, të Urtit.

Pyetje.—Cila është natyra e lidhjes midis Perëndisë dhe krijesës—domethënë midis të Pavarurit, Më të Lartit, dhe qenieve të tjera?

Përgjigje.—Lidhja midis Perëndisë dhe krijesavë është ajo e krijesit me krijimin; ajo është si lidhja midis diellit dhe trupave të errët të qenieve të rastësishme, është si lidhja midis mjeshtrit dhe sendeve që ai ka bërë. Dielli në thelbin e vet është i pavarur nga trupat që ndriçon, sepse drita që lëshon është brenda vetes së tij, ajo është e lirë dhe e pavarur nga rruzulli tokësor; kështu toka është nën ndikimin e diellit dhe merr dritën e tij, ndërsa dielli dhe rrezet e tij janë krejtësisht të pavaruara prej tokës. Por, po të mos ishte dielli, toka dhe të gjitha qeniet tokësore nuk do të mund të ekzistonin.

Varësia e krijesave nga Perëndia është varësi prejardhjeje¹⁶⁰—domethënë krijesat burojnë nga Perëndia, por nuk e manifestojnë Atë.¹⁶¹ Ky është raport të buruari e jo manifestimi. Drita e diellit buron nga dielli; ajo nuk e manifeston atë. Shfaqja përmes të buruarit është si shfaqja e rrezeve nga ylli ndriçues i horizonteve të botës—domethënë thelbi i shenjtë i Diellit të së Vërtetës nuk ndahet dhe nuk bie në gjendjen e krijesave. Po kështu, lëmshi i diellit nuk ndahet e nuk bie mbi tokë. Jo, rrezet e diellit, që janë bujaria e tij, burojnë prej tij dhe ndriçojnë trupat e errët.

Por shfaqja përmes manifestimit është manifestimi i degëve, i gjetheve, i luleve e i frytit nga fara; sepse fara në vetë thelbin e saj bëhet degë e fryte, dhe realiteti i saj hyn në degët, në gjethet e në frytet. Kjo shfaqje përmes manifestimit do të ishte për Perëndinë, Më të Lartin, një papërsosuri e thjeshtë; dhe kjo është krejt e pamundur, sepse do të nënkuptonte që të Paraqenëshmit Absolut t'i vishen atribute të së rastësishmes. Por po të ishte kështu, pavarësia e kulluar do të bëhej thjesht varfëri, ekzistenca e vërtetë do të bëhej mosekzistencë, dhe kjo është e pamundur.

¹⁶⁰ Në mungesë të një termi të saktë në gjuhën shqipe për fjalën anglisht “emanation”, përdoret termi “të buruar”, i cili do të thotë diçka që buron, del, vjen apo përhapet nga diçka tjetër.—Shën. i përkth.

¹⁶¹ Kjo temë, e të buruarit dhe e manifestimit, shpjegohet në mënyrë më të plotë në kreun pasardhës.

Pra, të gjitha krijesat burojnë nga Perëndia—domethënë të gjitha gjërat realizohen nga Perëndia dhe prej Tij fitojnë ekzistencën të gjitha qeniet. Gjëja e parë që është buruar nga Perëndia është ai realitet universal, të cilin filozofët e lashtë e kanë quajtur “Mendja e Parë” dhe njerëzit e Bahá-it e quajnë “Vullneti i Parë”. Ky të buruar, përsa i përket veprimit të tij në botën e Perëndisë, nuk kufizohet nga koha ose vendi; ai është pa fillim ose fund—fillimi dhe fundi në raport me Perëndinë janë një. Paraqenia e Perëndisë është paraqenie e thelbit, e gjithashtu paraqenie e kohës, dhe dukuria e së rastësishmes është thelbësore e jo e përkohshme, siç e kemi shpjeguar një ditë rreth tryezës.¹⁶²

Edhe pse “Mendja e Parë” nuk ka fillim, ajo nuk bëhet pjesëtare e paraqenies së Perëndisë, sepse ekzistenca e realitetit universal është hiç në raport me ekzistencën e Perëndisë dhe nuk ka fuqi të bëhet shoqëruese e Perëndisë e t’i ngjajë Atij në paraqenie. Këtë çështje e kemi shpjeguar më parë.

Ekzistenca e gjërave të gjalla do të thotë përbërje dhe, me vdekjen e tyre, shpërbërje. Por materia universale dhe elementet nuk asgjësohen e shkatërrohen plotësisht. Jo, mosekzistenca e tyre është thjesht shndërrim. Për shembull, kur njeriu asgjësohet, ai bëhet pluhur; por ai nuk bëhet mosekzistencë absolute. Ai ende ekziston në formë pluhuri, por shndërrimi është kryer dhe kjo përbërje është shpërbërë në mënyrë të rastësishme. Asgjësimi i qenieve të tjera është i njëjtë, sepse ekzistenca nuk bëhet mosekzistencë absolute, dhe mosekzistenca absolute nuk bëhet ekzistencë.

54

SHPIRTI NJERËZOR VJEN NGA PERËNDIA

¹⁶² Shih “Paraqenia reale”, f. 280.

Pyetje.—Në Bibël thuhet se Perëndia fryu shpirtin në trupin e njeriut. Cila është domethënia e këtij vargu?

Përgjigje.—Dijeni se veprimi është dy llojesh: veprimi e shfaqja përmes të buruarit dhe veprimi përmes shfaqjes e manifestimit. Veprimi përmes të buruarit është i ngjashëm me veprimin që rrjedh nga aktori dhe me të shkruarit që rrjedh nga shkrimtari. Tani, të shkruarit buron nga shkrimtari, biseda buron nga folësi, dhe po kështu shpirti njerëzor buron nga Perëndia. Kjo nuk do të thotë se e manifeston Perëndinë—domethënë asnjë pjesë nuk është shkëputur nga Realiteti Hyjnor për të hyrë në trupin e njeriut. Jo, ashtu si ligjërata buron nga folësi, shpirti shfaqet në trupin e njeriut.

Por veprimi përmes manifestimit është manifestimi i realitetit të diçkaje në forma të tjera, si dalja e kësaj peme nga fara e pemës, ose dalja e lules nga fara e lules, sepse është vetë fara që shfaqet në formën e degëve, të gjetheve e të luleve. Ky quhet veprim përmes manifestimit. Shpirtrat e njerëzve, në raport me Perëndinë, kanë varësi përmes të buruarit, ashtu si ligjërata vjen nga folësi dhe shkrimi nga shkrimtari—domethënë vetë folësi nuk bëhet ligjëratë dhe as vetë shkrimtari nuk bëhet shkrim; jo, ato rrjedhin nga të buruarit. Folësi ka aftësi e fuqi të përsosur dhe ligjërata buron prej tij, ashtu si ndodh me veprimin e aktorit. Folësi i Vërtetë, Thelbi i Unitetit ka qenë gjithnjë në po atë gjendje, që as ndryshon e ndërrohet, as transformohet e as pëson të papritura. Ai është i Përrjetshmi, i Pavdekshmi. Pra, ardhja e shpirtit njerëzor nga Perëndia bëhet përmes të buruarit. Kur thuhet në Bibël se Perëndia i futi Shpirtin e Tij njeriut, ky është ai shpirt që, ashtu si ligjërata, buron prej Folësit të Vërtetë, duke u zbatuar në realitetin e njeriut.

Por, siç kemi thënë, veprimi përmes manifestimit (në qoftë se me këtë nënkuptohet shfaqja hyjnore, e jo ndarja në pjesë) është veprimi e shfaqja e Shpirtit të Shenjtë dhe e Fjalës, që vjen nga Perëndia. Siç thuhet në Ungjillin e Gjonit, “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë”,¹⁶³ pra, Shpirti i Shenjtë dhe Fjala janë shfaqja e Perëndisë. Shpirti dhe Fjala nënkuptojnë përsosuritë hyjnore që u shfaqën në Realitetin e Krishtit, dhe këto përsosuri ishin me Perëndinë; po kështu

¹⁶³ Gjoni 1:1.

dielli e manifeston gjithë lavdinë e vet në pasqyrë. Sepse Fjala nuk nënkupton trupin e Krishtit, jo, por përsosuritë hyjnore u manifestuan tek Ai. Sepse Krishti ishte si një pasqyrë e pastër që ndodhej përballë Diellit të Realitetit; dhe përsosuritë e Diellit të Realitetit—domethënë drita dhe ngrohtësia e tij—ishin të dukshme e të qarta në këtë pasqyrë. Po të vështrjmë në pasqyrë, shohim diellin dhe themi “Është dielli.” Prandaj Fjala dhe Shpirti i Shenjtë, që nënkuptojnë përsosuritë e Perëndisë, janë shfaqja hyjnore. Kjo është domethënia e vargut të Ungjillit që thotë. “Fjala ishte me Perëndinë dhe Fjala ishte Perëndia”;¹⁶⁴ sepse përsosuritë hyjnore nuk ndryshojnë nga Thelbi i Njëshmërisë. Përsosuritë e Krishtit janë quajtur Fjala, sepse të gjitha qeniet u përngjasin shkronjave dhe një shkronjë nuk ka një kuptim të plotë, ndërsa përsosuritë e Krishtit kanë fuqinë e fjalës, sepse prej fjalës mund të nxirret një kuptim i plotë. Duke qenë se realiteti i Krishtit ishte manifestimi i përsosurive hyjnore, ai ishte, pra, si fjala. Pse? Sepse Ai është tërësia e kuptimeve të përsosura. Ja përse Ai është quajtur Fjala.

Dhe dijeni se ardhja e Fjalës dhe e Shpirtit të Shenjtë nga Perëndia, që është veprimi e shfaqja e manifestimit, nuk duhet kuptuar sikur Realiteti i Hyjnës është ndarë në pjesë ose është shumëzuar ose sikur ai ka rënë nga lartësia e shenjtërisë dhe e dëlirësisë. Mos e dhëntë Zoti! Në qoftë se një pasqyrë e pastër dhe e lëmuar ndodhet përballë diellit, drita dhe nxehtësia, forma dhe pamja e diellit do të shkëlqejnë në të me një qartësi të tillë sa që po të thotë një shikues për diellin që ndriçon e duket në pasqyrë “Ky është dielli”, kjo është e vërtetë. Megjithatë, pasqyra është pasqyra dhe dielli është dielli. I Vetmi Diell, edhe në qoftë se shfaqet në shumë pasqyra, është një. Kjo gjendje nuk është as banim, as hyrje, as përzierje, as zbritje; sepse hyrja, qëndrimi, zbritja, dalja e përzierja janë nevoja e karakteristika të trupave, jo të shpirtave; dhe aq më pak i përkasin ato Perëndisë së shenjtëruar e të kulluar të Realitetit. Perëndia është i përjashtuar nga çdo gjë që nuk përputhet me pastërtinë e Tij dhe me shenjtërinë e Tij të lartësuar e sublime.

Dielli i Realitetit, siç e kemi thënë, ka qenë gjithnjë në të njëjtën gjendje; ai nuk pëson ndryshim, ndërrim, transformim e të papritura. Ai është i përjetshëm e i përhershëm. Por Realiteti i Shenjtë i Fjalës së

¹⁶⁴ Gjoni 1:1.

Perëndisë është si një pasqyrë e pastër, e bukur dhe e shndritshme; ngrohtësia, drita, pamja e përngjasimi—domethënë përsosuritë e Diellit të Realitetit—duken në të. Ja përse Krishti thotë në Ungjill “Ati është në Birin”—domethënë Dielli i Realitetit shfaqet në pasqyrë.¹⁶⁵ Lëvduar qoftë Ai Që shkëlqeu mbi këtë Realitet të Shenjtë, i Cili është i shenjtëruar midis qenieve!

55

FRYMA, SHPIRTI DHE MENDJA

Pyetje.—Cili është ndryshimi midis mendjes, shpirtit dhe frymës?

Përgjigje.—Është shpjeguar më parë se shpirti ndahet përgjithësisht në pesë kategori: shpirti bimor, shpirti shtazor, shpirti njerëzor, shpirti i besimit dhe Shpirti i Shenjtë.

Shpirti bimor është aftësia e rritjes që ekziston te fara falë ndikimit të ekzistencave të tjera.

Shpirti shtazor është aftësia e të gjitha shqisave, që realizohet nga përbërja dhe ndërthurja e elementeve; kur kjo përbërje shpërbëhet, humbet gjithashtu aftësia shqisore, e cila asgjësohet. Ajo mund të krahasohet më këtë llambë: kur vaji, fitili dhe zjarri kombinohen, ajo ndizet; dhe kur ky kombinim prishet—domethënë kur pjesët e kombinuara ndahen nga njëra-tjetra—llamba gjithashtu fiket.

Shpirti njerëzor që e dallon njeriun nga kafsha është fryma racionale dhe këta dy emra—shpirti njerëzor dhe fryma racionale—i referohen së njëjtës gjë. Ky shpirt, që në terminologjinë e filozofëve është fryma racionale, përshin të gjitha qeniet dhe, aq sa e lejon aftësia njerëzore, zbulon realitetin e gjërave dhe fiton njohuri për veçantitë dhe efektet e tyre, për cilësitë dhe tiparet e qenieve. Por shpirti njerëzor, po të mos ndihmohet nga shpirti i besimit, nuk njihet me të fshehtat hyjnore e me realitetet qiellore. Ai është si një pasqyrë që, edhe pse e pastër, e lëmuar dhe e shkëlqyeshme, megjithatë ka nevojë për dritë. Derisa të mos

¹⁶⁵ Shih Gjoni 14:11; 17:21.

reflektohet ndonjë rreze dielli mbi të, ajo nuk mund të zbulojë të fshehtat qiellore.

Por mendja është fuqia e shpirtit njerëzor. Shpirti është llamba; mendja është drita që ndriçon nga llamba. Shpirti është pema dhe mendja është fryti. Mendja është përsosuria e shpirtit dhe cilësia e tij thelbësore, ashtu si rrezet e diellit janë domosdoshmëria thelbësore e diellit.

Ky shpjegim, edhe pse i shkurtër, është i plotë; prandaj, reflektoni rreth tij dhe, në dashtë Perëndia, mund të njiheni me hollësitë.

56

AFTËSITE FIZIKE DHE AFTËSITË MENDORE

Te njeriu ekzistojnë pesë aftësi të jashtme, që janë faktorë të perceptimit—domethënë përmes këtyre pesë aftësive njeriu percepton qeniet materiale. Këto janë shikimi, që percepton format e dukshme; të dëgjuarit, që percepton tingujt e dëgjueshëm; të nuhaturit, që percepton erërat; të shijuarit, që percepton ushqimet; dhe të prekurit, që është i shpërndarë në të gjitha pjesët e trupit dhe percepton gjërat e prekshme. Këto pesë aftësi perceptojnë ekzistencat e jashtme.

Njeriu ka gjithashtu aftësi shpirtërore: përfytyrimin, që koncepton gjërat; mendimin, që reflekton për realitetet; të kuptuarit, që kupton realitetet; kujtesën, që ruan të gjitha ato që njeriu përfytyron, mendon e kupton. Ndërmjetëse në mes pesë aftësive të jashtme dhe aftësive të brendshme është ndijimi që ato e kanë të përbashkët—domethënë ndijimi, që vepron ndërmjet aftësive të brendshme e të jashtme, u përcjell aftësive të brendshme çdo gjë që dallojnë aftësitë e jashtme. Ai është quajtur aftësi e përbashkët, sepse komunikon midis aftësive të brendshme e të jashtme dhe, pra, është i përbashkët për aftësitë e jashtme e të brendshme.

Për shembull, shikimi është një prej aftësive të jashtme; ai sheh e percepton këtë lule dhe ia përcjell këtë perceptim aftësisë së

brendshme—aftësisë së përbashkët—e cila ia transmeton këtë perceptim aftësisë së përfytyrimit, që nga ana e vet koncepton e formon këtë pamje dhe ia transmeton atë aftësisë së të menduarit; aftësia e të menduarit reflekton dhe, pasi e ka kapur realitetin, ia përcjell atë aftësisë së të kuptuarit; të kuptuarit, kur e ka kuptuar këtë, ia çon pamjen e objektit të perceptuar kujtesës, dhe kujtesa e ruan atë në depozitën e vet.

Aftësitë e jashtme janë pesë: aftësia e të parit, e të dëgjuarit, e të shijuarit, e të nuhaturit dhe e të prekurit.

Aftësitë e brendshme janë gjithashtu pesë: aftësia e përbashkët dhe aftësitë e përfytyrimit, të të menduarit, të të kuptuarit e të kujtesës.

57

SHKAQET E DALLIMEVE NË KARAKTERET E NJERËZVE

Pyetje.—Sa lloje karakteresh ka njeriu dhe cili është shkaku i dallimeve e i larmisë te njerëzit?

Përgjigje.—Njeriu ka karakterin e lindur, karakterin e trashëguar dhe karakterin që fitohet me anë të edukimit.

Përsa i përket karakterit të lindur, megjithëse krijesa hyjnore është krejt e mirë, por larmia e cilësive natyrore te njeriu vjen në shkallë të ndryshme; të gjitha janë shumë të mira, por janë pak a shumë kështu, sipas shkallës së secilit. Kështu gjithë njerëzimi zotëron inteligjencë e aftësi, por inteligjenca, aftësia dhe vlerat e njeriut ndryshojnë nga një njeri te tjetri. Kjo duket qartë.

Për shembull, merrni një numër fëmijësh të një familjeje, të një vendi, të një shkolle, të mësuar nga i njëjti mësues, të ushqyer me të njëjtin ushqim, të rritur në të njëjtën klimë, me të njëjtat veshje dhe që studiojnë të njëjtat mësimë—është e sigurt se ndër këta fëmijë disa do të jenë të zotët në shkenca, disa do të jenë me aftësi mesatare dhe disa të ngathët. Është, pra, e qartë se në natyrën origjinale të tyre ka dallim në shkallë e larmi përsa i përket vlerës e aftësisë. Ky dallim nuk ka të

bëjë me të mirën ose të keqen, por është thjesht dallim në shkallë. Njëri ka shkallën më të lartë, një tjetër shkallën e mesme dhe një tjetër shkallën më të ulët. Kështu, njeriu ekziston; kafsha, bima dhe sendet gjithashtu ekzistojnë—por shkallët e këtyre katër ekzistencave ndryshojnë. Ç’dallim i madh midis ekzistencës së njeriut dhe të kafshës! Megjithatë që të dyja janë ekzistenca. Është e qartë se në ekzistencë ka dallime në shkallë.

Larmia e cilësive të trashëguara vjen nga forca ose dobësia e konstruktit—domethënë kur të dy prindërit janë të dobët, fëmijët do të jenë të dobët; në qoftë se ata janë të fortë, fëmijët do të jenë të fuqishëm. Po kështu, pastërtia e gjakut ka ndikim të madh; sepse fara e pastër është si lloji më i zgjedhur që ekziston në bimët e në kafshët. Për shembull, ju e shihni se fëmijët e lindur nga baba e nënë të dobët e të pafuqishëm do të kenë nga natyra konstrukt të brishtë e nerva të dobët; ata do të sëmuren e nuk do të kenë as durim, as qëndrueshmëri, as vendosmëri, as këmbëngulje, dhe do të jenë të nxituar; sepse fëmijët trashëgojnë dobësinë e pafuqinë e prindërve të tyre.

Veç kësaj, një bekim i veçantë u jepet disa familjeve e disa brezave. Kështu, është një bekim i veçantë që të gjithë Profetët e bijve të Izraelit kanë ardhur nga pasardhësit e Abrahamit. Ky është një bekim që Perëndia ia ka dhuruar kësaj breznie: Moisiut nga i ati dhe e ëma, Krishtit në linjën e nënës së tij; po kështu Muhametit e Báb-it dhe të gjithë Profetëve e Manifestimeve të Shenjta të Izraelit. Bukuria e Bekuar¹⁶⁶ është gjithashtu një pasardhës i linjës së Abrahamit, sepse Abrahami kishte edhe djem të tjerë veç Ishmaelit e Isakut, të cilët në ato kohë emigruan në tokat e Persisë e të Afganistanit, dhe Bukuria e Bekuar është një prej pasardhësve të tyre.

Nga kjo shihet qartë se karakteri i trashëguar gjithashtu ekziston dhe në një shkallë të tillë saqë, në rast se karakteret nuk janë në pajtim me origjinën e tyre, ata megjithëse i përkasin fizikisht asaj linje, shpirtërisht nuk konsiderohen anëtarë të familjes, si Kanaani,¹⁶⁷ që nuk llogaritej se ishte i racës së Nojit.

¹⁶⁶ Bahá’u’lláh-u.

¹⁶⁷ Shih Zanafilla 9:25.

Por dallimi i cilësive përsa i përket kulturës është shumë i madh, sepse edukimi ushtron ndikim të madh. Nëpërmjet edukimit i padituri bëhet i mësuar; frikacaku bëhet trim. Me anë të kultivimit dega e shtrembër bëhet e drejtë; fryti i thartë e i hidhur i maleve e i pyjeve bëhet i ëmbël e i shijshëm; dhe lulja pesëpetalëshe bëhet njëqindpetalëshe. Nëpërmjet edukimit kombe të egra bëhen të qytetëruara, madje edhe kafshët zbuten. Edukimi duhet konsideruar si shumë i rëndësishëm. Sepse ashtu si sëmundjet në botën e trupave janë tepër ngjitëse, po kështu edhe cilësitë e shpirtit e të zemrës janë tepër ngjitëse. Edukimi ushtron një ndikim universal dhe dallimet e krijuara prej tij janë shumë të mëdha.

Ndoshta dikush do të thotë që, përderisa aftësia dhe vlera e njerëzve janë të ndryshme, atëhere dallimi në aftësitë sigurisht sjell dallimin në karakteret.¹⁶⁸

Por nuk është kështu, sepse ka dy lloje aftësish: aftësi natyrore dhe aftësi të fituara. Të parat, që janë krijim i Perëndisë, janë krejt të mira—në krijimin e Perëndisë nuk ekziston e keqja; mirëpo aftësitë e fituara janë bërë shkak i shfaqjes së të keqes. Për shembull, Perëndia i ka krijuar të gjithë njerëzit në mënyrë të tillë dhe u ka dhënë atyre një konstrukt e aftësi të tilla, që atyre u bëjnë mirë sheqeri e mjalti dhe i dëmton e shkatërron helmi. Kjo natyrë e ky konstrukt janë të lindura, dhe Perëndia ia ka dhënë ato në mënyrë të barabartë gjithë njerëzimit. Por njeriu fillon ta mësojë pak nga pak veten me helm, duke marrë çdo ditë një sasi të vogël dhe duke e shtuar atë gradualisht, derisa arrin që nuk mund të jetojë pa një gram opium çdo ditë. Aftësitë natyrore degjenerojnë kështu plotësisht. Shikoni sa shumë mund të ndryshohen aftësitë e konstrukti natyror, derisa me shprehi e stërvitje të ndryshme ato zvetënohen krejtësisht. Askush nuk i kritikon njerëzit me vese për shkak të natyrës e të aftësive të tyre të lindura, por për natyrën e aftësitë e tyre të fituara.

Në krijim nuk ekziston e keqja; gjithçka është e mirë. Disa veti e natyra të lindura në disa njerëz dhe në dukje të qortueshme, në të vërtetë nuk janë të tilla. Për shembull, që në fillim të jetës së tij, ju mund të vëreni në një fëmijë gjiri shenjat e lakmisë, të zemërimit e të

¹⁶⁸ domethënë, prandaj njerëzit nuk mund të fajësohen për karakterin e tyre.

inatit. Pra, mund të thuhet se e mira dhe e keqja janë të lindura në realitetin e njeriut, dhe kjo është në kundërshtim me mirësinë e kulluar të natyrës e të krijimit. Përgjigja është se lakmia, që do të thotë të kërkosh diçka më shumë, është një veti e lavdërueshme po që se përdoret në mënyrë të përshtatshme. Kështu, në qoftë se një njeri është lakmitar për të fituar shkencë e dije, ose për t'u bërë i mëshirshëm, bujar e i drejtë, kjo është tepër e lavdërueshme. Në qoftë se ai e përdor zemërimin e indinjatën e tij kundër tiranëve gjakpirës, që janë si bisha të egra, kjo është shumë e lavdërueshme; por në qoftë se ai nuk i përdor drejt këto cilësi, ato janë të qortueshme.

Atëherë duket qartë se në krijim dhe në natyrë e keqja nuk ekziston fare; por kur cilësitë natyrore të njeriut përdoren në mënyrë të paligjshme, ato janë të qortueshme. Kështu, po që se një njeri i pasur e zemrëgjjerë i jep një shumë parash një të varfri për nevojat e tij, dhe po që se i varfëri e harxhon këtë shumë parash për gjëra të paligjshme, kjo do të ishte e qortueshme. E njëjta gjë është me të gjitha vetitë e natyrshme të njeriut, të cilat përbëjnë kapitalin e jetës; në qoftë se ato përdoren e shfrytëzohen në mënyrë të paligjshme, atëherë bëhen të qortueshme. Shihet, pra, qartë se krijimi është krejt i mirë. Duhet vënë në dukje se më e keqja ndër vetitë dhe më i urryeri ndër atributet, që qëndron në themel të të gjitha të këqijave, është gënjeshtria. Nuk mund të përfytyrohet që të ketë veti më të keqe e më të qortueshme se kjo; ajo është shkatërruesja e të gjitha përsosurive njerëzore dhe shkaku i veseve të panumërta. Nuk ka karakteristikë më të keqe se kjo; ajo është themeli i të gjitha të këqijave. Me gjithë këtë, në rast se një doktor i jep zemër një të sëmuri duke i thënë “Shyqyr Zotit je më mirë dhe ka shpresë të shërohesh”, edhe pse këto fjalë janë në kundërshtim me të vërtetën, ato mund të bëhen ngushëllim për të sëmurin e një pikë kthese në sëmundjen. Kjo nuk është e qortueshme.

Kjo çështje është ndriçuar tashmë qartë. Përsëritet!

Pyetje.—Cila është shkalla e të kuptuarit në botën njerëzore dhe cilat janë kufizimet e tij?

Përgjigje.—Dijeni se të kuptuarit ndryshon. Shkalla më e ulët e të kuptuarit është ajo e kafshëve—domethënë ndjenja natyrore që shfaqet përmes aftësive të shqisave e që quhet ndijim. Këtë njeriu dhe kafshët e kanë të përbashkët; për më tepër, disa kafshë përsa u përket shqisave janë më të fuqishme se njeriu. Por te njerëzimi të kuptuarit është i ndryshëm dhe ndërron sipas gjendjeve të ndryshme të njeriut.

Gjendja e parë e të kuptuarit në botën e natyrës është të kuptuarit e shpirtit racional. Këtë veti të të kuptuarit e këtë aftësi e kanë të gjithë njerëzit, të pavëmendshëm a syhapur, besimtarë a mohues të fesë qofshin. Ky shpirt racional njerëzor është krijim i Perëndisë; ai rrethon krijesat e tjera e ua kalon atyre; e duke qenë më fisnik e më i shquar, i rrethon gjërat. Fuqia e shpirtit racional mund të zbulojë realitetet e gjërave, të kuptojë veçantitë e qenieve dhe të depërtojë në misteret e ekzistencës. Të gjitha shkencat, dijet, artet, mrekullitë, institucionet, zbulimet e ndërmarjet vijnë nga ushtrimi i inteligjencës së shpirtit racional. Ka qenë një kohë kur ato ishin të panjohura, ishin mistere të mbuluara e sekrete të fshehura; shpirti racional i zbuloi ato gradualisht dhe i nxorri nga rrafshi i së padukshmes e i së fshehurës në mbretërinë e së dukshmes. Kjo është aftësia më e madhe e të kuptuarit në botën e natyrës, i cili në fluturimin e ngjitjen e tij më të lartë kupton realitetet, vetitë dhe efektet e qenieve të së rastësishmes.

Por mendja hyjnore universale, që është tej natyrës, është bujaria e Fuqisë së Paraqenëshme. Kjo mendje universale është hyjnore; ajo përfshin realitet ekzistuese dhe merr dritën e mistereve të Perëndisë. Ajo është fuqi e ndërgjegjshme, jo aftësi hetimi e kërkimi. Aftësia intelektuale e botës së natyrës është aftësi hetimi dhe me kërkimet e saj zbulon realitetet e qenieve dhe vetitë e ekzistencave; por aftësia intelektuale qiellore, që është tej natyrës, përfshin e njeh të gjitha gjërat, i di, i kupton ato, është në brendi të mistereve, të realiteteve e të domethënëve hyjnore dhe është zbuluesja e të vërtetave të fshehura të Mbretërisë. Kjo fuqi intelektuale hyjnore është atributi i posaçëm i Manifestimeve të Shenjta e i Agimeve të profetërisë; një rreze e kësaj

drite bie mbi pasqyrat e zemrave të të drejtëve dhe një sasi e një pjesë e kësaj fuqie vjen tek ata përmes Manifestimeve të Shenjta.

Manifestimet e Shenjta kanë tri gjendje: gjendjen fizike; gjendjen e shpirtit racional dhe gjendjen e manifestimit të përsosurisë e të shkëlqimit sovran. Trupi i kupton gjërat sipas shkallës së aftësisë së tij në botën fizike; prandaj në raste të caktuara tregon dobësi fizike. Për shembull: “Unë isha në gjumë e i pavetëdijshëm; flladi i Perëndisë kaloi mbi Mua e Më zgjoi, dhe Më urdhëroi të shpall Fjalën”; ose, kur Krishti në vitin e Tij të tridhjetë u pagëzua dhe Shpirti i Shenjtë zbriti mbi Të; para kësaj Shpirti i Shenjtë nuk ishte manifestuar tek Ai. Të gjitha këto gjëra i referohen gjendjes trupore të Manifestimeve; por gjendja e tyre qiellore përfshin të gjitha gjërat, di të gjitha misteret, zbulon të gjitha shenjat dhe sundon mbi të gjitha gjërat; kjo është kështu njëlloj si para dhe pas misionit të Tyre. Prandaj Krishti ka thënë: “Unë jam Alfa dhe Omega, i pari dhe i fundit”¹⁶⁹—domethënë kurrë nuk ka pasur e kurrë nuk do të ketë ndonjë ndryshim e ndërrim tek Unë.

59

DIJA E NJERIUT PËR PERËDINË

Pyetje.—Deri në çfarë shkalle e kupton Perëndinë mendja e njeriut?

Përgjigje.—Ky subjekt kërkon mjaft kohë dhe nuk është e lehtë ta shpjegosh atë kështu, në tryezë; megjithatë, do të flasim shkurt për këtë.

Mësoni se ka dy lloj dijesh: dija për thelbin e diçkaje dhe dija për vetitë e saj. Thelbi i diçkaje njihet përmes vetive të saj; përndryshe, ajo mbetet e panjohur dhe e fshehur.

Meqenëse dija jonë për gjërat, qoftë edhe për gjëra të krijuara e të kufizuara, është dije e vetive e jo e thelbit të tyre, si është e mundur të kuptojmë në vetë thelbin e tij Realitetin Hyjnor, që është i pakufizuar? Sepse thelbi i brendshëm i çdo gjëje qoftë nuk kuptohet; kuptohen vetëm vetitë e saj. Për shembull, thelbi i brendshëm i diellit është i

¹⁶⁹ Shih Revelacioni 22:13.

panjohur, por ai kuptohet nga vetitë e tij, që janë ngrohtësia dhe drita. Thelbi i brendshëm i njeriut është i panjohur e jo i dukshëm, por ai karakterizohet e njihet nga cilësitë e tij. Kështu çdo gjë njihet nga vetitë e jo nga thelbi i saj. Edhe pse mendja përfshin të gjitha gjërat, dhe qeniet e jashtme kuptohen prej saj, megjithatë këto qenie përsa i përket thelbit të tyre janë të panjohura; ato njihen vetëm përsa u përket vetive të tyre.

Pra, si mundet Zoti i përjetshëm e i pavdekshëm, i Cili konsiderohet i çliruar nga të kuptuarit e konceptimi, të njihet në thelbin e Tij? Domethënë, duke qenë se gjërat mund të njihen vetëm nga vetitë e jo nga thelbi i tyre, është e sigurt se Realiteti Hyjnor është i panjohur përsa i përket thelbit dhe njihet vetëm përsa u përket attributeve të tij. Veç kësaj, si mundet realiteti fenomenal të përfshijë Realitetin e Paraqenëshëm? Sepse të kuptuarit është rezultat i përfshirjes—duhet të ekzistojë përfshirja që të ekzistojë të kuptuarit—ndërsa Thelbi i Unitetit rrethon gjithçka dhe nuk mund të rrethohet.

Gjithashtu dallimet e kushteve në botën e qenieve janë një pengesë për të kuptuarit. Për shembull, ky mineral i përket mbretërisë së mineraleve; sado lart që të ngrihet, ai kurrë nuk mund të kuptojë aftësinë e rritjes. Bimët, pemët, çfarëdo progresi që të bëjnë nuk mund të konceptojnë aftësinë e të parit ose aftësitë e shqisave të tjera; dhe kafsha nuk mund të përfytyrojë gjendjen e njeriut—domethënë aftësitë e tij shpirtërore. Dallimet e gjendjes janë një pengesë për njohjen; shkalla më e ulët nuk mund ta kuptojë shkallën më të lartë. Si mundet atëherë realiteti fenomenal të kuptojë Realitetin e Paraqenëshëm? Njohje e Perëndisë; pra, do të thotë kuptim e njohje e attributeve të Tij dhe jo e Realitetit të Tij. Kjo njohje e attributeve është gjithashtu në përpjesëtim me kapacitetin e aftësinë e njeriut; ajo nuk është absolute. Filozofia është kuptimi i realitetit të gjërave ashtu siç ekzistojnë, në përputhje me kapacitetin e aftësinë e njeriut. Sepse realiteti fenomenal mund t'i kuptojë atributet e Paraqenëshme vetëm brenda kufirit të kapacitetit njerëzor. Misteri i Hyjnisë është i çliruar e i spastruar nga të kuptuarit e qenieve, sepse çdo gjë që vjen në imagjinatë është ajo që njeriu kupton, dhe aftësia e të kuptuarit e njeriut nuk përfshin Realitetin e Thelbit Hyjnor. Gjithçka që njeriu është në gjendje të kuptojë janë

atributet e Hyjnisë, rrezatimi i së cilës shfaqet e është i dukshëm në botë dhe në shpirtrat e njerëzve.

Kur vështrojmë botën e në shpirtrat e njerëzve, shohim shenja të mrekullueshme të përsosurive hyjnore, që janë të qarta e të dukshme, sepse realiteti i gjërave provon Realitetin Universal. Realiteti i Hyjnisë mund të krahasohet me diellin, i cili nga lartësia e madhësisë së tij shkëlqen mbi të gjitha horizontet; dhe çdo horizont, çdo shpirt merr një pjesë të rrezatimit të tij. Sikur kjo dritë e këto rreze të mos ekzistonin, nuk do të ekzistonin as qeniet; të gjitha qeniet shprehin diçka dhe marrin disa rreze e pjesë të kësaj drite. Shkëlqimet e përsosurive, të bujarive e të attributeve të Perëndisë ndriçojnë e rrezatojnë nga realiteti i Njeriut të Përsosur—domethënë të Vetmit, të Manifestimit suprem të Perëndisë. Qenie të tjera marrin vetëm një rreze, por Manifestimi suprem është pasqyra për këtë Diell, i cili shfaqet e manifestohet në të, me të gjitha përsosuritë, atributet, shenjat e mrekullitë.

Dija për Realitetin e Hyjnisë është e pamundur dhe e paarritshme, por dija për Manifestimet e Perëndisë është dije për Perëndinë, sepse bujaritë, shkëlqimet e atributet hyjnore janë të dukshme tek Ata. Prandaj në qoftë se njeriu arrin dijen për Manifestimet e Perëndisë, ai do të arrijë dijen për Perëndinë; dhe në qoftë se është i pavëmendshëm ndaj dijes për Manifestimet e Shenjta, do të mbetet pa dije për Perëndinë. Është, pra, e sigurt dhe e provuar se Manifestimet e Shenjta janë qendra e bujarive, e shenjave dhe e përsosurive të Perëndisë. Lum ata që marrin dritën e dhuntive hyjnore nga Agimet e ndriçuara!

Shpresojmë se Miqtë e Perëndisë, si një forcë tërheqëse, do t'i nxjerrin këto bujari nga vetë burimi dhe se ata do të ngrihen me një ndriçim e me shenja të tilla saqë do të jenë prova të dukshme të Diellit të Realitetit.

60

PAVDEKËSIA E SHPIRTIT (1)

Pasi kemi treguar se ekziston shpirti i njeriut,¹⁷⁰ duhet të provojmë pavdekësinë e tij.

Pavdekësia e shpirtit përmendet në Librat e Shenjtë; ajo përbën bazën themelore të feve hyjnore. Thuhet se dënimet dhe shpërblimet janë dy llojesh: së pari, shpërblimet dhe dënimet në këtë jetë; së dyti, ato të botës tjetër. Por parajsa dhe ferri i ekzistencës gjenden në të gjitha botët e Perëndisë, qoftë në këtë botë ose në botët shpirtërore qiellore. Të fitosh këto shpërblime do të thotë të fitosh jetën e amshuar. Ja përse Krishti tha “Vetëm ai që lind me anë të ujit e të shpirtit mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë”.¹⁷¹

Shpërblimet në këtë jetë janë virtytet e përsosuritë që stolisin realitetin e njeriut. Për shembull, ai ishte i errët dhe bëhet i ndriçuar; ishte i paditur dhe bëhet i mençur; ishte i pavëmendshëm dhe bëhet syhapur; ishte në gjumë dhe zgjohet; ishte i vdekur dhe bëhet i gjallë; ishte i verbër dhe bëhet me sy; ishte i shurdhër dhe bëhet me veshë; ishte tokësor dhe bëhet qiellor; ishte material dhe bëhet shpirtëror. Përmes këtyre shpërblimeve ai rilind shpirtërisht dhe bëhet një krijesë e re. Ai bëhet manifestimi i vargut të Ungjillit ku për dishepujt thuhet se ata “kanë lindur jo nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i njeriut, por nga Perëndia”¹⁷²—domethënë ata u çliruan prej tipareve e vetive shtazore, që janë tipare të natyrës njerëzore, dhe u veshën me tipare hyjnore, që janë dhunti e Perëndisë. Kjo është domethënia e lindjes së dytë. Për njerëz të tillë nuk ka torturë më të madhe sesa ndarja prej Perëndisë, dhe nuk ka dënim më të rëndë sesa veset trupore, vetitë e errëta, poshtërsia e karakterit, rrëmbimi prej dëshirave e pshore. Kur ata çlirohen përmes dritës së besimit nga errësira e këtyre veseve dhe ndriçohen nga rrezatimi i diellit të realitetit, dhe fisnikërohen me të gjitha virtytet, ata e çmojnë këtë si shpërblimin më të madh dhe e dinë se kjo është parajsa e vërtetë. Po kështu, ata mendojnë se dënimi

¹⁷⁰ Shih “Dallimi midis njeriut dhe kafshës”, f. 185.

¹⁷¹ Shih Gjoni 3:5.

¹⁷² Gjoni 1:13.

shpirtëror—domethënë tortura dhe dënimi i ekzistencës—është t'i nënshtrohesh botës së natyrës; të ndahesh nga Perëndia; të jesh brutal e injorant; të zhytesh në epsht trupore; të biesh në dobësi shtazore; të karakterizohesh nga veti të errëta si gënjeshtra, tirania, mizoria, tërheqja pas gjërave të kësaj bote dhe pushtimi nga mendime djallëzore. Për ta këto janë dënimet e torturat më të mëdha.

Po ashtu, shpërblimet e botës tjetër janë jeta e amshuar që përmendet qartë në të gjithë Librat e Shenjtë, përsosuritë hyjnore, bujaritë e përjetshme dhe lumturia e pasosur. Shpërblimet e botës tjetër janë përsosuritë dhe paqja që fitohet në botët shpirtërore pas largimit nga kjo botë, ndërsa shpërblimet e kësaj bote janë përsosuritë e vërteta të ndritura që realizohen në këtë botë dhe që sjellin jetë të amshuar, sepse ato janë vetë përparimi i ekzistencës. Është si me njeriun, që kalon nga bota embrionale në gjendjen e pjekurisë dhe bëhet manifestimi i këtyre fjalëve: “Bekuar qoftë, pra, Alláhu, më i miri i Krijuesve”.¹⁷³ Shpërblimet e botës tjetër janë paqja, huret shpirtërore, dhuntitë e ndryshme shpirtërore në Mbretërinë e Perëndisë, plotësimi i dëshirave të shpirtit e të zemrës dhe takimi me Perëndinë në botën e përjetësisë. Po kështu, dënimet e botës tjetër—domethënë mundimet e botës tjetër—janë privimi nga bekimet e veçanta hyjnore e nga bujaritë absolute dhe rënia në shkallën më të ulët të ekzistencës. Ai që është i privuar nga këto favore hyjnore, megjithëse vazhdon të jetojë pas vdekjes, konsiderohet si i vdekur nga njerëzit e së vërtetës.

Prova logjike e pavdekësisë së shpirtit është kjo, që asnjë shenjë nuk mund të vijë nga diçka që nuk ekziston,—domethënë është e pamundur që nga mosekzistenca absolute të shfaqen shenja—sepse shenjat janë rrjedhojë e një ekzistence dhe rrjedhoja varet nga ekzistenca e shkakut. Kështu, nga një diell i paqenë nuk mund të rrezatohet dritë; nga një det i paqenë nuk shfaqen valë; nga një re e paqenë nuk bie shi; një pemë e paqenë nuk jep fryte; një njeri i paqenë as shfaq as krijon gjë. Prandaj sakohë shfaqen shenja të ekzistencës, ato janë një provë se zotëruesi i shenjës ekziston.

Vëreni që sot Mbretëria e Krishtit ekziston. Si mund të manifestohej një mbretëri e tillë e madhe nga një mbret i paqenë? Si mund të ngrihen

¹⁷³ Kurani 23:14.

kaq lart valët nga një det i paqenë? Si mund të përhapen fllade të tilla erëndshme nga një kopësht i paqenë? Pa mendoni se asnjë efekt, asnjë gjurmë, asnjë ndikim nuk mbetet nga cilado qenie pasi gjymtyrët e saj janë shpërndarë dhe elementet e saj janë shpërbërë, mineral, bimë a kafshë qoftë. Vetëm realiteti njerëzor dhe shpirti i njeriut, pas shpërbërjes së organeve, shpërndarjes së pjesëzave dhe shkatërrimit të përbërjes, qëndron dhe vazhdon të veprojë e të ketë fuqi.

Kjo çështje është tepër e hollë: shiheni atë me vëmendje. Kjo është një provë racionale që po japim, dhe i urti mund ta peshojë atë në peshoren e arsyes e të drejtësisë. Por në qoftë se shpirti njerëzor do të ngazëllohet e të tërhiqet drejt Mbretërisë së Perëndisë, në qoftë se shikimi i brendshëm hapet dhe dëgjimi shpirtëror forcohet, dhe mbizotëron ndjenja shpirtërore, ai do ta shohë pavdekësinë e shpirtit po aq qartë sa shikon diellin, dhe lajmi i gëzuar e shenjat e Perëndisë do ta rrethojnë atë.

Nesër do të japim prova të tjera.

61

PAVDEKËSIA E SHPIRTIT (2)

Dje diskutuam lidhur me pavdekësinë e shpirtit. Djeni se aftësia dhe të kuptuarit e shpirtit njerëzor janë dy llojesh—domethënë ato perceptojnë e veprojnë në dy mënyra të ndryshme. Njëra mënyrë është me anë të mjeteve e të organeve: kështu ai me sy shikon; me vesh dëgjon, me gjuhë flet. I tillë është veprimi i shpirtit dhe perceptimi i realitetit të njeriut, që bëhet me anë të organeve—domethënë shpirti është shikuesi, me anë të syve; shpirti është dëgjuesi, me anë të veshit; shpirti është folësi, me anë të gjuhës.

Manifestimi tjetër i aftësive e i veprimeve të shpirtit është pa mjete e organe. Për shembull, në gjendje gjumi njeriu shikon pa sy; dëgjon pa vesh; flet pa gjuhë, vrapon pa këmbë. Me pak fjalë, këto veprime janë tej përdorimit të mjeteve e të organeve. Sa shpesh ndodh që njeriu në gjumë sheh një ëndërr dhe domethënia e saj del në shesh pas dy vjetësh

në rrethana që i korrespondojnë ëndrrës. Po kështu, sa shpesh ndodh që një çështje, që dikush nuk e zgjidh dot kur është zgjuar, gjen zgjidhje në ëndërr. Kur njeriu është zgjuar, syri shikon vetëm në një distancë të shkurtër, por në ëndrra ai që është në Lindje sheh Perëndimin. I zgjuar ai shikon të tashmen; në gjumë sheh të ardhmen. I zgjuar, me mjete të shpejta, ai mund të udhëtojë të shumtën vetëm me njëzet farsakë¹⁷⁴ në orë; në gjumë, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, përshkon Lindjen e Perëndimin. Sepse shpirti udhëton në dy mënyra të ndryshme: pa mjete, që është udhëtim shpirtëror, dhe me mjete, që është udhëtim material: si zogjtë që fluturojnë dhe ata që i transportojnë.

Në kohën e gjumit, trupi është si i vdekur; ai nuk shikon dhe as dëgjon; ai nuk ndien; ai nuk ka vetëdijë, as perceptim—domethënë aftësitë e njeriut bëhen joaktive, por shpirti jeton e mbahet gjallë. Madje depërtimi i tij rritet, fluturimi i tij është më i lartë dhe mençuria e tij është më e madhe. Të mendosh se pas vdekjes së trupit shpirti zhduket, është njëlloj si të përfytyrosh se një zog në kafaz do të asgjësohet në rast se kafazi thyhet, megjithëse zogu nuk ka përse t'i trembet shkatërrimit të kafazit. Trupi ynë është si kafazi dhe shpirti është si zogu. Ne shohim se pa kafaz ky zog fluturon në botën e gjumit; prandaj, në qoftë se kafazi thyhet, zogu do të vazhdojë të ekzistojë. Ndjenjat e tij do të jenë madje më të fuqishme, perceptimet e tij më të mëdha dhe lumturia e tij do të shtohet. Në të vërtetë, nga ferri ai arrin një parajsë kënaqësish, sepse për zogjtë mirënjohës nuk ka parajsë më të madhe sesa lirimi nga kafazi. Ja përse martirët, me gëzimin e lumturinë më të madhe, nxitojnë për në vendin e flijimit.

Në gjendje të zgjuar syri i njeriut shikon të shumtën një orë larg,¹⁷⁵ sepse nëpërmjet përdorimit të trupit fuqia e shpirtit është e kufizuar me kaq; por me shikimin e brendshëm e me syrin e mendjes ai sheh Amerikën, mund të perceptojë atë që ka atje dhe të zbulojë gjendjen e gjërave e të organizojë punët. Sikur shpirti të ishte i njëjtë me trupin, atëherë edhe aftësia e shikimit të brendshëm duhej të kishte të njëjtat përmasa. Është, pra, e qartë se shpirti është i ndryshëm nga trupi, dhe se zogu është i ndryshëm nga kafazi, dhe se aftësia e depërtimi i shpirtit

¹⁷⁴ Një farsak [farsakh] është rreth katër milje.

¹⁷⁵ Është një zakon persian të matet largësia me kohën.

është më i fuqishëm pa ndërmjetësinë e trupit. Kështu, në qoftë se braktiset mjeti, zotëruesi i mjetit vazhdon të veprojë. Për shembull, në qoftë se pena braktiset ose thyhet, shkrimtari mbetet gjallë e i pranishëm; në qoftë se shkatërrohet një shtëpi, pronari mbetet gjallë dhe ekziston. Kjo është një nga provat logjike të pavdekësisë së shpirtit.

Ka dhe një tjetër: trupi mund të bëhet i dobët ose i rëndë a i sëmurë, ose mund të gjejë shëndet; mund të jetë i lodhur ose i çlodhur; ndodh që një dorë apo një këmbë pritet ose fuqia fizike bie; njeriu mund të bëhet i verbër ose shurdh a memec; gjymtyrët mund të paralizohen; me një fjalë, trupi mund të ketë të gjitha cenet. Megjithatë, shpirti në gjendjen e vet origjinale, në perceptimin e vet shpirtëror, do të jetë i përjetshëm e i përherëshëm; ai as pëson cene as gjymtohet. Por, kur trupi i nënshtrohet tërësisht sëmundjes apo fatkeqësisë, ai mbetet pa bujaritë e shpirtit, si një pasqyrë që, kur thyhet ose bëhet pis a pluhuroset, nuk mund të reflektojë rrezet e diellit ose nuk mund të tregojë më bujaritë e tij.

E kemi shpjeguar se shpirti i njeriut nuk gjendet në trupin, sepse ai është i lirë e i spastruar nga hyrja e dalja, që janë kushte trupore. Raporti i shpirtit me trupin është si raporti i diellit me pasqyrën. Me një fjalë, shpirti njerëzor nuk është i kushtëzuar nga trupi. Ai as sëmuret për shkak të sëmundjeve të trupit, as shërohet nga shëndeti i tij; ai nuk raskapitet, as dobësohet, as bëhet fatkeq, as varfërohet, as bëhet i lehtë e as rrëgjohet—domethënë ai nuk plagoset për shkak të lëngatave të trupit dhe asnjë efekt nuk vihet re edhe në qoftë se trupi dobësohet ose duart e këmbët apo gjuha priten, ose ai humbet aftësinë e të dëgjuarit a të të parit. Është, pra, e qartë dhe e sigurt se shpirti ndryshon nga trupi dhe se ekzistenca e tij është e pavarur nga ajo e trupit; përkundrazi, shpirti sundon me madhështinë më të madhe në botën e trupit; dhe fuqia e ndikimi i tij, ashtu si dhuntia e diellit në pasqyrë, janë të qarta e të dukshme. Por kur pasqyra zë pluhur ose thyhet, ajo pushon së reflektuari rrezet e diellit.

62

PËRSOSURITË NUK KANË KUFÏ

Dijeni se kushtet e ekzistencës janë të kufizuara në kushtet e nënshtrimit, të profetërisë e të Hyjnisë, por përsosuritë hyjnore e të rastësishme janë të pakufizuara. Kur mendon thellë, zbulon se edhe përsosuritë e jashtme të ekzistencës janë gjithashtu të pakufizuara, sepse nuk mund të gjesh një qenie aq të përsosur sa të mos mund të përfytyrosh një tjetër që t'ia kalojë. Për shembull, nuk mund të shohësh një rubin në mbretërinë minerale, një trëndafil në mbretërinë bimore ose një bilbil në mbretërinë shtazore pa përfytyruar se mund të ketë lloje më të mira. Duke qenë se bujaritë hyjnore janë pa fund, edhe përsosuritë njerëzore janë pa fund. Po të ishte e mundur të arrihej kufiri i përsosurisë, atëherë një prej realiteteve të qenies mund të arrinte gjendjen e të qenit i pavarur nga Perëndia, dhe e rastësishmja do të arrinte gjendjen e absolutes. Por për çdo qenie ka një pikë të cilën ajo nuk mund ta kapërcejë—domethënë ai që është në gjendje nënshtrimi, sado të përparojë në arritjen e përsosurive të pakufizuara, kurrë nuk do të arrijë gjendjen e Hyjnisë. Kështu ndodh edhe me qeniet e tjera. Një mineral, sado të përparojë në mbretërinë minerale, nuk mund të arrijë cilësinë bimore. Gjithashtu një lule, sado të përparojë në mbretërinë bimore, asnjë aftësi shqisore nuk do të shfaqet. Kështu, ky mineral argjendi nuk mund të arrijë të dëgjojë ose të shikojë; ai vetëm mund të përmirësojë gjendjen e vet dhe të bëhet një mineral i përsosur, por nuk mund të fitojë aftësinë e rritjes, ose aftësinë e ndijimit, ose të arrijë jetën; ai vetëm mund të përparojë brenda gjendjes së vet.

Për shembull, Pjetri nuk mund të bëhet Krisht. E shumta që ai mund të bëjë, në gjendjen e nënshtrimit, është të fitojë përsosuri pa fund; sepse çdo realitet ekzistues është i aftë të përparojë. Ashtu si shpirti i njeriut, i cili pas heqjes së formës së vet materiale ka një jetë të amshuar, sigurisht çdo qenie ekzistuese është e aftë të përparojë; prandaj lejohet të kërkohet përparim, ndjesë, mëshirë, bamirësi e bekime për një njeri pas vdekjes, sepse ekzistenca ka aftësinë të përparojë. Ja përse në lutjet e Bahá'u'lláh-ut kërkohet ndjesë dhe falje e

mëkateve për ata që kanë vdekur. Për më tepër, meqë njerëzit kanë nevojë për Perëndinë në këtë botë, ata do të kenë nevojë për Të edhe në botën tjetër. Krijesat gjithnjë kanë nevojë, dhe Perëndia është absolutisht i pavarur, si në këtë botë dhe në botën tjetër.

Pasuria e botës tjetër është afërsi me Perëndinë. Për rrjedhojë, është e sigurt se atyre që janë pranë Oborrit Hyjnor u lejohet të ndërhyjnë, dhe kjo ndërhyrje miratohet nga Perëndia. Por ndërhyrja në botën tjetër nuk është si ndërhyrja në këtë botë. Ajo është diçka tjetër, një realitet tjetër, që nuk mund të shprehet me fjalë.

Në qoftë se një njeri i pasur në momentin e vdekjes jep një dhuratë për të varfërit e të mjerët dhe lë një pjesë të pasurisë që të shpenzohet për ta, ky veprim mund të bëhet ndoshta shkak që ai të marrë ndjesë e t'i falen mëkatet dhe të përparojë në Mbretërinë Hyjnore.

Edhe babai e nëna përballojnë shqetësimet e vështirësitë më të mëdha për fëmijët e tyre; dhe shpesh, kur fëmijët kanë arritur moshën e pjekurisë, prindërit shkojnë në botën tjetër. Rrallë ndodh që një baba e një nënë ta shohin në këtë botë shpërblimin për kujdesin e shqetësimet që kanë përjetuar për fëmijët e tyre. Prandaj fëmijët, në këmbim të këtij kujdesi e shqetësimi, duhet të tregohen bamirës e shpirtmirë dhe të kërkojnë ndjesë e falje për prindërit e tyre. Kështu, në këmbim të dashurisë e të mirësisë së treguar nga ati juaj, ju duhet t'u jepni të varfërve për hir të tij dhe, me nënshtrimin e përlulësinë më të madhe, të luteni për ndjesë e falje të mëkateve dhe të kërkonin mëshirën supreme.

Është madje e mundur që gjendja e atyre që kanë vdekur në mëkat e mosbesim të ndryshojë—domethënë ata mund të bëhen objekt i ndjesës falë bujarisë së Perëndisë, jo falë drejtësisë së Tij—sepse bujari do të thotë të japësh pa e merituar, ndërsa drejtësi do të thotë të japësh atë që të takon. Ashtu siç e kemi në dorë të lutemi për këta persona këtu, po kështu do ta kemi në dorë në botën tjetër, që është Mbretëria e Perëndisë. A nuk janë të gjithë njerëzit në atë botë krijesa të Perëndisë? Pra, ata edhe në atë botë mund të përparojnë. Ashtu si mund të marrin dritë këtu me anë të lutjeve të tyre, edhe atje ata mund të lypin ndjesë e të marrin dritë me anë faljesh e lutjesh. Ashtu si shpirtat në këtë botë, me ndihmën e lutjeve e të kërkesave të shenjtoreve, mund të arrijnë zhvillim, po kështu ndodh edhe pas vdekjes. Përmes lutjeve e kërkesave

të veta ata gjithashtu mund të përparojnë, por sidomos kur janë objekt i ndërhyrjes së Manifestimeve të Shenjta.

63

PËRPARIMI I NJERIUT NË BOTËN TJETËR

Dijeni se asgjë që ekziston nuk mbetet në gjendje prehjeje—domethënë të gjitha gjërat janë në lëvizje. Çdo gjë ose është në rritje ose është në rënie: të gjitha gjërat ose vijnë nga mosqenia në jetë, ose shkojnë nga qenia në mosqenie. Kështu, kjo lule, ky zambak, në njëfarë kohe erdhi nga bota e mosqenies në qenie dhe tani po kalon nga qenia në mosqenie. Kjo gjendje lëvizjeje thuhet se është thelbësore—domethënë e natyrshme; ajo nuk mund të ndahet prej qenieve, sepse është kërkesa e tyre thelbësore, siç është kërkesa thelbësore e zjarrit të digjet.

Pra, është provuar se kjo lëvizje është e nevojshme për ekzistencën, e cila është ose në rritje ose në rënie. Tani, duke qenë se shpirti vazhdon të ekzistojë pas vdekjes, ai medoemos ose përparon ose është në rënie; dhe në botën tjetër të pushosh së përparuari është njëlloj si të jesh në rënie; por shpirti kurrë nuk del jashtë gjendjes së vet, në të cilën vazhdon të zhvillohet. Për shembull, realiteti i shpirtit të Pjetrit, sado të përparojë, nuk mund të arrijë gjendjen e realitetit të Krishtit; ai përparon vetëm brenda mjedisit të vet.

Vërejani këtë mineral. Sado që të zhvillohet, ai zhvillohet vetëm brenda gjendjes së vet; nuk mund ta çosh një kristal në një gjendje që ai të arrijë të fitojë shikim. Kjo është e pamundur. Kështu, hëna që është në qiell, sado të zhvillohet, kurrë nuk mund të bëhet diell i shndritshëm, por në gjendjen e vet ajo ka një apogje e një perigje. Sado të përparojnë dishepujt, ata kurrë nuk bëhen dot Krisht. Është e vërtetë se qymyri mund të bëhet diamant, por të dy ndodhen në gjendje minerale dhe elementet e tyre përbërëse janë të njëjta.

64

GJENJDA NJERIUT DHE PËRPARIMI I TIJ PAS VDEKJES

Kur i shohim qeniet me sy vëzhgues, vërejmë se ato kufizohen në tre lloje—domethënë në tërësi ato janë ose minerale, ose bimë, ose kafshë, dhe secila prej këtyre tri klasave përmban specie. Njeriu është specia më e lartë, sepse ai zotëron përsosuritë e të gjitha klasave—dmth ai ka një trup që rritet e që ndien. Veç që ka përsosuritë e mineraleve, të bimëve e të kafshëve, ai zotëron gjithashtu një shquarsi të veçantë që qeniet e tjera nuk e kanë—dmth përsosuritë intelektuale. Prandaj njeriu është më fisnikja e qenieve.

Njeriu është shkalla më e lartë e materialitetit dhe fillimi i shpirtësisë—domethënë ai është fundi i papërsosurisë dhe fillimi i përsosurisë. Ai është në shkallën e fundit të errësirës dhe në fillimin e dritës; ja përse është thënë se gjendja e njeriut është fundi i natës dhe fillimi i ditës, që do të thotë se ai është tërësia e të gjitha shkallëve të papërsosurisë dhe se ai zotëron shkallët e përsosurisë. Ai ka anën shtazore si dhe anën engjëjllore, dhe qëllimi i një edukatori është t'i stërvitë karakteret njerëzore në mënyrë të tillë që aspekti i tyre engjëllor të mposhtë anën e tyre shtazore. Kështu, po qe se aftësia hyjnore e njeriut, që është përsosuria e tij thelbësore, ia kalon aftësisë djallëzore, që është papërsosuri absolute, ai bëhet më i shkëlqyeri ndër krijesat; por po qe se aftësia djallëzore e mposht aftësinë hyjnore, ai bëhet më i ulëti i krijesave. Ja përse ai është fundi i papërsosurisë dhe fillimi i përsosurisë. Në asnjë specie tjetër në botën e ekzistencën nuk ka një ndryshim, kontrast, kontradiktë e kundërvënie të tillë si në specien e njeriut. Kështu, pasqyrimi i Dritës Hyjnore ishte te njeriu, si dhe te Krishti, dhe shihni sa i dashur e i nderuar është Krishti! Në të njëjtën kohë, e shohim njeriun të adhurojë një gur, një plis dheu ose një pemë.

Sa poshtë qëndron ai, që objekti i tij i adhurimit është ekzistenca më e ulët—dmth një gur ose balta pa shpirt; një mal, një pyll ose një pemë. A ka turp më të madh për njeriun se sa të adhurojë ekzistencat më të ulëta? Në të njëjtën mënyrë, dija është një veti e njeriut dhe po kështu është injoranca; vërtetësia është veti e njeriut; dhe po kështu është gënjeshtria; besnikëria dhe tradhtia, drejtësia dhe padrejtësia janë veti të njeriut e kështu me radhë. Me një fjalë, të gjitha përsosuritë e virtytet dhe të gjitha veset janë veti të njeriut.

Shikoni edhe dallimet individuale midis njerëzve. Krishti ishte në formën e njeriut dhe Kaifai ishte në formën e njeriut; Moisiu dhe Faraoni, Abeli dhe Kaini, Bahá'u'lláh-u dhe Jahjai,¹⁷⁶ ishin njerëz.

Thuhet se njeriu është përfaqësuesi më i madh i Perëndisë, dhe ai është Libri i Krijimit, sepse të gjitha misteret e ekzistencës janë tek ai. Në qoftë se ai hyn nën hijen e Edukatorit të Vërtetë dhe stërvitet drejt, ai bëhet thelbi i thelbeve, drita e dritave, shpirti i shpirtave; ai bëhet qendra e shfaqjeve hyjnore, burim i vetive shpirtërore, vendagimi i dritave qiellore dhe marrësi i frymëzimeve hyjnore. Në qoftë se mbetet pa këtë edukim, ai bëhet manifestimi i vetive djallëzore, tërësia e veseve shtazore dhe burimi i gjithfarë rrethanave të errëta.

Arsyeja e misionit të Profetëve është t'i edukojnë njerëzit, në mënyrë që kjo copë qymyri të mund të bëhet diamand, dhe kjo pemë e pafrytshme të mund të shartohet e të japë frytet më të ëmbla e më të shijshme. Kur njeriu arrin gjendjen më fisnike në botën e njerëzimit, atëhere ai mund të bëjë përparim të mëtejshëm në kushtet e përsosurisë, por jo në gjendjen e tij njerëzore; sepse gjendje të tilla kanë kufij, ndërsa përsosuritë hyjnore janë pa fund.

Si para dhe pas heqjes së kësaj forme materiale, ka përparim në përsosuri por jo në gjendjen. Kështu, qeniet arrijnë përsosjen te njeriu i përkryer. Nuk ka qenie tjetër që të qëndrojë më lart se një njeri i përkryer. Por njeriu, kur ka arritur këtë gjendje, ende mund të përparojë në përsosuritë, por jo në gjendjen e tij, sepse nuk ka gjendje më të lartë sesa ajo e njeriut të përsosur, në të cilën ai të mund të shndërrohet. Ai vetëm përparon në gjendjen e njerëzimit, sepse përsosuritë njerëzore

¹⁷⁶ Mirza Jahja Subi Azal [Mírzá Ya+yá ☒ub+i-Azal], gjysmëvëlla i Bahá'u'lláh-ut dhe armik i papajtueshëm i Tij.

janë pa fund. Kështu, sado i ditur të jetë një njeri, ne mund të përfytyrojmë një më të ditur.

Pra, duke qenë se përsosuritë e njerëzimit janë pa fund, njeriu mundet gjithashtu të përparojë në përsosuri pas largimit nga kjo botë.

65

SHPJEGIM I NJË VARGU NË QITAPI AKDAS

Pyetje.—në Qitapi Akdas thuhet “...cilido që privohet nga kjo, ka shkuar në rrugë të gabuar, edhe në qoftë autor i çdo vepre të drejtë”. Cili është kuptimi i këtij vargu?

Përgjigje.—Ky varg i bekuar do të thotë se themeli i suksesit e i shpëtimit është njohja e Perëndisë, dhe se rezultatet e njohjes së Perëndisë janë veprimet e mira, fryte të besimit.

Në qoftë se një njeri nuk e ka këtë njohuri, ai do të ndahet nga Perëndia, dhe kur kjo ndarje ekziston, veprimet e mira nuk kanë efekt të plotë. Ky varg nuk do të thotë se shpirtat e ndarë nga Perëndia janë të barabartë qoftë nëse bëjnë veprime të mira ose të këqija. Ai do të thotë vetëm që themeli është të njohësh Perëndinë, dhe veprimet e mira rezultojnë nga kjo njohje. Megjithatë, është e sigurt se ka dallim midistë të mirëve, mëkatarëve dhe të ligjve që janë të ndarë nga Perëndia. Sepse ai që është i ndarë, por ka parime e karakter të mirë, meriton faljen e Perëndisë, ndërsa ai që është mëkatar dhe ka cilësi e karakter të keq është i privuar nga bujaritë e bekimet e Perëndisë. Këtu qëndron ndryshimi.

Pra, ky varg i bekuar do të thotë se vetëm bëmat e mira, të pashoqëruara me njohjen e Perëndisë, nuk sjellin shpëtim të përjetshëm, sukses të përhershëm, begati dhe hyrjen në Mbretërinë e Perëndisë.

66

EKZISTENCA E NDËRGJEGJES RACIONALE PAS VDEKJES SË TRUPIT

Pyetje.—Pasi është braktisur trupi dhe shpirti ka fituar lirinë, në ç'mënyrë do të ekzistojë fryma racionale; le të supozojmë se personat që ndihmohen nga bujaria e Shpirtit të Shenjtë arrijnë ekzistencën e vërtetë dhe jetën e amshuar. Por ç'bëhet me frymët racionale—me fjalë të tjera, me shpirtërat e ndarë me perde?¹⁷⁷

Përgjigje.—Disa mendojnë se trupi është substanca dhe ekziston vetiu dhe se shpirti është i rastësishëm e varet nga substanca e trupit, megjithëse, në të kundërtën, fryma racionale është substanca dhe trupi varet prej saj. Në qoftë se e rastësishmja—domethënë trupi—shkatërrohet, substanca, shpirti mbetet.

Së dyti, fryma racionale, që do të thotë shpirti njerëzor, nuk zbret te trupi—domethënë nuk hyn në të, sepse zbritja e hyrja janë karakteristika të trupave, dhe fryma racionale është e çliruar nga kjo. Shpirti kurrë nuk ka hyrë në një trup, kështu që duke u larguar prej tij nuk do të ketë nevojë për banesë: jo, shpirti është i lidhur me trupin siç është drita me këtë pasqyrë. Kur pasqyra është e pastër dhe e përsosur, drita e llambës do të duket në të, dhe kur pasqyra zë pluhur ose thyhet, drita do të zhduket.

Fryma racionale—domethënë shpirti njerëzor—as ka hyrë në këtë trup dhe as ekziston nëpërmjet tij; kështu, pas shpërbërjes së ndërtimit trupor, si do të ketë nevojë ai për një substancë nëpërmjet së cilës të mund të ekzistojë? Në të kundërtën, fryma racionale është substanca nëpërmjet së cilës ekziston trupi. Personaliteti i frymës racionale ekziston që nga fillimi; ai nuk varet nga funksioni i trupit, por gjendja dhe personaliteti i frymës racionale mund të forcohen në këtë botë; ai mund të bëjë përparime dhe të arrijë shkallët e përsosurisë ose të mbetet në humnerën më të thellë të injorancës, i mbuluar me vel e i privuar nga soditja e shenjave të Perëndisë.

Pyetje.—Me ç'mjete do të përparojë shpirti i njeriut—domethënë fryma racionale—pas ndarjes nga kjo botë e vdekshme?

¹⁷⁷ “Shpirtra të ndarë me perde” ka këtu keptimin e frymëve racionale, të frymëve që nuk zotërojnë shpirtin e besimit. Shih “Fryma, shpirti dhe mendja”, f. 208.

Përgjigje.—Përparimi i shpirti njerëzor në botën hyjnore, pas shkëputjes së lidhjes së tij me trupin prej pluhuri, bëhet vetëm nëpërmjet bujarisë e hirit të Zotit, ose nëpërmjet ndërhyrjes e lutjeve të sinqerta të shpirtave të tjerë njerëzorë, ose nëpërmjet bamirësive e veprave të mira me rëndësi që bëhen në emër të tij.

PAVDEKËSIA E FËMIJËVE

Pyetje.—Cila është gjendja e fëmijëve që vdesin para se të arrijnë moshën e arsyes ose para se të lindin?

Përgjigje.—Këto foshnje janë nën hijen e dashamirësisë së Perëndisë; dhe meqë nuk kanë bërë ndonjë mëkat dhe nuk janë njollosur me papastërtitë e botës së natyrës, ata janë qendra të manifestimit të bujarisë dhe Syri i Dhembshurisë do të qëndrojë mbi ta.

67

JETA E AMSHUAR DHE HYRJA NË MBRETËRINË E PERËNDISË

Ju pyesni për jetën e amshuar dhe hyrjen në Mbretërinë. Shprehja e jashtme që përdoret për Mbretërinë është qielli; por ky është një krahasim e gjasim, dhe jo një realitet apo fakt, sepse Mbretëria nuk është një vend material; ajo është e spastruar nga koha e hapësira. Ajo është botë shpirtërore, botë hyjnore dhe qendra e Sovranitetit të Perëndisë; ajo është e çliruar nga trupi e nga çdo gjë trupore, dhe është e spastruar dhe e lirë nga përfytyrimet e botës njerëzore. Të kufizohesh në hapësirë është veti e trupave e jo e shpirtave. Vendi dhe koha rrethojnë trupin, jo mendjen e shpirtin. Vini re se trupi i njeriut është i kufizuar në një vend të vogël; ai zë vetëm dy pëllëmbë tokë. Ndërsa shpirti e mendja e njeriut udhëtojnë në të gjitha vendet e krahinat—madje edhe përmes hapësirës së qiejve—rrethojnë çdo gjë që ekziston, dhe bëjnë zbulime në sferat më të larta e në distanca të pafundme. Kjo ndodh sepse shpirti nuk ka vend; ai është i pavend; dhe për shpirtin toka

dhe qielli janë një, derisa ai bën zbulime në të dyja. Ndërsa trupi është i kufizuar në një vend dhe nuk di se ç'ndodh përtej tij.

Sepse jeta është dy llojesh: ajo e trupit dhe ajo e shpirtit. Jeta e trupit është jetë materiale, ndërsa jeta e shpirtit shpreh ekzistencën e Mbretërisë, thelbi i së cilës është të marrësh Frymën e Perëndisë dhe të këndellesh nga flladi i Shpirtit të Shenjtë. Edhe pse jeta materiale ka ekzistencë, ajo është thjesht mosekzistencë dhe vdekje absolute për shenjtoret e shenjtëruar. Kështu, njeriu ekziston, dhe ky gur gjithashtu ekziston, por sa ndryshim ka midis njeriut dhe gurit! Edhe pse guri ekziston, në raport me ekzistencën e njeriut ai është sikur nuk ekziston.

Domethënia e jetës së amshuar është dhuntia e Shpirtit të Shenjtë, ashtu si lulje merr dhuntitë e stinës, të ajrit e të flladit pranveror. Shikoni: në fillim kjo lule ka pasur jetë të ngjashme me jetën e mineralit; por me ardhjen e stinës së pranverës, falë bujarisë së reve pranverore dhe nxehtësisë së diellit flakëruës, ajo arriti një jetë tjetër plot freski, shije e aroma erëndshme. Jeta e parë e lules, në krahasim me jetën e dytë, është vdekje.

Domethënia është se jeta e Mbretërisë është jetë e shpirtit, jetë e amshuar dhe se ajo është e spastruar nga hapësira, ashtu si shpirti i njeriut që nuk ka shtrirje në hapësirë. Sepse, po të vëzhgosh trupin njerëzor, nuk gjen ndonjë vend a seli të posaçme për shpirtin, sepse ai kurrë nuk ka pasur ndonjë vend; ai është jomaterial. Ai ka një lidhje me trupin si atë të diellit me këtë pasqyrë. Dielli nuk është brenda pasqyrës, por ka lidhje me pasqyrën.

Po kështu bota e Mbretërisë është e spastruar nga çdo gjë që mund të perceptohet prej syrit ose prej shqisave të tjera—të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit ose të prekurit. Mendja që është te njeriu, ekzistenca e së cilës është e njohur, në ç'vend ndodhet tek ai? Po ta këqyrësh trupin me sy, me veshë ose me shqisat e tjera, nuk do ta gjesh; megjithatë, ajo ekziston. Pra, mendja nuk ka ndonjë vend, por është e lidhur me trurin. Mbretëria i përngjet kësaj. Po kështu dashuria nuk ka ndonjë vend, por është e lidhur me zemrën; Mbretëria nuk ka ndonjë vend, por është e lidhur me njeriun.

Hyrja në Mbretërinë bëhet nëpërmjet dashurisë ndaj Perëndisë, nëpërmjet shkëputjes, nëpërmjet shenjtërisë e dëlirësisë, nëpërmjet vërtetësisë, pastërtisë, qëndrueshmërisë, besnikërisë dhe flijimit të jetës.

Këto sqarime tregojnë se njeriu është i pavdekshëm dhe jeton përjetësisht. Për ata që besojnë te Perëndia, që ushqejnë dashuri e besim ndaj Perëndisë, jeta është e përsosur—dmth është jetë e amshuar; por për ata shpirta që janë të ndarë me perde nga Perëndia, edhe pse ata kanë jetë, ajo është e errët dhe, në krahasim me jetën e besimtarëve, është mosqenie.

Për shembull, syri dhe thoi janë të gjallë; por jeta e thoit, në krahasim me jetën e syrit, është sikur nuk ekziston. Ky gur dhe ky njeri që të dy ekzistojnë; por guri në krahasim me ekzistencën e njeriut është sikur nuk ekziston; ai nuk ka qenie; sepse kur njeriu vdes dhe trupi i tij shkatërrohet e asgjësohet, ai bëhet si guri e dheu. Pra, është e qartë që edhe pse minerali ekziston, në krahasim me njeriun ai sikur nuk ekziston.

Po kështu, shpirtat që janë të ndarë si me perde nga Perëndia, edhe pse ekzistojnë në këtë botë dhe në botën pas vdekjes, në krahasim me ekzistencën e shenjtë të fëmijëve të Mbretërisë së Perëndisë, nuk ekzistojnë dhe janë të ndarë nga Perëndia.

68

FATI

Pyetje.—A është paracaktimi që përmendet në Librat e Shenjtë një gjë e vendosur? Po qe kështu, a nuk është e kotë përpjekja për ta shmangur atë?

Përgjigje.—Fati është dy llojesh: njëri është i vendosur, tjetri është i kushtëzuar ose që kanoset. Fati i vendosur është ai që nuk mund të ndryshohet a të ndërrohet, ndërsa fati i kushtëzuar është ai që mund të ndodhë. Kështu, për këtë llambë fati i vendosur është që vaji digjet e do të konsumohet; prandaj fikja e saj përfundimtare është një vendim që nuk mund të ndryshohet a të ndërrohet, sepse ky është një fat i

vendosur. Po kështu, në trupin e njeriut është krijuar një fuqi jetësore dhe sapo ajo të shkatërrohet e të marrë fund, trupi me siguri do të shpërbëhet; kur vaji në këtë llambë të digjet e të mbarojë, llamba padyshim do të shuhet.

Por fati i kushtëzuar mund të krahasohet me këtë: ndërkohë që ka ende vaj, një erë e fortë fryn mbi llambë dhe e fik atë. Ky është fati i kushtëzuar. Është mençuri ta shmangësh atë, ta ruash veten prej tij, të jesh i kujdesshëm e i matur. Por fati i vendosur, që është i ngjashëm me mbarimin e vajt në llambë, nuk mund të ndërrohet, të ndryshohet ose të shtyhet. Ai duhet të ndodhë; është e pashmangshme që llamba do të fiket.

69

NDIKIMI I YJEVE

Pyetje.—A kanë yjet e qiellit ndonjë ndikim mbi shpirtin njerëzor apo jo?

Përgjigje.—Disa yje të qiellit kanë një efekt material të qartë e të dukshëm mbi rruzullin tokësor e mbi qeniet tokësore, që nuk ka nevojë të shpjegohet. Shikoni diellin, i cili falë ndihmës e kujdesit të Perëndisë zhvillon tokën dhe të gjitha qeniet tokësore. Pa dritën e ngrohtësinë e diellit, të gjitha krijesat tokësore nuk do të ekzistonin fare.

Përsa i përket ndikimit shpirtëror të yjeve, edhe pse ky ndikim i yjeve në botën njerëzore mund të duket i çuditshëm, përsëri, po të mendosh thellë për këtë çështje, nuk ka përse të habitesh shumë. Sidoqoftë, unë nuk dua të them se parashikimet që astrologët e kohëve të kaluara nxirrnin nga lëvizjet e yjeve u korrespondojnë ngjarjeve që ndodhnin; sepse parashikimet e këtyre astrologëve të së kaluarës ishin forma të imagjinatës, që e kishin prejardhjen te priftërinjtë egjiptianë, asirianë e kaldeanë; madje ato vinin nga fantazitë e hinduve, nga mitet e grekëve, të romakëve e të adhuruesve të tjerë të yjeve. Por dua të them se kjo gjithësi e pafundme është si trupi njerëzor, të gjithë gjymtyrët e të cilit janë të lidhur e të bashkuar shumë ngushtë me njëri-tjetrin. Sa shumë organet, gjymtyrët e pjesët e trupit të njeriut janë të gërshetuara e të lidhura për ndihmë e mbështetje të ndërsjellë dhe sa shumë

ndikojnë ato mbi njëra-tjetrën! Po kështu pjesët e kësaj gjithësie të pafundme i kanë gjymtyrët e elementet të lidhur midis tyre dhe ndikojnë mbi njëri-tjetrin shpirtërisht e materialisht.

Për shembull, syri shikon dhe gjithë trupi ndikohet; veshi dëgjon dhe ndiejnë të gjitha pjesët e trupit. Për këtë nuk ka dyshim; dhe gjithësia është si një person i gjallë. Për më tepër, lidhjet që ekzistojnë midis gjymtyrëve të qenieve medoemos duhet të ushtrojnë ndikim e të lënë mbresë, qoftë materiale ose shpirtërore.

Për ata që e mohojnë ndikimin shpirtëror mbi gjërat materiale po japim këtë shembull të shkurtër: tinguj e intonacione të mahnitshme melodi e zëra të këndshëm janë dukuri që ndikojnë mbi ajrin—sepse tingulli është termi që përdoret për dridhjet e ajrit—dhe këto dridhje ndikojnë mbi nervat e timpanit të veshit, e nga kjo rezulton të dëgjuarit. Tani, mendoni se dridhja e ajrit, që është një dukuri e parëndësishme, tërheq e gëzon shpirtin e njeriut dhe ka një efekt të madh mbi të: e bën atë të qajë ose të qeshë; ndoshta mund të ndikojë mbi të deri në atë shkallë sa ai ta verë veten në rrezik. Shihni, pra, lidhjen që ekziston midis shpirtit të njeriut dhe dridhjes atmosferike, aq sa lëvizja e ajrit shkakton kalimin e tij nga një gjendje në një tjetër dhe e mposht tërësisht atë; madje mund të bëjë që ai të humbasë durimin e qetësinë. Mendoni sa e çuditshme është kjo, sepse asgjë nuk del nga këngëtari që të hyjë tek dëgjuesi; megjithatë, shkaktohet një efekt i madh shpirtëror. Pra, sigurisht që një lidhje kaq e madhe midis qenieve duhet të ketë efekt e ndikim shpirtëror.

E kemi përmendur se organet dhe pjesët e ndryshme të njeriut prekin e ndikojnë njëra-tjetrën. Për shembull, syri shikon; ndikohet zemra. Dëgjon veshi dhe ndikohet shpirti. Zemra është e qetë; mendimet bëhen të qeta dhe në të gjitha gjymtyrët e trupit të njeriut përhapet një ndjenjë e këndshme. Ç’lidhje e ç’marrëveshje është vallë kjo! Derisa kjo lidhje, ky efekt e ky ndikim shpirtëror ekzistojnë midis organeve të trupit të njeriut, i cili është vetëm një prej shumë qenieve të fundme, sigurisht midis këtyre qenieve universale e të pafundme duhet gjithashtu të ekzistojë një lidhje shpirtërore e materiale. Edhe pse me rregullat ekzistuese dhe me shkencën e sotme këto lidhje nuk mund të zbulohen, megjithatë ekzistenca e tyre midis të gjitha qenieve është e sigurt e absolute.

Si përfundim: qeniet, të mëdha a të vogla qofshin, janë të lidhura me njëra-tjetrën nga urtia e përsosur e Perëndisë dhe prekin e ndikojnë njëra-tjetrën. Po të mos ishte kështu, do të kishte çrregullim e papërsosuri në sistemin universal dhe në rregullimin e përgjithshëm të ekzistencës do të kishte çrregullim e papërsosuri. Por meqë qeniet janë të lidhura aq ngushtë me njëra-tjetrën, ato janë në rregull në vendet e tyre e të përsosura.

Kjo çështje ia vlen të shqyrtohet.

70

VULLNETI I LIRË

Pyetje.—A është njeriu i lirë në të gjitha veprimet e tij, apo është i detyruar e i shtrënguar?

Përgjigje.—Kjo pyetje është një ndër problemet hyjnore më të rëndësishme e më të ngatërruara. Në dashtë Perëndia, një ditë tjetër, në fillim të drekës, do t'i futemi shpjegimit të hollësishëm të kësaj çështjeje; tani do ta shpjegojmë atë shkurt, me pak fjalë, në mënyrën që vijon. Disa gjëra i nënshtrohen vullnetit të lirë të njeriut, siç janë drejtësia, paanësia, tirania e padrejtësia, me fjalë të tjera veprimet e mira e të këqija; është e qartë e duket vetiu se këto veprime, në pjesën më të madhe, i janë lënë vullnetit të njeriut. Por ka disa gjëra, për të cilat njeriu është i detyruar apo i shtrënguar, siç janë gjumi, vdekja, sëmundja, rënia e forcave, dëmtimet e fatkeqësitë; këto nuk varen nga vullneti i njeriut dhe ai nuk është përgjegjës për to, sepse është i detyruar t'i përjetojë ato. Por në zgjedhjen e veprimeve të mira e të këqija ai është i lirë dhe i kryen ato sipas vullnetit të tij.

Për shembull, në qoftë se dëshiron, ai mund ta kalojë kohën duke lavdëruar Perëndinë, ose mund të jetë i zënë me mendime të tjera. Ai mund të jetë një dritë e ndezur nga zjarri i dashurisë për Perëndinë dhe një filantrop që e do botën, ose mund të jetë njeri që e urren njerëzimin e që rend pas gjërave materiale. Ai mund të jetë i drejtë ose zemërgur. Këto veprime e bëma janë nën kontrollin e vullnetit të vetë njeriut; pra, ai është përgjegjës për to.

Tani del një çështje tjetër. Njeriu është absolutisht i pafuqishëm e i varur, derisa forca e fuqia i përkasin në mënyrë të posaçme Perëndisë. Si lartësimi dhe poshtërimi varen nga dëshira e vullneti i Më të Lartit.

Në Dhiatën e Re thuhet se Perëndia është si një poçar që bën “një enë për përdorim fisnik e një tjetër për përdorim jofisnik”.¹⁷⁸ Tani, ena për përdorim jofisnik nuk ka të drejtë të bëjë me faj poçarit duke thënë “Përse nuk më bërë mua një kupë të çmuar, që kalon nga dora në dorë?” Domethënia e këtij vargu është se pozitat e qenieve janë të ndryshme. Ajo që është në gjendjen më të ulët të ekzistencës, si minerali, nuk ka të drejtë të ankohet duke thënë, “O Perëndi, përse nuk më dhe mua përsosuritë bimore?” Po kështu, bima nuk ka të drejtë të ankohet se i janë mohuar përsosuritë e botës shtazore. Gjithashtu nuk u takon kafshëve të ankohen se u mungojnë përsosuritë njerëzore. Jo, të gjitha këto gjëra janë të përsosura në shkallën e tyre dhe ato duhet të përpiqen të arrijnë përsosuritë e shkallës së tyre. Qeniet më të ulëta, siç e kemi thënë, as kanë të drejtën as janë të përshtatshme për gjendjen e përsosurive më të larta. Jo, përparimi i tyre duhet të kryhet brenda gjendjes së tyre.

Gjithashtu mosveprimi ose veprimi i njeriut varet nga ndihma e Perëndisë. Në qoftë se nuk ndihmohet, ai nuk është në gjendje të bëjë as mirë as keq. Por kur ndihma e ekzistencës vjen nga Zoti bujar, ai është në gjendje të bëjë si mirë edhe keq; por në qoftë se ndihma ndërpritet, ai mbete krejt i pafuqishëm. Ja përse në Librat e Shenjtë flitet për ndihmën dhe mbështetjen e Perëndisë. Kështu, kjo gjendje është si ajo e një anije që lëviz nga fuqia e erës ose e avullit; në qoftë se kjo fuqi ndërpritet, anija nuk mund të lëvizë fare. Megjithatë, timoni i anijes e kthen atë nga çdo anë dhe fuqia e avullit e lëviz atë në drejtimin e dëshiruar. Në qoftë se ajo është drejtuar nga Lindja, shkon në Lindje; ose po qe drejtuar nga Perëndimi, shkon në Perëndim. Kjo lëvizje nuk vjen nga anija, por nga era ose avulli.

Po kështu, në çdo veprim ose mosveprim të njeriut, ai merr fuqi nga ndihma e Perëndisë; por zgjedhja e së mirës ose e së keqes i takon vetë njeriut. Kështu, në rast se një mbret do të emëronte dikë si guvernator të një qyteti, dhe do t’i jepte atij pushtet e autoritet, dhe do t’i tregonte atij

¹⁷⁸ Letër romakëve 9:21.

rrugët e drejtësisë e të padrejtësisë në përputhje me ligjet—në qoftë se pastaj ky guvernator do të bënte padrejtësi, edhe pse do të vepronte me autoritetin e pushtetit e mbretit, ky i fundit do të ishte i shfajësuar për padrejtësitë. Por në qoftë se ai do të vepronte me drejtësi, ai do ta bënte këtë, gjithashtu, përmes autoritetit të mbretit, të cilit kjo do t'i pëlqente e do të ishte i kënaqur.

Pra, edhe pse zgjedhja e së mirës dhe e së keqes i takon njeriut, ai, në të gjitha rrethanat, është i varur nga mbështetja për jetën, që i vjen nga Fuqiploti. Mbretëria e Perëndisë është e paanë dhe të gjithë janë robër në dorën e Pushtetit të Tij. Shërbëtori nuk mund të bëjë asgjë sipas dëshirës së vet; Perëndia është i pushtetshëm, i gjithëfuqishëm dhe Ndhimuesi i të gjitha qenieve.

Kjo çështje u shpjegua qartë. Përshëndetje!

71

VIZIONET DHE KOMUNIKIMI ME SHPIRTRAT

Pyetje. - Disa njerëz besojnë se arrijnë zbulime shpirtërore—domethënë se bisedojnë me shpirtrat. Ç'loj komunikimi është ky?

Përgjigje.—Ka dy lloje zbulimesh shpirtërore: njëri është thjesht imagjinatë dhe mbështetet vetëm në thënie të pak njerëzve; lloji tjetër i përngjet frymëzimit dhe është real—të tilla janë revelacionet e Isaisë, të Jeremisë e të Shën Gjorit, që janë të vërteta.

Pa mendoni që fuqia e mendimit të njeriut është dy llojesh. Njëri lloj është i vërtetë, kur është në pajtim me një të vërtetë të caktuar. Koncepte të tilla realizohen në botën e jashtme; të tilla janë mendimet e sakta, teoritë e drejta, zbulimet dhe shpikjet shkencore.

Lloji tjetër i konceptimeve përbëhet prej mendimesh të kota e idesh të padobishme, që nuk japin as fryte as rezultate dhe të cilat nuk kanë realitet. Jo, ato dalin si dallgët e detit të imagjinatës dhe zhduken si ëndrra të kota.

Po kështu, ka dy lloje zbulimesh shpirtërore. Njëri janë revelacionet e Profetëve dhe zbulimet shpirtërore të të zgjedhurve. Vizionet e

Profetëve nuk janë ëndrra; jo, ata janë zbulime shpirtërore dhe kanë realitet. Ata thonë, për shembull, “Unë pashë një person në një formë të caktuar dhe i thashë një gjë të tillë dhe ai më dha një përgjigje të tillë”. Ky vizion është në botën e vigjilimit e jo në atë të gjumit. Jo, ai është një zbulim shpirtëror që shprehet në formën e një vizioni.

Lloji tjetër i zbulimeve shpirtërore përbëhet prej imagjinatash të kulluara, por këto imagjinata trupëzohen në mënyrë të tillë saqë shumë njerëz të patëkeq besojnë se ato janë realitet. Ajo që e provon qartë këtë është se ky kontroll i shpirtave kurrë nuk ka dhënë ndonjë fryt a rezultat. Jo, këto s’janë veçse përralla e histori.

Dijeni se realiteti i njeriut përfshin realitetet e gjërave dhe zbulon të vërtetat, vetitë dhe të fshehtat e gjërave. Kështu, të gjitha këto arte, mrekulli, shkenca e dije janë zbuluar nga realiteti njerëzor. Dikur, këto shkenca, dije, mrekulli e arte ishin sekrete të fshehura e të mbuluara; pastaj, gradualisht, realiteti njerëzor i zbuloi ato dhe i solli nga sfera e së padukshmes në rrafshin e së dukshmes. Është, pra, e qartë se realiteti i njeriut i përfshin gjërat. Kështu, ai është në Evropë dhe zbulon Amerikën; është në tokë dhe bën zbulime në qiejt. Ai është zbuluesi i sekreteve të gjërave dhe njohësi i realiteteve të asaj që ekziston. Këto zbulime, që i korrespondojnë realitetit, janë të ngjashme me revelacionin, që është kuptim shpirtëror, frymëzim hyjnor dhe bashkim shpirttrash njerëzorë. Për shembull, Profeti thotë, “Unë pashë, Unë thashë, Unë dëgjova një gjë të tillë”. Është,pra, e qartë që shpirti ka një perceptim të madh pa ndërmjetësinë e ndonjëres prej pesë shqisave, siç janë sytë ose veshët. Midis shpirttrash të frymëzuar ka kuptime e zbulime shpirtërore, një komunikim shpirtëror të spastruar nga imagjinata e fantazia, një shoqërim të pavarur nga koha e vendi. Kështu, në Ungjill është shkruar se Moisiu dhe Elia shkuan te Krishti në Malin Tabor, dhe është e qartë se ky nuk ishte një takim material. Ishte një gjendje shpirtërore e shprehur si takim fizik.

Lloji tjetër i bisedimit, i pranisë e i komunikimit të shpirtave s’është veçse imagjinatë e fantazi, e cila vetëm duket sikur ka realitet.

Mendja dhe mendimi i njeriut ndonjëherë zbulojnë të vërteta dhe ky mendim e zbulim japin shenja e rezultate. Ky mendim e ka një bazë. Por shumë gjëra që vijnë në mendjen e njeriut janë si valët e detit të imagjinatave; ato nuk kanë fryt e prej tyre nuk vjen ndonjë rezultat. Po

kështu, njeriu sheh në botën e gjumit një vizion që realizohet me saktësi; në një rast tjetër, ai sheh një ëndërr që nuk ka asnjë rezultat.

Ajo që duam të themi është se kjo gjendje, që e quajmë bisedim e komunikim shpirttrash; është dy llojesh: njëri është thjesht imagjinar, ndërsa tjetri është si vizionet që përmenden në Librin e Shenjtë, siç janë revelacionet e Shën Gjonit e të Isaisë dhe takimi i Krishtit me Moisiun e Elian. Këto janë reale e japin efekte të mahnitshme në mendjet e në mendimet e njerëzve, dhe tërheqin zemrat e tyre.

72

SHËRIMI ME MJETE SHPIRTËRORE

Pyetje.—Ka njerëz që i shërojnë të sëmurët me mjete shpirtërore—domethënë pa ilaçe. Si bëhet kjo?

Përgjigje.—Dijeni se ka katër lloje kurimi e shërimi pa ilaçe. Dy janë për shkaqe materiale dhe dy për shkaqe shpirtërore.

Nga dy llojet e shërimit material, njëri i detyrohet faktit që te njeriu si shëndeti dhe sëmundja janë ngjitëse. Ngjitja e sëmundjes është e furishme dhe e shpejtë, ndërsa ajo e shëndetit është tepër e dobët dhe e ngadalshme. Po të vihen në kontakt me njëri-tjetrin dy trupa, është e sigurt se pjesëza mikrobike kalojnë nga njëri tek tjetri. Ashtu si sëmundja transferohet nga një trup tek tjetri me një infeksion të shpejtë e të fuqishëm, mund të ndodhë që shëndeti i fortë i një njeriu të shëndetshëm të qetësojë një sëmundje shumë të lehtë te një person i sëmurë. Domethënë, ngjitja e sëmundjes është e furishme dhe ka efekt të shpejtë, ndërsa ajo e shëndetit është shumë e ngadalshme dhe ka efekt të vogël, madje edhe këtë efekt të vogël e ka vetëm në raste sëmundjesh shumë të lehta. Fuqia e madhe e një trupi të shëndetshëm mund të mposhtë një sëmundje të lehtë të një trupi të sëmurë, dhe rezultati është shëndeti. Ky është një lloj shërimi.

Lloji tjetër i shërimit pa ilaçe bëhet me anë të forcës magnetike që vepron nga një trup në tjetrin dhe bëhet shkak shërimi. Edhe kjo forcë ka vetëm një efekt të lehtë. Ndonjëherë mund t'i sjellësh dobi një personi të sëmurë duke i vënë dorën mbi kokë ose mbi zemër. Pse? Për

efekt të magnetizimit e të përshtypjes mendore që ushtrohet mbi personin e sëmurë, gjë që largon sëmundjen. Por edhe ky efekt është mjaft i dobët e i lehtë.

Prej dy llojeve të shërimit me mjete shpirtërore—domethënë kur mjete të shërimit është një fuqi shpirtërore—njëri vjen nga përqëndrimi i plotë i mendjes së një personi të fortë mbi një person të dobët, kur ky i fundit ka besim të plotë që shërimi do të vijë nga fuqia shpirtërore e personit të fortë, deri në atë shkallë sa të vendoset një lidhje tonizuese midis personit të fortë dhe invalidit. Personi i fortë bën të gjitha përpjekjet për ta shëruar të sëmurin dhe i sëmuri është atëherë i sigurt se do të shërohet. Këto përshtypje mendore shkaktojnë një ngacmim të nervave dhe kjo përshtypje e ky ngacmim i nervave sjell shërimin e të sëmurit. Kështu, kur një i sëmurë ka dëshirë të fortë e shpresë të madhe për diçka dhe dëgjon papritur lajmin e gëzuar të realizimit të saj, shkaktohet një ngacmim nervor që e zhdruk krejtësisht sëmundjen. Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se papritur krijohet një gjendje tmerri, kjo mund të shkaktojë në nervat e një personi të fortë një ngacmim që ta sëmurë menjëherë atë. Shkaku i sëmundjes nuk do të jetë diçka materiale, sepse ai person nuk ka ngrënë asgjë dhe asgjë e dëmshme nuk e ka prekur atë; ngacmimi i nervave, pra, është shkaku i vetëm i sëmundjes. Po kështu, realizimi i papritur i një dëshire të gjallë do të shkaktojë një gëzim të tillë, sa që nervat do të nxiten dhe ky ngacmim mund të sjellë shëndet.

Si përfundim, lidhja e plotë dhe e përsosur midis mjekut shpirtëror dhe personit të sëmurë—dmth një lidhje e tillë që mjeku shpirtëror përqëndrohet tërësisht dhe gjithë vëmendja e personit të sëmurë mbështetet te mjeku shpirtëror nga i cili ai pret të shërohet—shkakton një ngacmim të nervave dhe vjen shëndeti. Por e gjithë kjo ndikon vetëm në një shkallë të caktuar, madje edhe kaq jo gjithmonë. Sepse, në qoftë se dikush vuan nga një sëmundje shumë e rëndë, ose është i plagosur, këto mjete nuk do ta zhdukin sëmundjen, as nuk do ta mbyllin e shërojnë plagën—domethënë këto mjete nuk kanë fuqi në raste sëmundjesh të rënda, veçse po të ndihmojë konstrukti, sepse një konstrukt i fortë shpesh e mposht sëmundjen. Ky është lloji i tretë i shërimit.

Por lloji i katërt i shërimit kryhet përmes fuqisë së Shpirtit të Shenjtë. Kjo nuk varet nga kontakti, as nga të parët, as nga prania; kjo nuk varet nga asnjë kusht. Qoftë sëmundja e lehtë ose e rëndë, qoftë nëse ka apo jo kontakt të trupave, qoftë nëse vendoset ose jo lidhje personale midis personit të sëmurë e shëruesit, ky shërim kryhet përmes fuqisë së Shpirtit të Shenjtë.

73

SHËRIMI ME MJETE MATERIALE

Dje folëm për metoda mjekimi e shërim shpirtëror, që qëndrojnë në mjekimin e sëmundjeve me anë të aftësive shpirtërore.

Tani le të flasim për shërimin material. Shkenca e mjekësisë është ende në gjendje foshnjërie; ajo nuk ka arritur ende pjekurinë. Por kur ta ketë arritur këtë pikë, mjekimi do të bëhet me gjëra që nuk janë të neveritshme për të nuhaturit e për shijen e njeriut—domethënë me ushqime, me fruta e perime që janë të këndshme për shijen e që kanë aromë të këndëshme. Sepse shkaku që provokon sëmundjen—domethënë shkaku i depërtimit të sëmundjes në trupin njerëzor—është ose fizik ose efekt i ngacmimit të nervave.

Por shkaqet kryesore të sëmundjeve janë fizike, sepse trupi njerëzor përbëhet prej elementesh të shumta, por në masën e një baraspeshe të posaçme. Sakohë ruhet kjo baraspeshë, njeriu është i mbrojtur nga sëmundjet; por në qoftë se ky drejtpeshim thelbësor, që është strumbullari i organizmit, prishet, organizmi çrregullohet dhe shfaqet papritur sëmundja.

Bie fjala, ka një pakësim në njërin prej elementeve përbërëse të trupit të njeriut, ndërsa te një tjetër ka një shtim; kështu baraspesha prishet dhe shkaktohet sëmundja. Për shembull, një element përbërës

duhet të ketë një peshë prej një mijë gramësh, ndërsa një tjetër një peshë prej pesë gramësh, që të ruhet baraspesha. Elementi që është një mijë gram pakësohet në shtatëqind gram, ndërsa ai që është pesë gram shtohet derisa masa e baraspeshës prishet; atëherë shfaqet sëmundja. Kur me ilaçe e mjekim rivendoset baraspesha, sëmundja zhduket. Kështu, në qoftë se rritet sheqeri, shëndeti dëmtohet; dhe kur doktori i ndalon ëmbëlsirat e brumërat, sheqeri pakësohet, rivendoset baraspesha dhe sëmundja mposhtet. Tani, përshtatja e këtyre elementeve përbërëse të trupit njerëzor fitohet me dy mjete: ose me ilaçe, ose me ushqime; dhe kur organizmi e ka rifituar baraspeshën e tij, sëmundja zhduket. Të gjitha elementet që janë kombinuar te njeriu ekzistojnë gjithashtu në perimet; prandaj, në qoftë se një prej elementeve përbërëse që formojnë trupin e njeriut pakësohet, dhe në qoftë se ai merr ushqime që përmbajnë shumë nga ky element përbërës i pakësuar, atëhere baraspesha do të rivendoset dhe njeriu do të shërohet. Sakohë që qëllimi është përshtatja e elementeve përbërëse të trupit, kjo mund të bëhet qoftë me ilaçe qoftë me anë të ushqimit.

Shumica e sëmundjeve që godasin njeriun godasin edhe kafshët, por kafsha nuk kurohet me ilaçe. Në male, si dhe në pyje, mjeku i kafshës është aftësia e të shijuarit dhe e të nuhaturit. Kafsha e sëmurë nuhat bimët që rriten në pyje; ajo ha ato që janë të ëmbla e erëmira për shijen e nuhatjen e saj, dhe kështu mjekohet. Shkaku i shërimit është ky. Kur sheqeri është pakësuar në organizmin e saj, ajo fillon të kërkojë gjëra të ëmbla; prandaj ha barishte me shije të ëmbël, sepse natyra e nxit dhe e udhëheq atë; aroma dhe shija e këtyre barishteve i pëlqejnë dhe kafsha i ha ato. Sheqeri në organizmin e saj shtohet dhe shëndeti i rikthehet.

Shihet, pra, qartë se është i mundur mjekimi me ushqime e me fruta; por duke qenë se sot shkenca e mjekësisë nuk është e përsosur, ky fakt nuk është kuptuar ende tërësisht. Kur shkenca e mjekësisë të arrijë përsosurinë, mjekimi do të bëhet me ushqime, me fruta e perime erëmira dhe me ujëra të ndryshme, me temperaturë të lartë ose të ulët.

Kjo bisedë është e shkurtër; por, në dashtë Perëndia, në një kohë tjetër, kur të ketë ndonjë rast të përshtatshëm, kjo çështje do të shpjegohet në mënyrë më të plotë.

Pjesa e pestë

ÇËSHTJE TË NDRYSHME

74

MOSEKZISTENCA E SË KEQES

Shpjegimi i saktë i kësaj çështjeje është mjaft i vështirë. Dijeni se ka dy lloje qeniesh: materiale dhe shpirtërore, qenie të kapshme nga shqisat dhe qenie intelektuale.

Gjërat shqisore janë ato që kapen nga pesë shqisat e jashtme; kështu, ato ekzistenca të jashtme që i shohin sytë quhen shqisore. Gjërat intelektuale janë ato që nuk kanë ekzistencë të jashtme, por janë koncepte të mendjes. Për shembull, vetë mendja është diçka intelektuale dhe nuk ka ekzistencë të jashtme. Të gjitha karakteristikat e vetitë e njeriut formojnë ekzistencën intelektuale dhe nuk janë të kapshme nga shqisat.

Me pak fjalë, realitetet intelektuale, ashtu si të gjitha vetitë e përsosuritë e admirueshme të njeriut, janë krejt të mira dhe ekzistojnë. E keqja është thjesht mosqenia e tyre. Kështu, injoranca është mungesë dije; gabimi është mungesë udhërrëfimi; harresa është mungesë kujtese; budallallëku është mungesë arsyeje të shëndoshë. Të gjitha këto gjëra nuk kanë ekzistencë reale.

Po kështu, realitetet shqisore janë krejtësisht të mira dhe e keqja rrjedh nga mosqenia e tyre—domethënë verbëria është mungesë e të shikuarit, shurdhësia është mungesë e të dëgjuarit, varfëria është mungesë e pasurisë, sëmundja është mungesë e shëndetit, vdekja është mungesë e jetës dhe dobësia është mungesë e forcës.

Megjithatë, lind një dyshim—dmth gjarpërinjtë dhe akrepat janë helmues. A janë ata të mirë apo të këqinj, sepse ata janë qenie që ekzistojnë? Po, një akrep është i keq në lidhje me njeriun; një gjarpër është i keq në lidhje me njeriun; por në lidhje me vetveten ata nuk janë të këqinj, sepse helmi është arma e tyre dhe me thumbin e tyre ata

mbrojnë veten. Por, meqenëse elementet e helmit të tyre nuk pajtohen me elementet tona—domethënë meqë ka antagonizëm midis këtyre elementeve të ndryshme, ky antagonizëm është një e keqe; por në realitet, përsa i përket vetes së tyre, ata janë të mirë.

Thelbi i kësaj bisede është se diçka mund të jetë një e keqe në lidhje me një tjetër, dhe në të njëjtën kohë, brenda kufijve të vetë qenies, kjo mund të mos jetë një e keqe. Kështu provohet se nuk ka të keqe në ekzistencë; çdo gjë që ka krijuar Perëndia e ka krijuar të mirë. E keqja është mosqenie; kështu vdekja është mungesë e jetës. Kur njeriu nuk merr më jetë, ai vdes. Errësira është mungesë e dritës: kur nuk ka dritë, ka errësirë. Drita është diçka që ekziston, ndërsa errësira është joekzistuese. Pasuria është diçka që ekziston, ndërsa varfëria është joekzistuese.

Është, pra, e qartë se të gjitha të këqijat çojnë në mosqenie. E mira ekziston; e keqja është joekzistuese.

75

DY LLOJE VUAJTJEJE

Dijeni se ka dy lloje vuajtjeje: të pakapshme dhe të hapta. Për shembull, vetë injoranca është një vuajtje, por është një vuajtje e pakapshme; indiferenca ndaj Perëndisë është në vetvete një vuajtje; po kështu janë gënjeshtria, mizoria dhe tradhtia. Të gjitha papërsosuritë janë vuajtje, por ato janë vuajtje të pakapshme. Sigurisht për një njeri të mençur vdekja është më e mirë se mëkati, dhe është më mirë t'i presin gjuhën sesa të gënjejë ose të shpifë.

Lloji tjetër i vuajtjes është i hapët—siç janë dënimet, burgimi, rrahja, dëbimi e syrgjynosja. Por për njerëzit e Perëndisë, ndarja nga Perëndia është më e madhja vuajtje nga të gjitha.

DREJTËSIA DHE MËSHIRA E PERËNDISË

Dijeni se të bësh drejtësi do të thotë t'i japësh secilit atë që ka hak. Për shembull, kur një punëtor punon nga mëngjesi në darkë, drejtësia kërkon që atij t'i jepet paga; por kur ai nuk ka bërë asnjë punë dhe nuk ka marrë asnjë mundim, atij i jepet një dhuratë: kjo është zemërgjerësi. Në qoftë se i jep lëmosha e dhurata një të varfri, megjithëse ai nuk ka bërë asgjë për ju, as nuk ka kryer ndonjë gjë që ta ketë hak këtë, kjo është bujari. Kështu Krishti kërkoi falje për vrasësit e tij: kjo quhet bujari.

Tani, çështja e gjërave të mira ose të këqija vendoset me arsye ose me ligj. Disa besojnë se kjo vendoset me ligj; të tillë janë hebrenjtë, të cilët, duke besuar se të gjitha porositë e Pesëlibërshit ishin absolutisht të detyrueshme, i shohin ato si çështje ligji e jo arsyeje. Kështu, ata thonë se një prej porosive të Pesëlibërshit është se të hash mish e gjalpë bashkë është e paligjshme, sepse kjo është teref dhe teref në hebraishte do të thotë e papastër, ashtu si kosher do të thotë e pastër. Kjo, thonë ata, është çështje ligji e jo arsyeje.

Por teologët mendojnë se e mira dhe e keqja e gjërave varen edhe nga arsyeja edhe nga ligji. Baza kryesore e ndalimit të vrasjes, të vjedhjes, të tradhtisë, të mashtrimit, të hipokrizisë e të mizorisë është arsyeja. Çdo njeri i zgjuar e kupton se vrasja, vjedhja, tradhtia, mashtrimi, hipokrizia dhe mizoria janë diçka e keqe dhe e dënueshme; sepse po ta shposh një njeri me gjemb, ai do të bërtasë, do të ankohet e do të rënkojë; është, pra, e qartë që ai do ta kuptojë se sipas arsyes vrasja është diçka e keqe dhe e dënueshme. Në rast se kryen vrasje, ai do të përgjigjet, qoftë po pat arritur deri tek ai ose jo fama e Profetit; sepse është vetë arsyeja që tregon karakterin e dënueshëm të këtij veprimi. Kur një njeri kryen këtë veprim të keq, ai me siguri do të mbajë përgjegjësi.

Por në një vend ku porositë e Profetit nuk janë të njohura dhe ku njerëzit nuk veprojnë sipas udhëzimeve hyjnore, siç është porosia e Krishtit për t'iu përgjigjur së keqes me të mirë, pra veprojnë sipas instinktit natyror—dmth në qoftë se mendojnë ata që i mendojnë,—nga

këndvështrimi i fesë ata janë të shfajësuar, sepse porosia hyjnore nuk u është çuar atyre. Edhe pse ata nuk meritojnë mëshirë e dashamirësi, megjithatë Perëndia i trajton ata me mëshirë e i fal.

Tani, hakmarrja, sipas arsyes, është gjithashtu e qortueshme, sepse hakmarrja nuk i sjell ndonjë gjë të mirë hakmarrësit. Kështu, në qoftë se një person godet një tjetër dhe i godituri hakmerret duke i kthyer goditjen, ç'përfitim do të ketë ai? A do të jetë kjo një balsam për plagën që ka marrë ose një ilaç për dhimbjen e shkaktuar? Jo, mos e dhëntë Zoti! Në të vërtetë të dy veprimet janë njëlloj: si njëri dhe tjetri shkaktojnë dëmtime; ndryshimi i vetëm është se njëri ka ndodhur më parë dhe tjetri më pas. Prandaj, në qoftë se ai që u është goditur fal, madje në qoftë se ai vepron në mënyrë të kundërt me atë që u përdor ndaj tij, kjo është e lavdërueshme. Ligji i komunitetit do ta dënojë agresorin, por nuk do të bëjë hakmarrje. Ky dënim ka për qëllim të paralamërojë, të mbrojë dhe t'i kundërvihet mizorisë e shkeljeve, në mënyrë që njerëz të tjerë të mos bëhen tiranë.

Por, nëse, ai që u godit fal e harron, ai tregon mëshirën më të madhe. Kjo është e denjë për t'u admiruar.

77

METODA E DREJTË PËR TRAJTIMIN E KRIMINELËVE

Pyetje.—A duhet që një kriminel të dënohet, apo të falet dhe krimi i tij të mos merret parasysh?

Përgjigje.—Ka dy lloje dënimesh shpagimi. Njëri është hakmarrja, tjetri është ndëshkimi. Njeriu nuk ka të drejtë të hakmerret, por komuniteti ka të drejtë ta dënojë kriminelin; dhe ky dënim ka për qëllim të paralajmërojë e të parandalojë, në mënyrë që asnjë person tjetër të mos guxojë të kryejë një krim të tillë. Ky dënim ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por nuk është hakmarrje; hakmarrja qetëson zemërimin e zemrës duke i kundërvënë një të keqe një tjetre. Kjo nuk është e lejueshme, sepse njeriu nuk ka të drejtë të hakmerret.

Por në qoftë se kriminelët do të faleshin krejtësisht, rregulli në botë do të pështjellohej. Pra, dënimi është një prej kërkesave thelbësore për sigurinë e komuniteteve, por ai që e pëson nga shkelësi nuk ka të drejtë të hakmerret. Në të kundërtën, ai duhet të falë e të ndjejë, sepse kjo është e denjë për botën e njeriut.

Komunitetet duhet ta dënojnë shtypësin, vrasësin, keqbërësin, në mënyrë që të paralajmërojnë e të pengojnë të tjerët nga kryerja e krimeve të tilla. Por gjëja më thelbësore është që njerëzit të edukohen në mënyrë të tillë që të mos bëhen krime; sepse është e mundur që masat të edukohen aq efektivisht, sa t'i shmangen e t'i bëjnë bisht kryerjes së krimeve, kështu që vetë krimi do t'u duket atyre si ndëshkimi më i madh, si dënimi e vuajtja më e rëndë. Pra, nuk do të kryhen krime që kërkojnë dënim.

Ne duhet të flasim për gjëra që janë të mundshme të kryhen në këtë botë. Ka shumë teori e ide të mëdha për këtë çështje, por ato nuk janë të realizueshme; për rrjedhojë, ne duhet të flasim për gjërat që janë më të arritshme.

Për shembull, nëse dikush, shtyp, dëmton e i bën keq një tjetri dhe i keqtrajtuari merr shpagim, kjo është hakmarrje dhe është e dënueshme. Në qoftë se i biri i Amrit vret të birin e Zaidit, Zaidi nuk ka të drejtë të vrasë të birin e Amrit; po e bëri këtë, kjo është hakmarrje. Në qoftë se Amri çnderon Zaidin, ky i fundit nuk ka të drejtë të çnderojë Amrin; po e bëri këtë, kjo është hakmarrje dhe është shumë e dënueshme. Jo, ai, përkundrazi, duhet ta kthejë të keqen me të mirë dhe jo vetëm të falë, por gjithashtu, nëse është e mundur, ta ndihmojë shtypësin e tij. Kjo sjellje është e denjë për njeriun: sepse, ç'përfitim do të ketë ai nga hakmarrja? Të dy veprimet janë njëlloj; në qoftë se njëri veprim është i dënueshëm, të dy janë të dënueshëm. I vetmi ndryshim është se njëri është kryer në fillim dhe tjetri më pas.

Por komuniteti ka të drejtën e mbrojtjes e të vetëmbrojtjes; aq më tepër që komuniteti nuk ushqen urrejtje as armiqësi për vrasësin: ai e burgos ose e dënon atë thjesht për mbrojtjen dhe sigurinë e të tjerëve. Kjo nuk bëhet për hakmarrje ndaj vrasësit, por që të jepet një dënim i cili t'i shërbejë mbrojtjes së komunitetit. Në qoftë se komuniteti dhe trashëgimtarët e të vrarit do ta falnin atë dhe do ta shpërblenin të keqen me të mirë, keqbërësi do të vazhdonte të godiste të tjerët dhe

vazhdimisht do të ndodhnin vrasje. Njerëzit e mbrapshtë, si ujqër, do të asgjësonin delet e Perëndisë. Komuniteti nuk ka armiqësi ose mllef në dhënien e dënimit dhe nuk dëshiron të qetësojë inatin e zemrës; qëllimi i tij është që me anë të dënimit të mbrojë të tjerët, në mënyrë që të mos kryhen veprime barbare.

Kështu, kur Krishti tha: “Kujtdo që të godet në faqen e djathtë, ktheji edhe të majtën”,¹⁷⁹ kjo kishte për qëllim t’i mësonte njerëzit të mos bënin hakmarrje personale. Ai nuk donte të thoshte që, në qoftë se ujku bie në tufën e deleve dhe kërkon ta asgjësojë atë, ky duhet të inkurajohet që ta bëjë këtë. Jo, po ta dinte Krishti se një ujku kishte hyrë në vathë dhe ishte gati të shqyente delet, Ai me siguri do ta pengonte këtë.

Ashtu si ndjesa është një prej attributeve të të Mëshirshmit, edhe drejtësia është një prej attributeve të Zotit. Tenda e ekzistencës mbështetet mbi shtyllën e drejtësisë e jo mbi atë të ndjesës. Vazhdimësia e njerëzimit varet nga drejtësia e jo nga ndjesa. Kështu, në qoftë se tani ligji i ndjesës do të zbatohet në të gjitha vendet, brenda një kohe të shkurtër bota do të pështjellohet dhe themelet e jetës njerëzore do të shembeshin. Për shembull, sikur qeveritë e Evropës të mos i kishin qëndruar famëkeqit Atila, ai nuk do të kishte lënë gjallë asnjeri.

Disa njerëz janë si ujqër gjakpirës: po të mos shohin dënimin që i pret, ata do të vrisnin njerëzit thjesht për qejf e zbavitje. Një prej tiranëve të Persisë vrau kujdestarin e vet thjesht për t’u zbavitur, për qejf e për sport. I famshmi Mutavakkil, Abbasidi, pasi thirri ministrat, këshilltarët e funksionarët në praninë e tij, hapi një kuti plot me akrepa në mbledhje dhe i ndaloi të gjithë të lëvizin nga vendi. Kur akrepat i pickuan të pranishmit, ai ia plasi të qeshurit me të madhe.

Që ta përmbledhim: ndërtimi i komuniteteve mbështetet në drejtësinë, jo në ndjesën. Pra, ajo që nënkuptonte Krishti me falje e ndjesë nuk do të thotë që, kur kombet të sulmojnë, të djegin shtëpitë, të grabitin pasurinë, të sulmojnë gratë, fëmijët e të afërmit dhe të dhunojnë nderin, t’u nënshtrohesh këtyre armiqve tiranë dhe të lejosh që ata të kryejnë mizori e të ushtrojnë shtypje. Jo, fjalët e Krishtit i referohen sjelljes së dy individëve ndaj njëri-tjetrit: në qoftë se një

¹⁷⁹ Shih Mateu 5:39.

person sulmon tjetrin, i dëmtuari duhet ta falë atë. Por komunitetet duhet të mbrojnë të drejtat e njeriut. Kështu, nëse ndokush më sulmon, më dëmton, më shtyp e më plagos mua, unë nuk do të bëj rezistencë dhe do ta fal atë. Por në qoftë se një person dëshiron të sulmojë Sijid Manshadin [Siyyid Manshadí],¹⁸⁰ sigurisht që unë do ta pengoj atë. Edhe pse për keqbërësin mosndërhyrja është sigurisht mirësi, kjo do të ishte një e keqe për Manshadin. Në qoftë se, në këtë moment, një arab i egër do të hynte këtu me shpatë zhveshur, për t'ju sulmuar, plagosur e vrarë ju, sigurisht që unë do ta pengoja atë. Në qoftë se unë do t'ju braktisja ju përballë arabit, kjo nuk do të ishte drejtësi por padrejtësi. Por, në qoftë se ai do të më bënte keq mua personalisht, unë do ta falja atë.

Mbetet një gjë për t'u thënë: kjo është se komunitetet merren ditë e natë me hartim ligjesh penale dhe me përgatitje e organizim instrumentesh e mjeteve dënimi. Ata ndërtojnë burgje, bëjnë pranga e zinxhirë, përgatitin vende internimi e syrgjynosjeje dhe shpikin gjithfarëlloj mundimesh e torturash, duke menduar që me këto mjete të disiplinojnë kriminelët, ndërsa në të vërtetë shkatërrojnë moralin dhe shkaktojnë zvetënimin e karaktereve. Komuniteti, në të kundërtën, duhet të përpiket e të mundohet ditë e natë, me zellin më të madh, të përsosë edukimin e njerëzve, të bëjë që ata të përparojnë dita ditës dhe të rriten në pikëpamje të shkencës e të dijes, të pajisen me virytute, të fitojnë moral të mirë dhe të shmangin veset, në mënyrë që të mos ndodhin krime. Në kohën e sotme mbizotëron e kundërta; komuniteti mendon gjithmonë si të forcojë ligjet penale dhe si të përgatitë mjete dënimi, instrumente të vdekjes e të ndëshkimit, vende burgosjeje e internimi; kështu, pra, ata presin që të kryhen krime. Kjo ka efekt demoralizues.

Por në qoftë se komuniteti do të përpiquej t'i edukonte masat, nga dita në ditë do të shtoheshin dijet e shkencat, të kuptuarit do të zgjerohej, ndjeshmëria do të zhvillohej, zakonet do të përmirësoheshin dhe morali do të normalizohej; me një fjalë, në të gjitha këto shkallë të përsosurisë do të vërehej përparim dhe do të kishte më pak krime.

¹⁸⁰ Një Bahá'í që ishte me ne në tryezë.

Është vërtetuar se midis popujve të qytetëruar krimi është më i rrallë se sa midis të paqytetëruarve—domethënë midis atyre që kanë fituar qytetërim të vërtetë, që është qytetërimi hyjnor, qytetërimi i atyre që bashkohen të gjitha përsosurisë shpirtërore e materiale. Duke qenë se shkak i krimeve është injoranca, sa më shumë të rriten dijet e shkenca aq më shumë do të pakësohen krimet. Mendoni sa shpesh ndodhin vrasje midis barbarëve të Afrikës; ata madje vriten me njëri-tjetrin që të hanë mishin e gjakun e njëri-tjetrit! Pse nuk ndodhin të tilla egërsi në Zvicër? Arsyeja është e qartë: sepse edukimi dhe virtytet i ndalojnë ata.

Pra, komunitetet duhet të mendojnë për parandalimin e krimeve, sesa për dënimin e rreptë të tyre.

78

GREVAT

Më keni pyetur për grevat. Kjo çështje është dhe do të jetë për një kohë të gjatë subjekt vështirësish të mëdha. Grevat ndodhin për dy shkaqe. Njëri është lakmia e skajshme dhe pangopësia e fabrikantëve dhe e industrialistëve; tjetri janë tepritë, lakmia dhe papajtueshmëria e punëtorëve dhe e mjeshtrave. Është, pra, e nevojshme t'u gjendet ilaçi këtyre dy shkaqeve.

Por shkak kryesor i këtyre vështirësive qëndron në ligjet e qytetërimit të tanishëm; sepse ato lejojnë që një numër i vogël individësh të akumulojnë pasuri të pakrahasueshme tej nevojave të tyre, ndërsa pjesa më e madhe e njerëzve mbeten nevojtarë, në skamje e në mjerimin më të madh. Kjo bie në kundërshtim me drejtësinë, me humanizmin e me barazinë; kjo është kulmi i padrejtësisë, e kundërta e asaj që sjell kënaqësi hyjnore.

Ky kontrast është karakteristik për botën e njeriut: ndër krijesat e tjera—pra, pothuajse ndër të gjitha kafshët—ka njëfarë drejtësie e barazie. Kështu, barazia ekziston në një grigjë delesh e në një tufë drerësh në fshat. Po kështu, midis zogjve të stepës, të fushës, të kodrave ose të kopshtit dhe midis të gjitha llojeve të kafshëve mbizotëron

njëfarë barazie. Ndër to nuk ka një dallim të tillë në mjetet e jetesës; kështu që ato jetojnë në paqen e gëzimin më të madh.

Krejt e kundërta ndodh me specien njerëzore, që ngul këmbë në gabimin më të madh e pabarazinë e plotë. Mendoni një individ që ka grumbulluar thesare duke kolonizuar një vend në përfitim të vet: ai ka siguruar një pasuri të pakrahasueshme dhe fitime e të ardhura që rrjedhin lumë, ndërsa njëqindmijë veta të pafat, të dobët e të pafuqishëm janë në nevojë për një kafshatë bukë. Nuk ka as barazi as dashamirësi. Kështu paqja e gëzimi i përgjithshëm shkatërrohen dhe mirëqenia e njerëzimit mohohet në një shkallë të tillë sa që jetët e shumë njerëzve bëhen të padobishme. Sepse pasuria, nderet, tregtia, industria janë në duart e disa industrialistëve, ndërsa njerëz të tjerë ndeshen me vështirësi të shumta e halle të pasosura: ata nuk kanë as dobi, as fitime, as rehati, as paqe.

Pra, duhen vendosur praktika e ligje për të vënë rregull mbi pasuritë e tepërta të individëve të caktuar privatë dhe për të plotësuar nevojat e miliona njerëzve të shtresave të varfra; kështu do të arrihej njëfarë zbutje. Sidoqoftë, barazia absolute është krejt e pamundur, sepse barazia absolute në pasuri, ndere, tregëti, bujqësi, industri do të çonte në rrëmujë, në kaos, në çorganizim të mjeteve të jetesës dhe në një zhgënjim të përgjithshëm: rregulli i komunitetit do të minohej krejtësisht. Kur barazia e pajustificuar imponohet, lindin gjithashtu vështirësi. Është, pra, e preferueshme të vendoset moderimi me anë ligjesh e rregullash, për të penguar krijimin e pasurive të tepërta të disa individëve dhe për të mbrojtur kërkesat thelbësore të masave. Për shembull, fabrikantët e industrialistët grumbullojnë pasuri çdo ditë, ndërsa zejtarët e varfër nuk sigurojnë as bukën e përditshme: ky është kulmi i padrejtësisë dhe asnjë njeri i drejtë nuk mund ta pranojë. Prandaj duhet të vendosen ligje e rregulla që t'i lejojnë punëtorët të marrin nga pronari i fabrikës pagat e tyre dhe një përqindje në masën e një të katërtës ose të një të pestës së fitimeve, sipas kapacitetit të fabrikës; ose në ndonjë mënyrë tjetër, punëtorët dhe fabrikantët duhet të ndajnë me drejtësi fitimet e përfitimet. Me të vërtetë, kapitali dhe drejtimi vijnë nga pronari i fabrikës, ndërsa puna e mudi nga punëtorët. Ose punëtorët duhet të marrin paga që t'u sigurojnë atyre një mbështetje të mjaftueshme dhe, kur të mos punojnë më, të bëhen të

dobët a të paaftë, të kenë përfitime të mjaftueshme nga të ardhurat e industrisë; ose pagat duhet të jenë të tilla sa t'u mjaftojnë punëtorëve, në mënyrë që ata të mund të kursejnë nga pak për ditë nevoje e pafuqie.

Kur punët të rregullohen kështu, pronari i fabrikës nuk do të grumbullojë përditë pasuri për të cilat ai nuk ka absolutisht nevojë (aq më tepër që, po qe se pasuria është në shpërpjesëtim të madh, kapitalisti mposhtet nën një barrë tepër të rëndë dhe bie në vështirësitë e telashe të mëdha; administrimi i një pasurie të tepruar është shumë i vështirë dhe shteron forcën natyrore të njeriut). Dhe punëtorët e zejtarët nuk do të jenë më në mjerim e skamje; ata nuk do të pësojnë më privacionet më të këqija nga fundi i jetës së tyre.

Është, pra, e qartë e duket sheshit se shpërndarja e pasurive shumë të mëdha midis një numri të vogël individësh, në një kohë që masat janë në skamje, është një padrejtësi. Por edhe barazia absolute do të ishte një pengesë për jetën, për mirëqenien, për rregullin e për paqen e njerëzimit. Në një çështje të tillë është i preferueshëm moderimi. Ky nënkupton moderim të kapitalistëve në marrjen e fitimeve të tyre dhe që ata të mbajnë parasysh mirëqenien e të varfërve e të atyre që janë nevojtarë—domethënë që punëtorët e mjeshtrat të kenë një pagë ditore fikse e të përcaktuar dhe të marrin pjesë në fitimet e përgjithshme të fabrikës.

Do të ishte mirë, lidhur me të drejtat e përbashkëta të fabrikantëve, të punëtorëve e të zejtarëve, të nxirreshin ligje që t'u lejonin fabrikantëve fitime të moderuara, ndërsa punëtorëve t'u jepnin mjetet e nevojshme të jetesës e të sigurisë për të ardhmen. Kështu, kur ata dobësohen e nuk punojnë më, plaken e bëhen të pafuqishëm, ose lënë pas fëmijë në moshë të vogël, ata dhe fëmijët e tyre nuk do të shfaroseshin nga varfëria e skajshme. Dhe pikërisht nga të ardhurat e vetë fabrikës, për të cilat kanë të drejta, ata do të merrnin një pjesë, sado të vogël, për të siguruar jetesën.

Po kështu, punëtorët nuk duhet të nxjerrin më pretendime të skjashme e të bëjnë revolta, as të kërkojnë tej të drejtave të tyre; ata nuk duhet të bëjnë më greva; duhet të jenë të bindur e të nënshtruar dhe të mos paraqesin kërkesa për paga të tepruara. Por të drejtat e ndërsjellta e të arsyeshme të të dyja palëve duhet të përcaktohen legalisht dhe të zgjidhen sipas zakonisht me ligje të drejta e të paanshme. Në rast se njëra

nga të dy palët bën shkelje, gjyqi do ta dënojë shkelësin dhe dega ekzekutive do të verë në zbatim dënimin; kështu rregulli do të vendoset dhe vështirësitë do të kapërcehen. Ndërhyrja e gjyqeve dhe e qeverisë në vështirësitë që lindin midis fabrikantëve e punonjësve është e ligjshme, sepse problemet midis punëtorëve e fabrikantëve nuk mund të krahasohen me problemet e zakonshme midis personave privatë, që nuk kanë të bëjnë me publikun dhe me të cilat nuk duhet të merret vetë qeveria. Në të vërtetë, edhe pse duken si çështje private, këto vështirësi midis dy palëve i shkaktajnë dëm shoqërisë; sepse tregëtia, industria, bujqësia dhe punët e përgjithshme të vendit janë të gjitha të lidhura ngushtë midis tyre. Nëse njëra prej tyre pëson goditje, e keqja prek masën. Kështu, vështirësitë midis punonjësve e fabrikantëve bëhen shkak për një të keqe të përgjithshme.

Gjyqi dhe qeveria kanë, pra, të drejtën të ndërhyjnë. Kur ndodh një vështirësi midis dy individësh lidhur me të drejtat private, është e nevojshme që një i tretë ta zgjidhë çështjen. Kjo është pjesë e qeverisjes. Atëherë, si mund të lihet pasdore problemi i grevave—që shkaktajnë telashe në vend e që shpesh janë të lidhura me dëshpërimin e skajshëm të punonjësve, si dhe me pangopësinë e fabrikantëve?

O Zot i madh! A është e mundur që, duke parë një krijesë tjetër të vuajë nga uria, të privuar nga gjithçka, një njeri të mund të pushojë e të jetojë rehat në vilën e tij luksoze? Ai që e sheh tjetrin në mjerimin më të madh a mund ta gëzojë pasurinë e vet? Ja përse në Fenë e Perëndisë është përcaktuar e vendosur që njerëzit e pasur të japin çdo vit një pjesë të caktuar të pasurisë së tyre për mbajtjen e të varfërve e të fatkeqëve. Ky është themeli i Fesë së Perëndisë dhe është i detyrueshëm për të gjithë.

Dhe duke qenë se njeriu nuk është i shtyrë e i detyruar për këtë nga qeveria, por për prirje të natyrshme të zemrës së tij të mirë vullnetarisht e me gëzim tregon dashamirësi ndaj të varfërve, një vepër e tillë është shumë e lavdërueshme, e pëlqyeshme dhe e kënaqshme.

I tillë është kuptimi i veprave të mira në Librat e në Tabelat Hyjnore.

79

REALITETI I BOTËS SË JASHTME

Disa sofistë mendojnë se ekzistenca është një iluzion, se çdo qenie është një iluzion absolut që nuk ka ekzistencë—me fjalë të tjera se ekzistenca e qenieve është si një mirazh, ose si pasqyrimi i një figure në ujë a në pasqyrë, që është vetëm një pamje e cila nuk ka në vetvetë burim, themel ose realitet.

Kjo teori është e gabuar; edhe pse ekzistenca e qenieve kundrejt ekzistencës së Perëndisë është një iluzion, megjithatë në rrethanat e qenies ajo ka ekzistencë reale e të sigurt. Është e kotë të mohohet kjo. Për shembull, ekzistenca e mineralit në krahasim me atë të njeriut është mosqenie, sepse kur njeriu në pamje asgjësohet, trupi i tij bëhet mineral; por minerali ka ekzistencë në botën e mineraleve. Është, e qartë se toka kundrejt ekzistencës së njeriut është mosekzistuese dhe ekzistenca e saj është iluzore; por në raport me mineralin ajo ekziston.

Po kështu, ekzistenca qenieve kundrejt ekzistencës së Perëndisë s'është veçse një iluzion e një hiç; ajo është një dukje, si figura e reflektuar në një pasqyrë. Por edhe pse një figurë që shihet në pasqyrë është një iluzion, burimi dhe realiteti i kësaj figure iluzore është personi i reflektuar, fytyra e të cilit shfaqet në pasqyrë. Me pak fjalë, reflektimi kundrejt personit të reflektuar është një iluzion.

Është, pra, e qartë që, edhe pse qeniet kundrejt ekzistencës së Perëndisë nuk kanë ekzistencë, por janë si mirazhi apo reflektimi në pasqyrë, përsëri në nivelin e tyre ato ekzistojnë.

Ja përse ata që ishin moskokëçarës e mohonin Perëndinë u cilësuan nga Krishti si të vdekur, megjithëse në dukje ata ishin të gjallë; në krahasim me njerëzit e besimit ata ishin të vdekur, të verbër, të shurdhër e memecë. Këtë donte të thoshte Krishti me fjalët “Lërimi të vdekurit të varrosin të vdekurit e tyre”.¹

80

PARAQENIA REALE

Pyetje.—Sa lloje paraqeniesh e fenomenesh ka?

Përgjigje.—Disa dijetarë e filozofë besojnë se ka dy lloje paraqeniesh: paraqenie thelbësore dhe paraqenie kohe. Fenomenet janë gjithashtu dy llojesh, fenomene thelbësore dhe të kohës.

Paraqenia thelbësore është një ekzistencë që nuk paraprihet nga ndonjë shkak, ndërsa fenomenet thelbësore paraprihen prej shkaqesh. Paraqenia e kohës nuk ka fillim, ndërsa fenomenet e kohës kanë fillime dhe mbarime; sepse ekzistenca e gjithçkaje varet nga katër shkaqe—shkaku veprues, materia, forma dhe shkaku i fundit. Për shembull, kjo karrige ka një krijues që është marangoz, një substancë që është dru, një formë që është ajo e karriges dhe një qëllim që është të përdoret si ndenjësë. Pra, kjo karrige është në thelb fenomenale, sepse paraprihet nga një shkak dhe ekzistenca e saj varet prej shkaqesh. Kjo quhet thelbësore e me të vërtetë fenomenale.

Tani, kjo botë e ekzistencës kundrejt krijuesit të vet është një fenomen real. Meqë trupin e mban shpirti, ai në raport me shpirtin është një fenomen thelbësor. Shpirti është i pavarur nga trupi dhe në raport me të shpirti është një paraqenie thelbësore. Edhe pse rrezet janë gjithnjë të pandashme nga dielli, megjithatë dielli është i paraqenëshëm dhe rrezet janë fenomenale, sepse ekzistenca e rrezeve varet nga ekzistenca e diellit. Kurse ekzistenca e diellit nuk varet nga ajo e rrezeve, sepse dielli është dhuruesi dhe rrezet janë dhurata.

Pohimi i dytë është se ekzistenca dhe mosqenia janë të dyja relative. Kur thuhet se një diçka erdhi në jetë nga mosqenia, kjo nuk i referohet moqenies absolute, por do të thotë se gjendja e saj e mëparshme në raport me gjendjen e saj të tanishme ishte një hiç. Sepse hiçi absolut nuk mund të gjejë ekzistencë, meqë ai nuk e ka aftësinë e ekzistencës. Njeriu, ashtu si dhe minerali, ekziston; por ekzistenca e mineralit kundrejt asaj të njeriut është një hiç, por ekzistenca e sendit kundrejt asaj të njeriut është një hiç, sepse, kur trupi i njeriut asgjësohet, ai bëhet pluhur e mineral. Por kur pluhuri përparon në botën njerëzore dhe ky trup i vdekur bëhet i gjallë, njeriu bëhet i qenëshëm. Edhe pse pluhuri—domethënë minerali—ekziston në gjendjen e vet, në krahasim me njeriun ai është hiç. Që të dy ekzistojnë, por ekzistenca e mineralit

dhe e pluhurit në krahasim me njeriun është mosqenie e hiç; sepse kur njeriu bëhet i paqenë, ai kthehet në pluhur e mineral.

Prandaj, edhe pse bota e rastësishme ekziston, kundrejt ekzistencës së Perëndisë ajo është e paqenë e një hiç. Njeriu dhe pluhuri ekzistojnë që të dy, por sa i madh është ndryhsimi midis ekzistencës së mineralit dhe asaj të njeriut! Njëri në krahasim me tjetrin është mosqenie. Po kështu mosqenia e krijimit kundrejt ekzistencës së Perëndisë është mosqenie. Është, pra, e qartë e duket sheshit se megjithëqë qeniet ekzistojnë, në krahasim me Perëndinë dhe me Fjalën e Perëndisë, ato janë të paqena. Ky është fillimi dhe fundi i Fjalës së Perëndisë, i Cili thotë: "Unë jam Alfa dhe Omega"; sepse Ai është fillimi dhe fundi i bujarisë. Krijuesi gjithnjë ka pasur një krijesë; rrezet gjithnjë kanë ndriçuar e shkëlqyer nga realiteti i diellit, sepse pa rreze dielli do të ishte errësirë e padepërtueshme. Emrat dhe atributet e Perëndisë e kërkojnë ekzistencën e qenieve dhe Bujaria e Përrjetshme nuk ka mbarim. Në rast se do të kishte, kjo do të ishte në kundërshtim me përsosuritë e Perëndisë

81

RITRUPËZIMI

Pyetje.—Cila është e vërteta për çështjen e ritrupëzimit, në të cilin besojnë disa popuj?

Përgjigje.—Objekti i asaj që do të themi është të shpjegojmë realitetin—jo të vemë në lojë besimet e popujve të tjerë, por vetëm të shpjegojmë faktet; kjo është e gjitha. Ne nuk u kundërvihemi ideve të askujt, dhe as e miratojmë kritikën.

Dijeni, pra, se ata që besojnë në ritrupëzimin ndahen në dy kategori: një kategori nuk beson në ndëshkimet shpirtërore e në shpërblimet e botës tjetër, dhe ata mendojnë se njeriu përmes ritupëzimit e rikthimit në këtë botë fiton shpërblime e kompensime; ata i përmbahen pikëpamjes se qielli e ferri janë të kufizuar në këtë botë dhe nuk flasin për ekzistencë të botës tjetër. Ndër ta ka dy nënndarje të mëtejshme.

Njëra nëndarje mendon se njeriu nganjëherë kthehet në këtë botë në formën e një kafshe, për të vuajtur një ndëshkim të ashpër dhe se, pasi e vuan këtë torturë të dhimbshme, do të çlirohet nga bota shtazore dhe do të vijë përsëri në botën njerëzore; kjo quhet transmigrim. Nënndarja tjetër mendon se nga bota njerëzore personi kthehet përsëri në botën njerëzore dhe se me anë të këtij kthimi merren shpërblimet e ndëshkimet e një jete të mëparshme; kjo quhet ritrupëzim. Asnjëra prej këtyre dy kategorive nuk flet për ndonjë botë tjetër veç kësaj.

Kategoria e dytë e atyre që besojnë në ritrupëzimin pohon ekzistencën e botës tjetër dhe e konsideron ritrupëzimin si mjet për t'u bërë të përsosur—dmth ata mendojnë se njeriu, duke ikur nga kjo botë dhe duke u rikthyer këtu, do të fitojë gradualisht përsosuri, derisa arrin përsosurinë më të madhe. Me fjalë të tjera, ata mendojnë se njerëzit përbëhen prej lënde e force: në fillim, domethënë në ciklin e parë, lënda është e papërsosur, por, duke ardhur në mënyrë të përsëritur në këtë botë, ajo përparon dhe fiton elegancë e delikatesë, derisa bëhet si një pasqyrë e lëmuar; dhe forca, që s'është tjetër, veçse shpirt, realizohet në të me të gjitha përsosuritë.

Kështu e paraqesin çështjen ata që besojnë në ritrupëzimin e në transmigrimin. Ne e përmblohdhëm atë; në rast se do të hynim në hollësi, kjo do të kërkonte shumë kohë. Kjo përmbledhje është e mjaftueshme. Për këtë çështje nuk jepen argumente e prova logjike; ato që thuhet janë vetëm supozime e konkluzione me hamendje dhe jo argumente bindëse. Atyre që besojnë në ritrupëzimin u duhen kërkuar prova dhe jo hamendje, supozime e imagjinata.

Por ju keni kërkuar argumente për pamundësinë e ritrupëzimit. Pikërisht këtë duhet të sqarojmë tani. Argumenti i parë për këtë pamundësi është se e jashtëmja është shprehje e së brendshmes; toka është pasqyra e Mbretërisë së Perëndisë; bota materiale i korrespondon botës shpirtërore. Tani, vëreni se në botën shqisore nuk përsëriten dukjet, sepse asnjë qenie në asnjë aspekt nuk është identike, as e njëjtë, me ndonjë qenie tjetër. Shenja e veçanësisë është e dukshme dhe e qartë në të gjitha gjërat. Sikur të gjithë hambarët e botës të ishin plot me grurë, ju nuk do të gjenit dot dy kokrra gruri absolutisht të ngjashme, të njëlljoja e identike, pa asnjë dallim. Është e sigurt se do të ketë dallime e ndryshime midis tyre. Duke qenë se prova e veçanësisë është në të

gjitha gjërat dhe Njeshmëria e Uniteti i Perëndisë është i dukshëm në realitetin e të gjitha gjërave, përsëritja e së njëjtës paraqitje është absolutisht e pamundur. Prandaj ritupëzimi, që është paraqitja e përsëritur e të njëjtit shpirt me thelbin dhe gjendjen e tij të mëparshme, në po këtë botë të paraqitjes, është e pamundur dhe e parealizueshme. Duke qenë se përsëritja e së njëjtës paraqitje është e pamundur dhe e ndaluar për secilën prej qenieve materiale, po kështu edhe për qeniet shpirtërore një kthim në të njëjtën gjendje, qoftë në harkun e zbritjes ose në harkun e ngjijtes, është i ndaluar e i pamundur, sepse materialja i korrespondon shpirtërores.

Megjithatë, kthimi i qenieve materiale në raport me specien duket qartë; kështu, pemët që gjatë viteve të mëparshme kanë dhënë gjethe, lule e fryte, në vitet e mëtejshme do të japin pikërisht po ato gjethe, lule e fryte. Kjo quhet përsëritje e species. Nëse ndokush bën vërejtje duke thënë se gjethja, lulja dhe fryti janë shpërbërë dhe kanë zbritur nga bota bimore në botën minerale, pastaj janë kthyer përsëri nga bota minerale në botën bimore dhe, pra, është bërë një përsëritje—përgjigja është se janë shpërbërë lulja, gjethja dhe fryti i vitit të shkuar, se këto elemente të kombinuara janë dezintegruar e janë shpërndarë në hapësirë, dhe se pjesëzat e gjetheve e të fryteve të vitit të shkuar, pas shpërbërjes, nuk janë kombinuar përsëri e nuk janë kthyer. Përkundrazi, përmes kombinimit të elementeve të reja është kthyer specia. E njëjta gjë ndodh me trupin njerëzor, i cili pas prishjes shpërbëhet dhe elementët që e përbënin atë shpërndahen. Në qoftë se ky trup, po kështu, do të kthehej përsëri nga bota minerale ose bimore, ai nuk do të kishte me saktësi të njëjtën përbërje të elementeve si njeriu i mëparshëm. Ato elemente janë shpërbërë e shpërndarë; ato janë përhapur në hapësirën e gjerë. Më pas janë kombinuar pjesëza të tjera elementesh dhe është formuar një trup i dytë; ndoshta një prej pjesëzave të individit të mëparshëm ka hyrë në përbërjen e individit të mëvonshëm, por këto pjesëza nuk janë ruajtur e mbajtur me saktësi e tërësisht, pa ndonjë shtesë ose pakësim, që të mund të kombinoheshin përsëri dhe nga ky kombinim e përzierje të mund të vinte në jetë një individ tjetër. Kështu, nuk mund të provohet se ky trup me të gjitha pjesëzat është kthyer; se njeriu i mëparshëm është bërë ai i tanishmi; dhe se, për rrjedhojë, ka pasur përsëritje; se

shpirti, gjithashtu, është kthyer si dhe trupi; dhe se, pas vdekjes, thelbi i tij është kthyer përsëri në këtë botë.

Po të themi se ky ritrupëzim bëhet për të arritur përsosuri, në mënyrë që materia të mund të fitojë elegancë e delikatesë dhe që drita e shpirtit të mund të shfaqet në të me përsosurinë më të madhe, kjo gjithashtu është thjesht imagjinatë. Sepse, edhe sikur të supozojmë se besojmë në këtë argument, përsëri ndryshimi i natyrës është i pamundur përmes ritrupëzimit e kthimit. Thelbi i papërsosurisë, duke u rikthyer, nuk bëhet realitet i përsosurisë; errësira e plotë, duke u rikthyer, nuk bëhet burim i dritës; thelbi i dobësisë nuk shndërrohet në forcë e fuqi duke u rikthyer, dhe një natyrë tokësore nuk bëhet një realitet qiellor. Pema e Zakumit [Zaqúm],¹⁸¹ sado shpesh të rikthehet, kurrë nuk do të jap fryt të ëmbël dhe pema e mirë, sado shpesh të rikthehet, kurrë nuk do të japë fryt të hidhur. Pra, është e qartë se kthimi dhe ardhja përsëri në botën materiale nuk sjell përsosuri. Kjo teori nuk mbështetet as në prova as në fakte; ajo është thjesht një ide. Jo, në realitet ajo që sjell përsosuri është bujaria e Perëndisë.

Teozofistët besojnë se njeriu në harkun e ngjitjes¹⁸² do të kthehet shumë herë, derisa të arrijë Qendrën Supreme; në atë gjendje materia bëhet një pasqyrë e kulluar, drita e shpirtit do të ndritë mbi të me tërë forcën dhe do të arrihet një përsosuri thelbësore. Tani, ky është një pohim teologjik i vërtetuar e i thellë, sepse botët materiale mbarojnë në fundin e harkut të zbritjes dhe sepse kushti i njeriut ndodhet në fundin e harkut të zbritjes e në fillimin e harkut të ngjitjes, në të kundërtën e Qendrës Supreme. Nga fillimi deri në fund të harkut të ngjitjes, ka gjithashtu shkallë të shumta shpirtërore. Harku i zbritjes quhet fillim,¹⁸³ dhe ai i ngjitjes quhet përparim.¹⁸⁴ Harku i zbritjes përfundon në gjëra materiale dhe harku i ngjitjes përfundon në gjëra shpirtërore. Pika e kompasit që bën një rreth nuk kryen lëvizje prapavajtëse, sepse kjo do të ishte në kundërshtim me lëvizjen e natyrshme e me rendin hyjnor; përndryshe, simetria e rrethit do të prishej.

¹⁸¹ Pema e ferrit që përmendet në Kuran.

¹⁸² dmth në Rrethin e Ekzistencës.

¹⁸³ Fjalë për fjalë, që lind, nxjerr.

¹⁸⁴ Fjalë për fjalë, që prodhon diçka të re.

Për më tepër, kjo botë materiale nuk ka vlerë ose përsosuri të tillë saqë njeriu, pasi të ketë shpëtuar nga ky kafaz, të dëshirojë të bjerë për herë të dytë në këtë grackë. Jo, falë Bujarisë së Përrjetshme, vlera e aftësia e vërtetë e njeriut bëhet e qartë dhe e dukshme duke i kapërcyer shkallët e ekzistencës e jo duke u kthyer pas. Pasi guacka është hapur, bëhet e qartë e shihet nëse përmban një margaritar apo lëndë pa vlerë. Pasi lulja është rritur, ajo jep ose lule ose gjemba; nuk ka nevojë që ajo të rritet përsëri. Veç kësaj, përparimi e lëvizja në botë në një renditje të drejtë sipas ligjit natyror është shkaku i ekzistencës, ndërsa një lëvizje e kundërt me sistemin e me ligjin e natyrës është shkaku i mosqenies. Kthimi i shpirtit pas vdekjes është në kundërshtim me lëvizjen natyrore e në kundërvënie me sistemin hyjnor.

Pra, duke u kthyer është absolutisht e pamundur të fitohet ekzistencë; është sikur njeriu, pasi të jetë çliruar nga barku i nënës, të kthehej në të për herë të dytë. Shihni ç'imagjinate fëminore nxit besimi në ritrupëzimin e në transmigrimin. Ata që besojnë në këtë e konsiderojnë trupin si një enë në të cilën përmbahet shpirti, ashtu siç mbahet uji në një gotë; ky ujë është marrë nga një gotë dhe është hedhur në një tjetër. Kjo është një lojë fëmijësh. Ata nuk e kuptojnë se shpirti është një qenie e përfshirë në trup dhe as nuk hyn as nuk del, por vetëm është i lidhur me trupin si dielli me pasqyrën. Po të ishte ashtu, dhe shpirti duke u rikthyer në këtë botë materiale të kalonte përmes shkallësh të ndryshme e të arrinte përsosuri thelbësore, do të ishte më mirë që Perëndia ta zgjaste jetën e shpirtit në botën materiale derisa ai të fitonte përsosuri e hire; atëherë nuk do të ishte e nevojshme që ai të provonte kupën e vdekjes ose të fitonte një jetë të dytë.

Ideja se ekzistenca është e kufizuar në këtë botë të vdekshme dhe mohimi i ekzistencës së botëve hyjnore ka lindur fillimisht nga imagjinata e disa besimtarëve në ritrupëzimin; por botët hyjnore janë pa fund. Sikur botët hyjnore të arrinin kulmin në këtë botë materiale, krijimi do të ishte pa dobi; madje ekzistenca do të ishte thjesht një lojë fëmijësh. Rezultati i këtyre qenieve të pafundme, që është ekzistenca fisnike e njeriut, do të vinte e do të shkonte për pak ditë në këtë banesë të vdekshme dhe, pasi të merrte ndëshkime e shpërblime, më në fund gjithçka do të bëhej e përsosur. Krijimi hyjnor dhe qeniet ekzistuese të pafund do të përsoseshin e të plotësosheshin dhe atëherë Hyjnia e Zotit

dhe emrat e cilësitë e Perëndisë, në emër të këtyre qenieve shpirtërore, do të përfundonin, përse i përket efektit të tyre, në përtaci e mosveprim! “Lavdi Zotit tënd, Zotit i Cili është i spastruar nga të gjitha përshkrimet e tyre”.¹⁸⁵

Të tilla ishin mendjet e kufizuara të filozofëve të mëparshëm si Ptolemeu e të tjerët, që besonin e përfytyronin se bota, jeta dhe ekzistenca ishin të ngushtuara në këtë rruzull tokësor dhe se kjo hapësirë e paanë ishte e kufizuar brenda nëntë sferave të qiellit e se gjithçka ishte boshllëk dhe e zbrazët. Shihni sesa të kufizuara ishin mendimet e tyre dhe sa të dobëta mendjet e tyre. Ata që besojnë në ritrupëzimin mendojnë se botët shpirtërore janë të kufizuara në botët e imagjinatës njerëzore. Për më tepër, disa prej tyre, si Druzët dhe Nusajritë, mendojnë se ekzistenca është e kufizuar në këtë botë fizike. Çfarë supozimi injorant! Sepse në këtë gjithësi të Perëndisë, që shfaqet me përsosurinë, bukurinë e madhështinë më të plotë, yjet e shndritshëm të gjithësisë materiale janë të panumërt! Pra, duhet të reflektojmë sesa të pakufizuara e të pafundme janë botët shpirtërore, që përbëjnë themelin thelbësor. “Kini mendjen ju që jeni të pajisur me intuitë”.¹⁸⁶

Por le të kthehemi te subjekti ynë. Në Shkrimet Hyjnore e në Librat e Shenjtë flitet për “kthim”, por injorantët nuk e kanë kuptuar domethënien dhe ata që besonin në ritrupëzimin kanë bërë hamendje për këtë çështje. Sepse ajo që Profetët hyjnorë nënkuptonin me “kthim” nuk është kthimi i thelbit, por i vetive; nuk është kthimi i Manifestimit, por i përsosurive. Në Ungjill thuhet se Gjoni, i biri i Zaharisë, është Elia. Këto fjalë nuk duan të thonë kthim i frymës racionale e i personalitetit të Elias në trupin e Gjosit, por që përsosuritë dhe vetitë e Elias u manifestuan e u shfaqën te Gjoni.

Një llambë ndriçonte në këtë dhomë natën e kaluar dhe kur një tjetër llambë shkëlqen sonte ne themi se drita e natës së kaluar po shkëlqen përsëri. Uji rrjedh nga një burim; pastaj ai ndalon; dhe kur fillon të rrjedhë për herë të dytë, ne themi se ky është i njëjti ujë që rrjedh përsëri; ose themi se kjo dritë është e njëllajtë me dritën e mëparshme. E njëjta gjë është me pranverën e vitit të kaluar, kur sythet, lulet dhe

¹⁸⁵ Shih Kurani 37:180.

¹⁸⁶ Kurani 59:2.

barërat erëndshme lulëzuan dhe u prodhuan fryte të shijshme; vitin tjetër ne themi se këto fryte të shijshme janë kthyer përsëri dhe këto sythe, lule e gonxhe janë rikthyer e kanë ardhur përsëri. Kjo nuk do të thotë se pikërisht të njëjtat pjesëza përbërëse të luleve të vitit të kaluar pas shpërbërjes janë kombinuar përsëri dhe përsëri kanë ardhur e janë kthyer. Përkundrazi, kuptimi është se delikatesa, freskia, aroma e këndëshme dhe ngjyra e mrekullueshme e luleve të vitit të kaluar shihen e shfaqen saktësisht në të njëjtën mënyrë në lulet e këtij viti. Me pak fjalë, kjo shprehje i referohet vetëm ngjashmërisë e ngjasimit që ekziston midis luleve të mëparshme e atyre të mëvonshme. “Kthimi” që përmendet në Shkrimet e Shenjta është ky: ai shpjegohet plotësisht nga Penda Supreme¹⁸⁷ në Qitapi Ikan. Referojuni atij, në mënyrë që të njihni të vërtetën e mistereve hyjnore.

Përsëritje e lavdërime juve.

82

PANTEIZMI

Pyetje.—Si e kuptojnë teozofistët dhe sufitet çështjen e panteizmit?¹⁸⁸ Ç’kuptim ka ai dhe sa i afrohet së vërtetës?

Përgjigje.—Dijeni se subjekti i panteizmit është i lashtë. Ky është një besim që nuk është i kufizuar vetëm te teozofistët dhe sufitet; përkundrazi, disa prej të urtëve të Greqisë besonin në panteizmin, si Aristoteli, i cili ka thënë: “E vërteta e thjeshtë janë të gjitha gjërat, por nuk është asnjëra prej tyre”. Në këtë rast, “e thjeshtë” është e kundërta e “së përbërës”; ajo është Realiteti i izoluar, që dëliret e spastrohet nga përbërja e ndarja dhe që e zbërthen Vetën në forma të panumërta. Pra, Ekzistencë Reale janë të gjitha gjërat, por nuk është një prej gjërave

Me pak fjalë, ata që besojnë në panteizmin mendojnë se Ekzistenca Reale mund të krahasohet me detin dhe se qeniet janë si dallgët e detit.

¹⁸⁷ Bahá’u’lláh-u.

¹⁸⁸ Fjalë për fjalë, unitet i ekzistencës.

Këto dallgë, që nënkuptojnë qeniet, janë forma të panumërta të asaj Ekzistence Reale; prandaj, Realiteti i Shenjtë është Deti i Paraqenies,¹⁸⁹ ndërsa format e panumërta të krijesave janë valët që shfaqen.

Po kështu, ata e krahasojnë këtë teori me unitetin real dhe me pafundësinë e numrave; uniteti real e reflekton vetveten në shkallët e numrave të pafundmë, sepse numrat janë përsëritja e unitetit real. Kështu numri dy është përsëritja e njëshit, dhe e njëjta gjë ndodh edhe me numrat e tjerë.

Një prej provave që sjellin ata është kjo: të gjitha qeniet janë gjëra që njihen prej Perëndisë; dhe dija pa gjëra të njohura nuk ekziston, sepse dija ka të bëjë me atë që ekziston e jo me hiçin. Mosqenia e kulluar nuk mund të ketë kurrfarë specifikimi ose individualizimi në shkallët e dijes. Prandaj realitetet e qenieve, që janë gjërat e njohura prej Perëndisë, Më të Lartit, kanë ekzistencën që ka dija,¹⁹⁰ përderisa ato kanë formën e Dijes Hyjnore dhe janë të paraqenëshme, siç është e paraqenëshme dija Hyjnore. Duke qenë se dija është e paraqenëshme, edhe gjërat e njohura janë po ashtu të tilla dhe individualizimet e specifikimet e qenieve, që janë dijet e paraqenëshme të Thelbit të Unitetit, janë vetë Dija Hyjnore. Sepse realitetet e Thelbit të Unitetit, dija dhe gjërat e njohura kanë një unitet absolut, që është real e i përcaktuar. Përndryshe Thelbi i Unitetit do të bëhet vendi i fenomeneve të shumta dhe shumësia e paraqenieve¹⁹¹ do të bëhej e nevojshme, gjë që është absurde.

Provohet kështu se gjërat e njohura përbëjnë vetë dijen dhe dija përbën vetë Thelbin—domethënë se Njohësi, dija dhe gjërat e njohura janë një realitet i vetëm. Dhe nëse ndokush përfytyron diçka jashtë kësaj, kjo bën të nevojshme kthimin përsëri të shumësia e paraqenieve e të vargëzimi,¹⁹² dhe paraqeniet përfundojnë duke u bërë të panumërta. Duke qenë se individualizimi dhe specifikimi i qenieve në dijet e Perëndisë ishin vetë Thelbi i Unitetit dhe se nuk kishte ndonjë dallim midis tyre, nuk kishte veçse një Unitet të vërtetë dhe të gjitha gjërat e

¹⁸⁹ Perëndia.

¹⁹⁰ dmth një ekzistencë intelektuale.

¹⁹¹ e perëndive.

¹⁹² dmth vazhdimi i pasosur i shkaqeve e i pasojave.

njohura ishin të përhapura e përfshiheshin në realitetin e këtij Thelbi të vetëm—domethënë se, sipas metodës së thjeshtësisë e të unitetit, ato përbëjnë dijen e Perëndisë, Më të Lartit, dhe thelbin e Realitetit. Kur Perëndia manifestoi lavdinë e Tij, këto individualizime e këto specifikime të qenieve që kishin një ekzistencë të njëmendtë—domethënë që ishin një formë e Dijes Hyjnore—domethënë e gjetën ekzistencën e tyre të materializuar në botën e jashtme; dhe kjo Ekzistencë Reale e zbrërtheu Vetveten në forma të panumërta. E tillë është baza e argumentit të tyre.

Teozofistët dhe sufistë janë ndarë në dy degë: njëra, që përfshin masën, e cila thjesht në frymë imitimi beson në panteizmin pa e kuptuar domethënien që i atribuojnë atij dijetarët e tyre; sepse masa e sufive besojnë që domethënia e Qenies është ekzistenca e përgjithshme, e marrë materialisht, që kuptohet nga arsyeja e inteligjenca—domethënë që njeriu e kupton atë. Në vend të kësaj, kjo ekzistencë e përgjithshme është një prej rastësive që përshkojnë realitetin e qenieve dhe cilësitë e qenieve janë thelbi. Kjo ekzistencë e rastësishme, e cila varet nga qeniet, është si vetitë e tjera të gjërave që varen prej tyre. Ajo është një rastësi midis rastësive, dhe sigurisht ajo që është thelb qëndron më lart se ajo që është rastësi. Sepse thelbi është origjina dhe rastësia është rrjedhoja; thelbi varet nga vetvetja, kurse rastësia varet nga diçka tjetër—domethënë ajo ka nevojë për një thelb nga i cili të varet. Në këtë rast, Perëndia do të ishte rrjedhojë e krijesës. Ai do të kishte nevojë për të dhe ajo do të ishte e pavarur prej Tij.

Për shembull, sa herë që elementet e veçanta kombinohen në përputhje me sistemin hyjnor universal, një qenie vjen në botë midis qenieve. Domethënë kur kombinohen elemente të caktuara, shfaqet një ekzistencë bimore; kur kombinohen të tjera, krijohet një kafshë; kur kombinohen të tjera akoma, dalin krijesa të ndryshme. Në këtë rast, ekzistenca e gjërave është rrjedhojë e realitetit të tyre: si mundet kjo ekzistencë, që është një rastësi midis rastësive dhe ka nevojë për një tjetër thelb nga i cili të varet, të jetë Thelbi i Paraqenëshëm, Autori i të gjitha gjërave?

Por dijetarët e mësuar të teozofistëve e të sufive, që e kanë studiuar këtë çështje, mendojnë se ka dy kategori të ekzistencës. Njëra është ekzistenca e përgjithshme, që kuptohet nga inteligjenca njerëzore; kjo

është një fenomen, një rastësi midis rastësive dhe realiteti i gjërave është thelbi. Por panteizmi nuk i kushton vëmendje kësaj ekzistence të përgjithshme e imagjinare, por vetëm Ekzistencës së Vërtetë, të çliruar e të spastruar nga të gjitha interpretimet e tjera; falë Asaj ekzistojnë të gjitha gjërat dhe Ajo është Uniteti përmes të cilit kanë ardhur në botë të gjitha gjërat, si materia, energjia dhe kjo ekzistencë e përgjithshme që kuptohet nga mendja njerëzore. Kjo është e vërteta e kësaj çështjeje sipas teozofistëve e sufive.

Me pak fjalë, përsa i përket kësaj teorie, sipas së cilës të gjitha gjërat ekzistojnë falë Unitetit, të gjithë janë në një mendje—domethënë filozofët dhe Profetët. Por ka një dallim midis tyre. Profetët thonë se dija e Perëndisë nuk ka nevojë për ekzistencën e qenieve, por dija e krijesave ka nevojë për ekzistencën e gjërave të njohura; në qoftë se Dija e Perëndisë do të kishte nevojë për ndonjë gjë tjetër, atëhere ajo do të ishte dije e krijesave e jo e Perëndisë. Sepse i Paraqenëshmi është i ndryshëm nga fenomenali, dhe fenomenali është e kundërta e të Paraqenëshmit; atë që ia atribuojmë krijesës—dmth nevojat e qenieve të rastësishme—ne e mohojmë për Perëndinë; sepse dëlirja apo spastrimi nga papërsosuritë është një prej vetive të Tij të nevojshme. Kështu në fenomenalen ne shohim injorancë; te i Paraqenëshmi njohim dijen. Në fenomenalen shohim dobësi; te i Paraqenëshmi dallojmë fuqinë. Në fenomenalen shohim varfëri; te i Paraqenëshmi dallojmë pasurinë. Kështu fenomenalja është burimi i papërsosurive, ndërsa i Paraqenëshmi është shuma e përsosurive. Dija fenomenale ka nevojë për gjërat e njohura; Dija e Paraqenëshme është e pavarur nga ekzistenca e tyre. Kështu, paraqenia e specifikimit dhe e individualizimit të qenieve, që janë gjërat e njohura prej Perëndisë, Më të Lartit, nuk ekziston; dhe këto attribute hyjnore e të përsosura nuk kuptohen nga inteligjenca aq sa ne të mund të vendosim nëse Dija Hyjnore ka nevojë për gjërat e njohura apo jo.

Me pak fjalë, ky është argumenti kryesor i sufive; dhe në qoftë se ne do të donim të përmendnim të gjitha provat e tyre e të shpjegonim përgjigjet, kjo do të na merrte një kohë shumë të gjatë. Kjo është prova e tyre vendimtare dhe argumenti i tyre më i zakonshëm—të paktën i dijetarëve të sufive e të teozofistëve.

Por çështja e Ekzistencës Reale, falë së cilës ekzistojnë të gjitha gjërat—domethënë Realiteti i Thelbit të Unitetit, përmes të cilit kanë ardhur në botë të gjitha gjërat—pranohet nga gjithkush. Dallimi qëndron në atë që thonë sufritë se “Realiteti i gjërave është manifestimi i Unitetit Real”. Por Profetët thonë “Ai buron nga Uniteti Real”; dhe ka një dallim të madh midis manifestimit e të buruarit. Shfaqja si manifestim do të thotë se një gjë e vetme shfaqet në forma të panumërta. Për shembull, fara, e cila është një gjë e vetme që zotëron përsosuritë bimore e që i manifeston në forma të panumërta, duke e kthyer vetveten në degë, gjethe, lule e fryte: kjo quhet shfaqje si manifestim; ndërsa në shfaqjen përmes të buruarit, ky Unitet Real mbetet dhe vazhdon në lartësinë e shenjtërisë së Tij, kurse ekzistenca e krijesave buron nga Ai dhe nuk manifestohet prej Tij. Ai mund të krahasohet me diellin, nga i cili buron drita që derdhet mbi të gjitha krijesat; por dielli mbetet në lartësinë e shenjtërisë së tij. Ai nuk zbret dhe nuk e kthen vetveten në forma të ndritshme; ai nuk shfaqet në brendinë e gjërave përmes specifikimit e individualizimit të gjërave; i Paraqenëshmi nuk bëhet fenomenal; pasuria e pavarur nuk bëhet varfëri e lidhur; përsosuria e kulluar nuk bëhet papërsosuri absolute.

Që ta përmbledhim: sufritë i pranojnë Perëndinë e krijesën, dhe thonë se Perëndia e kthen Vetveten në format e panumërta të krijesave, dhe paraqitet si deti, që shfaqet në format e panumërta të valëve. Këto valë fenomenale e të papërsosura janë e njëjta gjë si Deti i Paraqenëshëm, i cili është shuma e të gjitha përsosurive hyjnore. Profetët, përkundrazi, besojnë se ekziston bota e Perëndisë, bota e Mbretërisë dhe bota e Krijimit: tri gjëra. E para që buron nga Perëndia është bujaria e Mbretërisë, e cila buron e pasqyrohet në realitetin e krijesave, si drita që buron nga dielli dhe shkëlqen në krijesat; dhe kjo bujari, që është drita, pasqyrohet në forma të panumërta në realitetin e të gjitha gjërave, duke e specifikuar dhe individualizuar vetveten sipas aftësisë, meritës e vlerës së qenësishme të gjërave. Por pohimi i sufive kërkon që Pasuria e Pavarur të zbresë në shkallën e varfërisë, që i Paraqenëshmi ta ngushtojë vetveten në forma fenomenale dhe që Pushteti i Kulluar të ndrydhet në gjendjen e dobësisë, sipas kufizimeve të qenieve të rastësishme. Dhe ky është një gabim që duket sheshit. Vëreni se realiteti i njeriut, që është më fisnikja e krijesave, nuk zbret në realitetin

e kafshës, se thelbi i kafshës, që është e pajisur me aftësitë e ndijimit, nuk e ul veten në shkallën e bimës, dhe se realiteti i bimës, që ka aftësinë e rritjes, nuk zbret në realitetin e mineralit.

Me pak fjalë, realiteti më i lartë nuk zbret as nuk e ul veten në gjendje më të ulëta; atëhere si mundet Realiteti Universal i Perëndisë, që qëndron mbi të gjitha përshkrimet e kualifikimet, me gjithë delirësinë e pastërtinë e tij absolute, ta kthejë vetveten në format e realiteteve të krijesave, që janë burimi i papërsosurive? Kjo është thjesht imagjinatë që askush nuk mund ta konceptojë.

Në të kundërtën ky Thelb i Shenjtë është shuma e përsosurive hyjnore; dhe të gjitha krijesat favorizohen nga bujaria e shkëlqimit përmes burimit dhe marrin dritat, përsosurinë dhe bukurinë e Mbretërisë së Tij, ashtu si të gjitha krijesat tokësore marrin bujarinë e dritës së rrezeve të diellit, por dielli nuk zbret e nuk e ul vetveten në realitetet e favorizuara të qenieve tokësore.

Është pasdreke, dhe duke pasur parasysh se vajti vonë, nuk ka kohë për të shpjeguar më tej.

Përsëritje.

83

KATËR METODAT PËR TË FITUAR DIJE

Ka vetëm katër metoda të pranuar për të kuptuar—domethënë realitetet e gjërave kuptohen nëpërmjet këtyre katër metodave.

Metoda e parë është me anë të shqisave—domethënë të gjitha gjërat që i percepton syri, veshi, të shijuarit, të nuhaturit dhe të prekurit kuptohen me anë të kësaj metode. Sot kjo metodë konsiderohet si më e përsosura nga të gjithë filozofët evropianë: ata thonë se metoda themelore për të fituar dije është ajo me anë të shqisave; ata e konsiderojnë atë si supreme, edhe pse është e papërsosur, sepse bën gabime. Për shembull, më e madhja ndër shqisat është aftësia e të parit. Syri e sheh mirazhin si ujë dhe i sheh figurat e reflektuara në pasqyrë si të vërteta e që ekzistojnë; trupat e mëdhenj që janë larg duken të vegjël

dhe një pikë që rrotullohet duket si rreth. Shikimit toka i duket e palëvizshme dhe diellin e sheh në lëvizje, dhe në shumë raste të ngjashme bën gabime. Prandaj ne nuk mund t'i besojmë atij.

Metoda e dytë është ajo e arsytimit, që ishte metoda e filozofëve të lashtë, shtylla të urtisë; kjo është metoda e të kuptuarit. Ata i provonin gjërat me arsytim dhe u përmbaheshin fort provave logjike; të gjitha argumentet e tyre janë argumente të arsytimit. Megjithatë, ata kishin dallime të mëdha dhe mendimet e tyre ishin kontradiktore. Ata madje i ndryshonin pikëpamjet e tyre—domethënë gjatë njëzet vjetëve ata provonin ekzistencën e diçkaje me argumente logjike dhe më pas e mohonin atë po me argumente logjike. Kaq është e vërtetë kjo, saqë Platoni në fillim provoi logjikisht palëvizshmërinë e tokës dhe lëvizjen e diellit; më pas me argumente logjike provoi se dielli ishte qendra e palëvizshme dhe se toka ishte në lëvizje. Më vonë u përhap gjerësisht teoria e Ptolemeut dhe ideja e Platonit u harrua krejtësisht, derisa më në fund një vëzhgues i ri e thirri atë përsëri në jetë. Kështu, të gjithë matematikanët nuk qenë dakord, megjithëse mbështeteshin mbi argumente të arsyes. Po kështu, me argumente logjike, ata e provojnë një problem në një kohë të caktuar, dhe më pas, me argumente të së njëjtës natyrë, ata e mohojnë atë. Kështu, një prej filozofëve për një kohë i përmbahet vendosmërisht një teorie dhe e mbështet atë me argumente e prova të fuqishme, të cilat më pas i tërheq dhe i kundërshton me argumente të arsyes. Shihet qartë, pra, se metoda e arsytimit nuk është e përsosur, sepse dallimet në pikëpamjet e filozofëve të lashtë, mungesa e stabilitetit dhe ndryshueshmëria e mendimeve të tyre e provojnë këtë. Sepse, po të ishte e përsosur, të gjithë duhet të kishin ide të njëjta dhe të ishin të një mendjeje në opinionet e tyre.

Metoda e tretë e të kuptuarit është përmes traditës—dmth përmes tekstit të Shkrimeve të Shenjta—sepse njerëzit thonë “Në Dhiatën e Vjetër e të Re Perëndia foli kështu”. Edhe kjo metodë po kështu nuk është e përsosur, sepse traditat kuptohen me anë të arsyes. Duke qenë se vetë arsyeja është e prirur të gabojë, si mund të thuhet se në interpretimin e domethënies së traditave ajo nuk do të gabojë, sepse është e mundur që ajo të bëjë gabime dhe siguri nuk mund të ketë. Kjo është metoda e udhëheqësve fetarë; çdo gjë që ata kuptojnë e kapin nga

teksti i librave është ajo që kupton nga teksti arsyeja e tyre dhe jo doemos e vërteta e mirëfilltë; sepse arsyetimi është si një peshore dhe domethëniet që përmban teksti i Librave të Shenjtë janë si gjërat që peshohen. Në qoftë se peshorja nuk është e saktë, si mund të jemi të sigurt për peshën?

Dijeni pra, ajo që është në duart e njerëzve, ajo që ata besojnë, i nënshtrohet gabimit. Sepse, duke provuar ose hedhur poshtë diçka, në qoftë se sillet një provë që është marrë nga ajo që eidentojnë shqisat tona, kjo metodë, siç e sqaruam, nuk është e përsosur; në qoftë se provat janë intelektuale, është e vërtetë e njëjta gjë; ose, në qoftë se ato janë tradicionale, prova të tilla gjithashtu nuk janë të përsosura. Nuk ka, pra, në duart e njerëzve asnjë kriter mbi të cilin të mund të mbështetemi.

Por bujaria e Shpirtit të Shenjtë na jep metodën e vërtetë të të kuptuarit, që është e pagabueshme dhe e padyshimtë. Kjo vjen te njeriu përmes ndihmës së Shpirtit të Shenjtë dhe ky është kushti i vetëm që lejon të arrihet siguria.

84

NEVOJA E NDJEKJES SË MËSIMEVE TË MANIFESTIMEVE HYJNORE

Pyetje.—Ata që janë të bekuar me vepra të mira e dashamirësi universale, që kanë tipare të lavdërueshme, që veprojnë me dashuri e mirësi kundrejt të gjitha krijesave të tjera, që kujdesen për të varfërit dhe që përpiqen të vendosin paqen universale—ç'nevojë kanë ata për mësimet hyjnore, prej të cilave ata mendojnë se janë të pavarur? Cila është gjendja e këtyre njerëzve?

Përgjigje.—Dijeni se vepra të tilla, përpjekje e fjalë të tilla janë të lavdërueshme e të mirëpritura, ato janë lavdia e njerëzimit. Por vetëm këto vepra nuk janë të mjaftueshme; ato janë si një trup shumë i hijshëm, por pa shpirt. Jo, ajo që sjell jetë të pasosur, nder të përjetshëm, ndriçim universal, shpëtim e begati të vërtetë është, para së

gjithash, njohja e Perëndisë. Dihet se njohja e Perëndisë është tej çdo dije dhe është lavdia më e madhe e botës njerëzore. Sepse në dijen ekzistuese të realitetit të gjërave ka përfitim material dhe përmes saj përparon qytetërimi i jashtëm; por njohja e Perëndisë është shkaku i përparimit e i tërheqjes shpirtërore dhe nëpërmjet saj arrihen perceptimi i së vërtetës, lartësimi i njerëzimit, qytetërimi hyjnor, një moral i drejtë dhe ndriçimi i mendjes.

E dyta vjen dashuria për Perëndinë, drita e së cilës shkëlqen në llambën e zemrave të atyre që njohin Perëndinë; rrezet e saj të shkëlqyeshme ndiçojnë horizontin dhe i japin njeriut jetën e Mbretërisë. Në të vërtetë, fryti i ekzistencës njerëzore është dashuria për Perëndinë, sepse kjo dashuri është shpirti i jetës dhe bujaria e përjetshme. Po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, bota e rastësishme do të ishte në errësirë; po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, zemrat e njerëzve do të ishin të vdekura e të zhveshura nga ndjenjat e ekzistencës; po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, bashkimi shpirtëror do të humbiste; po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, drita e unitetit nuk do të ndriçonte njerëzimin; po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, Lindja dhe Perëndimi nuk do të përqafoheshin me njëri-tjetrin si dy dashnorë; po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, ndarja e përçarja nuk do të shndërroheshin në vëllazërim; po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, indiferenca nuk do të kthehej në dashuri; po të mos ekzistonte dashuria për Perëndinë, i huaji nuk do të bëhej mik. Dashuria e botës njerëzore ka ndriçuar nga dashuria për Perëndinë dhe është shfaqur falë bujarisë e hirit të Perëndisë.

Është e qartë se realiteti i njerëzimit është i ndryshëm, se mendimet janë të shumëllojshme dhe ndjenjat jo të njëjta; dhe ky dallim pikëpamjesh, mendimesh, intelligence, ndjenjash midis gjinisë njerëzore lind nga një nevojë thelbësore, sepse dallimet në shkallët e ekzistencës së krijesave janë një prej nevojave të ekzistencës, që shpaloset në forma të panumërta. Prandaj ne kemi nevojë për një forcë të përgjithshme që të mund t'i dominojë ndjenjat, opinionet e mendimet e të gjithëve, falë së cilës këto ndarje të mos kenë më efekt dhe të gjithë individët të mund të futen nën ndikimin e unitetit të botës së njerëzimit. Është e qartë e duket sheshit se kjo forcë e madhe në botën njerëzore është dashuria për Perëndinë. Ajo i sjell popujt e ndryshëm nën hijen e

tendës së dashurisë; ajo u jep kombeve e familjeve antagonistë e armike dashurinë e bashkimit më të madh.

Shihni, pas kohës së Krishtit, falë fuqisë së dashurisë për Perëndinë, sa shumë kombe, raca, familje e fise u futën nën hijen e fjalës së Perëndisë. Ndarjet e dallimet e një mijë vjetëve u likuiduan e u asgjësuan tërësisht. Konceptet e racës e të atdheut u zhdukën plotësisht. U krye bashkimi i shpirtave e i ekzistencave; të gjithë u bënë shpirtërisht të krishterë të vërtetë.

Virtyti i tretë i njerëzimit është dashamirësia, që është baza e veprave të mira. Disa filozofë e kanë konsideruar qëllimin si superior ndaj veprimit, sepse dashamirësia është drita absolute; ajo është e dëlirë dhe e pastruar nga papastërtitë e egoizmit, të armiqësisë, të mashtrimit. Mund të ndodhë që një njeri të bëjë një veprim, i cili në dukje është i drejtë, por që diktohet nga lakmia. Për shembull, një kasap rrit një dele dhe e mbron atë; por ky veprim i drejtë i kasapit diktohet nga dëshira për të nxjerrë fitim dhe rezultati i këtij kujdesi është therja e deles së mjerë. Sa veprime të drejta diktohen nga lakmia! Por dashamirësia është e dëlirë nga papastërti të tilla.

Me pak fjalë, në qoftë se njohjes së Perëndisë i shtohet dashuria për Perëndinë dhe tërheqja, ekstaza dhe dashamirësia, atëherë një vepër e drejtë është e përsosur dhe e plotë. Përndryshe, edhe pse një vepër e mirë është e lavdërueshme, por në qoftë se nuk mbështetet nga njohja e Perëndisë, dashuria për Perëndinë e nga një qëllim i sinqertë, ajo është e papërsosur. Për shembull, qenia njerëzore, për të qenë e përsosur, duhet të bashkojë të gjitha përsosuritë. Të shikuarit është tejet i vyer e i çmuar, por ai duhet të ndihmohet nga të dëgjuarit; të dëgjuarit është shumë i çmuar, por ai duhet të ndihmohet nga aftësia e të folurit; aftësia e të folurit është shumë e pranueshme, por ajo duhet të ndihmohet nga aftësia e të arsyetuarit e kështu me radhë. Kjo është e vërtetë edhe për aftësitë, organet dhe pjesët e tjera të njeriut; kur të gjitha këto aftësi, këto shqisa, këto organe e këto pjesë ekzistojnë së bashku, ai është i përsosur.

Ja, sot takojmë njerëz në botë që, me të vërtetë, duan të mirën e përgjithshme dhe që, sipas aftësive të tyre, merren me mbrojtjen e të shtypurve dhe ndihmën për të varfërit: ata janë entuziastë për paqen e për mirëqenien e përgjithshme. Edhe pse nga kjo pikëpamje ata mund

të jenë të përsosur, por po të jenë të privuar nga njohja e Perëndisë e dashuria për Të, ata janë të papërsosur.

Galeni, mjeku, në librin e tij ku komenton traktatin e Platonit për artin e qeverisjes¹⁹³, thotë se parimet themelore të fesë kanë një ndikim të madh për një qytetërim të përsosur, sepse “shumica nuk mund ta kuptojë lidhjen e fjalëve shpjeguese; pra ka nevojë për fjalë simbolike që të tregojnë shpërblimet e ndëshkimet e botës tjetër; dhe ajo që provon të vërtetën e këtij pohimi”, thotë ai, “është se sot ne shohim njerëz të quajtur të krishterë, që besojnë në shpërblimet e ndëshkimet; dhe ky sekt kryen vepra të bukura, si ato që bën një filozof i vërtetë. Kështu ne të gjithë e shohim qartë se ata nuk kanë frikë nga vdekja, se ata nuk presin e nuk dëshirojnë prej turmës asgjë, veçse drejtësi e barazi, dhe se ata konsiderohen si filozofë të vërtetë”.

Tani, vëreni sa ishte shkalla e sinqeritetit, e zellit, e ndjenjës shpirtërore, e detyrimit miqësor dhe e veprave të mira të një besimtari në Krishtin, saqë Galeni, mjeku filozof, edhe pse nuk ishte i fesë së krishterë, megjithatë dëshmonte për moralin e mirë dhe përsosuritë e këtyre njerëzve, deri në atë pikë sa të thoshte se ata ishin filozofë të vërtetë. Këto virtyte, ky moral ishin fituar jo vetëm përmes veprave të mira, sepse, po qe se virtyti është vetëm çështje e marrjes dhe e dhënies së të mirës, ashtu si kjo llambë që ndizet e ndriçon shtëpinë—padyshim, ky ndriçim është një vepër e mirë—atëhere përse ne nuk e lavdërojmë llambën? Dielli bën që të gjitha qeniet e tokës të rriten dhe përmes nxehtësisë e dritës së tij jep rritje e zhvillim: a ka vepër më të madhe se kjo? Megjithatë, meqë kjo e mirë nuk vjen nga dashamirësia dhe nga dashuria e njohja e Perëndisë, ajo është e papërsosur.

Kur, në të kundërtën, një njeri i jep një tjetri një gotë ujë, ky i fundit është mirënjohës dhe e falënderon atë. Një njeri, pa u thelluar, do të thotë “Ky diell që i jep dritë botës, kjo bujari supreme që është e dukshme në të duhet të adhurohet e të lavdërohet. Përse nuk duhet t’i jemi mirënjohës e t’i falemi nderit diellit për bujarinë e vet, kur ne lavdërojmë një njeri që bën një vepër të thjeshtë mirësie?” Por, në qoftë se kërkojmë të vërtetën, shohim se kjo mirësi e parëndësishme e njeriut

¹⁹³ Shih Ibn Abi Usaybiá, ‘*Uyún al-anbá fí *abaqát al-a*ibbá*’ (Kajro: 1882) vëll. i, f. 76-77).

i detyrohet ekzistencës së ndjenjave të vetëdijshme; prandaj është e denjë të lavdërohet, ndërsa drita dhe ngrohtësia e diellit nuk i detyrohen ndjenjave e vetëdijës; prandaj ato nuk e vlen të lartësohen ose lavdërohen dhe nuk meritojnë mirënjohje apo falenderime.

Po kështu, kur një person kryen një vepër të mirë, edhe pse ajo është e lavdërueshme, por në qoftë se nuk vjen nga dashuria e njohja e Perëndisë, është e papërsosur. Për më tepër, po të mendoni si duhet, do të shihni se këto vepra të mira të njerëzve të tjerë që nuk e njohin Perëndinë janë shkaktuar gjithashtu, në thelb, prej mësimëve të Perëndisë—domethënë që Profetët e mëparshëm kanë bërë që njerëzit t'i kryejnë këto vepra, u kanë shpjeguar bukurinë e tyre dhe kanë treguar efektet e tyre të shkëlqyera; pastaj këto mësimë janë përhapur midis njerëzve dhe kanë arritur tek ata me sukses, njëri pas tjetrit, duke i kthyer zemrat e tyre drejt këtyre përsosurive. Kur njerëzit e kanë parë se këto vepra konsideroheshin të bukura dhe i sillnin gëzim e lumturi njerëzimit, ata u janë përshtatur atyre.

Pra, këto veprime vijnë, gjithashtu, nga mësimet e Perëndisë. Por për ta kuptuar këtë duhet drejtësi dhe jo kundërvënie e polemikë. Shyqyr Zotit, ju keni qenë në Persi dhe e keni parë sesi persët, falë flladeve të shenjta të Bahá'u'lláh-ut janë bënë dashamirës ndaj njerëzimit. Më parë, po të takonin ndokënd të një race tjetër, ata e torturonin atë dhe silleshin me armiqësinë, urrejtjen e keqdashjen më të madhe; ata arrinin deri atje sa të hidhnin baltë mbi të. Ata digjinin Ungjillin e Dhiatën e Vjetër dhe, në qoftë se u “ndoteshin” duart nga prekja e këtyre librave, i lanin ato. Sot pjesa më e madhe e tyre recitojnë e këndojnë, ashtu siç duhet, përmbajtjen e këtyre dy Librave në takimet e mbledhjet e tyre, dhe shpjegojnë mësimet e tyre të fshehta. Ata tregohen mikpritës ndaj armiqve të tyre. Ata i trajtojnë ujqit gjakpirës me mirësi, si gazelat në fushat e dashurisë së Perëndisë. Ju i keni parë doket e zakonet e tyre dhe keni dëgjuar për sjelljet e persëve të mëparshëm. Ky transformim i moralit, ky përmirësim i sjelljes e i fjalëve, a do të ishte i mundur ndryshe, veçse falë dashurisë së Perëndisë? Jo, për Perëndi. Në qoftë se do të donim t'i futnim këtë moral e këto zakone me ndihmën e shkencës e të dijes, me të vërtetë do të duheshin një mijë vjet, madje edhe atëherë nuk do të ishin përhapur midis masave.

Sot, falë dashurisë së Perëndisë, kjo është arritur me lehtësinë më të madhe.

Jini të paralajmëruar, o ju që zotëroni mençuri!

TREGUESI TEMATIK¹⁹⁴

A

- Aaroni, 44
- ‘Abdu’l-Bahá-i, 11 shën.
- Abrahami, 4, 18
- mërgimi i, rezultatet e, 4
- pasardhësit e, 4, 57
- Adami, 18
- domethënia e, dhe Eva, 30
- ky cikël fillon me, 41
- shkaku i jetës fizike të njeriut, 29
- Afarizmi, praktikat e, 78
- grevat, 78
- moderimi i të ardhurave, 78
- ndarja e fitimeve, 78
- Aftësitë e njeriut. Shih Njeriu
- Akra [‘Akká] (Burgu Më i Madh), 9, 10 shën.
- Alfa dhe Omega, 58, 80
- Aliu, 11
- fuqia e, si Jozuei, 11
- shpjegimet dhe komentet e, 11
- Apostujt. Shih Jesu Krishti, dishepujt e
- E ardhmja. Shih gjithashtu Koha
- ëndrrat mund të revelojnë, 61
- sekretet e, të reveluara Profetëve, 35
- Të ardhurat, moderimi në, 78
- Aristoteli, 5, 82
- Arsyeja, gabueshmëria e, 83
- Astrologjia, 69
- Dielli i Realitetit del nga shenja të ndryshme të Zodiakut, 14

¹⁹⁴ Numrat që jepen për çdo zë të Treguesit tematik janë ata të kapitujve të librit.

Astronomia

elementet e gjithësisë janë të ndërlidhura, 69

në Kuran, 7

përkulja e horizontit, 48

“Ati është në Birin”, 54

Atomët

të ngjashme me qeniet më të mëdha të gjithësisë, 47

Atributet. Shih Karakteri; Njeriu, aftësisë dhe virtytet e; Shpirtësia

B

Báb-i, 8, 11

Bahá'u'lláh-u e njohu, e ndihmoi, 9

erudicioni i, 8

lindur nga Ligji i Muhametit, 13

martirizimi i, 11

profecitë e dhe në lidhje me (shih Profecitë)

referimi atij si

Hadrat-i-A'lá (Lartësia e Tij Supreme), 8 shën.

Pika Parësore, 13

rrjedh nga Abrahami, 4, 57

shkopi i hekurt i, 13

Bábí-të, përndjekja e, 9

Bahá'í-të

larmia e, 12

mund të bëhen njerëz të Diellit të Realitetit, 59

Bahá'u'lláh-u, 9

Báb-i i njohur, i ndihmuar nga, 9

deklarimi i, 10 shën.

edukoi mijëra, 9

erudicioni i, 9

njohuritë e arabishtes, 9

fuqia e, 9

mrekullitë e

nuk janë prova vendimtare, 10

propozon të kryejë, 9

që i atribuohen, 9, 10

- përsosuria e, 37
- pozita e
- dallimi midis, dhe Manifestimeve të tjera, 37
 - Manifestimi suprem për ciklin Adamik, 41
 - Manifestimi universal, 11
- prania e, efekti i, 9, 10
- profecitë e dhe në lidhje me (shih Profecitë)
- provat e, rivendikimi i, 10
- referimi atij si
- Dega Hyjnore, 12
 - Dega e Pakrahasueshme, 12
 - Drita e Realitetit, 10
 - Emri Më i Madh, 37
 - Penda Supreme, 81
 - Xhemal-i-Kidam (Bukuria e Paraqenëshme, ose e Lashtë), 9 shën.
 - Xhemal-i-Mubarak (Bukuria e Bekuar), 9 shën.
 - Ylli Më i Madh, 30
- rrjedh nga Abrahami, 57
- syrgjynosjet e, 9
- efektet e, 4
 - ndihmoi Kauzën, 9, 10
 - në Akra [‘Akká], 9, 10 shën.
- Shkrimet e
- Letra e Besëlidhjes, 11, 11 shën.
 - Qitapi Akdas (Libri Më i Shenjtë), 12, 45 shën., 65
 - Qitapi Hejkal, 9
 - Qitapi Ikan, 26, 26 shën.
 - Sureja e Hejkalit, 9
 - Tabelat drejtuar Mbretërve, 9
- ulam të nuk i përgjigjeshin dot letrës së, 9
- zgjuar nga flladet e Lavdiplotit, 16
- Barbara, Shën, 34
- Besëlidhja, Letra e, 11 shën.
- Besimi është jetë e pasosur, 32

Bëmat

e mira, vetëm këto nuk janë të mjaftueshme, 65, 84
 mirëbërëse, mund të jenë shkak ndjese, 62

Bibla

kleri nuk e kuptoi, 23
 profecitë e (shih Profecitë)
 simbolizmi në, 16 (shih gjithashtu
 Shpjegime të vargjeve të Biblës; Profecitë; Simbolizmi)

Bibla: Shpjegime të vargjeve

Danieli 8:13-14, 6; 10
 Danieli 9:24, 8; 10
 Danieli 12:6-7, 3-4; 10
 Deut. 3:26; 44
 Deut. 5:8-9; 43
 Eksodi 20:4-5; 43
 Ezekieli 4:6; 11
 Ezekieli 30:1-3; 11
 Gjoni 1:1; 38, 39, 42, 54
 Gjoni 1:12-13; 18
 Gjoni 1:13; 60
 Gjoni 1:19-21; 33
 Gjoni 3:5; 60
 Gjoni 3:6; 22
 Gjoni 3:13; 23, 26
 Gjoni 6:26, 33, 35; 21
 Gjoni 6:38; 23
 Gjoni 6:41; 29
 Gjoni 6:42; 21, 23
 Gjoni 6:50; 21, 29
 Gjoni 6:51; 21,30
 Gjoni 6:58; 29
 Gjoni 6:63; 21
 Gjoni 12:40-41; 22
 Gjoni 14:11; 38, 54
 Gjoni 16:12-13; 25
 Gjoni 17:5; 28
 Gjoni 17:21; 38, 54

Isaia 11:1-10;12
 Isaia 43:1; 44
 Isaia 48:12; 44
 1 Kor. 15:22; 29
 Luka 11:2; 39
 Mateu 3:13-15; 19
 Mateu 5:39; 77
 Mateu 6:9; 39
 Mateu 8:22; 22, 30, 79
 Mateu 12:31-32; 31
 Mateu 13:14; 22
 Mateu 16:18; 34
 Mateu 19:16-17; 44
 Mateu 22:14; 32
 Mateu 24:3; 10
 Mateu 24:29; 26
 Mateu 26:26; 21
 Numrat 20:13; 44
 Revelacioni 12:1-6; 13
 Revelacioni 21:1-3; 13
 Revelacioni 22:13; 58
 Romakëve 9:21; 70
 Romakëve 14:14; 20
 Titi 1:15; 20
 Veprat 15:20; 20
 Zanafilla 1:26; 49
 Zanafilla 2:16-17, 3:5, 11-15, 22; 30
 Zanafilla 9:25; 57
 Bindja ndaj Manifestimeve, 45
 Bota. Shih Toka
 Bota bimore, 15, 36, 55, 64
 Bota minerale, 15, 64
 Bota tjetër. Shih Jeta, pas vdekjes
 Brahma, 22
 Buda, 43
 Burgu Më i Madh. Shih Akra

C

Cikli (et), 41, 43

Adamik, 41

në botën materiale, 14

e reja, përtërihen nga Shpirti i Shenjtë, 36

shpirtërore, e Profetëve, 14

universale, 41

Cilësitë. Shih Karakteri; Kërkuesi; Shpirtësia

Ç

Çifutët

do të mblidhen në Izrael, 12

Krishti nuk u pranua prej, 26, 28

sepse i mbanin sytë nga horizonti i Moisiut, 14

Muhameti i mbronte, 7

shkonin pas ligjit, jo arsyes, 76

D

Darka e Fundit, 21

Dashuria për Perëndinë, 84

Davidi, 43

Dávúdí, Sijid, 9

Dega

Hyjnore, 12

E Pakrahasueshme, 12

Dënimi është ndarja me perde nga Perëndia, 60

Dielli

i Realitetit, 11, 23, 45, 54

ka shumë vendagime, 14

pasqyrohet në Manifestimet e Perëndisë, 27

simbol i Persisë, 13

sjell jetë e ndriçim, 42

shëmbëlltyrë e, dhe pasqyra, 24, 27, 36, 37, 39, 50, 52, 54, 59, 61

Dija, 25, 34, 64
 dallimet e kushteve janë pengesë për, 59
 dy lloje, 16, 40
 katër metoda për të fituar, 83
 për Perëndinë (shih Perëndia)
 simbolet e
 drita, 16
 uji, 19

Ditura. Shih Dija
 Doktorët. Shih Mjekët
 Drejtësia, 62, 76
 Drita, 37
 simbolizon dijen, 16
 shëmbëlltyra e llambës dhe e, 39, 81, 84
 Druzët, 81

E

Edukatorët. Shih Manifestimet e Perëndisë
 Edukimi, 3
 Hyjnor, 3
 material, 3
 ndikimi i, 57
 njerëzor, 3
 për të parandaluar krimin, 77
 roli i Manifestimeve në edukimin e njeriut, 3, 64
 shpirtëror, 3

Egjiptianët, mospranimi i Muhametit shkaktoi shkatërrimin e, 11
 Ekonomia. Shih Praktikat e afarizmit
 Ekzistenca. Shih gjithashtu Krijimi; Paraqenia
 iluzioni dhe realiteti i, 79
 kushtet dhe shkallët e, 32, 64, 70
 janë të kufizuara në shërbyesí, profetëri dhe Hyjni, 62
 njeriu nuk mund të përparojë tej gjendjes së vet të, 64
 lëvizja (progresi dhe rënia) është e nevojshme për, 63
 materiale, është mosqenie relative, 67, 79, 80
 mosqenia nuk mund të bëhet, 47, 53, 80

- përsëritja është e pamundur në, 81
- përsosuritë e, janë të pakufizuara, 62
- shenjat e, nuk mund të shfaqen nga mosqenia, 60
- shkaqet e, 80
- Elia
 - Gjon Pagëzori ishte, 33
 - kthimi i, 10, 81
- Eukaristi, 21
- Eva, 30
 - përfaqëson shpirtin e Njeriut, 30
- Evolucioni, 49, 51
 - i njeriut, 17, 38, 46-47, 49, 51
 - gjithnjë një specie më vete, 47, 49
 - i tokës, 38, 47
- Ezekieli, 43
- Ë**
- Ëndrrat, 61, 71
- F**
- Fabrikat, ligjet për. Shih Praktikat e afarizmit
- Fati (paracaktimi), 35, 68. Shih gjithashtu Vullneti i lirë
- Feja, 40
 - ciklet shpirtërore të, 14, 36, 41, 43
 - Ligji i Perëndisë i ndarë në dy pjesë, 11
 - shkenca dhe, 34
 - traditat e, i nënshtrohen gabimit, 83
 - vendosja e Mbretërisë Hyjnore, 11
- Ferri, 60
- Fëmijët
 - duhet të luten për ndjesë për prindërit, 62
 - vdekja e, 66
- Filozofët
 - Aristoteli, 5, 82
 - Platoni, 5

Sokrati, 5
 Filozofia, gabueshmëria e arsyes në, 83
 Fiset arabe
 barbarizmi i, 7
 Muhameti i edukoi, 7, 11
 Fjala
 e Perëndisë, 28, 30, 38
 është shkaku i çdo jete, 42
 përsosuritë e Krishtit quhen, 54
 Flijimi, 15
 i Krishtit, 29
 Fuqploti, cikli hyjnor i, 11
 Furkani, 11

G

Galeni, 5
 Galileu, 7 shën.
 Gënjeshtra, 75
 është atributi më i urryer, 57
 Grevat, 78

GJ

Gjarpri, 30
 simbolizmi i, 30
 Gjithësia
 elementet e, janë të ndërlidhura, 69
 kërkon ekzistencën e njeriut, 50
 nuk ka fillim, 47
 përsosuria e, 46
 kërkon forma të panumërta ekzistence, 32
 Gjon Pagëzori, 19, 19-20
 ishte kthimi i Elias, 33, 81
 Gjumi, simbolizmi i, 16. Shih gjithashtu Ëndrrat
 Gjyqi, dita e, 11

H

Hagari, 4
 Hakmarrja, 76, 77
 Hasan ‘Amú, Mullá, 9
 Hebraizmi. Shih Moisiu; Profecitë
 Hëna si simbol i Perandorisë Otomane, 13
 Hipokrati, 5
 Hyjnia. Shih Perëndia

I

Ibn Naufal, Varakat-, 10
 Imagjinata, 56, 71
 Imamët, të simbolizuar nga dymbëdhjetë yje, 13
 Injoranca, 34
 e simbolizuar nga errësira, 16
 Inteligjenca, 1, 3. Shih gjithashtu Dija; Mendja
 Irani. Shih Persia
 Isaija, 43
 Isaku, 57
 Islami. Shih gjithashtu Muhameti
 armiqëdia midis Krishtërimt e, 7
 Imamët e, simbolizuar nga dymbëdhjetë yje, 13
 Mihdiu dhe Mesia priten nga, 10
 i mposhtur nga Umjadët, 11, 13
 ngritja dhe rënia e, 11
 profecitë e (shih Profecitë)
 traditat e rreme në, 7
 ulamatë nuk iu përgjigjën dot Bahá’u’lláh-ut, 9
 Ishmaeli, 4, 57
 Izraeli, çifutët do të mblidhen në, 12
 Izraelitët, 5, 6

J

Jakovi, 4, 44

- Jeremia, 43
- Jerusalemi, 11
- hyjnor, 11
 - i Ri, 13
- Jesu Krishti, 6, 38
- anulimi i Ligjit të Moisiut nga, 6, 20
 - ardhja e
 - erdhi nga qielli, 26
 - Fjala e Perëndisë ekzistonte para manifestimit trupor të saj, 28
 - profecitë që kanë të bëjnë me, 10
 - “Ati është në Birin”, simbolizmi i, 16
 - buka dhe vera e, 21, 29
 - dallimet midis, dhe Manifestimeve të tjera, 37
 - dishepujt e
 - kurrë nuk mund të bëhen Krisht, 60
 - lindur nga Perëndia, 60
 - zbritja e Shpirtit të Shenjtë te, 24
 - do të kishte vepruar si Muhameti, 7
 - kthimi i, 10, 26
 - lindja e, 26
 - lindur nga Shpirti i Shenjtë, 6
 - madhështia i detyrohet përsosurive, jo lindjes, 18
 - martirizimi i, 23
 - mrekullitë pas, 10
 - Mbretëria e, 60
 - Moisiu dhe Elia takohen me, 71
 - mospranimi i, 13, 14, 26, 28
 - nuk ishte degë e dalë nga trangu i Jeseut, 12
 - pagëzimi i, 19
 - pasardhës i Abrahamit, 4, 57
 - pëllumbi, simbolizmi i, 16
 - përsosuria e, 29, 37
 - përsosuritë e Perëndisë të manifestuara te, 54
 - i quajtur Fjala, 54
 - prova e, 22
 - puna e
 - bashkoi popuj të ndryshëm, 3, 84

- edukoi njëmbëdhjetë veta, 9
- ndriçoi njerëzimin, 29
- pema e jetës e mbjellur nga, 30
- e përfunduar, 3, 22
- sjell jetën shpirtërore të njeriut, 29
- i quajtur
 - Fjala e Perëndisë, 37
 - Ruhulláh, 20 shën.
- ringjallja e, 23
- Trinia, domethënia e, 27
- Jeta. Shih gjithashtu Ekzistenca
 - e pasosur, 21
 - pas vdekjes, 60, 66
 - Mbretëria e Perëndisë në, 67
 - të ndarë si me perde nga Perëndia në, 67
 - pasuria e, është afërsia me Perëndinë, 62
 - për fëmijët, 66
 - përparimi shpirtëror me anë të lutjeve, ndërmjetësimit,
 - bamirësisë së të tjerëve në, 62, 66
 - përparimi shpirtëror vazhdon në, 62-64
 - shpërblimet e botës tjetër në, 60
 - zog i lëshuar nga kafazi, 61
 - e përjetshme (e amshuar), 29, 30
 - besimi është, 32
 - pema e jetës e mbjellut nga Krishti është, 30
 - Shpirti i Shenjtë jep, 67
- Jobesimtari
 - dallimi midis të mirëve, mëkatarëve dhe të ligjve që janë të ndarë me perde, 65
 - mund të falet pas vdekjes, 62
- Josifi, 4

- K**

- Kadija (gruaja e Muhametit), 10
- Kafsha
 - bota e, 15, 64

- nuk mund të perceptojë realitetet intelektuale, 48
 shpirti i, 36, 55
- Kallami, Njeriu i Përkryer është si, 11
- Kanaani, 57
- Karakter. Shih gjithashtu Njeriu
 atributet e mira në, 15
 dallimet në, 57
 i lindur e i fituar, 57
 Njeriu i Përkryer është si kallami, 11
 vetitë e njeriut, 64
 virtytet shfaqen përmes fuqisë së Perëndisë, 15
- E keqja
 mosekzistenca e, 57, 74
 njeriu mund të zgjedhë që të bëjë, 70
 pema e së mirës dhe e së, 30
 pema e Zakumit, 81
 vetitë djallëzore, 64
- Kërkuesi
 cilësitë e, 10
 duhet të jetë si flutura e bilbili, 14
 duhet të kërkojë Diellin e Realitetit e jo vendagimin, 14
- Kisha Katolike, Papët e, 34, 43
- Koha
 Fjala e Perëndisë është e përjashtuar nga, 38
 gjithësia nuk ka fillim, 47
 e kaluar, e tashme dhe e ardhme, në botën e Perëndisë, 39
 ngjarjet e ardhme, dija për, 35
 mund të shihen në ëndrra, 61
 paraqenia e, 28, 37, 53
- Konfuci, 43
- Koperniku, 7 shën.
- Kopshti i Edenit, 30
- Krijimi, 2. Shih gjithashtu Ekzistenca; Gjithësia
 asgjësimi i materies i pamundur, 53
 atributet e Perëndisë kërkojnë, 80
 bota e, kërkon shfaqjen e shpirtit njerëzor, 52
 Krijuesi gjithmonë ka pasur, 80

- mirësia e, 57, 74
- në fillim materia ishte një, 47
- njeriu nuk mund të krijojë, 47
- përsosuria e, 46
- Krimi dhe kriminelët
 - dënimi i
 - komuniteti është përgjegjës për, 76, 77
 - qëllimi i, 76, 77
 - edukimi i nevojshëm për të parandaluar, 77
 - hakmarrja është e qortueshme, 76, 77
 - shkaku i, është injoranca, 77
 - vrasja dhe, 76
- Krishti. Shih Jesu Krishti
- Krishtërimi
 - armiqësia midis Islamit dhe, 7
 - Eukaristi, 21
 - kalbëzimi i, 43
 - kisha e Perëndisë e themeluar në shkëmbin e besimit, 34
 - Pagëzimi, 19-20
 - Papët, 34, 43
 - Rrëshajët, 24
 - Trinia, domethënia e, 27
- Të krishterët
 - madhështia e, dëshmuar nga Galeni, 84
 - Muhameti i mbronte, 7
- Kthimi, domethënia e, 33, 81
- Kudus-iu (Haxhi Mulla Muhamet-Ali Barfurushi), 11, 11 shën.
- Kungimi. Shih Eukaristi
- Kuptimi. Shih Dija
- Kurani, 7
 - lëvizja e tokës e përmendur në, 7
 - i quajtur gjithashtu Furkan, 11
 - shpjegime të vargjeve
 - Sureja 19:17; 17
 - Sureja 23:14; 47, 60
 - Sureja 36:35; 17
 - Sureja 37:180; 81

Sureja 48:1-2; 44
59:2; 81

L

Libri Më i Shenjtë (Qitapi Akdas), 12, 45 shën., 65

Ligji

duhet të ndryshojë me ndryshimin e njeriut, 11, 20
hyjnor, 11

Manifestimi jep ligj të Shenjtë, 40

i Perëndisë

bindja ndaj, 45

është Jerusalemi i Ri, 13

gruaja si simbol i, 13

mosnjohja e, është e falshme, 76

i ndarë në dy pjesë, 11

Lindja, shpirtërore, 60

Logjika, gabueshmëria e, 83

Loti, 4

LL

Llamba. Shih Drita

M

Mali Karmel, 9

Manifestimi dhe të buruarit, 54

Manifestimet e Perëndisë, 16, 31, 37, 42, 58. Shih gjithashtu

Manifestimet individuale: Abrahami; Báb-i; Bahá'u'lláh-u; Buda;

Jesu Krishti; Muhameti e ardhmja u revelohet, 35

atributet dhe fuqitë e

dija hyjnore e pafituar, 40

fuqia hyjnore, 3

fuqia intelektuale hyjnore, 58

fuqitë e mbinatyrshme, 22

manifestojnë përsosuritë, atributet e Perëndisë, 37, 54, 59

- pagabueshmëria, 45
- të pandara nga Bujaria e Perëndisë, 39
- pasqyrojnë Diellin e Realitetit, 27, 37, 59
- shenjat e madhësisë që në fëmijëri, 39
- ciklet e, 14, 41, 43
- dallimet midis dy llojeve të Profetëve, 43
- dy, priten nga bota, 10
- ekzistenca e
 - nuk ka fillim, as fund, 38
 - Njeriu i Përsosur (Përkryer) gjithmonë ekziston, 50
- kthimi i, domethënia e, 33, 81
- mësimet e
 - është e nevojshme të ndiqen, 84
 - ligjet materiale ndërrohen në çdo cikël, 11
 - Ligji i Perëndisë jepet me anë të, 40
 - ndryshojnë me ndryshimet te njeriu, 20
- mospranimi i, 31
 - urrejtja për Shpirtin e Shenjtë është e pafalshme, 31
- ndërmjetësimi nga ana e, 62
- ndikimi i, 3, 42
- nevoja e bindjes ndaj, 45
- ngjitja e, 39
- njohja e, 31
- përsosuria e, 3, 37-38, 44
 - Krishti dhe Bahá'u'lláh-u zotërojnë përsosuritë e Manifestimeve të mëparshme e më shumë, 37
 - Njeriu i Përsosur (Përkryer), 27, 45, 50, 59
- i Premtuari që do të vijë pas Krishtit, 25
- qëllimi i
 - të edukojnë njerëzimin, 3
 - si kopshtarë të botës së njerëzimit, 49
 - të ndërmjetësojnë midis Perëndisë dhe krijesave të Tij, 36
- qortimi i, synon njerëzit, 44
- pozitat ose kushtet e, janë tri, 38-39, 58
- Manifestimi universal, 11
- vizionet e, 71
- Martirizimi i Bábí-ve, 8. Shih gjithashtu Provat e sprovat

Mbretëria e Perëndisë, 11, 66

Mendja

është aftësi e shpirtit njerëzor, 55

nuk ka ekzistencë të jashtme, 74

e Parë, 53

Mendja e Parë (Vullneti i Parë), 53

Mëkati, 29

dallimi midis, të mirëve, mëkatarëve dhe të ligjve që janë të ndarë
me perde, 65

lidhja pas botës fizike është, 30

veprat e mira të njerëzve të drejtë janë mëkate të të Afërmëve, 30

Misteret

hyjnore, 30

njeriu bën sondazhe, 48

e qenies ekzistojnë te njeriu, 64

Mjekësia. Shih Shëndeti dhe shërimi

Mjekët, 20, 40

Galeni, 5, 84

gënjimi i të sëmurit nga, 57

Manifestimet janë si, 20, 40

i sëmuri duhet të bindet, 45

Mihdiu, 10

Moisiu, 5

ligji i, anuluar nga Krishti, 6, 20

pasardhës i Abrahamit, 4, 57

qortimi i, që praktikisht synonte Izraelin, 44

Mosqenia. Shih Ekzistenca

Mrekullitë, 22

atribuar Bahá'u'lláh-ut, 9, 10

Bahá'u'lláh-u ofron të bëjë, 9

domethënia e brendshme e, 10

nuk janë prova vendimtare, 10, 22

Muhameti, 7, 11

çifutët mbroheshin nga, 7

fillimi i profetërisë së, u mbajt sekret, 10

fuqia e, 11

të krishterët mbroheshin nga, 7

Kurani (shih Kurani)

Ligji i Perëndisë zbriti mbi, 13

ligjet e, 11

pasardhës i Abrahamit, 4, 57

Pesëlibërshi dhe Ungjilli të shpallur nga, 7

përndjekja e, 7

profecitë që kanë të bëjnë me (shih Profecitë)

profetëria e, si e Moisiut, 11

qortimi i, synonte njerëzit, 44

veprimi ushtarak mbrojtës i, 7

Muhamet Ali Barfurushi, Haxhi Mulla (Kudus), 11, 11 shën.

Muzika, fuqia e, 69

N

Napoleoni i Tretë [Perandor i Francës], 9

Nasiridin Shah (Shah i Persisë), 9, 16 shën.

Natyra, 1. Shih gjithashtu Toka

bashkimi i mashkullit dhe femrës, 17

bota bimore, 15, 36

bota minerale, 15

bota shtazore, 15, 36

ciklet e botës materiale, 14

njeriu mund t'i qëndrojë, 48

Perëndia sundon, 1

trupi i njeriut është rob i, 29

Ndërmjetësimi, 62

Ndikimi shpirtëror mbi gjërat materiale, 69

Ndjesa, 62, 76

Noji, Kanaani nuk ishte pasardhës shpirtëror i, 57

Nusajritë, 81

NJ

Njeriu, 2, 64

aftësitë dhe virtytet e, 15, 84

aftësia për shpikje, 48

- kap realitetet intelektuale, 48, 58
- mund t'i qëndrojnë Natyrës, 48
- pesë aftësitë e brendshme ose shpirtërore, 56
- pesë aftësitë e jashtme, 56
- shfaqen përmes fuqive të Perëndisë, 15
- virtytet janë shpërblime të kësaj jete, 60
- asimilimi nga, është nder për botën shtazore, 15
- dallimet midis të mirëve, mëkatarëve dhe të ligjve që janë të ndarë me perde, 65
- dija e, është dy llojesh, 16
- edukohet nga Manifestimet, 3
- ekzistenca e, 50
 - Adami shkaktoi jetën fizike të, 29
 - është krijuar nga Perëndia, 2
 - jeta e trupit është shkaktuar nga shpirti, 52
 - ka buruar nga Perëndia, 53, 54
 - Krishti shkaktoi jetën shpirtërore të, 29
 - Manifestimi i Përsosur gjithmonë ekziston, 50
 - përbën arsyen e ekzistencës së gjithësisë, 50
 - shumë e lashtë, 41
- evolucioni i, 17, 38, 46-47, 49, 51
- gjendja e
 - dallimet midis, njeriut dhe kafshëve, 48
 - është fundi i papërsosurisë, fillimi i përsosurisë, 64
 - gjithmonë një specie më vete, 47, 49
 - ndryshimet, 20
 - nuk mund të krijojë, 47
 - varësia e, nga Perëndia, 70
- inteligjenca e, 1
- karakteri i (shih Karakteri)
- Perëndia është i pakutueshëm për, 37
- përsosuritë e, 46
 - fitohen duke kaluar përmes kushteve të ekzistencës, 58
 - qortimet e Perëndisë përmes Manifestimeve të Tij, 44
 - shpirti i (shih Shpirti)
 - trup i, mund të jetë i paaftë të pasqyrojë shpirtin, 61
 - vullneti i lirë i, 70

P

Pagabueshmëria, dy lloje të, 45

Pagëzimi, 19-20

 i foshnjave, 20

 i Krishtit, 19

Panteizmi, 82

Papërsosuritë. Shih gjithashtu Përsosuria

 baraz me vdekjen, 29

 janë vuajtje, 75

 kur arrijnë përsosurinë, bëhen të përjetshme, 38

 të qortueshme, 32

Papët, 34, 43

Paqja, vendosja e, 11, 12

Paracaktimi. Shih Fati; Vullneti i lirë

Parajsja, 60, 61

Paraqenia, 28, 37, 53, 80

 Fuqia e Paraqenëshme, 58

 Realiteti i Paraqenëshëm, 59

Pasuria

 moderimi në, 78

Pavli, 20

Pema

 e Bekuar, 11

 e jetës (e mira dhe e keqja), 30

 e Zakumit, 81, 81 shën.

Pendesa, 19

Perandoria Otomane, hëna është simboli i, 13

Perëndia, 37, 45, 62, 80

 afërsia ndaj, është pasuri e botës tjetër, 62

 e ardhmja, dija për, nuk shkakton që ajo të ndodhë, 35

 Bota e, 28, 30, 38

 nuk ka as fillim as fund, 38

 bujaria e, 62

 të buruarit nga, 53-54, 82

 dashuria e

- është fryt i ekzistencës njerëzore, 84
- privimi nga, rezulton në papërsosuri, 84
- zjarri është simbol i, 19
- dita e, 11
- drejtësia e, 62
- Fryma e, 67
- koha është e paqenë për, 28, 38, 39
- Krijuesi ka gjithmonë një krijim, 80
- Ligji i
 - i ndarë në dy pjesë, 11
 - mosnjohja e, është e falshme, 76
 - Jerusalemi i Ri është, 13
 - gruaja si simbol i, 13
- manifestimi i, 54
- Mbretëria e, 11, 67
- Natyra sundohet nga, 1
- ndarja nga, është vuajtja më e madhe, 75
- njeriu varet nga, 70
 - në krijesat është i pamundur, 53, 82
- njëshmëria e
 - dhe koncepti i Trinisë, 27
 - sistemi hyjnor është një, 51
 - Thelbi i Unitetit, 47, 59
 - vendosur prej Abrahamit, 4
- njohja e, nga njeriu
 - baza e shëlbimit, 65
 - lavdia më e madhe e botës njerëzore, 84
 - vetëm përmes Manifestimeve, 37, 59
 - i panjohshëm, 37, 59
- papërsosuritë janë të pamundura te, 37
- paraqenia e, 53
- përsosuritë e, 50
 - shkëlqejnë nga realiteti i njeriut, 50
 - të manifestuara në Realitetin e Krishtit, 54
- provat e ekzistencës së, 2
- u shfaq si shtyllë zjarri, 16
- vë në provë krijesat e Tij, 9

Persia

Báb-i ndriçoi, 8

Bahá'u'lláh-u ndriçoi, 9, 84

dielli është simbol i, 13

kalbëzimi i, 9

rindërtimi i, varet nga mësimet e Bahá'u'lláh-ut, 9

Pëllumbi, simbolizmi i, 16

Përsosuri(të)

çdo shkallë e ekzistencës kërkon, 32

e gjithë krijimit, 46

të gjitha gjërat janë krijuar të përsosura që në fillim, 51

janë pa kufi, 62, 64

e Krishtit, 29

e Manifestimeve të Perëndisë, 3, 27, 27 shën., 45

e shpirtit të njeriut, 36

Njeriu i Përsosur (Përkryer), 27, 27 shën., 45, 50, 59

papërsosuritë dhe, 32, 38

Pitagora, 7

Pjetri, 20, 34, 34 shën.

Planetët, përbërja dhe shpërbërja e, 47. Shih gjithashtu Toka

Platoni, 5, 7, 83

Pleqtë, njëzet e katër, 11

Pranvera, 14, 15, 36, 67

hyjnore, 11

shpirtërore, 14

I Premtuari, 25

Prindërit, fëmijët duhet të luten për ndjesë për, 62

Profecitë, 10. Shih gjithashtu Shpjegime të vargjeve të Biblës

arka e Dhiatës së Tij, 11

dragoi me shtatë krerë, 13

dy Manifestimet që pret bota, 10

engjëlli i shtatë, 11

fatkeqësitë, e para, e dyta dhe e treta, 11

Fryma e së vërtetës do të vijë, 25

grykimi i të vdekurve, 11

Jerusalemi, i Ri, 13

Mbretëria Shpirtërore e Hyjnore do të vendoset, 11

- pleqtë, njëzet e katër, 11
- që kanë të bëjnë me Báb-in
- data e ardhjes, 10, 11, 13
 - fatkeqësia e dytë është shfaqja e, 11
 - të gjitha përputhen me njëra-tjetrën, 13
 - martirizimi i, 11
 - pasardhës i përsosur i lindur nga ligji i Muhametit, 13
- që kanë të bëjnë me Bahá'u'lláh-un
- data e ardhjes, 10
 - degë e dalë ga trungu i Jeseut, 12
 - do të vendosë unitetin, 12
 - fatkeqësia e tretë është shfaqja e, 11
 - Zoti i Ushtrive i manifestuar në Tokën e Shenjtë, 9
- që kanë të bëjnë me Krishtin
- data e ardhjes, 10
 - kthimi, 26
- që kanë të bëjnë me Muhametin, 11
- dy dëshmitarët e veshur me rroba thesi, 11
 - dy pemët e ullirit, 11
 - fatkeqësia e parë është shfaqja e, 11
 - gruaja e veshur me diellin, 13
 - kurorë me dymbëdhjetë yje, 13
- që kanë të bëjnë me Napoleonin e Tretë (Perandor i Francës), 9
- Qyteti i Shenjtë i shkelur me këmbë dyzet e dy muaj, 11
- shpërble ata që i druhen emrit Tënd, 11
- tempulli i Perëndisë i hapur në qiell, 11
- toka do të transformohet, 10
- trupa të vdekur do të qëndrojnë shtrirë në rrugë, 11
- ujku do të rrijë me qengjin, 12
- vetëtima, zëra dhe bubullima, 11
- yjet do të bien në tokë, 26
- Profetët, 43. Shih gjithashtu Manifestimet e Perëndisë
- Provat e sprovat. Shih gjithashtu Martirizimi
- e Bahá'i-ve, 9
 - vuajtja, dy lloje, 75
- Ptolemeu, 81

Q

Qielli. Shih Mbretëria e Perëndisë

Qitapi Akdas (Libri Më i Shenjtë), 12, 45 shën., 65

Qitapi Hejkal, 9

Qitapi Ikan, 26, 26 shën., 81

Qyteti i Shenjtë, domethënia e, 11, 13

Qytetërimi

 i Izraelit, 5

 varet nga edukatorët, 3

R

Ridvani, Festa e, 10 shën.

Ringjallja, 14, 23

Ritrupëzimi, 81

Rumelia, 9

RR

Rrëshajët, 24

S

Sabati, dënimi për shkeljen, 20

Sëmundja. Shih Shëndeti dhe shërimi

Simbolizmi, 16. Shih gjithashtu Shpjegime të vargjeve të Biblës;

 Profecitë

 i Adamit dhe Evës, 30

 i bukës dhe verës, 21, 29, 30

 i dritës është dija, 16

 i errësirës është injoranca, 16

 i gjarprit, 30

 i Jerusalemit (shih Jerusalemi)

 kleri nuk e ka kuptuar, 23

 i pagëzimit, 19

 i pëllumbit, 16

i Qytetit të Shenjtë, 11, 13
 i ringjalljes, 23
 i shurdhësisë, 22
 i ujit është dija dhe jeta, 19
 i të vdekurve, 11, 22, 30
 i verbërisë, 22
 i yjeve që bien në tokë, 26
 i zjarrit, 19
 i zogut në kafaz, 61
 Simoni. Shih Pjetri
 Siria, 11
 Sodoma, 11
 Sokrati, 5
 Sollomoni, 43
 Sufitë, 82
 Sureja e Hejkalit, 9

SH

Shahu i Persisë, Nasiridin Shahu, 9, 16
 I Shenjti i të Shenjtëve, 11
 domethënia simbolike e, 11
 është bërë i dukshëm, 11
 Shëndeti dhe shërimi, 73. Shih gjithashtu Mjekët
 sëmundjet
 janë ngjitëse, 57, 72
 shkaqet e, 73
 trajtimet mjekësore për, 20, 40
 shërimi pa ilaçe, 72
 me anë të dietës, 73
 shpirtëror, 72
 tmerri mund të shkaktojë sëmundje, 72
 Shikimi, 56, 83
 Shkenca
 feja dhe, 34
 përparimi i, 12
 zbulimet e, 36

Shpikja, fuqia e, 36, 48

Shpirtësia

cilësitë e, janë ngjitëse, 57

fuqia trupore është e dobët në krahasim me fuqinë shpirtërore, 30

lindja shpirtërore, 60

Njeriu i Përkryer është si kallami, 11

përsosuritë dhe papërsosuritë, 32

virtutet e njeriut shfaqen përmes fuqisë së Perëndisë, 15

Shpirti (Fryma)

bimor, 36, 55

i kafshës, 36

komunikimi me shpirtrat, 71

Manifestimet kanë shpirt racional, 38, 39

mineral, 15, 64

njerëzor, 36, 37, 38, 48, 55

buron nga Perëndia, 54

është fryma racionale, 55, 58, 66

ka ekzistuar gjithmonë, 51

mendja është aftësi e, 55

nevoja e shfaqjes së, në trupin, 52

nuk është i kufizuar nga vendi ose koha, 67

nuk preket nga peripecitë trupore, 39, 61, 66

pas vdekjes (shih Jeta, pas vdekjes)

pavdekësia e, 60-61, 67

shkakton jetën e trupit, 52

i Perëndisë, 25

pesë kategori të, 36, 55

qiellor, 36

i Shenjtë. Shih Shpirti i Shenjtë

Shpirti i Shenjtë, 25, 27, 36, 38, 83

fuqia shëruese e, 72

jeta e pasosur është dhuratë e, 67

Krishti lindur nga, 6, 17, 29

pranimi ose mospranimi i, 31

zbritja e, 24-25

Shqisat (aftësitë), pesë të brendshme dhe pesë të jashtme, 56

Shtëpia e Drejtësisë, 45, 45 shën.

Shtëpia Universale e Drejtësisë
 pagabueshmëria e, 45, 45 shën.
 Shurdhësia, shpirtërore, 22

T

Tabelat për Mbretërit, 9

Teherani, 9

Teozofia, 81, 82

Toka

bota e rastësishme është burim papërsosurish, 2

evolucioni i, 38, 47, 50, 51

harkimi i, 48

përsosuria e, duhet të jetë pjellore, 15

teoria e materialistëve për formimin e, 17

transformimi i, në këtë cikël, 12

Transmigrimi, 81

Trinia, domethënia e, 27

“Ati është në Birin”, 54

U

Uji është simbol i dijes e i jetës, 19

Umajadët, 11, 13

Uniteti

dashuria për Perëndinë sjell, 84

Mbretëria e, 30

panteizmi, 82

Pragu i, 34

Thelbi i, 47, 59

vendosja e, 12

V

Valí, 9 shën.

Të varfërit, kujdesi për, 78

Vdekja. Shih Jeta, pas vdekjes

Të vdekurit
 domethënia e, 11, 22, 30, 79
 komunikimi me shpirtrat, 71
 Vendagimet. Shih Manifestimet e Perëndisë
 Veprat. Shih Bëmat
 Veprimet e drejta, 84. Shih gjithashtu Bëmat
 Verbëria, shpirtërore, 22
 Vetitë e trashëguara, 57
 E vërteta, 34
 hetimi i, 11
 kërkesat ndaj kërkuesit të, 10
 Vrasja (shih Krimi dhe kriminelët)
 Vuajtja. Shih Provat e sprovat
 Vullneti, 1
 Vullneti i lirë, 70. Shih gjithashtu Fati

Z

Zakumi, pema e, 81, 81 shën.
 Zodiaku, Dielli i Realitetit del nga shenja të ndryshme të, 14
 Zoroastrianizmi, 10
 Zoti i Ushtrive, 10, 11
 Zjarri
 Perëndia u shfaq si shtyllë, 16
 simbol i dashurisë së Perëndisë, 19